


DITURIA ISLAME

400

NUMRI JUBILAR



REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 400 | MARS 2024

“DITURIA ISLAME” QËNDRON
PËRKRAH PËRPEKJEVE TË
POPULLIT PËR ÇLIRIMIN E VENDIT

KURANI – LIBRI MADHËSHTOR
QË ZBRITI NË NJË NATË
MADHËSHTORE

KATEGORITË E NGARKUARA ME
AGJËRIM DHE RASTET QË E JUSTIFI-
KOJNË MOSBAJTJEN E AGJËRIMIT

Urimi i Myftiut Tërnavë për muajin e bekuar Ramazan

Ramazani, zotëria i muajve të tjerë

Muaji i bekuar Ramazan është muaj i veçuar prej Zotit xh.sh. me shumë cilësi dhe virtyte, në të zbritën dhe zbresin mëshira dhe begati të shumta. Zoti xh.sh. i falë mëkatet dhe të këqijat, veprat e mira shumëfishohen, hapen dyert e Xhenetit, mbyllen dyer e Xhehenemit, derisa shejtanët prangosen. Kurani fisnik dhe tradita e Pejgamberit a.s. janë të bollshëm dhe dëshmojnë për atë që ky muaj ka mirësi dhe merita të mëdha.

Me këtë rast dhe në këtë atmosferë hyjnore të ardhjes së këtij muaji të bekuar, ftoj myslimanët shqiptarë e të tjerë brenda Kosovës sonë, brenda trojeve etnike shqiptare, por edhe në mërgatën e largët që t'i përkushtohen me bindje, adhurim, sinqeritet, lidhje familjare, me shtrirje të dorës së ndihmës ndaj të varfërve dhe nevojtarëve, si dhe të refuzojnë të gjitha format e ndarjes dhe dallimeve, duke thirrur në forcimin e unitetit dhe vëllazërisë ndërmjet vete.

Lutemi që i Plotfuqishmi të na e pranojë agjërimin dhe lutjet tona, t'i japë kombit e fesë sonë siguri e stabilitet, duke kërkuar prej Zotit xh.sh. që të ndalen konfliktet dhe luftërat dhe që të marrë fund gjakderdhja ndërmjet njerëzve pa dallim besimi, feje, race, ngjyre a gjuhe.

Ky muaj është muaj i bekuar, është zotëria i muajve të tjerë, është i veçantë për myslimanët dhe ka një status të veçantë për dallim nga muajt e tjerë të vitit. Në këtë muaj, më saktësisht në Natën e Kadrit, u shpall Kurani. Është muaji i agjërimin, e që agjërimi është një nga shtyllat e Islamit, ku besimtarët, gjatë ditës abstenojnë nga ushqimi dhe pija, dhe qëndrojnë larg gjërave të ndaluara nga agimi e deri në perëndim të diellit.

Myftiu i Kosovës
Naim ef. Tërnavë



EDITORIAL

- 4 Manifestimi i jubileut të "Diturisë" në muajin e mirësisë

JUBILE

- 5 "Dituria Islame" qëndroi përkrah përpjekjeve të popullit për çlirimin e vendit
Myftiu Naim ef. Tërnavë
- 20 Sherif ef. Ahmeti – personalitet kulturor kosovar
Granit Sadiku

FETARË

- 24 Ripërtëritja e besimit dhe raporteve ndërnjerezore në Ramazan
Dr. Bahri Hoxha
- 27 Devotshmëria e ridefinuar
Evzal Sinani
- 30 Kategoritë e ngarkuara me agjërim dhe rastet që e justifikojnë mosmbajtjen e agjërimin
Bashkim Aliu
- 35 Dispozita e agjërimin të shtatzënës dhe gjdhënësës dhe mënyra e kompensimit të tij
Dr. Ilmije Kuqi
- 38 Ç`është e urryer për agjëruesin?
Vehbi Sylejman Gavoqi[†]
- 40 Historiku i agjërimin te popujt e tjerë dhe specifikat e agjërimin Islam
Mr. Sead Paqarizi
- 44 Një ditë e Muhamedit a.s. në Ramazan
Mr. Rashit Zylfu
- 47 Kurani – libri madhështor që zbriti në një natë madhështore
Prof. dr. ass. Lulzim Esati
- 50 Dita, që nuk qe si ditët e tjera
Blerim Musliu



- 52 Koncepti i zekatit në Kuran
Akademik Enes Kariq
- 55 Sadakatul fitri
Mr. Fitim Gashi
- 58 Kuptimi i hadithit në dritën e Sunetit
Dr. Muhamed Stublla

KULTURË

- 62 Ramazani në "Diturinë Islame" – përmbledhje bibliografike
Dr. Sedat Islami
- 68 Pritja e muajit të bekuar Ramazan në Toronto të Kanadasë
Mr. Adnan Berbatovci
- 70 Hëna - simbol i fesë islame apo jo?
Njomza Sadriu
- 72 Si arritën dijetarët myslimanë ta ruanin pavarësinë e tyre prej pushtetarëve?
Muhamed el Sijad

HISTORI & CIVILIZIM


- 75 Kandilat e Ramazanit në xhamitë e Kosovës sipas vakëfnameve
Dr. Besir Neziri

PERSONALITETE

- 78 Mulla Sejdiu dhe Ur`e Vezirit në Shkodër¹
Akademik Feti Mehdiu
- 81 Në kujtim të orientalistit të parë shqiptar, Tahir Dizdarit
Muhamed Arnaut
- 84 Kontributi i Taki el Dinit (Takijjeddin) (1526 – 1585) në zhvillimin e shkencave
M.sc Artan S. Mehmeti

AKTIVITETE

- 95 Myftiu priti në takim anëtarin e Parlamentit të Britanisë së Madhe, znj. Bruce



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore
Nr. 400 • viti 37 • Mars 2024
• Sha'ban / Ramazan 1445
• çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnavë,
Mr. Vedat Shabani.
Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net
Shtypi:
"NTG", Blendi

Manifestimi i jubileut të “Diturisë” në muajin e mirësisë



*“Allahu e ndriçoftë
fytyrën e atij njeriu që
ka dëgjuar fjalën time,
dhe e ka përcjellë atë
te të tjerët (besnikërisht)
ashtu siç e ka dëgjuar...”*

(Muhamedi, a.s.)

Tani, kur muaji i bekuar Ramazan ka hedhur shkëndijat vezulluese në horizontet tona, dhe puhiza e lehtë e mirësive të tij nuhatet kudo, penëdashësit e islamistikës shqipe në veçanti, dhe besimtarët në përgjithësi, i gëzohen edhe arritjeve të shënuara të kësaj reviste në të cilën po përvijojmë mesazhet universale të fesë së vërtetë.

Koincidencë e mahnitshme duket kjo, por ja që tribuna mbarëshqiptare e fjalës së shkruar shqipe – revista “Dituria Islame” në vitin e 38-të të jetës së saj, po shënon numrin e vet jubilar, të 400-tin me radhë, mu në këtë muaj të mirësisë së madhe. Quajeni si të doni, por themelimi, e edhe mbijetesa e saj gjerë më sot, është një dhunti e shkruar nga Zoti ynë, që nga ne me përlulësi, Ai duhet falënderuar.

Ky zë që mori barrën e çlirimit të ndërgjegjes shqiptare nga mynxyra e monizmit të ngjizur me ateizmin dehumanizues, sikur dikur, edhe sot, përçon guximshëm mesazhin se, errësira, pavarësisht “triumfit” të përkohshëm që mund ta shënojë, ajo, përfundimisht s’mund ta mposhtë dritën. Thënë troç, përballë sprovës shpeshherë tunduese, për të heshtur apo për ta thënë të vërtetën, ky fanar ndriçues zgjodhi të dytën pa asnjë hamendësim.

Kjo revistë, ishte ajo që mori rolin e dëshmitarit më besnik dhe të rrëfyesit më objektiv të të gjitha atyre ngjarjeve tronditëse që po kalonte populli shqiptar i Kosovës, në periudhat më sfiduese të historisë së vet bashkëkohore. Veç kësaj, me lapsat e saj të patrembur po përmbysen guximshëm rrëfimi i mbrapsht për historinë tonë kombëtare që sajohej mizorisht nga armiq të tanë.

Për katër decenie me radhë, “Dituria” u bë minberi më i zëshëm fetaro-kombëtar, ngase s’di njeriu çëmër tjetër më të denjë se ky t’i vë, asaj që në fletat e saja pranoi të hedhë bojën e penës së krejt atyre njerëzve që aspiratën për liri e besimin në Zot e kishin ngjizur në shpirt, për ta lënë pastaj edhe si amanet të shtrenjtë për të gjithë brezat e së ardhmes.

“Dituria Islame” u bë tejet bujare, nga kur mori barrën që krushqve të dasmës së lirisë sonë t’ua mbante të gjallë aspiratën për çlirim, dhe ëndrrën për pavarësi në sytë tanë ta pasqyronte si të mundshme e si realitet. E zezë mbi të bardhë duhet gjithnjë të shkruhet se kjo tribunë përbrendësoi si më së miri projektin kombëtar shqiptar, dhe e bëri atë pjesë të vizionit të kristaltë të saj.

Më të lumtur se kushdo tjetër, me sukseset e kësaj reviste në këtë jubilar të çmuar, ndihet vargu i gjatë i atyre njerëzve që morën mundin që të hedhin në faqet e saj interpretime e komentet e kulluara shkencore rreth shpalljes së fundit hyjnore – Kuranit dhe Sunetit profetik. Të gjithë ata kanë të drejtë të mburren, sepse emrat e tyre mbase listohen si një hallkë e pashkëputur e atyre që Muhamedi a.s. për ta tha: “Allahu e ndriçoftë fytyrën e atij njeriu që ka dëgjuar fjalën time, dhe e ka përcjellë atë te të tjerët (besnikërisht) ashtu siç e ka dëgjuar...” (Termidhiu, Ibën Maxheh, e të tjerë). Fytyrëndritur kanë qenë dhe do të mbesin, sepse fjalët e njeriut më besnik, i përcollën te shoqëria shqiptare me konsekuencë e besnikëri.

Në vigjilje të muajit Ramazan, “Dituria Islame”, duke qenë zëri më kumbues i Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës dhe i kauzës shqiptare në përgjithësi, hedh në dritë numrin e saj jubilar, sikur për të shprehur mirënjohjen e përzemërt për të gjithë ata besimtarë që besuan në mesazhin e dëlirë të saj. Përtej kësaj, edhe për të thënë se tërë atë përkrahje morale e materiale që ju e bëtë, e vazhdoni ta bëni edhe më tej me sadakatë e zekatin tuaj, shpagimin e saj, përpos se tek Allahu në Botën e Përtejme, do e gjeni edhe këtu brenda shkronjave, mesazheve dhe fletave të pavdekshme të saj.

Ju që besuat dhe shpresuat se guximi për të thënë të vërtetën lënë gjurmë të pashlyeshme në faqet e historisë, mos harroni se “Dituria Islame” është njëra prej provave e dëshmive më të forta që besnikërisht e dëshmon atë.

Në fund, ajo që e pret dhe që duhet bërë në të ardhmen kjo revistë, nuk është as më pak në vlerë e as më pak fisnike se sa detyra që ajo ka kryer me pietet deri më sot. Ajo, në ndonjë linjë tjetër, as nuk duhet e as nuk guxon të hapërojë!

Zot i Madh, te bujaria Jote ndihmë e sukses kërkujmë!

“Dituria Islame” qëndroi përkrah përpjekjeve të popullit për çlirimin e vendit

Myftiu Naim ef. Tërnavë

Revista “Dituria Islame” që nga koha e themelimit të saj, më 1986, e deri më sot, nuk mundi asesi t’i shmangej në asnjë çast kontekstit dhe rrethanave historike me të cilën lindi. Ajo, përgjatë rrugëtimit të saj gati prej katër dekadash barti me vete gjendjen e rrethanave dhe përthyerjet sociale, historike, fetare, arsimore e ideologjike të shqiptarëve. Ajo ishte dhe mbeti revista më e madhe dhe më e përhapur islame brenda audiencës shqiptare, me reputacionin dhe

ndikimin më të madh edhe sot. Revista “Dituria Islame” zë një pozitë të spikatur brenda shtypit islam, përkundër botimit të revistave të tjera brenda hapësirës shqiptare.

Botimi i revistës “Dituria Islame” dhe 400 numrat e saj që janë botuar deri më sot nga Bashkësia Islame e Kosovës, në vazhdimësi bënë përpjekje të identifikojnë, të vlerësojnë dhe t’u japin vendin e merituar arritjeve, por edhe preokupimeve të besimtarëve tanë. Revista krijoi një tingull të jashtëzakonshëm, një aktivitet të përhapur dhe një ndryshim në opinionin e mendim. Ajo brenda një kohe të shkurtër përjetoi një vlerësim të jashtëzakonshëm nga ana e lexuesve të saj. Pas kësaj reviste nuk qëndronin institucionet shtetërore, në botimin, financimin dhe redaktimin e saj, por qëndronte Bashkësia Islame, e cila me gjithë vështirësitë me të cilat ballafaqohej, përmes kësaj reviste paraqiste gjendjen reale të shqiptarëve në Kosovë e në vendet e tjera shqiptare, në rajon dhe në mërgatën shqiptare, si në aspektin fetar, ashtu edhe në atë kombëtar.

Temat të cilat janë botuar në revistën “Dituria Islame” nuk janë vetëm të një natyre. Ato përfshinë njohuri e tema të shkencave të shumta e të ndryshme, duke filluar nga interpretimi i Kuranit, çështjet të cilat kanë të bëjnë me besimin, artikuj shoqëror e historik, të jurisprudencës islame,

*“Dhe thuaj:
Punoni, se
Allahu, i
Dërguari i Tij
dhe besimtarët
do ta shohin
punën tuaj.”*

(Et Tevbe, 105).



hadith, e rubrika për aktivitetet, lajmet, opinionet e traditës e të kulturës sonë kombëtare. Ajo nuk u kufizua vetëm në çështjet apo kërkimet fetare, por botoi artikuj mbi ligjet universale, mjekësinë dhe shëndetin, e një rëndësi i kushtoi edhe letërsisë, poezisë, kërkimeve gjuhësore etj..

Përveç këtyre, temat në këtë revistë përfshinin edhe mendimin e avancuar që kishte të bënte me reformat për mënyrën e shpjegimit të fesë, luftimin e herezive dhe besëtytnive në shoqëri, përhapjen e mendimit të saktë dhe avancimin e ndjenjës së pastër karshi mësimave të fesë sonë islame. Revista jonë, me materialin që përmbante në veten e saj, kishte për qëllim edukimin dhe vetëdijesimin e drejtë në veçanti të rinisë sonë, ngase ky ishte thelbi i thirrjes së Muhamedit a.s.. "Dituria Islame" qëndroi përkrah përpjekjeve të popullit për çlirimin e vendit. Përmes shkrimeve të shumta, në vazhdimësi botoi tema dhe bëri thirrje për rizgjim të ndjenjës kombëtare të masa e gjerë e popullit për çlirimin dhe pavarësinë e vendit, për ndihmën e popullatës dhe mbështetjen e UÇK-së nga masa e gjerë e popullit.

Nisur nga këto parime dhe qëllime që kishte redaksia dhe përmbajtja e kësaj reviste, ajo, nga shoqëria islame shqiptare u prit jashtëzakonisht mirë, falë përmbajtjes së temave që shtjelloheshin, qëllimit, gatishmërisë, kujdesit, por edhe guximit, duke u marrë kështu me tema që kishin të bënin me gjendjen e përgjithshme të okupimit tonë nga Serbia dhe përpjekjes sonë për liri. Interesimi për revistën tonë rritej dita-ditës. Abonentët e saj u shtuan dhe revista u përhap gjithandej, u shtri nëpër të gjitha vendet shqiptare, duke fituar kështu përkrahës dhe admirues të shumtë. Andaj, me të drejtë mund të themi se "Dituria Islame" u bë shkollë e mendimit nëpër këto vende. Me kalimin e kohës, ajo u bë model për shumë revista të mëvonshme, të cilat do ta ndiqnin rrugën e ndritshme të revistës "Dituria Islame".

Me përgjegjësi të plotë, them se vazhdimi i pandërprerë i botimit të revistës "Dituria Islame" nuk ishte një çështje e lehtë. Ajo u përballë me shumë vështirësi, kriza financiare, sule të vazhdueshme nga kundërshtarët e Islamit, mirëpo, vendosmëria për të qenë të durueshëm, të palëkundur dhe të gatshëm për përballje me kundërshtarët e Islamit, na

"Dituria Islame" qëndroi përkrah përpjekjeve të popullit për çlirimin e vendit. Përmes shkrimeve të shumta, në vazhdimësi botoi tema dhe bëri thirrje për rizgjim të ndjenjës kombëtare të masa e gjerë e popullit për çlirimin dhe pavarësinë e vendit, për ndihmën e popullatës dhe mbështetjen e UÇK-së nga masa e gjerë e popullit.

mundësoi që ta përballojmë çdo krizë dhe çdo sfidë.

Përveç llojllojshmërisë në fusha dhe tema, përmbajtja e revistës shërbeu edhe për të konfirmuar kërkesën publike të lexuesve tanë, atë të rritjes së kërkesës për t'u pajisur me të gjithë numrat e kësaj reviste.

Që nga botimi i numrit të parë, revista jonë është fokusuar në përhapjen e besimit, kulturës dhe shkencës të lexuesit e shtresave – kategorive të ndryshme. Politika redaktuese e editoriale e revistës ka adaptuar gjuhë të kuptueshme dhe kombinim të tekstit tërheqës me përdorimin e imazheve të afërta me realitetin, për të pasqyruar një mendim shumë të qartë dhe të pasur të kulturës shqiptare islame. Ajo prezantoi mendime të ndryshme me qëllim të konsolidimit të vlerave të dialogut e të llojllojshmërisë. Revista jonë gjithashtu adaptoi një qasje shumë të moderuar për trajtimin e çështjeve fetare, intelektuale e kulturore, si dhe u angazhua që përmes shpërndarjes dha avancimit të mësimave të mirëfillta islame e shkencore, të përballë me të menduarit joshkencor, ekstrem dhe atij radikal fetar, si dhe me intolerancën e mundshme.

Bashkësia Islame e Kosovës dhe redaksitë e revistës "Dituria Islame", në përmbajtjen e materialit që kishin temat e shtjelluara të kësaj reviste, e kishin në vazhdimësi qëllimin e rrugëtimit të drejtë të ambicieve për ta bërë revistën një degë të njohurive apo mësimave fetare islame, të shkencës dhe të dijeve, nga e cila mund të nxjerrin dhe të marrin të gjithë studiuesit dhe ata që janë të interesuar.

Së fundi, dua të falënderoj të gjithë ata që kontribuan në themelimin e kësaj reviste, ruajtjen dhe përkujdesjen rreth përmbajtjes dhe botimit të këtyre 400 numrave pandërprerë. Me këtë rast, duhet të rikujtojmë të gjithë kryeredaktorët, anëtarët e redaksive për përpjekjet, interesimin dhe kujdesin e tyre për t'u botuar dhe forcuar fetarisht e shkencërisht revista, duke dëshmuar integritetin e saj, duke shtrirë ndikimin dhe përhapjen e saj, si dhe duke tërhequr studiues të shumë të fushave të shumta në universitete e institucione të ndryshme, ashtu që revista të mbetet inkubatori fetar e shkencor për kërkime të vazhdueshme.

Jubileu që kujton të kaluarën e lavdishme

Jubile që na bënë krenarë!




Me rastin e numrit jubilar të 400-të të revistës “Dituria Islame”, sot i kujtoj me mburrje e krenari vitet kur Bashkësia Islame e Kosovës po luante një rol të rëndësishëm për shqiptarët dhe po korrtte suksese të çmueshme.

Edhe pse në kohë shumë të vështira, atëbotë ne arritëm të botojmë dy përkthimet e Kuranit në

gjuhën shqipe, arritëm të konkretizojmë ndërtimin e godinës prestigjioze të Medresesë, e në vitin 1986, hodhëm në dritë edhe “Diturinë Islame”. Si themelues dhe kryeredaktori i parë i saj, pa hezitim them se ishte një hap i madh i Bashkësisë Islame të atëhershme. Kështu që, kur Serbia mbylli “Rilindjen”, “Dituria Islame” do të botohej në dhjetëra mijë ekzemplarë dhe do të shërbente si organi e vetëm informativ i shqiptarëve jo vetëm në Kosovë.

Më vjen mirë që “Dituria Islame” i mbijetoi kohës ku edhe sot e kësaj dite po kryen misionin e saj të shenjtë. I dëshiroj suksese revistës dhe punonjësve të saj! “Dituria Islame” duhet të vazhdojë edhe më tutje si një fanar ndriçues dhe hapësirë për studime, analiza dhe shkrime islame. Shqiptarët kanë nevojë shumë për “Diturinë Islame”.

Haxhi Jetish ef. Bajrami



Shumë revista shkencore dhe fetare në trojet shqiptare, në fillimet e tyre, kanë pasur synime ambicioze, që ndoshta të arrijnë të botojnë një numër të caktuar, si f.v. 100 apo 200 numra, por që kjo shifër të arrijë në një numër kaq jubilar, të 400, kjo sdo mend se është jo vetëm jubile historik, por një e arritur e madhe historike e

publicistikës islame në të gjitha trojet shqiptare.

I gjithë ky suksese, është arritur falë angazhimit të të gjitha strukturave të BIK-ut që kur e themeluan këtë revistë që tashmë është pjesë e pandashme e identitetit tonë edhe fetar, edhe kombëtar. Por mbi të gjitha, atë e rritën, studiuesit, shkencëtarët e profileve të ndryshme, hoxhallarët dhe entuziastët, të cilët kurrë nuk u ndalën së shkruari, për ta ngritur revistën tonë “Dituria Islame” deri në këto maja kulmore të profesionalizmit, në shumë segmente.

Sot, nga retrospektiva e gjithë këtyre viteve, kur kujtojmë të gjitha vështirësitë me të cilat jemi ballafaquar si ish-kryeredaktorë të saj, ndihem shumë krenar që isha pjesë e kësaj historie dhe e këtij rrugëtimi të lavdishëm të revistës “Dituria Islame”, dhe atë në kohërat mbase më të vështira për popullin dhe vendin tonë.

Ndoshta nuk është e tepërt ta ritheksoj edhe njëherë shkurtimisht fjalën time si kryeredaktor me rastin e numrit të 100-të jubilar, ku ndër të tjera pata theksuar: “Sot, kur po

festojmë numrin e 100-të jubilar të "Diturisë Islame", e ndiejmë veten krenarë që kemi arritur të afirmojmë një revistë vërtetë serioze, me qasje të mirëfillta ndaj Islamit. Nëse duam një themel të shëndoshë kombëtar, natyrisht se do të na duhet të ngremë edhe edukatën tonë morale e shpirtërore. Dhe, nëse i vëmë një gur këndor fesë, kemi ngritur një kështjellë të fortë mbi muranat e ngrahinës kombëtare. Nëse dëshirojmë që mosha e njomë të rritet edhe me moral të shëndoshë, duhet t'i ofrojmë asaj gjëra të mira të shkruara."

Pikërisht kjo moto, e ka përcjellë revistën tonë më prestigjioze gjatë këtij rrugëtimi tashmë 38-vjeçar, dhe mendoj se ia kemi dalë në përpjekjet tona për ta përcjellë këtë mesazh te pjesa më e madhe e popullatës, sepse ishim dëshmitarë të historisë, e cila shënoi këtë rrugëtim të shenjtë. Revista jonë, ashtu si edhe krejt Bashkësia Islame e Kosovës, ishte në ballë të vlimeve historike, gjithnjë duke gërshetuar ndjenjën fetare me atë kombëtare, dhe mendoj se edhe ne kemi hedhur një gur të fortë themeltar në shtet ndërtimin e atdheut tonë Kosovës.


Uroj që kjo reviste të vazhdojë suksesshëm drejt sukseseve të reja! Dhashë Zoti ta përjetojmë pas ca vitesh edhe numrin e saj të 500, e pastaj edhe më tutje, duke iu përshtatur rrethanave të reja në epokën globale të internetit, ku informacioni i shpejtë është parësori, por mbi të gjitha përcjellja e mesazheve të pastra islame te gjeneratat e reja, duke i mbrojtur ata nga rreziqet e ideologjive që për qëllim kanë degradimin e shoqërisë njerëzore.

Suksese dhe krenar me të gjithë ata që ishin pjesë e kësaj historie!

Sabri Bajgora



"Dituria Islame" vazhdon me misionin e saj të shenjtë



Kam nderin, kënaqësinë dhe privilegjin që me pak fjalë të tregoj disa kujtime të mia në cilësinë e ish-kryeredaktorit të revistës sonë dhe tuaj, e cila po hapëron drejt dekadës së katërt të daljes së saj, duke përmbushur misionin të cilin e ka marrë dhe duke arritur numrin jubilar 400. Jubiletë

si ky na rikujtojnë rrugëtimin dhe rrethanat në të cilat ka kaluar kjo revistë, angazhimet e bëra, arritjet, vështirësitë dhe sfidat.

Tashmë s'ka dyshim që revista "Dituria Islame" paraqet një vlerë të rëndësishme të shoqërisë sonë në përgjithësi, dhe në veçanti të Bl-së së Kosovës dhe besimtarëve tanë të respektuar.

Revista "Dituria Islame" po shënon këtë jubile duke përmbushur misionin e saj, edhe pse rrugëtimi i saj nuk ishte i lehtë kur kemi parasysh kohën kur filloi dalja e saj, sistemi komunist, pastaj zhvillimet e mëvonshme, lufta çlirimtare nga okupatori serb, pastaj faza e shtetndërtimit e deri në ditët e sotme. Por, pavarësisht këtyre sfidave, ajo edhe sot, vazhdon të luaj rolin e tribunit dhe zërit islam shqiptar dhe jo vetëm.

Vërtet ishte nder, kënaqësi, privilegj, por edhe përgjegjësi që të jem në krye të redaksisë së kësaj reviste për dy mandate (2000-2004), kjo periudhë e pasluftës, kur

Kosova doli e shkatërruar nga lufta, kur shumëçka filloi nga zero, por falë vullnetit, gatishmërisë dhe mbështetjes së vazhdueshme të Bashkësisë Islame dhe kolegëve, bashkëpunëtorëve, e në veçanti lexuesit tonë shumë të diciplinueshëm, ia arritëm qëllimit.

Ishte faza kur revista u profilizua në format në të cilat vazhdon edhe sot e tutje me tema dhe rubrika të rregullta nga feja, kultura, historia dhe shkenca të tjera të ndryshme. Vlen të theksohet se gjatë mandatit katër vjeçar sa isha në krye të revistës, falë Zotit, pastaj bashkëpunëtorëve dhe para së gjithash lexuesve, kemi arritur që me sukses dhe në kohë ta nxjerrim revistën. Ka qenë një organizim dhe angazhim i përbashkët duke mos kursyer as kohë e as mund që revista të jetë sa ma cilësore dhe e pranueshme për lexuesin.

Dhe krejt në fund, një përshëndetje e veçantë për lexuesin e respektuar të "Diturisë Islame", me porosinë që të vazhdojnë ta lexojnë, mbështesin dhe ndihmojnë në forma të ndryshme, kurse redaksisë aktuale i dëshiroj suksese dhe punë të mbarë në këtë mision të shenjtë dhe me përgjegjësi duke e lutur Allahun xh.sh. që t'u ndihmojë në realizimin përgjegjësive të marra!

Ahmet Sadriu



“Dituria Islame” – pjesë e jetës



“Dituria Islame”, revistë e jona, që ekzistenca e saj na ka ushqyer me informata të dobishme rreth fesë islame e më gjerë. Si një ish-kryeredaktor i saj për dy mandate, gjatë periudhës 2004-2009, nga numri 176 deri në numrin 223, bëmë përpjekjet tona të mëdha që revistën tonë ta bëjmë të

lexueshme e të dobishme, duke prekur kështu tema të ndryshme, që nga temat e aktualitetit të atëhershëm fetar e kombëtar, e për të vazhduar reflektimin mbi sfidat bashkëkohore me të cilat përballej në atë kohë komuniteti mysliman.

Revista ka pasur dhe vazhdon të ketë një linjë redaksionale të kualitetit më të lartë, të përqendruar në kualitetin e lartë të shkrimeve dhe analizave, duke sjellë kështu kontributet e shkencëtarëve të njohur myslimanë dhe të shkrimtarëve të talentuar, shkrimet e të cilëve kanë intensifikuar përpjekjet e revistës për të ndërgjegjësuar komunitetin ndaj vlerave islame. Revista gjithashtu ka promovuar dialogun ndërfaqet dhe ka shpalosur vlerat e tolerancës dhe mirëkuptimit. Ndërthurja e temave të shumta e të thella në përmbajtjen fetare e kombëtare me çështjet e aktualitetit, ka bërë që “Dituria Islame” të jetë një burim informacioni për Kosovë, Shqipëri e më gjerë.


Duke u ndalur pak më gjatë në periudhën time si kryeredaktor, kemi arritur të bashkëpunojmë me shkrimtarë, studiues e personalitete të ndryshme, duke e bërë revistën më tërheqëse dhe më të vlerësuar në trojet tona e më gjerë. Njëkohësisht ne kemi siguruar që revista jonë të ofrojë artikuj të cilësisë së lartë, gjë që ka ndikuar në rritjen e besueshmërisë ndaj revistës. Gjatë periudhës 2004-2009, u shtypën 47 numra dhe kishim fatin të kishim edhe disa data e numra me shumë vlerë e rëndësi, si për mua, ashtu edhe për revistën, si p.sh. jubileun e 200 të revistës "Dituria Islame" në muajin mars 2007, si dhe njërën ndër datat më të rëndësishme të historisë së Kosovës, pra shpalljen e pavarësisë në shkurt 2008, ku po në të njëjtin muaj u shtyp edhe numri 211 i revistës.

Kjo është një mundësi shumë e mirë që ta shfrytëzoj rastin e t'i falënderoj të gjithë ata bashkëpunëtorë të palodhshëm, që falë tyre ishim dëshmitarë të ngritjes së pandalshme të revistës "Dituria Islame". Shpresojmë që rritja dhe zhvillimi i revistës "Dituria Islame", do të vazhdojë edhe për shumë vite të tjera me suksese të mëtutjeshme! Në fund, kujtojmë një ajet kuranor, në të cilin Allahu xh.sh. na drejtohet e na siguron se për çdo të mirë që ne e bëjmë na pret e mira. "Kushdo që ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë." (El Zelzele, 7).

Bahri Simnica



Revista "Dituria Islame", promovuese e mendimit dhe vlerave Islame



Revista "Dituria Islame" mbetet dëshmi e shkruar, që me krenari po shënon historinë në Kosovë dhe jo vetëm. Ajo është memoria kolektive, e cila ruan hapat e zhvillimit, ruajtjes dhe përcjelljes së frymës së pastër islame, ashtu siç na mësojnë tekstet fetare nga dy burimet e

pashtershme, Kuranit dhe Sunetit të Muhamedit a.s..

Në qershor të këtij viti, ajo shënon përvjetorin e 38-të të daljes së saj, dhe ja, sot, me gëzim e krenari arritëm ta presim numrin e 400-jubilar. Ishte krenari dhe përgjegjësi që isha kryeredaktor i saj për tri mandate, nga vitet 2009-2016, ku edhe pata fatin që si kryeredaktor, ta shënojmë edhe numrin jubilar të 300-të të daljes së saj, pra në vitin 2015. Në atë përvjetor të rëndësishëm, unë në cilësinë e kryeredaktorit të saj pata shkruar editorialin "Dituria Islame", *promotore e vlerave fetare dhe kombëtare*, ku pata shkruar se revista tashmë është bërë pjesë e çdo familje kosovare dhe më gjerë, duke u bërë e dashur me lexueshmërinë më të larë nga të gjithë brezat. E udhëhequr nga realiteti, guximi dhe prosperiteti, me këtë kreativitet tejet të rezonuar, revista qëndron krenare, ballëhapur dhe bujare karshi lexuesve të saj të shumtë. Unë gjej rastin t'i falënderoj që të gjithë bashkëpunëtorët që hapëruam në ato vite të pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës më 2008, që në vendin tonë u krijua një realitet i ri, dhe që edhe për revistën sollën risi të shumta.

Me përkrahjen e Myftiut të nderuar, Naim ef. Tërnavë dhe bashkëpunëtorëve tanë, "Dituria Islame" për herë të parë kaloi nga shtypi bardh e zi në atë kolor, pra ishte nr. 228-229 i muajit Ramazan, korrik-gusht i vitit 2009, që vlerësoj se ishte nevojë dhe domosdoshmëri e kohës, që lexuesi i ka edhe mund t'i shfletoj faqet e revistës së atyre viteve.

Revista arriti që të ofrojë rreth vetes shumë intelektualë e personalitete nga jeta politike, fetare etj., të kohërave dhe sferave të ndryshme, duke iu krijuar hapësirë të shprehin idetë, mendimet e tyre për shumë problematika të shumë çështjeve, qofshin fetare, shkencore, edukative, kulturore, identitare, historike etj..

Jo vetëm që i mbijetoi kohës, por revista jonë, arriti të jetë bartëse e proceseve më të rëndësishme në të cilat ka kaluar Kosova dhe çështja kombëtare shqiptare. Deri sot, meritat janë për të gjithë ata punonjës që kanë dhënë kontribut shumë të çmuar duke dhënë mundin dhe talentin e tyre nëpërmjet artikujve shkencor që revista mos të pauzoi apo ruana Zot edhe mos të shohë dritën e botimit të saj dhe thjesht bëri edhe historinë si revista mujore më jetëgjatë në trojet shqiptare. Është krenaria dhe pasuria e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe popullit të Kosovës në fushën e publicistikës islame.

Ajo do të mbetet bartëse e amanetit dhe frymëzuese e artikullimit dhe mendimit dhe edukimin islam, zhvillimit dhe formësimit të gjeneratave të reja në frymën e islamit burimor.

Shpresojmë që kjo frymë intelektuale të mbahet gjallë duke pasuruar dhe begatuar faqet e rubrikat e saj në synim të avancimit të frymës së mendimit islam burimor. Në këtë përvjetor shumë nga ata që kontribuan në daljen e kësaj reviste, kanë kaluar në botën tjetër, andaj lusim Allahu xh.sh., që t'i shpërblejë me të mirat e Tij. Revistës i dëshirojmë suksese edhe më të mëdha drejt realizimit të synimeve të saj! Do ta përfundoja me një ajet kuranor, që është frymëzim për të gjithë ne, ku i Lartësuar i drejtohet duke na thënë: "Dhe thuaj: "Veproni, Allahu do ta shohë veprën tuaj, edhe i Dërguari i Tij e besimtarët, e vonë do të ktheheni te njohësi i së fshehës dhe të dukshmes, e do t'ju njoftojë për atë që vepruat." (Et Tevbe, 105).

Dr. Rexhep Suma

Me rastin e numrit jubilar të 400-të të revistës "Dituria Islame"



Marrja e vendimit për fillimin e botimit të revistës "Dituria Islame" ishte një hap i guximshëm për kuptimin e përgjegjesisë dhe barrës së institucionit të Bashkësisë Islame në ruajtjen dhe promovimin e vlerave islame edhe përmes fjalës së shkruar.

Revista "Dituria Islame" shënon fillimin e një tradite të rëndësishme mediatike të shtypit islam në gjuhën shqipe. Gjatë 400 numrave, "Dituria Islame" ka fituar një reputacion si një nga mediat e shkruara më të rëndësishme islame në gjithë trojet shqiptare. Misioni i saj është promovimi i vlerave islame universale nëpërmjet shkrimeve autoriale dhe të përkthyer nga autorë të ndryshëm nga shumë vende të botës.

Emërtimi "Dituria Islame" tregon qartë qëllimin sublim të saj që, përmes arsimimit dhe leximit të vazhdueshëm, ta bëjmë individin dhe shoqërinë më të avancuar në përputhje me kërkesat e kohës në frymën e porosive kuranore. Përmirësimi është i mundur vetëm nëse përpiqemi për ta fisnikëruar veten dhe për ta bërë shoqërinë më të mirë.

"Dituria Islame", qysh nga numri i saj i parë i vuri vetës për mision vetëdijesimit dhe emancipimin e besimtarëve dhe kontinuiteti i saj prej disa dekadash në skenën mediatike dëshmon për rëndësinë dhe ndikimin që ka ajo. Duke pasur parasysh sfidat me të cilat përballen mediat e shkruara në mbarë botën, dhe faktin që sot ato nuk kanë rolin që kishin dikur, megjithatë është për t'u përshëndetur që revista "Dituria Islame" vijon misionin e saj me shkrime cilësore dhe

vazhdon të frymëzoj ndryshime pozitive në shoqëri veçmas te lexuesit e saj.

Përkundër sfidave, "Dituria Islame" vazhdon të ketë lexues besnik brenda dhe jashtë vendit dhe duhet të punohet që ajo të jetë edhe në formë digjitale që të jetë e qasshme në të gjitha kontinentet.

Shkrimet në revistën "Dituria Islame" përfaqësojnë një përpjekje për ta parë Islamin si zgjidhje në mënyrë perspektive, përmes autorëve dhe bashkëpunëtorëve, me tema dhe çështje që konsiderohen të rëndësishme për kohën në të cilën jetojmë.

Autorët përpunohen të ofrojnë përgjigje për sfidat bashkëkohore me të cilat përballen myslimanët dhe udhëzime që ata të ndërtojnë një jetë cilësore, bazuar në mësimet islame.

Në revistën "Dituria Islame" është respektuar tradita, dhe në faqet e saj kanë zënë vend trajtesa nga lëmi i tefsirit, të drejtës islame, shkollave juridike e akaidologjike, jurisprudencës islame, hadithit, etikes islame, simpoziumeve dhe konferencave shkencore, si dhe shkrime nga jeta kulturore dhe trashëgimia jonë e pasur.

Begati e veçantë e revistës "Dituria Islame" është se ajo është një lloj enciklopedie e fesë, traditës, trashëgimisë, kulturës dhe historisë që ekziston në këto treva prej shekujsh, dhe është pothuajse e pamundur të bëhet çfarëdo lloj studimi e kërkimi për mendimin islam në nënqiellin tonë, pa iu referuar revistës "Dituria Islame" si burim i rëndësishëm shkencor.

Dalja në dritë e revistës "Dituria Islame" ishte një dëshmi e vendosmërisë dhe përkushtimit tonë që fetarisht, intelektualisht dhe kulturalisht të mbrojmë të drejtën për të qenë njerëz të lirë dhe besimtarë të mirë, në shërbim të Islamit, traditës dhe vendit!

Secila redaksi duhet të jetë mirënjohëse për redaksinë paraardhëse, të vlerësohet puna dhe ajo që është trashëguar prej tyre. Të ruhen autorët e vjetër, t'u jepet hapësirë edhe autorëve të rinj, duke u respektuar kriteret profesionale dhe, natyrisht, duke ruajtur parimet tona dhe misionin e Bashkësisë Islame. Një kontribut modest në këtë drejtim kam pasur fatin të ofrojë në cilësinë e kryeredaktorit të saj për tri mandate.

E urojmë revistën "Dituria Islame" për këtë jubile dhe shpresojmë që ajo të ketë jetëgjatësi duke ofruar edhe më shkrime me përmbajtje cilësore dhe të frymëzojë në vijimësi ndryshime pozitive në shoqërinë tonë brenda dhe jashtë vendit!

Puna dhe munda i sinqertë shoqërohet edhe me ndihmën e Allahut xh.sh., prandaj, përmirësimi dhe fisnikërimi është një mision për çdo gjeneratë. Allahu na ndihmoftë dhe na pranofte mundin dhe përpjekjet tona!

Dr. Ajni Sinari

"Dituria Islame" - kronikë e Bashkësisë Islame dhe e ngjarjeve historike



Në këtë numër jubilar, të 400-in, të revistës "Dituria Islame", sipas kërkesës së kryeredaktorit aktual të saj dhe aq sa lejon hapësira në të këtilla raste, për lexuesit e nderuar, dua t'i ndajë disa hollësi, momente e ndjenja, të cilat e kanë karakterizuar krejtfillimin e daljes së kësaj reviste,

ndonëse, për këtë, më duhet të kthehem mbrapa në kohë, për gati katër dekada më parë...

Në të vërtetë, viteve të tetëdhjeta të shekullit të kaluar, sa herë që organizohej ndonjë mbledhje apo tubim i rëndësishëm në kuadër të institucioneve të Bashkësisë Islame të Kosovës, më kujtohet se pashmangshëm bisedohej e flitej edhe për nevojën e domosdoshme për nxjerrjen edhe të një reviste, e cila do të mbulonte një zbrazëti të theksuar në rrafshin e shtypit islam në gjuhën shqipe, zbrazëti kjo e cila vërehej edhe në pasqyrimin e aktiviteteve të Bashkësisë Islame, të organeve dhe institucioneve të saj dhe në shpjegimin e mësimave islame te xhemati dhe lexuesit. Në të tilla takime, nganjëherë, theksohej edhe një lloj hezitimi dhe një lloj frike e arsyeshme se mos organet e pushtetit të asokohshëm komunist-ateist do të mund të ndërhyjnë dhe nuk do të na lejonin dhe se me një hap të tillë kishim frikën, siç i thonë fjalës, se "mos ndillej ujku në torishtë"! Kishte edhe zëra që shpreheshin me rezervë se në mos nuk do të mund ta mbanin një revistë të tillë, të re, meqë për të

duheshin bashkëpunëtorë të shquar për t'i plotësuar rubrikat e saj me shkrime e lajme të nevojshme, për të cilët edhe nuk ishim të sigurt nëse i kishim! Kishte edhe nga ata që shprehnin rezervat e tyre, po ashtu me të drejtë, për mungesë të mjeteve materiale, sepse nxjerrja e një reviste të re, kushtëzohej edhe nga mundësitë financiare, gjë që Bashkësia Islame, asokohe, në këtë drejtim, nuk ishte në gjendjen e saj më të mirë. Sa kohë që, para se të dilte revista "Dituria Islame", nga Shoqata Ilmije, kishte gjashtëmbëdhjetë vjet që botohej "Takvimi" (1970) dhe pesëmbëdhjetë vjet që botohej "Edukata Islame" (1971), por që të dy këto publikime, nuk ishin informative (siç synohej të nxirrej një revistë e re) dhe përderisa e dyta botohej me mundësi vetëm katër herë në vit, e para botohej vetëm një herë në vit.

Megjithatë, që të gjitha këto pengesa, sfida e rezerva, u tejkaluan, dhe jo vetëm që u tejkaluan, por ato edhe u sfiduan. Sepse falë njerëzve vizionarë, largpamës, të përgjegjshëm përballë detyrave të tyre dhe, sidomos, falë njerëzve dashamirës të shkrimit dhe leximit të fjalës islame në gjuhën shqipe, pas shumë debateve, diskutimeve, e besa, edhe polemikave e reagimeve të zhvilluara në mbledhjet e mbajtura në Kryesinë e BI-së midis viteve 1984-1985 dhe, veçan, në fillim vitin 1986, u mor vendimi që të botohej një revistë - (ndonëse, më kujtohet, që kishte edhe mendime që të botohej një si gazetë dhe jo revistë) - me karakter informativ dhe e cila do të quhej revista "Dituria Islame".

Në gjithë këto debate e diskutime, kishte një diçka që i përbashkonte që të gjithë, ama bash që të gjithë diskutuesit dhe të pranishmit. Ai ishte fakti se nxjerrja e një reviste të tillë, ishte nevojë e domosdoshme e kohës dhe një kërkesë e patjetërsueshme që lexuesit dhe besimtarët tanë të kishin një revistë më me shumë informacione për aktivitetet e Kryesisë së Bashkësisë Islame, për organet dhe institucionet e saj, për objektet fetare, për mbajtjen e mësim-besimit, për organizimin e programeve të ndryshme dhe në përgjithësi për zhvillimin e jetës fetare islame në vendin tonë dhe më gjerë, prandaj pavarësisht rrethanave dhe kushteve, revista patjetër duhej ta shihte dritën dhe të arrinte te lexuesit.

Kështu edhe ndodhi dhe kështu edhe u bë, ndaj numri i parë i revistës "Dituria Islame", doli nga shtypi dhe u bë pronë e lexuesit të gjerë shqipfolës, më 1 qershor 1986.

Dalja në dritë e numrit të parë të revistës "Dituria Islame", ishte padyshim një ngjarje e shënuar për Bashkësisë Islame të Kosovës, për institucionet e saj dhe për xhematin dhe lexuesin shqiptarë në përgjithësi. Kështu u vlerësua, kështu u ndje dhe kështu u mirëprit gjithandej ku arrinte "Dituria Islame". Kushdo që e merrte numrin e parë të revistës, sec

shprehte një gëzim të pashpjegueshëm, i cili përtej urimeve e fjalëve miradije e të sinqerta, vërehej shumë lehtë në fytyrën e cilitdo prej tyre. Kurse ne që kishim dhënë kontributin tonë për nxjerrjen e revistës, qoftë me diskutime, qoftë si anëtarë të redaksisë, po qoftë edhe që kishim kontribuar me shkrime e me lajme, ishim shumëfish të lumtur e të gëzuar.

Themelimi dhe botimi i "Diturisë Islame", vlerësuar nga kjo distancë kohore, për mendimin tim, është padyshim një nga vendimet më të mira dhe më të hairit të Bashkësisë Islame të Kosovës. Kjo u dëshmuar sidomos me kalimin e kohës, kur "Dituria Islame", rezultoi si shumë e bereqetshme dhe luajti rol të shënuar në disa aspekte.

Ajo u bë zëdhënëse e aktiviteteve të Bashkësisë Islame, e jetës fetare islame në vendin tonë, u bë fushë ku e sprovuan veten pena të reja nga radhët e ulemasë shqiptare, të nxënësve të medresesë, më pastaj të studentëve të Fakultetit të Studimeve Islame të Prishtinës, të cilat, po në "Dituria Islame" e morën zanatin e shkrimit dhe që më vonë e perfeksionuan dhe u bënë premtues në rrafshin e fjalës së shkruar dhe të cilët nuk u ndalen vetëm me aq. "Dituria Islame" u bë kronikë e ngjarjeve dhe e zhvillimeve me karakter vendor e kombëtar, sidomos në rrethanat krijuara përgjatë viteve '90-të, kur Kosova u (ri)okupua nga Serbia, kurse në rajon filluan të frynin erërat e demokracisë dhe njerëzit të hapeshin haptazi ndaj fesë. "Dituria Islame" u bë edhe një si model për daljen e revistave që do të lindnin më pastaj në Kosovë dhe në hapësirat e tjera shqiptare jashtë saj, si në Maqedoni, Mal të Zi e në Shqipëri.

Prandaj, sot, dhe këtë e them me gjithë bindje, të gjithë ata që dëshirojnë që të njohin jetën fetare dhe kulturore islame dhe zhvillimet e tjera në vendin tonë dhe jo vetëm, do ta kenë të pamundur që ta anashkalojnë revistën islame, kulturore dhe informative në gjuhën shqipe - "Dituria Islame".

"Dituria Islame" me angazhimin dhe kontributin e bashkëpunëtorëve të shumtë gjithandej trojeve shqiptare, me daljen e saj dhe me 400 numrat e botuar deri sot, i ka bërë vetit vend në historinë e publicistikës islame në gjuhën shqipe në veçanti dhe në atë kombëtare në përgjithësi.

Revistës "Dituria Islame" në këtë numër jubilar të 400-të, i uroj jetë të gjatë sa edhe vetë fjala e shkruar, shumë suksese dhe hapërim me kohën dhe me kërkesat e lexuesve të saj!

Resul ef. Rexhepi

Numri jubilar i 400-të i "Diturisë Islame"



Pasi që jemi në prag të daljes së numrit jubilar të 400-të të revistës "Dituria Islame", e cila botohet nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, e pash të udhës që me këtë vështrim të evokojë kujtimet rreth botimit të saj nga viti 1986.

Ky jubilar i revistës më rikujtoi ditën, kur para 38 vjetësh,

saktësisht në qershor të vitit 1986, doli numri i parë i revistës "Dituria Islame", i cili ishte një moment i veçantë, i rëndësishëm dhe shumë i çmuar për publicistikën islame shqiptare në atë kohë, pasi që krahas botimit të revistës "Edukata Islame" në Kosovë, por edhe gjithandej trevave shqiptare, kjo ishte revista e dytë islame që botohej në gjuhën shqipe në ish-Jugosllavi.

Gjatë kohës së ish-Jugosllavisë socialiste, ne gjer atëherë kryesisht furnizoheshim dhe lexonim gazetat dhe revistat islame që botoheshin në gjuhën boshnjake në Sarajevë nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Bosnjës e Hercegovinës, sikurse që ishin "Preporodi", "Gllasniku", "Islamska Misao", "Takvimi" dhe "Zemzemi".

Kryeredaktor i parë i saj ishte Jetish ef. Bajrami, ish-kryetari i Bashkësisë Islame me seli në Prishtinë, i cili në fjalën e tij hyrëse përveç të tjerash pati theksuar se ky ishte fillim pionierësh dhe pati bërë ftesë të gjithë bashkëpunëtorëve që me shkrimet e tyre të ndihmojnë në ngritjen e cilësisë dhe avancimin e revistës "Dituria Islame" si revistë shkencore, kulturore, fetare.

Duke kaluar me kohë, gjatë viteve, revista gjithnjë e më shumë pasurohej me shkrime të ndryshme dhe nga autorët e ndryshëm, ashtu që me kohë mori edhe fizionominë e duhur të një reviste shkencore, kulturore, fetare të mirëfilltë.

Sa i përket perceptimit tim, mendoj se filozofia e kësaj reviste do të merrte formën e saj edhe më bukur në fazat vijuese të atyre periudhave të trazura të popullit tonë. Më saktë, pas vitit 1990, kur u zgjodh si kryeredaktor përgjegjës i saj, prof. Qemajl ef. Morina, shpirti i tij rahmet pastë, i cili me sukses të plotë udhëhoqi për gjashtë vjet revistën "Dituria Islame", nga numri 18 gjer në numrin 84.

Gjatë kësaj periudhe, siç ndodhi edhe në periudhat e tjera, revista pati një rol shumë të rëndësishëm, jo vetëm në ngritjen dhe promovimin e kulturës fetare islame, por edhe asaj kombëtare, pasi që gjatë viteve 90-ta, me ndërprerjen e gazetës së përditshme "Rilindja" si dhe gazetave dhe revistave të tjera nga regjimi okupues serb, ajo sadopak e plotësoi këtë boshllëk informativ kulturor në gjuhën shqipe në Kosovë.

Që nga fillimi, përveç shkrimeve me tematikë fetare, "Dituria Islame" hapi faqet e veta edhe për shumë shkrime me tema të tjera, sikurse ato kombëtare, historike, kulturore, etj., në të cilin veçoheshin shkrimet, përveç kryeredaktorit të saj, edhe të bashkëpunëtorëve të tjerë, sikurse që ishin: Nexhat Ibrahim, Sabri Bajgora, Muhidin Ahmeti, Muhamet Piraku, Mexhid Yveysi, Idriz Vuçitërna, etj..

Në epokën aktuale, do të dëshiroja sikur "Dituria Islame" të trajtonte problemet me të cilën ballafaqohen myslimanët e Kosovës gjatë jetës së përditshme, kudo qoftë, në punë, në arsim, në kulturë, në media, në opinion publik, etj..

Në fund të këtij vështrimi të shkruar, enkas me rastin e daljes së numrit jubilar të 400-të të "Diturisë Islame", shpresoj dhe besoj, që Allahu Fuqiptotë të na mundësojë që kjo revistë e jona fetare e kulturore, të arrijë dhe të shoh dritën e botimit të 1000-të të saj, inshallah!

Faik Miftari

BESNIKE DHE KONSEKUENTE E TRADITËS ISLAME

Të nderuar lexues

Besoj se numri jubilar, i 100-ti i "Diturisë Islame" do të jetë rast i mirë që nga aspekte të ndryshme ta shikojmë dhe ta analizojmë rolin dhe kontributin e kësaj reviste, si në jetën tonë, ashtu edhe në zhvillimin e Bashkësisë Islame tek ne. Unë mendoj se ne do të bënim një padrejtësi të madhe ndaj "Diturisë Islame", nëse atë e unifikojmë ekskluzivisht vetëm me këto hapësira. Është e vërtetë se ajo filloi nga këto hapësira, mirëpo ajo shumë shpejt na prezantoi dhe na ofroi në veçanti botën islame, e mund të themi lirisht edhe botën në tërësi.

Të pakta janë ato revista, si tek ne, ashtu edhe në botë, që kanë arritur t'i plasojnë misionet dhe aktivitetet e tyre lokale me një shpejtësi të tillë në hapësirë dhe në opinion, e pastaj të ruajnë me sukses dhe me kontinuitet një trend dhe një pozicion të tillë.

Për t'u realizuar kjo, revista patjetër duhej të mbështetej në një koncept të qëndrueshëm dhe të shëndoshë. Po ashtu, ajo duhet të ketë patjetër një porosi të theksuar humanitare dhe, pa marrë parasysh rrethanat, t'i mbetet besnike dhe konsekuente idesë së saj themelore, përkatësisht konceptit të saj. Mendoj se "Dituria Islame", pikërisht në sajë të këtij qëndrimi e përcaktimi, ka arritur t'i përfitojë dhe t'i ruajë lexuesit e saj si tek ne, ashtu edhe në botë, dhe falë një qëndrimi e përcaktimi të këtillë, ajo do të fitojë lexues edhe në të ardhmen.

"Dituria Islame", tashmë dymbëdhjetë vjet, që nga fillimi i daljes së saj, kontribuoi vazhdimisht në krijimin e klimës së besimit dhe të respektimit të ndërsjellë, që është parakusht real për paqe dhe stabilizim në Bashkësi. Bashkësia është amaneti ynë më i madh, me të cilin na obligoi Allahu xh.sh. dhe Pejgamberi i Tij. "Dituria Islame" në mënyrën më të mirë, deri më tash ka treguar se si duhet të ruhet ai amanet. Besojmë se kështu edhe do të vazhdojë.

Mendoj se "Dituria Islame" ka arsytuar emrin dhe misionin e saj. Pa "Diturinë Islame" nuk do të ishte siç është me të.

Sot lexuesit tanë kanë në duar numrin e 100-të jubilar të revistës së tyre. Për dymbëdhjetë vjet, aq sa është jeta e saj, si revistë e përmuajshme, ky numër nuk është rekord. Prej datës së daljes së saj, në qershor 1986, i janë "ngrënë" 44 numra. Është gjë normale, ashtu si edhe në aspektet e tjera të jetës sonë, edhe "Dituria Islame" pati baticat e zbaticat e saj. Por, me rëndësi është se ajo e vazhdoi rrugën e saj dhe dita më ditë sa vjen e bëhet më kualitative, më komplete dhe më me përmbajtje. Me këtë ajo sikur po e dëshmon dhe po bëhet simbol i rritës sonë fetare e kombëtare.

Sot gëzohemi. Për një moment. Për arsye se popujt myslimanë, për të cilët shkruajmë, ndonëse nuk janë zgjuar sa duhet, tek ata ka shumë shenja të freskimit.

Ata dëshirojnë që në vend të fjalëve islame, t'i zgjojnë të rënat e historisë! Mos e dhashtë Zoti!

Rrethanat dhe fazat nëpër të cilat kaloi "Dituria Islame", në të njëjtën kohë shprehin gjendjen në Bashkësinë Islame e në një mënyrë të mirë edhe gjendjen e myslimanëve. Askush, sikur myslimanët, nuk është i thirrur që të mësojë nga e kaluara. Ky është imperativ i drejtpërdrejtë nga Kur'ani i madhërishtëm, Libri i Allahut xh.sh. Nëse është ashtu, atëherë ne duhet të kemi respekt ndaj fjalës së shkruar islame. Sepse jemi "civilizimi i fjalëve". Fjala e bukur ia hap derën Islamit, ndërsa fjala e shëmtuar ia mbyll derën atij. Fjala e bukur, në të njëjtën kohë, është e vërtetë dhe e moralshme. "Dituria Islame" bën vazhdimisht përpjekje që të jetë e tillë.

Mirëpo, në rrethanat tona, shtrohet pyetja a mjafton që ne të mbetemi vetëm me një revistë të përmuajshme islame. Unë jam i mendimit, dhe besoj se këtë mendim e përkrahin edhe shumë dashamirë të fjalës së shkruar islame, se ne kemi nevojë dhe janë pjekur kushtet për daljen në dritë të një gazete informative, kulturore islame, e cila sa për fillim mjafton të jetë e përdyjavshme.

Besoj se brezi ynë u ka borxh një gazetë të këtillë besimtarëve tanë në Kosovë, por edhe më gjerë në këto hapësira.

Ne, si në të kaluarën, por besojmë edhe në të ardhmen, me ndihmën e Allahut, do të përpiqemi të shkruajmë për të gjithë myslimanët kudo që jetojnë ata.


Në çdo pjesë të planetit ku jetojnë myslimanët, ata janë në gjendje të vështirë. Gjaku i tyre shkon rrëke, vatrat e tyre po shkatërrohen, vendet e tyre po okupohen, dinjiteti i tyre po nëpërkëmbet e në të njëjtën kohë ata akuzohen për mosdurim dhe agresivitet.

Shqiptarët, për fat të keq, nuk janë kursyer nga këto sprova dhe harbutëri të vrazhda. Duke thirrur për tolerancë fetare e kombëtare, duke qenë e hapur ndaj të gjithëve, duke respektuar të drejtat dhe qenien e të tjerëve, duke kërkuar paqe - "Dituria Islame" nuk do të ndalet së shkruari për vëllezërit tanë kurdo e kudo që ndaj tyre ushtrohet terror dhe u nëpërkëmben të drejtat e tyre.

"Dituria Islame", si në të kaluarën edhe në të ardhmen, në këto kohë të mjegulluara e të vështira do të zgjojë ndërgjegjen islame të popullit tonë.

Sa pati sukses ajo ta bëjë këtë në të kaluarën dhe sa do ta bëjë këtë në të ardhmen, është vështirë të përgjigjemi. Ndoshta për këto as që duhet të kërkojmë përgjigje. Ne duhet të bëjmë çdo gjë që është brenda mundësive tona, e rezultatet janë në duart e Allahut xh.sh.

(Shkruar nga Qemajl Morina, ish-kryeredaktor i "Diturisë Islame", nga numri 18-84, tetor 1990 - shtator 1996)



◆ Anon Aliu

RAMAZANI - MUAJI I KUR'ANIT

"Është e vërtetë se ky Kur'an udhëzon për atë rrugë, që është më se e vërteta, e besimtarët (mu'minët), që bëjnë vepra të mira i përgëzojnë se ata pa dyshim do të kenë shpërblim të madh"¹

Dihet mirëfilli se Allahu xh.sh. njeriut i dhuroi begati të mëdha dhe të panumërta. Së pari, atë e krijoi me një figurë e fizionomi më të bukur të përbërë prej dy komponentesh: trupit dhe shpirtit. Shpirti ka prejardhje hyjnore dhe është i pajisur me besim, me ideale dhe virtyte më të larta. Kurse trupi ka prejardhje prej elementeve tokësore, prandaj edhe ka karakterin material, është tokësor. Së dyti, Mëshirëploti, njeriun e dalloj prej të gjitha qenieve tjera dhe e bëri të shquar e të dalluar, duke i dhënë mend dhe arsye. E bëri kalif në Tokë dhe i vuri në shërbim të tij begatitë e tokës dhe të qiellit, kurse vetë njeriun e bëri me dije se duhet njohur vetëm Allahun dhe vetëm Atij t'i shpreh adhurim të plotë e në kuptimin më të lartë.

Mirëpo, edhe pse njeriu është i krijuar me aftësitë e theksuara më sipër, ai gjatë procesit të zhvillimit të tij në këtë pikëpamje mund të pësojë ndryshime dhe deformime, për të cilat, si shkaktarë më kryesor mund të jenë: prindërit, familja, rrethi, mjedisi ku jeton, pozita, interesi material, drejtimet dhe rrymat e ndryshme filozofike, e të tjera.

Njeriu, në bazë të aftësive të veta mendore dhe fizike është në gjendje të vërtetojë ekzistencën e Allahut, por nuk është në gjendje të kuptojë se si dhe në ç'mënyrë duhet adhuruar, cili është qëllimi dhe caku i jetës së tij, në ç'mënyrë duhet krijuar dhe rregulluar marrëdhëniet ndërmjet njerëzve dhe, a ekziston jetë tjetër pas kësaj jete, apo misioni i tij merr fund me vdekjen e tij. Ja pra, mendja e njeriut nuk është në gjendje të hedh dritë deri në fund për të gjitha këto çështje që i shtruan më sipër.

Allahu xh.sh. duke e njohur në esencë natyrën e njeriut, aftësitë dhe dobësitë e tij, nga mëshira e Vet, njerëzimit i dërgoi peygamber dhe i zbriti udhëzime për t'i drejtuar në rrugën e vërtetë. Me anë të dërguarve njerëzit mësuuan se si duhet besuar dhe adhuruar një Zot, Allahun, si duhet t'i zbatojnë dispozitat dhe urdhërat e Tij,

në ç'mënyrë t'i ndërtojnë marrëdhëniet ndërmjetveti, etj. Sa i domosdoshëm dhe pjesë përbërëse është besimi, më së miri shihet nga fakti se njeriu i parë ishte njëkohësisht edhe peygamber i parë - Ademi alejhisselam.

Të gjithë të dërguarit që nga Ademi a.s. e deri te Muhamedi a.s. i kanë predikuar kushtet e njëjta të besimit. Prandaj, Islam është një nga Allahu xh.sh. që filloi me Ademin dhe përfundoi si i përkryer me Muhamedin a.s. Dallimi ndërmjet të dërguarve është se ata të mëparshmit qenë të dërguar për një popull dhe kohë të caktuar, kurse Muhamedi a.s me Kur'anin është dërguar për tërë njerëzimin, pa dallim ngjyre, gjuhe, rase ose vendi. Si i dërguar i fundit, misioni i tij do të vazhdojë për të gjitha kohërat derisa të ketë jetë e njerëz. Në Kur'an janë përfshirë të gjitha dispozitat ligjore për të gjithë lëmenjtë e jetës shoqërore, ekonomike, politike, në bazë të të cilave në mënyrë të drejtë dhe adekuate njerëzimit iu kanë plotësuar të gjitha nevojat e arsyeshme shpirtërore e fizike. Muhamedi a.s. si i Dërguari i fundit me anë të Kur'anit i sollti njerëzimit bazat e një qytetërimi të ri, që sigurojnë perspektivë dhe mirëqenie shpirtërore e materiale. Qytetërimi Islam nuk bazohet kryekëput mbi parimet materiale siç është rasti me qytetërimin perëndimor, i cili po e tregon veten se është i dobët dhe s'ka fuqi t'u gjejë shërim plagëve, të cilat po e mundojnë shoqërinë njerëzore dhe po e shkatërrojnë mirëqenien e tij, por mbështet parimin shpirtëror, që e thërret njerëzimin ta kuptojë qëndrimin e tij në raport me ekzistencën dhe pozitën e tij në raport me krijesat e tjera të ndryshme.

Muhamedi alejhisselam u tërhoqte vërejtjen shokëve të vet: "Kini kujdes, do të bini në situatë të vështirë! Ndërsa shabet e pyesnin: Tregona, o i Dërguari i Allahut, - ku është rrugëdalja? - "Dispozitat e Allahut, Kur'anit", - i Dërguari tregonte. "Në të janë lajmet për atë që ka ndodhur para jush, për atë që do të vijë pas jush, dhe ligji për ju. Kur'anit, ky është ligji i fundit, është fjalë vendimtare, dallues i së vërtetës nga e pavërteta, dhe nuk është burleskë. Kush e braktis nga kryelartësia dhe mendjemadhësia, Allahu atë do ta shkatërrojë, e kush e kërkon udhëzimin jashtë Kur'anit, Allahu të tillin do ta

lërë të humbur. Kur'anit është litar i fuqishëm i Allahut. Ai është vërejtje e urtë. Ai është rruga e drejtë. Nuk shpie në epshe. Ndërsa fjalët për të, nuk mund ta përmbysin, dhe as që kanë fund mrekullitë e tij. Kush flet me Kur'an, e flet të vërtetën. Kush punon sipas tij, do të jetë i shpërblyer. Kush gjykon sipas tij, gjykon drejt. Kush thërret për të besuar, ai është i udhëzuar në rrugën e drejtë".²

Po të jetë se drita e Kur'anit dhe qytetërimi që sjell ky, të depërtonte në shpirtin e kësaj bote të ngulfatur nga problemet, dhe në vend të këtij ta udhëhiqte qytetërimi material i perëndimit, me siguri fati dhe ardhmëria e njerëzimit do të ndryshonte kryekëput, sepse parimet që sjell Islami janë në gjendje të caktojnë diagnozën e sëmundjeve dhe të krizave të sotme të botës dhe të gjejnë mjekimin e duhur.

Në shumë vende në Kur'an, Allahu xh.sh. thekson madhërinë, vlerën, rëndësinë dhe peshën e madhe që ka Kur'anit, si Shpallje e fundit dhe e përkryer: *"Është e vërtetë se ky Kur'an udhëzon për atë rrugë që është më se e vërteta..."* Ç'është ajo e vërteta e vërtetë kah e cila na udhëzon Kur'anit. Ajo do të duhej të ishte patjetër diçka më e lartë, më e fuqishme, më e përkryer, diçka që ndodhet në pikën kulmore, qëllimi i fundit i të gjitha mendimeve, i të gjitha dëshirave, synimeve dhe përpjekjeve tona!

Fjalën "Akvem", që thekson ajeti i Kur'anit, komentatori i njohur i Kur'anit, Nesefiu e komenton kështu:

"Ve hije tevhidullahi vel-iman".

Rruga më se e vërtetë është, ndërkaq, "imani" dhe "tevhidi", besimi në Allahun, i cili është Një.

Kur kemi parasysh këtë, atëherë na bëhet e qartë sepse besimi, që e shpall Kur'anit duhet të qëndrojë në krye të sistemit jetësor të myslimanëve. Nga ky besim pason edhe besimi në meleqtë, kitabet, të dërguarit e Zotit, të cilëve u është besuar Shpallja hyjnore, në saktësinë e peygamberisë së tyre dhe besimi në ditën e Gjykimit ku kërkohet përgjegjësia e njeriut për jetesën dhe veprimin e tij në jetë. Besimi në Allahun dhe në të vërtetat hyjnore ka për t'i siguruar njerëzimit mirëqenien e dëshiruar. Kur drita hyjnore përmbush shpirtin e njeriut dhe e bënë këtë themel

të jetës së tij, natyrisht ai arsyetonte me ligjin hyjnor, i cili zotëron në natyrë për ta bërë këtë edhe ligj e rregull të vetvetes. Një përfundim i tillë mund të arrihet vetëm atëherë kur njeriu të ketë fituar një dije të plotë mbi harmoninë e krijimit nëpërmjet vërejtjeve të vazhdueshme të kreaturave.

Për ta shprehur besimin në një Zot, Kur'ani përcakton mënyrën e jetës dhe të veprimtarisë njerëzore në jetën praktike. Kështu ai thekson namazin (salatin) dhe vlerën e tij. Namazi "pengon të keqen" dhe i ndihmon njeriut t'i përballojë vështirësitë, sidomos kur është së bashku me durimin dhe qëndrueshmërinë. Kur'ani urdhëron edhe agjërimin e Ramazanit, që nuk është aspak punë e lehtë, heqja dorë nga të ngrënit dhe të pirat duke filluar që nga agimi e deri në perëndimin e diellit. Ata që janë të sëmurë (apo kanë ndonjë vështirësi, pengesë) në rugë, mund ta anulojnë për ndonjë kohë më të përshtatshme. Edhe Kur'ani për herë të parë ka filluar të shpallet në muajin Ramazan.

Deri sa bashkësia e vogël islame jetonte në Mekë, dhënia e lëmoshës, edhe pse theksohej preferimi i këtij akti, konsiderohej kontribut në baza vullnetare, në dobi të asaj pjese të varfër të bashkësisë. Ndërkaq, në Medine, zeqati apo tatimi me qëllim bamirësie u përkufizua për bamirësinë e bashkësisë, dhe u caktuan edhe mbledhësit e zeqatit. Kur'ani i jep rëndësi të theksuar zeqatit, prandaj rrallëherë përmendet të falurit e të mos e përmendet edhe këtë detyrim si të domosdoshme ndaj nevojave sociale:

"Zeqati u takon vetëm të varfërve dhe të mjerëve, edhe atyre që e tubojnë, edhe atyre, zemrat e të cilëve duhet përfutur, edhe për lirimin e robërve, dhe të ngarkuarve me borxhe, edhe për hir të rrugës së Allahut, edhe udhëtarëve - mysafirë, si obligim nga Allahu. Kurse, Allahu i di të tëra dhe është i urtë".³

Kurse Muhamedi a.s. thoshte: "Atij që i jep Allahu pasuri dhe ai nuk e jep zekatin e saj, në Ditën e gjykimit ai do t'i shndërrohet në një gjarpër të madh helmues me pika të zeza mbi sy, i cili do ta shtrëngojë rreth qafe, pastaj do ta kapë për fulqin dhe do t'i thotë: Unë jam pasuria jote, unë jam kapitali yt".⁴ "Kush jep zekat që të marrë shpërblim, do të shpërblehet, e kush refuzon që ta japë, Ne do t'ia marrim me dhunë dhe krahas kësaj do t'ia konfiskojmë edhe gjysmën e pasurisë".⁵

Ndalimi i kamatës, gjykimi moral ndaj të cilit ka filluar në Meke, vazhdon në formë të një varg thirrjesh, në një rreth prej të cilave ka edhe kërcënim se Zoti dhe i Dërguari i Tij do të shpallin luftë kundër atyre që e hanë kamatën me arsyetim se me këtë në raport me huan themelore, rritet obligimi disa herë, prandaj është në kundërshtim me tregtinë:

"Ata që hanë kamatën do të ngrihen sikurse që do të ngrihet ai të cilin e ka përflakur, me të prekur, djalli, për shkak se ka thënë: 'dhe tregtia është një lloj sikur kamata'. Mirëpo, Allahu e ka lejuar tregtinë dhe e ka ndaluar kamatën..."⁶

"O besimtarë, mos hani kamatën e shumëfishuar dhe frikësohuni Allahut, ndoshta do të shpëtoni".⁷

"Populli që bën afarizëm me kamatë, do të mbarojë urie; ndërsa popullin tek i cili ka futur rrënjë rryshfeti, do ta mbulojë frika". "Do të vijë koha kur në emër të shitblerjes dhe të tregtisë, do të legalizohet kamata".⁸ "Mallkimi i Allahut qoftë mbi ata që marrin, dhe mbi ata që japin rryshfet, dhe mbi ata që ndërmerretësojnë ndërmjet këtyre të dyve".⁹

Haxhi, vizita e Qabes njëherë gjatë jetës, është proklamuar i domosdoshëm për të gjithë myslimanët, me çka është sqaruar se kjo ka të bëjë me secilin mysliman, i cili ka mundësi për këtë, do të thotë që ka mundësi jo vetëm të paguajë për vete rrugën deri në Mekë dhe në të kthyer, por që ta sigurojë edhe familjen e vet gjatë kohës së mungesës së vet.

"Kryeni haxhin dhe umren për hir të Allahut".¹⁰

"Haxhi është në muajt e caktuar. Ai që është i detyruar të kryej haxhin në ata (muajt) nuk duhet të ketë kontakt me gra e as fjalë të këqia dhe nuk ka konteste në ditët e haxhit. Çkado që të bëni mirë Allahu e di. Dhe, furnizohuni me çka ju nevojitet për rrugë. Devotshmëria është; furnizimi më i mirë, dhe frikësohuni prej Meje, o të mençur!"¹¹

"Luftëtarët në rrugën e Allahut dhe vizitorët e Qabesë të cilët kryejnë haxhin dhe umren, janë mysafir të Allahut; ata i janë përgjigjur ftesës së tij, prandaj edhe Ai u është përgjigjur lutjeve të tyre".¹² "Kur dikush nis për ta kryer haxhin dhe të gjitha pajisjet i ka fituar në mënyrë të ndershme dhe kafshën e udhëtimit ka blerë e paguar me të holla të fituara në mënyrë të ndershme, dhe ta vërë këmbën e tij në zingji e të thotë: "Lebbejkell-llahume lebbe-

jke", meleku në qiell thërret: "Pajisja jote është fituar në mënyrë të ndershme, ndërsa kafsha është blerë me mjete hallall, prandaj haxhin tënd Allahu i Lartmadhëruar e pranon".

"Nëse dikush nis në haxh me të hollat që i ka fituar në mënyrë të pandershme, kur të vërë këmbën në zingji e të thërrasë: "Lebbejkell-llahume Lebbejke", meleku në qiell thotë: "Pajisja jote është fituar në mënyrë të pandershme, ndërsa kafsha e kalërimit është blerë me mjete haram, haxhi yt refuzohet dhe Allahu i Lartmadhëruar nuk e pranon".¹³

Haxhi është institucion ku më së miri manifestohet solidarizimi praktik i vëllazërimit të të gjithë myslimanëve të botës.

Kur'ani i thërret besimtarët që të jenë të gatshëm për xhihad, që do të thotë të japin "pasurinë dhe jetën e tyre për në rrugën e Allahut". E qëllimi i tij është të vendoset Ligji i Tij në tokë dhe të zbatohen dispozitat kur'anore.

"Dhe luftoni për hir të Allahut kundër atyre, të cilët luftojnë kundër jush, por mos e teproni! Allahu njehmend nuk i do ata që e teprojnë".¹⁴

"Allahu me siguri i do ata, të cilët luftojnë për hir të Tij në radhë si mure të fortifikuar".¹⁵

"Dhe mos thuani për ata që janë vrarë në rrugë të Allahut 'janë të vdekur'! Përkundrazi, ata janë të gjallë, por ju nuk e dini".¹⁶

"Besimtarë të vërtetë janë ata, të cilët besuan Allahun dhe të Dërguarin e Tij, pastaj nuk u tundën, po luftuan me pasurinë dhe me shpirtin e tyre në rrugën e Allahut, ata si të tillë janë besimtarë të sinqertë". "Udhëhiqni xhihadin me politeistët me anën e pasurisë suaj, të vetvetes suaj dhe të gjuhëve tuaja".¹⁷ "Secili popull e ka udhëtimitin që i pëlqen Allahut, ndërsa udhëtimiti i ymetit im që i pëlqen Allahut, është lufta në rrugën e Allahut".¹⁸ "Allahu xh.sh. është obliguar që t'i ndihmojë këta të tre: luftëtarin në rrugën e Allahut, borxhliun që dëshiron ta kthejë borxhin, dhe atë që martohet me dëshirë që të ruajë maturinë seksuale".¹⁹ "Lufta më e preferuar, xhihadi, është të thuhet e vërteta para sundimtarit të padrejtë".²⁰

Ndërkaq, e gjithë kjo veprimtari, kjo dëshmi e tewhidit, domethënë e fesë në Njësimin e Zotit, na bën neve përgjegjës që si mëkëmbës të Zotit në tokë, të realizojmë obligimet, të cilat rrjedhin nga kjo, domethënë që praktikisht t'i zbatojmë. Në qoftë se Zoti është Krijuesi i vetëm, e pa dyshim se

është, atëherë edhe njerëzimi është një. Veprimtaria e përmbledhur në tewhid, nuk është qëllim për vete, por përgatitje e njeriut për të sendërtuar misionin e vet veprues si mëkëmbës. Duke vepruar jo për shkak të interesave të veta a të grupit të vet të ngushtë, por në shërbim të të vetmit Zot, e kjo do të thotë: të veprosh ashtu si ka urdhëruar Allahu: në aspektin individual, shoqëror, mbarënjëzësor dhe në aspektin kozmik. Njeriu që në çdo vepër "e kujton Zotin", dhe sillet si drejtues me përgjegjësi, si mëkëmbës i Zotit, i vetëdijshëm se Zoti e ka bërë përgjegjës për fatin e tij dhe për fatin e të tjerëve, dhe se vendosmërisht duhet të përvetësojë shkencën dhe teknikën, duke mos pasur ndonjë tjetër qëllim veçse të vë rendin e Zotit në tokë, kjo jep të nënkuptojë se duhet kontribuar në përparimin e shkencës dhe të teknikës, por në shërbim të Zotit dhe të njeriut "... Pohimi mbi njësimin Hyjnor nuk është konstatim, po akt. Tewhidi nuk është fakt i thjeshtë: gjykim mbi ekzistencën e Zotit të vetëm. Ky është angazhim, parim veprimi, i cili përshkon tërë jetën tonë. Çdo akt i veçantë, madje ai më i thjeshti dhe i përditshmi, ka për detyrë të realizojë atë qëllim Hyjnor në tokë, që të sendërtohet bashkësia universale, e cila do ta shndërrojë botën në një njësim të gjallë."²¹

Kur'ani, ndërkaq, është fjalë e Allahut, Shpallje e Tij. Në Kur'an është shfaqur vullneti i Zotit, të cilin, për herë të parë e ka realizuar i Dërguari i Tij, Muhamedi a.s.. Kur'ani si Shpallje e Allahut, vlenë përherë dhe bartë në vete vitalitetin e përhershëm krijues e kreativ. Kur'ani përherë na zbulon qëllimet që duhet ndjekur. Dhe detyrë e të gjithë njerëzve të të gjitha kohërave është që të gjenden mjete për t'i realizuar ato qëllime:

"(Kur'ani është) Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë, që t'i studiojnë argumentet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend".²²

Sot, myslimanët janë të vetmit njerëz të lumtur në botë, të cilët fjalën e Allahut e kanë të ruajtur plotësisht, ashtu si iu ka shpallur të Dërguarit të Zotit, Muhamedi a.s. Por, po këta myslimanë, janë njerëz më fatkeq, janë shënjestër e sulmeve dhe fatkeqësive nga të gjitha anët. Një popull që ka në duar fjalën e Allahut, heq të zinjte e ullirit. Vuan nën zgjedhjen e të tjerëve...

Kur'ani është burim mëshire, drite dhe fatbardhësie. "Pse sot ai Sheriat, ai Ligj i Zotit, nuk ndriçon botën? "Pse

populli mysliman, i çliruar nga kolonializmi, mbesin objekt, e jo subjekt krijues i historisë? Pse nuk japin shembull inisiativat historike? Sepse Kur'ani lexohet me sytë e të vdekurve".²³ Derisa myslimanët e hershëm ishin të aftë t'i zgjidhnin problemet e epokës së vet, ne nuk mund t'i zgjidhim problemet e epokës sonë, "sepse ne ndjejmë se është e mjaftueshme të përsërisim formulat e tyre dhe frymëzohemi me metodat e tyre. Mos, vallë, është punë formalizmi, për të cilin paralajmëron Muhamedi a.s. kur i thotë shokut të vet: "Ti po jeton në kohën në të cilën ka shumë njerëz, që i kuptojnë dispozitat kur'anore, po janë pak që e lexojnë. Shumë njerëz jetojnë sipas Kur'anit dhe i nderojnë dispozitat e tij, ndërsa pak janë që kujdesen për fjalët e Kur'anit. Ka pak lypës e shumë të atillë që japin. Njerëzit qëndrojnë shumë në namaz, e pak flasin. E do të vijë koha kur do të ketë pak të atillë që e kuptojnë Kur'anin, e shumë të atillë që e lexojnë. Atëherë do të shkelen dispozitat e Kur'anit, e do të kujdesen për fjalët e tij. Do të ketë shumë lypës, e pak të tillë që japin. Do të shpenzohet shumë kohë në bisedë, ndërsa pak në ibadet. Pak do të punohet e shumë do të përpiqen për të kënaqur epshet e veta".²⁴

Shtrohet pyetja: Si mund sot, myslimanët, ata të cilët e përbëjnë Ummetin, të çlirohen nga lustra e formalizmit? Përgjigjja është e thjeshtë. Mund të çlirohen dhe përsëri ta ndriçojnë botën me dritën e Ligjit të Allahut, po qe se e kuptojnë rrugën e vet kah janë duke shkruar, dhe, pasi që ta kuptojnë, t'i kthehen burimeve të mirëfillta: Kur'anit dhe Sunetit. "T'i kthehesh burimeve, nuk domethënë që në ardhmëri të hyjmë së prapthi, me sytë e kthyer kah e kaluara, por që përsëri të gjejmë burimin e gjallë dhe dinamizmin krijues të Islam-it të hershëm. Sheriati nuk është moçal akumulues, tek i cili do të kishim mundur të zëmë ujin e ndotur: Ashtu nuk do të kishim mundur të shuajmë etjen tonë të re. Sheriati është një lum që shkëlqen, dhe i bën të plleshme brigjet që i spërkat uji".²⁵

Kur'ani është "udhërrëfyes", dritë, prijës për njerëzit që janë të ruajtur, të njerëzishëm, cilësorë. Në qoftë se nuk harrojmë se çdo ajet i Kur'anit ka zbritur "të përgjigjet në problemet konkrete të paraqitura para një populli në një moment të tij historik dhe se vlera e përjetshme e atyre ajeteve konsiston pikërisht në atë, që nuk përfaqësojnë formulën abstrakte, po përgjigjen e

gjallë në pyetjen e gjallë, dhe se për ne pas 14 shekujsh, ruajnë vlerën e përjetshme, me këtë, neve na thërrasin që në to të zbulojmë përgjigjen e gjallë në çështje të gjalla të jetës sonë".²⁶

I Dërguari i Allahut, Muhamedi a.s. është shembulli më i mirë për të gjithë besimtarët. Në qoftë se na kujtohet shembulli praktik i tij, i cili ka ditur t'i zgjidh problemet e reja të kohës së vet. Dhe "në qoftë se na kujtohet se shokët e të Dërguarit, kalifë të vërtetë besimtarë, juristë të mdhenjë të së kaluarës, si krijues përgjegjës, kanë ditur të gjejnë zgjidhje në problemet e reja të kohës së tyre në shtetin, që ka dalluar nga Bashkësia e Medinës dhe për t'u qëndruar atyre besnik, nuk do të thotë se duhet përsëritur fjalën e tyre, por të ndiqet shembulli i tyre, veprimi i tyre krijues e me përgjegjësi. Ata janë në rrugë të drejtë të Zotit, zgjedhin problemet e kohës së vet: ata nuk na lënë receta kallauze, por metodën se si të ballafaqohemi me probleme të reja.

Vetëm kështu, Islami do të kthehet i gjallëruar, universal, i hapur për të gjithë, sikundër ka qenë në fillim".²⁷

Dhëntë Zoti që ky Ramazan me agjërimin e tij të na sjell fuqinë e kthjelltësinë e përkushtimit më të gjallë në leximin dhe në studimin e Kur'anit.

1. Kur'an, sura Isra, ajeti 9.
2. Hadith, Tirmidhiu.
3. Kur'an, sura Et-Tevbe, ajeti 60.
4. Hadith, Buhariu.
5. Hadith, Ebu Davudi.
6. Kur'an, sura El-Bekare, ajeti 275.
7. Kur'an, sura Ali Imran, ajeti 130.
8. Hadith, Ahmed.
9. Hadith, Ahmed, Taberani.
10. Kur'an, sura El-Bekare, ajeti 196.
11. Kur'an, ajeti 197.
12. Hadith, Ibn Maxhe.
13. Hadith, Taberani.
14. Kur'an, sura El-Bekare, ajeti 190.
15. Kur'an, sura Es-Saff, ajeti 4.
16. Kur'an, sura El-Bekare, ajeti 154.
17. Hadith, Darimi.
18. Hadith, Ebu Davudi, Hakimi, Bejhekiu.
19. Hadith, Tirmidhiu, Nesai, Hakimi.
20. Hadith, Ahmed.
21. R. Garodi, Gjallërimi Islamik, Gjakovë 1991, fq.98,103.
22. Kur'an, sura Es-Sad, ajeti 29.
23. R. Garodi, Gjallërimi Islamik, Gjakovë 1991, fq.40.
24. Hadith, Imami Malik, "Muvetta".
25. R. Garodi, Gjallërimi Islamik, Gjakovë 1991, fq.40.
26. Aty, fq. 122.
27. Aty, fq. 122.

Sherif ef. Ahmeti – personalitet kulturor kosovar

Granit Sadiku

Me rastin e botimit të numrit 400 – jubileut të revistës “Dituria Islame”, nuk mund ta lëmë pa përmendur edhe një personalitet të shquar, i cili me shkrimet e tij dha kontribut të madh për këtë revistë.

Kultura është aspekti më i rëndësishëm i një populli. Kultura si nocion lidhet me fjalën “kultivim”. Diçka që lërohet, përpunohet dhe bartet nga brezi në brez. E ardhmja e një populli varet nga kultura e tij. Thuhet: nuk mund ta dish nga shkon, nëse nuk e di nga ke ardhur. Populli jonë ka pasur shumë personalitete kulturore në historinë e tij. Disa janë mbajtur mend, janë lavdëruar, e kur e kur janë himnizuar. Ndërsa, disa të tjerë janë mbuluar me pluhurin e historisë dhe janë lënë në harresë.

Personaliteti për të cilin do të flas, është një njeri i veçantë intelektualisht, dhe me shumë vlerë në aspektin e përkthimeve në gjuhën shqipe të literaturës fetare. Sherif ef. Ahmeti, ishte një imam i përcaktuar në rrugën e Zotit, i cili ia kushtoi tërë jetën e tij kontributit për fenë e atdheun. Kultura, siç u tha më lart, është vlerë e veçantë e një populli. Pjesë e pandashme e kulturës së civilizimit mbarë botëror janë religjionet. Jeta e një imami apo prifti, ka të bëjë me fenë dhe predikimin e saj me përkushtim. Kanë ekzistuar më herët, dhe vazhdojnë të ekzistojnë, stereotipat se një predikues fetar nuk mund të jetë edhe atdhetar, ngase feja nga kombi është e ndarë – sipas tyre. Ndërsa, tani kemi për shtjellim të bëmat e një personaliteti që nuk i kontribuoi vetëm fesë, por i kontribuoi edhe kombit. Dhe me shembullin e jetës së tij, na bëri të kuptojmë se feja dhe kombi jo vetëm që nuk kundërshtohen, por e ndihmojnë vazhdimisht njëra-tjetrën.

Ai ishte pjesë e kohëve më të vështira për përhapjen e Islamit në vendin tonë, dhe kësaj detyrohej që të angazhohej me aksimumin e tij.



JETA

Sherif Ahmeti lindi në një fshat të Lipjanit, të quajtur Gumnasellë, në vitin 1920. Klasat e para të shkollës fillore i kishte përfunduar në Banullë, kurse mësimet e para islame i kishte marrë nga mulla Azizi – një hoxhë nga Banulla, për të vazhduar pastaj me mësimin e fesë në Medresenë e Ferizajt nga myderriz Azem Gremja, dhe nga hafëz Abdullah Efendiu. Në vitin 1934, ishte regjistruar në medresenë “Pirinaz” të Prishtinës, ku kishte ndjekur mësimet fetare për dhjetë vjet me radhë. Me përfundimin e kësaj medreseje, e mori ixhazetnamenë nga myderrizi Ahmet ef. Ajeti-Mardoçi.¹

Gjendja e popullit shqiptar në kohën e përfundimit të luftës së dytë botërore ishte e rënduar. Sherif Ahmeti ishte i diplomuar nga medreseja, dhe ishte më i spikatur me figurën e imamllëkut. Por, ky fakt nuk e bënte aspak që ta neglizhonte aspektin kombëtar. Ai e kishte pasur Medresenë bazë të mësimet fetare e atdhetare. Ai iu rrek pas kontributit për hapjen e shkollave shqipe në vendin e tij, dhe kështu më 19 dhjetor të vitit 1949 u emërua mësuesi i parë i gjuhës shqipe, në shkollën fillore të Banullës.²

Aktiviteti i tij si mësues i gjuhës shqipe, e kishte shqetësuar shpeshherë regjimin komunist serb të asaj kohe. Dhe kështu, nga detyra e mësuesit, të cilën e kishte ushtruar me përgjegjësi e nder, u detyra që në vitin 1956 të largohet, e t'i kthehej imamllëkut. Deri në vitin 1965 ai kishte qenë në funksion të imamit, e më vonë të kryetarit të Bashkësisë Islame të Lipjanit. Dhe pastaj nga aty, kishte kaluar si mësimdhënës në medresenë e mesme “Alaudin”, në Prishtinë.

Medreseja është vatër jo vetëm e dijes, por edhe e atdhedashurisë. Asnjëherë me tendencën për ta himnizuar, e lavdëruar së tepërmi, por ku mund të ketë vend më të bekuar sesa vendi ku lexohet fjala e Zotit?! E kjo begati i erdhi Medresesë pikërisht nga kuadrot e saj të cilat e ndërtuan, e në këtë rast, nga hoxha e myderrizi i nderuar, Sherif ef. Ahmeti. Me disa nxënës të tij më ka rënë rasti të bisedoj. Përshtypjet e tyre personale për këtë profesor të nderuar ishin të shkëlqyeshme. Nuk mund të dëgjoje asnjëherë nga askush fjalë të tjera, përveç lëndave, e lutjeve të mira për të nga dashuria që kishin.

Ai ishte pjesë e kohëve më të vështira për përhapjen e Islamit në vendin tonë, dhe kësaj detyrohej që të angazhohej me maksimumin e tij. Si ligjërues i lëndës së Akaidit në Medrese, ai përgatiti tri dispensa të kësaj lënde për tri vitet e para të shkollës. Puna si drejtor më pastaj në Medrese, pozitë të cilën e ka ushtruar nga viti 1983 – 1970, ia kishte bërë të mundshme angazhimet e tjera në lëmin e përkthimit. Nevoja e popullit për literaturë islame në gjuhën shqipe ishte e domosdoshme, dhe kështu hoxha i nderuar Sherif Ahmeti u angazhua me punë të pandalshme. Përveç përkthimit të “Ilmihalit”, që e kishte botuar më 1968, ai kishte botuar vazhdimisht shkrime në “Buletin Informativ”, në “Takvim”, në “Edukatën islame”, e më vonë në “Diturinë Islame”. Ai, si i pandalshëm në punën e tij, sikur e kishte pasur përshtypjen se çdo punë që e kishte bërë ishte e mangët dhe duhej bërë më shumë. Ky motiv e bënte atë të vazhdonte të thellohej akoma më shumë në lëmin e përkthimeve, e të punës shkencore.

Afër 200 shkrime (zëra bibliografikë) ishin botuar nga Sherif Ahmeti, të cilat i përkisnin lëmenjve të ndryshme, si: akaidit, tefsirit, filozofisë, kulturës islame në përgjithësi, komenteve, informatave të ndryshme për kohën, etj..³ Ajo që e tërhiqte atë më shumë të thellohej, ishte tefsiri (komentimi i Kuranit).

Herë pas here dëgjohej zëra se: përse namazi, kurani, ezani, e në përgjithësi feja duhet të jenë arabisht?! Pse nuk janë në gjuhën shqipe?! Pse duhet besimtari t'i thotë fjalët e një gjuhe të cilën nuk e kupton?! Hoxha i nderuar, Sherif Ahmeti, qysh herët u kishte dhënë një përgjigje përmblylëse këtyre pyetjeve tendencioze me vetë punën e tij. Në komentin e sures “El Fatiha, ai kishte thënë: “*Është turp për besimtarin të lexojë fjalë që nuk i kupton, ta adhurojë Zotin e vet të dashur me shprehje, të cilat gjersa nuk i kupton, nuk ia zgjojnë ndjenjat shpirtërore. E aq më keq, kur nuk kupton brendinë e kësaj*

Botimi i Kuranit të përkthyer nga Sherif Ahmeti, edhe pse nuk ishte i vetmi, pati më së shumti përhapje në qendrat shqiptare nëpër botë.

kaptinë, të cilën e lexon më së shumti në jetën e tij.”⁴ Kjo ishte brengë shqetësuese për hoxhën Sherif Ahmeti. Kështu ai vihet përballë një pune më të vështirë e më sfiduese, përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe.

Kurani kishte qenë gjithmonë dashuria e hoxhës së nderuar, por përkthimi i tij nuk ishte gjë e lehtë si në aspektin intelektual, po ashtu edhe në atë kohor. Në vitet e 60-ta, regjimi serb kishte shtrirë represion të tmerrshëm në popullin e Kosovës. Deri në vitin 1966, me mbajtjen e Pleniumit të Brionëve, populli shqiptar që jetonte në Jugosllavi shtypej, torturohej e vritej. Kurani, në kohën kur u përkthye, ishte veprimi i duhur, koha e duhur dhe njeriu i duhur që e përktheu.

Në një intervistë të zhvilluar nga Qemajl Morina dhe Elez Osmani, Sherif Ahmeti kishte thënë: “*Në çdo numër të “Edukatës” kam botuar të paktën nga një përkthim të ndonjë fragmenti të shkurtër, më vonë e përktheva suren “Jasin” me një koment të shkurtër, sipas komentit të Dhilalit, e shkrova tërë “Jasinin” me shkronja shqipe si në origjinalin arabisht, e përktheva edhe “Ilmihalin”. Dikur sistemin monist e kapën telashe të tjera, e largoi vëmendjen prej punimeve tona, andaj e shfrytëzova rastin dhe ja fillova përkthimit të plotë të Kuranit, të cilit ja bashkëngjita edhe një koment të shkurtër.”⁵*

PATRIOTI SHERIF EF. AHMETI

Ndër porositë e mëdha të fesë islame është edhe angazhimi i besimtarëve, pa dallim, në mbrojtjen e atdheut sa herë që kërkohet, e sido që kërkohet. Hoxha Sherif Ahmeti jo vetëm që e dinte këtë, por edhe e predikonte në mesin e popullit, xhematit, e nxënësve të tij. Kemi përmendur më lart se periudha pas përfundimit të luftës së dytë botërore, hoxhën e nderuar e gjeti si kontributdhënës në fushën e arsimit shqip.

Në atë kohë, kryeinspektor i arsimit shqip në Kosovë ishte njëri nga 100 mësuesit e dërguar nga Ernest Koliqi, i cili quhej Mehmet Gjevori. Ai kishte pasur kontakte me hoxhën e nderuar, të cilin e kishte pasur në sy si punëtor të frytshëm, e të zellshëm. Kur hoxha e pa se në fushën e arsimit kishin filluar të shtoheshin më shumë kuadro, e të zgjerohej rrjeti i mësimdhënësve, ai iu kishte drejtuar me një kërkesë Mehmet Gjevorit.

“- Zotëri Mehmet, meqenëse tani është shtuar numri i mësuesve dhe kuadri mësimor nuk mbetet keq, e meqë unë në vitet më të vështira e kam kryer me nder punën time

arsimore-edukative në shkollat shqipe, do të dëshiroja të marr pëlqimin tuaj që unë tani e tutje të ushtroj profesionin tim në fushën e edukimit e predikimit fetar, por duke mos lënë anash edhe atë kombëtar.”

“- Ju keni kryer punën tuaj edukativo-arsimore në mënyrë shembullore, dhe si i tillë jeni i nevojshëm gjithmonë, duke shërbyer si shembull edhe për të tjerët. Mirëpo, nëse ju mendoni dhe e shihni nevojën se atje jeni më të nevojshëm, atëherë varet nga dëshira juaj(...)”⁶

Ndonëse ishte larguar me vetëdëshirë nga profesioni i mësuesit të shkollës, ai do të mbetej gjithmonë “mësues” si në mes popullit të tij, ashtu edhe mes nxënësve të Medresesë, e xhematit të xhamisë.

Qysh nga vitet para luftës së dytë botërore, njihet tendenca turko-ruse, e më vonë serbe, për largimin e shqiptarëve nga trojet e tyre dhe dëbimin e tyre për në Turqi. Në vitin 1937, patrioti i madh Ramë Bllaca ishte vrarë pabesisht nga “hafijet” e pushtetit serb, pasi nuk kishte pranuar të nënshkruante largimin e shqiptarëve nga Kosova në Turqi.⁷

E njëjta histori u përsërit edhe pas luftës së dytë botërore. Në vitet e 50-ta, shqiptarët kishin intensifikuar ikjet e tyre për në Turqi. Në atë kohë Sherif Ahmeti ishte mësues shkollë në fshatin Sllovi, dhe kur e vërejti këtë gjë u shqetësua shumë. Ai nisi menjëherë angazhimin e tij, përmes ligjëratave e bisedave me popull, që ta ndalte këtë dukuri. Mirëpo, puna si mësues e kufizonte atë në aspektin lokal, dhe kështu zëri i tij nuk arrinte në shumë treva të Kosovës. Suksesin e përhapjes së mesazheve patriotike për të mos ikur nga atdheu e për të punuar për të, ai i arriti në mënyrën më të suksesshme kur u emërua kryetar i Shoqatës së Ylemave, ngase si kryetar mund të vizitonte shumë rajone të Kosovës, dhe të përhapte ligjëratat e tij atdhedashëse. Në një intervistë dhënë për “Diturinë Islame”, hoxha i nderuar tregonte se sa kishte ndikuar kjo gjë në aspektin psikik të tij, ngase emocionet e të qenët prezent në përshëndetjet mes familjarëve, që ndaheshin e nuk e dinin a bashkoheshin prapë, ishin të mëdha. Një imam i mirë duhet të ketë empati me xhemat, ashtu si mësuesit me nxënësit, ngase vetëm duke e njohur psikologjinë e tyre mund të arrijë ta përçojë mesazhin ashtu si duhet dhe me efekt të plotë.

Vlen të përmendet edhe fakti që në kohën sa Sherif Ahmeti kishte shërbyer si mësues, e kishte mbajtur gjithmonë në kokë plisin e bardhë. Simbolin e kulturës qindravjeçare të popullit shqiptar, që paraqet bardhësinë shpirtërore, morale, e burrërore. Me këtë gjë ai dëshironte të tregonte se vetëm duke qenë vetvetja, e duke qenë krenar për atë që je, mund të arrish atje ku do. Kjo e dëshmon akoma më mirë se Sherif Ahmeti nuk ishte thjesht imam xhamie, por ishte personalitet i shquar në ngritjen e kulturës kombëtare.

“Dhe thuaj, veproni, Allahu do ta shohë veprën tuaj dhe i Dërguari i Tij, e besimtarët, e më vonë do të ktheheni te Njohësi i së fshehtës dhe së dukshmes e do t’ju njoftojë për ato që vepruat.” (Et Tevbe, 105).

PËRKTHIMI I KURANIT

Sherif Ahmeti bëri pjesë në plejadën e hoxhallarëve të nderuar, që ishin: Hasan Nahi, e Feti Mehdiu, të cilët e kishin përkthyer Kuranin në gjuhën shqipe. Kjo ishte një lloj gare (nëse mund të thuhet) mes tyre, ngase vetë Zoti në Kuran ka porositur garimin në punë të mira: “Bëni gara me njëri-tjetrin në punë të mira...” - (El Bekare, 148). Përkthimi i Kuranit dhe komentimi i tij, për atë që e ka ndjenjën e përgjegjesisë para fjalëve të Zotit, ka peshë të rëndë. Sherif Ahmeti nuk e fsheh aspak frikën e tij përballë Zotit – në radhë të parë, e pastaj edhe ndaj lexuesve, për përkthimin e Kuranit. Në pasthënien e fjalës së përkthyesit, Sherif Ahmeti ndër të tjera thotë: “Jam i vetëdijshëm se kam përgjegjësi para Zotit dhe para lexuesve, por dëshira që edhe lexuesit e gjuhës shqipe ta kenë pranë vete një përkthim me komentime në gjuhën tonë, mbizotëroi frikën e përgjegjesisë(...)”⁸

Përkthimin e Kuranit e kishte bërë kohë pas kohe, e në mënyrë sistematike. Mirëpo, pas përkthimit ishte shfaqur një problematikë tjetër, që është e zakonshme thuajse në çdo përkthim të mundshëm. Çështja ishte se a është bërë shqipërimi i duhur gjuhësisht, e gramatikisht! Kështu Sherif Ahmeti, thirri në ndihmë dr. Mehmet Halimin, si njohës i gjuhës letrare shqipe, që ta ndihmonte në lekturimin e përkthimit të Kuranit, punë të cilën Mehmet Halimi e kishte bërë edhe më herët, duke e lekturuar Kuranin e përkthyer



nga Hasan Nahi. Punës së lekturimit iu kishin bashkangjitur edhe mr. Shefkije Islamaj, e mr. Ragip Mulaku.⁹ Duke e pasur parasysh faktin se Sherif Ahmeti ishte njohës i gramatikës dhe gjuhës shqipe, mendoj se puna e komisionit për lekturimin e Kuranit nuk kishte qenë e vështirë. Mirëpo, kam përshtypjen se nuk është marrë shumë seriozisht çështja e lekturimit në gjuhën shqipe. Natyrisht se nuk ka qenë fare punë e lehtë, dhe siç dihet: *është më e lehtë të kritikohet sesa të krijohet*. Mirëpo, duke qenë se gabimet janë gramatikore dhe nuk përbëjnë pjesën dërrmuese të përkthimit, mund të themi se përkthimi i Kuranit nga Sherif Ahmeti ka vlera të mirëfillta dhe është autentik.

Në vitin 1988 doli në dritë përpjekja disa vjeçare e Sherif Ahmetit: *Kur'an-i – Përkthim me komentim*.

Botimi i Kuranit të përkthyer nga Sherif Ahmeti, edhe pse nuk ishte i vetmi, pati më së shumti përhapje në qendrat shqiptare nëpër botë. Për shembull, u botua në Kajro në vitin 1992, me tirazh 20.000 kopje. Një vit më vonë u botua në Medine, ku arriti tirazhin 1.000.000 kopje. Pastaj u botua në Tripoli të Libisë, etj.. Të gjitha këto botime në numër aq të madh, u bënë nga puna e palodhshme e Sherif Ahmetit, i cili nuk mori asnjë shpërblim material për punën e tij. Atë që e konsideronte më urgjencë, ishte dërgimi i 10.000 kopjeve të Kuranit në Shqipëri, ngase në atë kohë atje kishte rënë sistemi komunist, i cili që nga viti 1967 e kishte shpallur Shqipërinë vend atëist.

PËRFUNDIM

Sherif Ahmeti e pati fatin të jetonte dhe vepronte në kohë të vështira për shqiptarët. Ai, përkundër ndalesave të shumta që kishte, e vazhdonte punën e tij me vullnet e moral të lartë. Sherif Ahmeti, ndonëse nuk ishte i pari që e përktheu Kuranin në gjuhën shqipe, ai e bëri përkthimin më të përhapur e më kualitativ të tij. Thujse çdo shtëpi shqiptare e ka në vitrinë Kuranin me kopertina të kuqe, të përkthyer nga Sherif Ahmeti. E kjo, padyshim, është dëshmi e cilësisë dhe e begatisë së përkthimit të tij.

Në historinë e civilizimit botëror, vendin më të rëndësishëm e zë historia e tri feve abrahamike monoteiste. Përmes këtyre tri feve, njerëzit e mësojnë kulturën dhe historinë e ekzistencës së njerëzimit nëpër shekuj. Lexuesi shqiptar, pa marrë parasysh se a i takon besimit përkatës apo jo, e ka rastin që ta kuptojë fenë në gjuhën amtare përmes përkthimeve të Sherif Ahmetit. Pra, nëse është me rëndësi të veçantë studimi i feve abrahamike (respektivisht fesë islame në këtë rast) në kulturën e civilizimit të një populli, atëherë kontributi i këtij hoxhe ka merita kombëtare më shumë sesa fetare.

Figurën e Sherif Ahmetit mund ta krahasojmë me figura të tjera historike, në aspektin e përkthimeve me të cilat e kanë ngritur gjuhën shqipe në pedestal të lartë. Për shembull vlen të përmendet Gjon Buzuku, si përkthyes i njërit nga dokumentet e para të gjuhës shqipe, “Mesharit”, që u shkrua

në vitin 1555. “Meshari” ishte i destinuar për t’u përdorur nga priftërinjtë që operonin në trojet shqiptare, gjatë shërbesave të tyre fetare. Pastaj Konstandin Kristoforidhi, i cili përktheu “Dhjatën e re” në dy dialektet e gjuhës shqipe. Po ashtu Fan Noli, i cili më shumë sesa prift njihet si shkrimtar, e veprimtar politik. Noli, me mbajtjen e meshës së parë ortodokse shqipe në vitin 1908 në Boston, ngriti vetëdijen kombëtare shqiptare në kulturën e besimit ortodoks. Ai po ashtu, përktheu disa vepra të tjera fetare nga literature greke në gjuhën shqipe. Po ashtu kemi përngjasime me figurat e shquara të fesë islame, që janë Feti Mehdiu e Hasan Nahi, të cilët e kishin përkthyer e komentuar paraprakisht Kuranin në gjuhën shqipe.

Te hoxha Sherif Ahmeti e kemi një profil të veçantë, si për nga aspekti fetar ashtu edhe nga ai kombëtar. Atë e preokuponte aspekti i besimit, e i diturisë, por, edhe i atdhedashurisë. Në kohën sa ishte mësues shkolle, me plis në kokë, i nxiste nxënësit që ta mësonin identitetin kulturor të shqiptarëve. Ndërsa si hoxhë, me shallë në kokë, e kultivoi akoma më shumë këtë kulturë, duke e pasuruar lexuesin shqiptar me tekste fetare në gjuhën shqipe.

Sherif Ahmeti nuk ishte i famshëm sa Noli apo Kristoforidhi, përkundrazi. Ende nuk ekziston një monografi, apo biografi e shkruar në formë të detajuar për të. Koha kur hoxhë Sherif Ahmeti vdiq, viti 1998, është vit i afërt. Xhemati i tij, nxënësit e tij, kolegët e bashkëpunëtorët e tij janë gjallë. Kësisoj, do duhej të bëhej përpjekje edhe në këtë fushë, ngase një figurë si Sherif Ahmeti është mëkat të mbetet e harruar dhe e lënë mbrapa në histori. Shteti do të duhej që së paku një emër rrugë ta bënte me emrin e këtij hoxhe, që ka dhënë kontribut të madh në fushën e kulturës shqiptare në përgjithësi, e kosovare në veçanti.

Ky vështrim mbi këtë figurë historike e kulturore, është përpjekje për të treguar se sa ka vlerë kultura e një populli, dhe sa kanë vlerë njerëzit që e bëjnë atë. Një popull i kulturuar kurrë nuk mund të robërohet, ngase mendja dhe shpirti janë përtej çdo aspekti material. Një popull me kulturë është i integruar, ndërsa një popull pa të është i harruar. E hapi i parë drejt ruajtjes së kësaj kulture, është kujtesa për personalitetet që e kanë krijuar atë.

1 Haxhi Sherif ef. Ahmeti – jeta dhe vepra, *Përmbledhje kumtesash*, Dituria Islame, Prishtinë, 2010, f. 8.

2 Po aty, f. 9

3 Po aty, f. 33.

4 “Edukata Islame”, nr. 3, 1971, f. 3-7.

5 “Dituria Islame”, Intervistë ekskluzive, nga Qemajl Morina dhe Elez Osmani, nr. 36, Prishtinë, 1992, f. 14.

6 Haxhi Sherif ef. Ahmeti – jeta dhe vepra, *Përmbledhje kumtesash*, Dituria Islame, Prishtinë, 2010, f. 86.

7 Shih: *Organizata Xhemijeti dhe rezistenca kundër kolonizimit*, Institucioni i trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve në Shkup, 2017, Shkup.

8 Kurani, *Përkthim dhe komentim nga Sherif Ahmeti*, Medinë, 1993.

9 Haxhi Sherif ef. Ahmeti – jeta dhe vepra, po aty, f. 76.

Ripërtëritja e besimit dhe raporteve ndërnjerëzore në Ramazan

Dr. Bahri Hoxha

Po të donim ta thjeshtësonim fenë islame në vetëm dy segmente, do të arrinim në përfundim se dy segmentet kryesore të Islamit si fe, janë këto: segmenti i raportit të besimtarit me Zotin Krijues dhe segmenti i raporteve të besimtarit me krijesat e Zotit.

Ndërlidhje e këtyre dy segmenteve shumë të ndryshme në një titull të përbashkët, vije si rezultat i konfirmimit se ekzistentët janë dy: Krijuesi dhe krijesa. Si rrjedhojë, natyrshëm, feja e Zotit duhet t'i përfshijë në mësimet e saj, mësimet përmes një qasjeje të duhur ndaj të dy ekzistentëve, si ndaj Krijuesit, po ashtu edhe ndaj krijesës. Realisht, po që se meditohehen tekstet nga Kurani famëlartë dhe Suneti i të Dërguarit a.s., vijmë në përfundim se qasja e tekstit fetar përfshinë trajtimin e të dy këtyre aspekteve njëkohësisht.

Sa i përket segmentit të parë, gjegjësisht të raporteve të besimtarit me Zotin e vet, është më se e njohur se paraqet aspektin kryesor në fenë islame. Ky segment përfshinë në vete njohjen e Zotit si Krijues, Furnizues, dhe i Vetmi që meriton adhurimin në ekzistencë. Zoti në Kuran thotë: *“Dije se nuk ka zot tjetër përveç Allahut.”* (Muhamed, 19).

Kur ky segment rregullohet te njeriu, njeriu fiton epitetin besimtar dhe është i gatshëm që të pranojë urdhrat hyjnorë nën kulmin e fjalës: *“O ju që keni besuar...”*

Një jetë pa besim në Atë që dha jetë, e bën atë të pavlefshme. Madje, sado që studiohet jeta, po që se nuk bëhet përpjekje për t'u kuptuar esenca e jetës dhe të arrihet deri të njohja e Dhënësit së saj, gjithë ajo përsiatje e lodhje, nuk ka kuptim.

Tekstet fetare kanë bërë një ndërlidhje të mahnitshme, në mes të ibadetit ndaj Zotit dhe kujdesit ndaj krijesave, duke filluar nga niveli më i afërt për njeriun e që janë prindërit.

“Ata kanë dije sipërfaqësore të kësaj bote, kurse janë plotësisht të verbëruar ndaj Ahiretit.” (Er Rrum, 7).

Asnjë arsye nuk e mbulon neglizhencën e njeriut për të kuptuar se jeta në këtë kozmos është krijimtari e Zotit Fuqiplotë. Sipas mësimëve fetare, krimi më i madh në raport me këtë segment është mosnjohja e Zotit, Krijuesit të Gjithësisë.

“Vërtet Allahu nuk e fal t'i bëhet shok Atij, kurse mëkatet më të vogla se kjo, i fal kujt të dojë.” (En Nisa, 48).

Prandaj kërkohet prerazi, që Krijuesit të Madhërishtëm, t'i nënshtrohemi si robër, e ta njohim Madhërinë e Tij, përmes adhurimeve që janë paraparë në fenë e pastër islame. Në kuptimin e përgjithshëm, ndërlidhja në mes këtyre dy segmenteve qëndron edhe në vetë faktin se tekstet fetare kanë bërë një ndërlidhje të mahnitshme, në mes të ibadetit ndaj Zotit



dhe kujdesit ndaj krijesave, duke filluar nga niveli më i afërt për njeriun e që janë prindërit.

Zoti Fuqplotë në Kuran thotë: *“Zoti yt urdhëroi prerazi, të mos adhurohet askush, përveç Tij dhe ndaj prindërve të bëhet mirësi.”* (El Isra, 23).

Kjo ndërlihdje në mes besimit dhe mirësjelljes ndaj krijesave të Zotit shkon deri në atë pikë saqë, të gjitha adhurimet, po që se nuk japin reflektim te besimtari në mirësjelljen e tij ndaj njerëzve, edhe dobia nga adhurimet bie tërësisht. Në njëfarë forme, mund të themi se ibadeti mund të matet me reflektimin e tij në raportet e besimtarit me njerëzit përreth tij.

Transmetohet se Pejgamberit të Zotit a.s., i treguan se kishin afër një grua që gjithë natën e kalonte në adhurim dhe gjithë ditën agjëronte, porse fqinjët e saj nuk janë rehat nga gjuha e saj. Pejgamberi u përgjigj shkurt dhe preraz: *“Nuk ka të mirë në atë grua, ajo është në zjarr.”*¹

Shpjegimet profetike qartësuan se besimtar është ai, nga dora dhe gjuha e të cilit, të tjerët janë rehat.² Ky urdhër përfshin të gjithë njerëzit pa dallim feje, ngjyre, kombi etj.. Për ata jomyslimanë që jetojnë në shoqërinë myslimane, Muhamedi a.s. iu drejtua besimtarëve me fjalët: *“Kush i shkakton ndonjë dëm jomyslimanit që jeton në shoqërinë islame, e fyen, e ngarkon përtej kapacitetit, apo i merr diçka pa dëshirën e tij, do të më ketë kundër Ditën e Kiametit.”*³

Ky reflektim i besimit nuk është i kërkuar vetëm në raport me njerëzit. Muhamedi a.s., besimtarëve ua kërkoi këtë gjë edhe në sjelljet e tyre me kafshët, kur u tha: *“Një grua ka hyrë në zjarr, për shkak të një maceje, e mbylli atë, as nuk e ushqeu dhe as nuk e liroi të ushqehet jashtë.”*⁴ Ky pasqyrim vije komfor shembullit të kundërt, kur tha: *“Një grua e keqe (prostitutë), kaloi pranë një pusi, afër të të cilit ishte një qen i etur, zbathi këpucën e saj dhe mori ujë nga pusi që t'i jepte qenit, për këtë veprim Zoti e falënderoi dhe ia fali mëkatet.”*⁵

RAMAZANI DHE RIPËRTËRITJA E BESIMIT

Nuk do mend se Ramazani, me një shtrirje tridhjetë ditore, besimtarit ia ofron mundësinë e ndryshimit dhe përmirësimit. Përmirësimi

Momentet e Ramazanit ofrojnë një lloj mbrojtjeje e vendstrehimi që bëhet si një lloj fortifikate, në të cilën besimtari do të jetë më i mbrojtur nga cytjet djallëzore. Kjo pasqyrohet në hadithin e Muhamedit a.s.: *“Agjërimi është mburojë.”*

parësor për besimtarin është ripërtëritja e raporteve të tij me Zotin Fuqplotë. Këtu fillon çdo përmirësim. Momentet e Ramazanit ofrojnë një lloj mbrojtjeje e vendstrehimi që bëhet si një lloj fortifikate, në të cilën besimtari do të jetë më i mbrojtur nga cytjet djallëzore. Kjo pasqyrohet në hadithin e Muhamedit a.s.: *“Agjërimi është mburojë.”*⁶ Përkushtimi tanimë ka arritur deri në atë pikë sa edhe hallallet të mos konsumohen, në mënyrë që, së paku, njësoj t'u përgjigjemi edhe haramëve. Kështu besimi fuqizohet në zemër dhe zemra ka liri të performojë me virtyte të larta dhe ibadete, që ia shtojnë edhe më shumë qetësinë zemrës. Shtohet dhikri (përmendja e Allahut) *“Me të përmendur Allahun, qetësohen zemrat.”* (Rrad, 28).

Një zemër e lirë nga këto cytje, niset drejt lutjeve të sinqerta. Ato lutje, si kible, kanë përpara premtimin hyjnor se do pranohen: *“Kur robërit e Mi të pyesin për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes së atij që më lutet.”* (El Bekare, 186).

Shtimi i namazit të natës (teravive), i kontribuon bukur kësaj ripërtëritje të besimit. Tani besimtari veç ka hyrë në ofensivë të rregullimit të këtij raporti, përballë cytjeve të shejtanit. Nuk flitet vetëm për durim, por për një mësymje serioze, me besim të fortë në sukses dhe i bindur shumë në mbështetjen që i dha Zoti i Madh, që besimtari të ofrojë pendim të sinqertë dhe nënshtrim të pakusht ndaj Zotit të vet.

RAMAZANI DHE RAPORTET NDËRNJERËZORE

Përderisa shtohet adhurimi në Ramazan, domosdo ky shtim do të reflektojë edhe në mirësjelljen e besimtarit ndaj njerëzve. Përveç kësaj, obligimet e Ramazanit përmbajnë në vete aspekte që qartazi u shërbejnë raporteve njerëzore. Në këtë muaj të bekuar janë vendosur disa obligime, apo forma adhurimesh, të cilat përveç të tjerash, duket se në rend të parë kontribuojnë në raportet e besimtarit me rrethin e tij familjar dhe shoqëror.

Nisur nga domosdoshmëria e të përmbajturit nga polemikat dhe sharjet e kundërshtimet në mes vete, përveç që agjëruesisit i ofron një drejtim që reflekton në



devotshmërinë e tij, kjo përmbajtje, jep fryte direkte në një qetësi sociale dhe mirëqenie kolektive. Muhamedi a.s. porositi: “*Kush fyhet nga dikush (në Ramazan), le të thotë unë jam agjërueshëm.*”⁷

Të ftuarit e ndërsjellë në mes familjarëve, shokëve e miqve në sofrë të përbashkëta, konsiderohet si një nga format më të vyeshme në forcimin e raporteve sociale. Këtë e gjejmë në Ramazan bukur të përhapur në mesin e shumë agjëruesve. Kjo vjen si përmbushje e porosisë profetike: “*Kushdo që ushqen një agjërues (për iftar), do të ketë sa shpërblimi i agjëruesit, pa i munguar agjëruesit shpërblimi i vet.*”⁸ Në mënyrë që mos të hezitojnë një pjesë e besimtarëve që mendojnë se nuk kanë kushte të mjaftueshme për të organizuar një ftesë të tillë, Muhamedi a.s., ofroi zgjidhjen për ta, kur u pyet nga shokët e tij: “*O i Dërguari i Allahut! Nuk ka mundësi çdonjëri nga ne të shtrojë iftar.*” Ai tha: “*Zoti i jep shpërblimin e plotë edhe atij që agjëruesit i ofron një gotë ujë, qumësht, apo edhe një hurme të vetme.*”⁹ Kjo është forma kur secili në shoqëri e sheh vetën baras me të tjerët, të denjë për të arritur shpërblimin dhe gradat e Xhenetit, me aktivizimin e tij në dobi të shoqërisë ku jeton, pa marrë parasysh shumën që ofron, përderisa ai tregon zemrën e pastër dhe qëllimin e mirë.

Edhe namazi i përbashkët gjatë netëve të Ramazanit, kur bëhet së bashku, paraqet një lidhje të fortë sociale, e formësuar, në kuadër të nënshtrimit të përbashkët ndaj Allahut Fuqiptotë dhe në kuadër të unifikimit dhe njësimimit të qëllimit të njëlojtë që të gjithë

Edhe namazi i përbashkët gjatë netëve të Ramazanit, kur bëhet së bashku, paraqet një lidhje të fortë sociale, e formësuar, në kuadër të nënshtrimit të përbashkët ndaj Allahut Fuqiptotë dhe në kuadër të unifikimit dhe njësimimit të qëllimit të njëlojtë që të gjithë agjëruesit e kanë – arritja e kënaqësisë së Zotit.

agjëruesit e kanë – arritja e kënaqësisë së Zotit.

Agjërimi, sipas mësimëve profetike, nuk është plotësisht i pranuar, pa mos menduar dhe kontribuar edhe për gjendjen e një pjese të shoqërisë, të cilët gjinden në kushte më të dobëta ekonomike. Bukur edhe këtu agjërimi (Ramazani), ndërlidhet për një kontribut social, duke i ofruar secilit të varfër shuma nga “*sadakatul fitri*”, në mënyrë që dallimet sociale të zhduken ose minimizohen në masën më të madhe të mundshme. Muhamedi a.s. tha: “*Sadekatul fitri është pastrim (nga mëkatet) për agjëruesin dhe ushqim për të varfërit.*”¹⁰ Kështu mund të themi se besimtari pas Ramazanit del fitimtar në suksesin e tij në ripërtëritjen e raporteve të tija me Zotin e vet dhe kjo është fitorja e madhe, por po ashtu fiton razinë e Zotit, me kujdesin e vet për robërit e Tij, duke synuar xhenetet e larta, i rreshtuar në një shoqëri ku secili anëtar i saj gëzon mirëqenie, përderisa kuptohen drejt mësimet e kësaj rruge të bekuar.

1 Transmetojnë Hakimi, 7305; Ahmedi, 9673; Buhariu në “*Edeb el Mufred*”, 119; Ibën Hibbani, 5764; e të tjerë.

2 Transmetojnë Buhariu, 10 dhe Muslimi, 40.

3 Transmeton Ebu Davudi, 3052.

4 Transmetojnë Ebu Davudi, 1194 dhe Nesaiu, 1482.

5 Transmetojnë Buhariu, 3467 dhe Muslimi, 2245.

6 Transmeton Buhariu, 1795.

7 Transmetojnë Buhariu, 1894 dhe Muslimi, 1151.

8 Transmeton Tirmidhiu, 807.

9 Po aty.

10 Transmetojnë Ebu Davudi 1609 dhe Ibën Maxheh, 1827.

Devotshmëria e ridefinuar

RAMAZANI DHE ZHVILLIMI I NJERIUT NË FOKUS

Evzal Sinani

Muaji i shenjtë Ramazan, përfaqëson një periudhë të mbushur me motive dhe frymëzime për njeriun. Jo vetëm aq, por ai shërben edhe si një furnizues i fuqishëm i energjisë që sjell te njeriu një mori ndryshimesh dhe përmirësimesh që doemos të reflektojnë në sjelljet e tija. Allahu Fuqiptotë ua bëri obligim myslimanëve agjërimin e këtij muaji me ajetin kuranor: *“O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të arrini devotshmërinë.”* (El Bekare, 183). Për të vijuar në ajetet e mëposhtme qartësimin, ku ndër të tjera thotë: *“Pra, kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë!”* (El Bekare, 185). Nga kjo urdhëresë e Krijuesit të Gjithëdijshëm, myslimanët kuptojnë se qëllimi kryesor i agjërimit të Ramazanit, po edhe të gjitha adhurimeve që kryhen brenda tij, është arritja e devotshmërisë dhe kësisoj si agjërimi i ditëve të tija po edhe falja e teravive, që janë një adhurim i posaçëm i netëve të këtij muaji, janë mjete për të arritur këtë qëllim.

PËRBËRJA E QENIES NJERI

Njeriu përbëhet nga katër komponentë kryesorë dhe madhështia e Islamit qëndron në faktin se për secilin nga këto komponentë ka trajtimin dhe ushqimin e duhur. Aspekti material i njeriut është vetëm një këto katër komponentë. Shpirtërorja, intelekti dhe emocionet përfaqësojnë tri komponentët e tjerë.¹

SHPIRTËRORJA BRENDA NJERIUT DHE RAMAZANI

Materialja dhe shpirtërorja brenda njeriut janë gjithmonë në proporcion të kundërt, ngritja e njëres nënkupton uljen e tjetres. Nga udhëzimet profetike që përshkruajnë gjendjen e haxhiut që viziton vendet e shenjta, shohim neglizhimin e qëllimshëm të anës së tij materiale, gjithmonë duke mos kaluar në papastërti, ngaqë ky anashkalim i materiales ngrit aspektin e tij shpirtëror duke e çuar atë në një nivel të lartë që rezulton me hapjen e deryve të Qiellit. Ramazani, në radhë të parë, shërben për këtë qëllim, fokusimin në anën shpirtërore dhe forcimin e saj. Nga Muhamedi a.s. përcillet se *“shejtani rrjedh brenda damarëve të birit të Ademit siç rrjedh gjaku”*,² e Imam Gazaliu, ekspert i spiritualizmit, përmend një transmetim që, edhe pse ka pasaktësi në zinxhirin e transmetuesve, është kuptimplotë dhe i saktë në porosinë që jep. Kjo pjesë e shtuar që mund të llogaritet edhe si udhëzim në luftën kundër shejtanit dhe djallëzive thotë: *“andaj, ngushtoni rrjedhat e tija nëpërmjet urisë.”*³

Definicioni terminologjik i Ramazanit është abstenimi nga haja, pija dhe kontakti gjinor, që prej agimit deri në perëndimin e diellit. Megjithatë, agjërimi arrin vlerën e tij të plotë kur nga e keqja abstenojnë edhe të gjitha gjymtyrët e njeriut nga të vepruarit keq. Ngushtimi i rrjedhave të së keqes brenda njeriut nëpërmjet urisë, që është kuptimi i parë i agjërimit, e ngrit nivelin shpirtëror të myslimanit dhe i hap rrugën atij për të arritur qëllimin tjetër, atë të abstenimit të veprimit keq në të gjitha format, me të gjitha gjymtyrët.

Nisur nga kjo strategji e ngritjes së shpirtërores, myslimanit në Ramazan i ofrohet një mjedis unik i favorshëm për vetëreflektim, duke i lejuar të rivlerësojë prioritetet e tija, të kërkojë falje për gjynahet e së shkuarës dhe të zhytet valëve të së panjohurës me siguri dhe shpresë, me bindje dhe kurajë, me mbështetjen në më të Fortin, Siguruesin.

Ishulli i materiales në detin e spiritualizmit *“Ne i dhamë atij (Isait) Inxhilin (Ungjillin), kurse në zemrat e pasuesve të tij mbollëm butësi dhe mëshirë. Sa për murgërinë, Ne nuk ua*

“O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të arrini devotshmërinë.”
(El Bekare, 183)





urdhëruam atë, por ata e shpikën vetë për të arritur kënaqësinë e Allahut. Megjithatë, nuk u kujdesën siç duhet për të...” (El Hadid, 27).

Allahu Fuqplotë si Krijues i njeriut e njeh çdo imtësi të qenies së tij dhe ka dije të përsosur edhe për skutat më të errëta të çdo elementi të ekzistencës së tij. Prandaj nuk ka urdhëruar asnjë popull në historinë njerëzore, e as myslimanët, në diçka që bie në kundërshtim me harmoninë në të cilën rrjedh qenia njerëzore. Nganjëherë, historikisht, njerëzit i kanë bërë obligim vetes disa veprime që prishin këtë harmoni funksionale të qenies së tyre, me të vetmin qëllim të kënaqin Madhërinë e Tij. Kështu kanë vepruar edhe besimtarët e Isait a.s. që shpikën murgërinë pas vdekjes së tij, por nuk mundën ta plotësojnë atë siç duhet. Murgjit e krishterë në Mesjetë stimulonin papastërtinë me qëllim të ngritjes së shpirtërores. Islami, për dallim, në çdo adhurim të tijin stimulon mbajtjen e baraspeshës mes të dyjave. Namazin, që është kontakti më i lartë shpirtëror për besimtarin gjatë të cilit ai i drejtohet Krijuesit të vet, e fillon me abdes, pra me pastrim, veprim ky që është fokusim në anën materiale të qenies njerëzore.

Edhe Ramazani, në këtë kontekst, ka ruajtur këtë harmoni të komponentëve të njeriut dhe nuk e ka neglizhuar plotësisht anën materiale. Pas një fokusi në anën shpirtërore nëpërmjet agjërimit, vjen koha e iftarit dhe fokusimit në anën materiale. Si pasojë, Islami nuk ka ndaluar asnjë nga ushqimet që janë të lejuara jashtë Ramazanit.

Megjithatë, është e pakontestueshme se vëmendja, në masën më të madhe, gjatë Ramazanit është në anën shpirtërore dhe kjo nuk e prish harmoninë e përgjithshme, ngase qëllimi i Islamit është të sigurojë baraspeshën në qenien njerëzore përgjatë gjithë vitit dhe ky fokusim në anën shpirtërore gjatë tërë muajit formon baraspeshën e përgjithshme mes këtyre dy komponentëve në periudhën njëvjeçare.

Nga ana tjetër, nuk gabojmë nëse themi se, Ramazani largon fokusin nga ana fizike e njeriut për ta forcuar atë. Janë të njohura dobitë e shumta shëndetësore të agjërimit dhe trajtimet për sëmundje të ndryshme që bëhen me të në klinika me renome botërore, si klinika Buhinger.

Pra, në trajtimin shpirtëror që Ramazani i bën besimtarit të sinqertë, nuk ka lënë pa ndërtuar në këtë det plot dobi një ishull të materiale. E ka bërë këtë i Urti, i Mirinformuari.

NUK KA FE AI QË NUK KA MENDJE

Shpallja e fundit e Zotit, Kurani është shpallur në Ramazan. Allahu Fuqplotë thotë: *“Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja)...”* (El Bekare, 185) Kurani përfaqëson mrekulli, është i papërsëritshëm, niveli më i lartë dhe i sofistikuar që mund ta ketë një libër dhe nuk e ka të shoqin. Ai nëpërmjet përzgjedhjes së duhur të fjalëve, radhitjes së tyre në fjali dhe kuptimit të thellë dhe të plotë që përçon te lexuesi është mrekullia më e madhe e Muhamedit a.s., nëpërmjet të cilës ka sfiduar gjithë poseduesit e intelektit.

Muhamedi a.s. çdo Ramazan përsëriste Kuranin me Xhibrilin, në një formë interaktive.⁴ Ky theksim i fokusimit në leximin, meditimin dhe interaktivitetin me Kuranin nuk ka qenë i rastësishëm në Ramazan, ashtu siç nuk është e rastësishme përzgjedhja e këtij muaji për ta zbritur atë. Nga praktika e Muhamedit a.s. mësojmë se është sunet të lexohet një herë Kurani, të paktën, gjatë këtij muaji. Kjo praktikë tregon se Muhamedi a.s. ushqente mendjen, krahas ushqimit të shpirtit dhe trupit gjatë këtij muaji të bekuar.

NDJENJAT DHE EMOCIONET NËN LLUPËN E RAMAZANIT

Nga aspekti i emocioneve, ndjenjave dhe sjelljeve njerëzore të ndërlidhura me emocione, Ramazani i agjëruar me

sinqeritet bën një reformë rrënjësore te njeriu, ose të paktën i dynd themelet e sjelljeve njerëzore të gabuara. Agjërimi gjatë Ramazanit kërkon abstenim nga ushqimi, pijet dhe nevojat e tjera fizike gjatë orëve të ditës. Ky akt i vetëdisiplinës dhe vetëkontrollit shkon përtej sferës fizike dhe shtrihet në aspektet psikologjike dhe emocionale të jetës së një individi. Praktika e agjëritimit gjatë Ramazanit ka një ndikim të thellë në karakterin dhe personalitetin e myslimanëve, pasi nxit cilësi të tilla si durimi, ndjeshmëria dhe mirënjohja.

Një nga ndikimet kryesore të agjëritimit në Ramazan është zhvillimi i durimit. Agjërimi teston aftësinë e një individi për të kontrolluar dëshirat e tyre dhe për t'i rezistuar tundimeve. Gjatë gjithë ditës, myslimanët përballen me sfida të ndryshme, si ndjesia e urisë dhe etjes. Duke praktikuar përmbajtjen dhe duke i duruar këto sfida, individët rritin gradualisht nivelin e durimit të tyre. Ky durim i sapo gjetur shpesh shtrihet përtej muajit Ramazan, duke kontribuar në një personalitet më të kompozuar dhe më fleksibil në jetën e përditshme.

Për më tepër, agjërimi gjatë Ramazanit gjithashtu kultivon ndjeshmëri brenda individëve. Gjersa myslimanët përjetojnë shqetësimin fizik të urisë dhe etjes, atyre u kujtohet gjendja e atyre me më pak fat. Kjo ndjenjë e rritur e ndjeshmërisë inkurajon aktet e bamirësisë dhe dhembshurisë ndaj të tjerëve. Myslmanët janë të motivuar për të ndihmuar dhe mbështetur ata në nevojë, duke nxitur një mirëkuptim dhe lidhje më të madhe me të tjerët. Kjo natyrë empatike rrit aftësitë e tyre ndërpersonale, duke i bërë ata individë më të dhembshur dhe më të kuptueshëm. Përveç saj, agjërimi gjatë Ramazanit ngjall edhe mirënjohje tek agjëruerit që nëpërmjet abstenimit bëhen të vetëdijshëm për bekimet që shpesh i marrin si të mirëqena në jetën e tyre të përditshme. Kjo ndjenjë e shtuar e mirënjohjes u mundëson myslimanëve të vlerësojnë bollëkun në jetët e tyre dhe të zhvillojnë një këndvështrim më pozitiv, duke rritur si pasojë mirëqenien e tyre të përgjithshme që rezulton në një personalitet më optimist dhe më të kënaqur.⁵

Ndikimi i agjëritimit në Ramazan shtrihet përtej nivelit individual dhe përshkon të gjithë komunitetin mysliman. Përvoja e përbashkët e agjëritimit nxit një ndjenjë uniteti dhe solidariteti mes myslimanëve. Përpyekja kolektive promovon një ndjenjë të fortë përkatësie dhe zhvillimin e një komuniteti koheziv. Praktika e faljes së teravive në bashkësi me imam, që janë një adhurim sunet, forcon ndjenjën e përkatësisë dhe përafron anëtarët e komunitetit. Individët fitojnë një ndjenjë

Ndër dobitë e shumta që Ramazani ia sjell besimtarit në aspektin emocional është edhe guximi për të thyer rutinën dhe të zakonshmen.

krenarie në praktikatat e tyre të përbashkëta fetare, gjë që forcon më tej identitetin e tyre dhe zhvillimin e përgjithshëm të personalitetit.

Ndër dobitë e shumta që Ramazani ia sjell besimtarit në aspektin emocional është edhe guximi për të thyer rutinën dhe të zakonshmen. Ky guxim, krahas faktit që e mëson myslimanin si të menaxhojë me situatat e jashtëzakonshme, bile edhe të adaptohet me to dhe të krijojë një stil të ri jetese varësisht prej nevojave dhe rrethanave, me nxjerrjen tonë prej zonës së komfortit, na bind praktikisht se sendet e mëdha dhe të rëndësishme në jetë, si ruajtja e harmonisë brenda qenies sonë, vijnë çdoherë pas përpjekjeve dhe sforcimit nga ana jonë. Megjithatë, nga përvojat individuale, asnjë agjëruer nuk e mohon se i tij është vetëm hapi i parë dhe se vazhdimësia karakterizohet me një forcë të brendshme, burimin e së cilës nuk e njohim dhe nuk mund ta definojmë. Kjo do të na thotë zëshëm të gjithëve se ashtu siç në këtë muaj, edhe në jetë, në çdo nismë tonën, po u fokusuar dhe e dhamë përpjekjen tonë

në formë serioze, vazhdimësia dhe suksesi do vijnë natyrshëm nga burime që nuk do mund t'i definojmë prej perspektivës sonë njerëzore. Prej nesh, sot dhe çdoherë, është kërkuar hapi i parë, me zemër të sinqertë.

PËRFUNDIM

Koncepti i devotshmërisë që kërkohet nga ne gjatë këtij muaji, nga ajo që përmendëm më lart, del të jetë më gjithëpërfshirës nga ajo që tradicionalisht kuptohet nga ky term. Duke u fokusuar në të gjitha aspektet e qenies njerëzore, devotshmëri përfshin ngritje shpirtërore, forcim fizik, përmirësim të brendshëm emocional dhe ngritje intelektuale për myslimanin gjatë Ramazanit, "që të bëheni të devotshëm" - që përmendet në ajetin e ligjësisë të agjëritimit nënkupton të gjitha këto. Neglizhimi i ndonjërit nga këto aspekte gjithësesi se e bën personalitetin model të myslimanit të çalë dhe poshtë nivelit të ideale. Ramazani është ligjësuar që ne të dalim të ndryshëm, më të mirë, më të arritur në të gjitha këto aspekte.

- 1 Ndarja e qenies njerëzore në katër komponentë është teori e prof. dr. Azmi Taha. Shih: Azmi Taha, *Islamic Culture*. (Amman: Kuds Open University, 2017)
- 2 Muhamed Ismail el Buhari, "*Sahih el Buhari*", (Damask, Ibën Kethir Publishing, 1993), v. 6, fq. 2623,
- 3 Ebu Hamid el Gazali, "*Ihja Ulum el Diin*", (Bejrut, Marifah Publishing), v.3, f. 82.
- 4 Shih: Buhari, v. 3, fq. 1177, hadithi numër 3048.
- 5 Ahmed, M. A. (Përfitimet psikologjike dhe fizike të agjëritimit), *Journal of Religion and Health*, (2015), 54 (2), 424-434.



Kategoritë e ngarkuara me agjërim dhe rastet që e justifikojnë mosmbajtjen e agjërimin

Bashkim Aliu

HYRJE

Islami është fe e cila në mësimet e veta ka lënë harmonizimin e dy aspekteve të rëndësishme të jetës në përgjithësi dhe të ritualeve fetare në veçanti: esencën dhe formën, gjegjësisht njeriun e shih si qenie dualiste: shpirtërore dhe materiale, dhe për këtë qëllim kërkon prej tij që të punojë në këtë botë për t'i plotësuar nevojat shpirtërore dhe materiale. Ai e ka promovuar qëllimin si parim bazë të vlefshmërisë së adhurimeve, por në të njëjtën kohë ka vënë rregulla dhe kushte të cilat duhet të plotësohen për të qenë një adhurim i pranuar në aspektin juridik formal. Kështu, nëse ndalemi t'i analizojmë katër shtyllat bazë të Islamit: namazin, agjërimin, zekatin dhe haxhin, do të shohim se esenca e këtyre adhurimeve konsiston në nënshtrim ndaj Krijuesit dhe ngritjen shpirtërore të njeriut, largimin e tij nga gjërat e urryera, ngritjen e tij në piedestale të larta të jetës shpirtërore, bërjen e tij të devotshëm, dhe përkushtimin në rrugën e Allahut të Madhërishëm, Mirëpo, ky aspekt nuk është i vetmi që duhet të plotësohet për vlefshmërinë e këtyre adhurimeve, por mësimet islame përmbajnë kushte, rregulla dhe veprime, të cilat duhet të plotësohen, për të qenë këto adhurime të vlefshme.

Së këndejmi, agjërimi si adhurim, ka synim bazë ngritjen shpirtërore të njeriut, humanizimin e tij, pajisjen e tij me virtyte të larta morale, si dhe shndërrimin e tij në faktor

Agjërimi si adhurim, ka synim bazë ngritjen shpirtërore të njeriut, humanizimin e tij, pajisjen e tij me virtyte të larta morale, si dhe shndërrimin e tij në faktor relevant pozitiv në shoqëri.

relevant pozitiv në shoqëri. Megjithatë, për të qenë agjërimi i vlefshëm, ka rregulla dhe kushte, ka gjëra që është obligim të bëhen me rastin e agjërimin, si dhe ka gjëra të cilat nuk guxojnë të bëhen, pasi e prishin agjërimin.

Në korpusin e rregullave juridike për vlefshmërinë e agjërimin, bëjnë pjesë edhe kategoritë e njerëzve të ngarkuar me agjërim, si dhe rastet që e justifikojnë prishjen e tij. Këto kategori dhe raste, do të jenë objekt shqyrtimi i këtij punimi.

KATEGORITË E NGARKUARA ME AGJËRIM

Agjërimi është adhurim trupor, dhe realizimi i këtij adhurimi nënkupton largimin nga veprime të caktuara, prej imsaku e deri në iftar. Karakteri i këtillë i këtij adhurimi që konsiston në abstenim nga gjëra të caktuara për një periudhë të caktuar kohore, pra gjatë ditës, e cila sipas dispozitave islame fillon me imsakun dhe mbaron me perëndimin e diellit, apo iftarin, na çon në pyetjen se a është agjërimi obligim për çdo person, apo ka kategori të caktuara njerëzish për të cilët agjërimi është obligim?

Kushtet që duhet të plotësohen për të qenë agjërimi obligim janë: 1. Të jetë mysliman; 2. Ta arrijë moshën madhore; 3. Të jetë mentalisht i shëndoshë; 4. Të mos jetë udhëtar; 5. Të mos jetë i sëmurë; 6. Gruaja të mos jetë në cikël (në të përmuajshme); 7. Të jetë në dijeni personi i cili ka kaluar në Islam

në një vend ku ka shumicë absolute të qytetarëve jomyslimanë se agjërimi është obligim. Këto janë kushtet e agjërimin sipas shkollës juridike hanefite.¹

PERSONAT QË NUK BËJNË PJESË NË KËTO KATEGORI

Përcaktimi i kategorive të përmendura, do të thotë se jomyslimanët nuk janë kategori e agjërimin, pasi ata në parim nuk besojnë në Islamin si fe dhe as në agjërimin si adhurim dhe obligim fetar. Kusht për vlefshmërinë e zbatimit të Islamit është besimi në të vërtetat islame dhe dëshmimi i përkatësisë islame.

AGJËRIMI I FËMIJËVE

Kategori e ngarkuar me detyrën e agjërimin nuk janë fëmijët, por janë ata që e kanë kaluar këtë fazë dhe kanë hyrë në fazën e moshës madhore. Sipas legjislacionit islam, një person kalon nga faza e fëmijërisë në fazën e moshës madhore, në rastin e meshkujve, kur ejakulon, si dhe me tregues të tjerë natyrorë që tregojnë se personi përkatës ka kaluar nga faza e fëmijërisë në atë të moshës madhore, dhe në rastin e femrave, kur i fillojnë menstruacionet. Në rast se vonojnë këto elemente, atëherë ata detyrohen me obligimet fetare kur të arrijnë moshën 15 vjeçare sipas kalendarit hënor.

Edhe pse fëmijët nuk janë kategori e ngarkuar me agjërim, nuk është e ndaluar, bile është e rrugës që prindërit t'i trajtojnë fëmijët me agjërim, duke pasur kujdes për përgatitjen trupore të fëmijës, gjegjësisht të mos e dëmtojë shëndetin e tij. Prindi duhet ta gjejë mënyrën

Personi i cili e humb vetëdijen në Ramazan, dhe kjo gjendje vazhdon gjatë gjithë muajit Ramazan, do ta kompensojë agjërimin e këtij muaji pas Ramazani.



më të përshtatshme për ta bërë këtë. Nëse fëmija agjëron, agjërimi i tij është i vlefshëm.

NJERËZIT ME ÇRREGULLIME MENTALE

Kategori e ngarkuar me agjërim nuk janë njerëzit që kanë probleme mentale, pasi ata nuk janë objekt i detyrave fetare. Obligimi i personave me detyra fetare varet nga aftësia e tyre për t'i kuptuar gjërat dhe të qenët e tyre të vetëdijshëm se çfarë janë duke bërë.

Në rast se kjo gjendje e shëndetit mental nuk është permanente, por në intervale të ndryshme kohore i kthehet vetëdija, atëherë nuk bie prej tij në tërësi obligimi i agjërimin, por duhet analizuar gjendja e tij. Kështu, nëse personi i këtillë e ka filluar muajin Ramazan, apo ka arritur një pjesë të muajit Ramazan në gjendje të rregullt mentale, obligohet që ta agjërojë Ramazanin. Nëse i ngelin ditë të pa agjëruara, ato ditë i kompenzon pas Ramazanit. Mirëpo, nëse gjatë gjithë Ramazanit ka qenë në gjendje jo të rregullt psikike, atëherë ky person nuk obligohet të agjërojë dhe nuk obligohet ta kompensojë muajin Ramazan.

Ky qëndrim arsyetohet me atë se personi i cili është i sëmurë mentalisht, nuk e ka kaluar muajin Ramazan, dhe as një pjesë të tij në gjendje të rregullt mentale.

Personi i cili e humb vetëdijen në Ramazan, dhe kjo gjendje vazhdon gjatë gjithë muajit Ramazan, do ta kompensojë agjërimin e këtij muaji pas Ramazani. Nëse personi e humb vetëdijen gjatë ndonjë dite të Ramazanit, nuk do ta kompensojë këtë ditë me agjërim (nuk do ta bëjë kaza), ngase agjërimi ka ndodhur, gjegjësisht ka ndodhur abstenimi i shoqëruar me nijet. Do t'i bëjë kaza ditët që nuk i agjëron më pas për shkak humbjes së vetëdijes.²

Dijetari i shquar Jusuf el Karadavi, Allahu e mëshiroftë, në lidhje me këtë shënon: "Personi i cili kohë pas kohe ka çrregullime mentale, konsiderohet i obliguar që t'i kryej detyrimet fetare në kohën kur kthehet në gjendje të rregullt mentale. Në këtë grup, disa juristë islamë i përfshijnë edhe personat të cilët e humbin vetëdijen ose bien në koma, dhe në këtë gjendje vazhdojnë një periudhë kohore, qoftë e gjatë apo e shkurtë. Sipas mendimit të tyre, personat e këtillë nuk obligohen as me namaz dhe as me agjërim gjatë kohës kur e humbin vetëdijen. Ndërkaq, kur të kenë vetëdije të plotë, nuk janë të obliguar t'i plotësojnë namazet dhe agjërimin që nuk

e kanë kryer gjatë asaj kohe sa nuk kanë qenë në vetëdije, pasi nuk ka qenë objekt i ngarkimit me detyra fetare.”

Nga ana tjetër, disa dijetarë tjerë mendojnë se personat në fjalë janë të obliguar që ta kompensojnë agjërimin që e kanë lëshuar gjatë kohës sa nuk kanë qenë në vetëdije, marrë parasysh se humbja e vetëdijes është sëmundje e cila e godet trurin e njeriut, por nuk e privon personin përkatëse nga detyrimet fetare, pasi nuk zgjat për një kohë të gjatë.

Sipas mendimit tim, kjo mund të merret si pikëpamje e drejtë nëse zgjat një ditë apo dy ditë. Mirëpo, humbja e vetëdijes për një kohë të gjatë, siç është rasti në këtë kohë kur njeriu mund të jetojë për një kohë të gjatë me aparate për frymëmarrje në gjendje kome, personi përkatës lirohet nga obligimi i kryerjes së detyrave fetare për atë kohë derisa ka qenë në gjendje të tillë, pasi kjo do të paraqiste për të vështirësi, ndërkaq Allahu i Madhërishëm nuk e ka bërë fenë të vështirë. Mbase, këtë qëndrim e ka kundërshtuar Ibën Rushdi, i cili ka thënë se dijetarët në të gjitha vendet janë të mendimit se personi i cili e humb vetëdijen, është i obliguar ta kompensojë agjërimin...”³

AGJËRIMI I UDHËTARIT

Kategoria “të mos jenë udhëtarë”, nuk i përfshinë ata të cilët janë udhëtarë. Kjo do të thotë se personat të cilët janë udhëtarë, gjegjësisht udhëtojnë në largësi afërsisht 89 kilometra,⁴ nuk obligohen me agjërim, dhe ato ditë sa kanë qenë udhëtarë, do t’i kompensojnë pas Ramazani. Por, nëse agjërojnë, agjërimi i tyre është i vlefshëm. Allahu i Madhërishëm ka thënë: “...E kush e përjeton prej jush këtë muaj, le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmurë ose në



udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. Allahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim...”⁵

Me këtë rast, duhet nënvizuar se vetë udhëtimi është shkak që e justifikon mos agjërimin, e jo kushtet apo mjetet e udhëtimit. Me fjalë të tjera, nuk është e saktë ajo që mund të pretendojnë disa se udhëtimi me mjete komode për udhëtim, siç janë në kohën tonë aeroplanët, trenat, veturat, etj., nuk e justifikon mos agjërimin, por vetëm udhëtimi në këmbë apo me kafshë, që si zakonisht shkakton vështirësi. Kjo nuk mban, pasi Kurani e potencon udhëtimin si shkak për justifikimin e agjërimin, e jo mjetin apo mënyrën e udhëtimit. Kjo, mbase do të ishte më mirë që të agjërohet, nëse udhëtimi bëhet me mjete komode dhe personi nuk has vështirësi në udhëtim, nisur nga fakti se vlera e muajit Ramazan është e pa arritshme pas kalimit të tij, edhe pse obligimi plotësohet me kompensimin e ditëve të lëshuara në Ramazan, pas tij.

Sipas pjesës më të madhe të dijetarëve, udhëtari ka të drejtë që mos të agjërojë, nëse e fillon udhëtimin para agimit të ditës, ndërkaq, nëse e fillon ditën duke qenë në shtëpi, e pastaj brenda ditës e fillon udhëtimin, atë ditë duhet ta agjërojë dhe nuk i lejohet ta prishë agjërimin, edhe pse ka nisur në udhëtim.

Krahas asaj se udhëtari nuk e ka obligim agjërimin, dijetarët kanë debatuar për atë se çka është më mirë për udhëtarin: të agjërojë, apo mos të agjërojë. Kështu, sipas hanefive dhe shafive, për udhëtarin është më mirë të agjërojë, nëse nuk dëmtohet. Ndërkaq, sipas malikive dhe hanbelive, mos agjërimi i udhëtarit është sunet, dhe nuk pëlqehet agjërimi në rast të udhëtimit që e dikton shkurtimin e namazit.⁶ Nga ana tjetër, sipas Omer ibn Abdulazizit, Muaxhahidit dhe Katades, për agjëruenin është më mirë ajo që është më lehtë. Këtë mendim e ka përzgjedhur edhe Jusuf el Karadavi⁷, i cili këtë e arsyeton me atë se vetë i Dërguari i Allahut kur ka zgjedhur në mes të dy gjërave, çdo herë e ka zgjedhur atë që ka qenë më e lehtë, derisa nuk ka qenë mëkat. Disa dijetarë të tjerë kanë thënë se agjërueni është ai që vendos vetë se a do të agjërojë, apo jo derisa është udhëtar, pasi ai ka të drejtë ta bëjë edhe njëherë, edhe tjetrën.

Statusin e udhëtarit e kanë edhe personat të cilët udhëtojnë në kuadër të punës që kryejnë, siç është rasti me vozitësit e autobusëve, pilotët, etj.. Këta janë vazhdimisht në udhëtim, dhe kur këtë e bëjnë gjatë muajit Ramazan, e kanë të lejuar që mos të agjërojnë, por agjërimin do ta kompensojnë pas Ramazani, kur do t’u jepet mundësia. Jusuf el Karadavi, shprehet se nëse nuk u jepet mundësia të agjërojnë edhe pas Ramazani për shkak natyrës së punës, apo për ndonjë shkak tjetër, atëherë e marrin statusin e personave që kanë sëmundje kronike, dhe agjërimin do ta kompensojnë me ushqimin e të varfrit - fidje.⁸



AGJËRIMI I PERSONIT TË SËMURË

Kategoria “të jenë të shëndoshë”, nuk i përfshinë ata që janë të sëmurë në këtë kohë, pasi ajeti qartë shprehet: “ ... Ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. Allahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim...”⁹ Që të mos obligohet agjërimi për shkak të sëmundjes, sëmundja duhet të jetë e tillë që e vështirëson shumë agjërimin, apo të ketë frikë se nëse agjërohet, personi dëmtohet si qenie njerëzore, apo të ketë frikë se agjërimi do ta shtojë sëmundjen, apo do ta prolongojë shërimin nga sëmundja. Nëse sëmundja nuk e dëmton agjëruetin dhe nuk ia rëndon gjendjen shëndetësore, personit nuk i lejohet të mos agjërojë.¹⁰ Këtë status e marrin edhe personat të cilët janë të shëndoshë, por në kohën e Ramazanit kryejnë ndonjë punë të rëndë, e cila kërkon fuqi fizike, ashtu që agjërimi mund të jetë një faktor potencial që do ta dëmtonte shëndetin e tyre, siç është rasti me punëtorët që punojnë në miniera, apo që kryejnë ndonjë punë tjetër të rëndë fizike. Këta persona, nëse nuk mund të marrin pushim, apo të punojnë me orar të shkurtuar, agjërimin do ta kompensojnë pas Ramazani, ngase ka mundësi që ta dëmtojnë shëndetin nëse agjërojnë, e në Kuran, në ajetet që flasin për agjërimin, qartë është theksuar

Që të mos obligohet agjërimi për shkak të sëmundjes, sëmundja duhet të jetë e tillë që e vështirëson shumë agjërimin, apo të ketë frikë se nëse agjërohet, personi dëmtohet si qenie njerëzore, apo të ketë frikë se agjërimi do ta shtojë sëmundjen,

se: “Allahu dëshiron me këtë t’ua lehtësojë juve, e jo t’ua vështirësojë”.

Nëse sëmundja është e përkohshme, personi do t’i agjërojë ditët e lëshuara në Ramazan, pasi të kalon Ramazani. Por, nëse sëmundja është kronike, atëherë personi nuk agjëron, por në vend të agjërimit do të japë “fidje”, gjegjësisht do ta kompensojë agjërimin me ushqimin e një të varfëri për çdo ditë që nuk ka agjëruar.

Në këtë kontekst trajtohet edhe personi i cili ka arritur moshë të thellë të pleqërisë, dhe kjo moshë nuk ia mundëson që të agjërojë. Edhe personat e shtyrë në moshë, të cilët për shkak të moshës nuk mund të agjërojnë, nuk obligohen me agjërim.

I SËMURI NGA ALZHEIMERI

Në lidhje me agjërimin e personit që vuan nga kjo sëmundje, dijetarët bashkëkohorë kanë dhënë disa mendime, e në këtu do ta përmendim mendimin e tretë, i cili duket se është më gjithëpërfshirës në kuptim të marrjes parasysh të fazave të sëmundjes dhe rregullave legislative islame për kushtet e vlefshmërisë dhe obligueshmërisë së agjërimit dhe adhurimeve fetare në përgjithësi.

MENDIMI I TRETË: SËMUNDJA E ALZHEIMERIT KA DISA FAZA DHE NIVELE

I sëmuri nga Alzheimeri, i cili e arrin nivelin e humbjes së memories, ashtu që harron, nuk i njeh të afërmit, apo bën veprime skandaloze të cilat nuk u takojnë njerëzve të mençur, e të ngjashme, konsiderohet jo i obliguar fetarisht me detyrat fetare, ashtu që prej tij nuk kërkohet të agjërojë, as ta plotësojë agjërimin më vonë, dhe as ta kompensojë me ushqim të të varfrit.

Nëse i sëmuri nga Alzheimeri është në fazat e hershme të sëmundjes, ashtu që ka humbje të pjesërishtme të memories, ngase i harron gjërat që kanë ndodhur në kohën më të afërt, mirëpo sjellja e tij është e matur dhe e kontrolluar, i njeh anëtarët e familjes, e të ngjashme, konsiderohet i obliguar me detyrat fetare. Ky duhet të agjërojë, nëse ka mundësi dhe nuk ka pengesa të tjera. Me këtë rast, ky nuk mund të kalojë në kompensimin e agjërimit me ushqim të të varfrit, me

Agjërimi nuk është obligim për gruan që është me menstruacione, si dhe për gruan që është shtatzënë apo që ka fëmijë në gji, nëse agjërimi e pengon në shtatzëni dhe gjidhënie.

përjashtim nëse nuk mund ta përballojë agjërimin për ndonjë problem, dhe është rëndë që ta plotësojë agjërimin më vonë. Në këtë rast, mund të kalojë në kompensimin e agjërimit me ushqimin e një të varfëri. (Fetvaja nr. 361768-islamweb.net)

Po ashtu, edhe Komisioni për Fetva pranë organizatës “El Itihad el-I slamij” në Liban, i udhëhequr nga shejh Othman Dijab, e ku marrin pjesë edhe shejh Velid Abas, prof. Ali Ibrahim, shejh Muhamed Talib, shejh Mahmud Sad Ali, shejh Jusuf el Kadirij, shejh Abdunasir Nessar, mbajnë qëndrimin se i sëmuri nga Alzheimeri në faza të përparuara, nuk obligohet me agjërim për shkak se i mungon kushti “el-aklu”. Sëmundja në këtë fazë e ka rrëmbyer memorien e tij, ashtu që nuk është mentalisht i shëndoshë, dhe me këtë nuk obligohet me detyra fetare. Sipas kësaj, ai nuk do ta kompensojë agjërimin as me ushqim të një të varfëri (fidje), por tutori i tij, apo fëmijët, obligohen ta japin për të sadekatul fitrin.

AGJËRIMI I GRUAS ME MENSTRUACIONE

Agjërimi nuk është obligim për gruan që është me menstruacione, si dhe për gruan që është shtatzënë apo që ka fëmijë në gji, nëse agjërimi e pengon në shtatzëni dhe gjidhënie. Në këtë rast, ajo është fizikisht e pa mundshme të agjërojë.¹¹ Pra, mendimi i pjesës më të madhe të dijetarëve të të gjitha shkollave juridike islame është se gruaja me menstruacione nuk do të agjërojë, dhe nëse agjëron, duhet përsëri ta kompensojë agjërimin, pasi agjërimi me menstruacione nuk është i vlefshëm.

1 El Kasani, Ebu Bekër ibën Mesud, “*Beda’i’us-Sana’i’fi Tertib ash-Shara’i*”, Matba’atul xhemalije, Egjipt, 1328h, vëll.II, f.83; Ez Zuhajli, Vehbe, “*El Fikhul islamij ve edil-letuhu*”, Darul fikër, botimi i dytë, Damask, 1985, 625-626.

2 Ez Zuhajli, vep. e cit., f.626.

3 El Karadavi, vep. e cit., f.44.

4 Tuhmaz, vep. e cit., f.375.

5 El Bekare, 185.

6 Ez Zuhajli, vep. e cit., f.643.

7 El Karadavi, vep. e cit., f.58.

8 Po aty, f.68.

9 El Bekare, 185.

10 Ez Zuhajli, vep. e cit., f.645.

11 Shih: Ez Zuhajli, vep. e cit., f.615, ‘Itri, vep. e cit., f.18.





Dispozita e agjërimit të shtatzënës dhe gjdhënëses dhe mënyra e kompensimit të tij

Dr. Ilmije Kuqi

Agjërimi i muajit Ramazan është një ndër pesë shtyllat e Islamit, të cilin Zoti i Madhëruar ia bëri obligim robërve të Tij myslimanë. Ky obligim është përmendur në Kuran, e për të cilin, i Lartmadhëruari, thotë: *“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.”* (El Bekare, 183).

Agjërimi është një nga ibadetet më të rëndësishme dhe më madhështore, përmes së cilit, myslimani i ofrohet Krijuesit të tij. Ai dallohet nga shtyllat e tjera të Islamit nga vendi i veçantë dhe i posaçëm që gëzon te Zoti, duke qenë se nëpërmjet gjuhës së profetit të Tij, Ai ka thënë: *“Çdo vepër e birit të Ademit është për të, përveç agjërimit. Ai është për Mua dhe Unë shpërblejë për të.”*¹

Agjërimi është i detyrueshëm për çdo mysliman të aftë e të moshërritur që ka mundësi të agjërojë. Por, megjithëkëtë, ka raste kur ndërprerja e agjërimit gjatë Ramazanit lejohet me kushtin e kompensimit ose dhënies së fidjes për ditët e pa agjëruara. Madje, ka raste specifike ku ndërprerja e agjërimit bëhet e detyrueshme për shkak të frikës nga dëmtimi. Këto arsye mund të ndryshojnë, disa prej tyre janë specifike për gratë, siç janë shtatzënia dhe gjdhënia, ndërsa disa janë të përgjithshme për të gjithë njerëzit, siç është sëmundja dhe pleqëria. Ne, në këtë artikull, do të fokusohemi në dispozitat e agjërimit të shtatzënës dhe gjdhënëses në Ramazan, dhe t'i përgjigjemi pyetjeve: A është agjërimi i detyrueshëm për

to? A lejohet ndërprerja e agjërimit dhe nëse e ndërprerë agjërimit, a duhet të kompensohet apo të paguhet fidjeh për ditët e pa agjëruara?

Dispozita e agjërimit të shtatzënës dhe gjdhënëses

Sa i përket dispozitës së agjërimit të gjdhënëses dhe shtatzënës, ekzistojnë dy raste që e shpjegojnë këtë dispozitë.

Rasti i parë: Nëse gjdhënësja dhe shtatzëna nuk ndikohen nga agjërimi dhe nuk i shkakton ndonjë rrezik atyre apo fëmijës së tyre, atëherë në këtë rast, të dyjave u obligohet agjërimi dhe nuk lejohet prishja e tij.

Rasti i dytë: Nëse gjdhënësja dhe shtatzëna kanë frikë se do t'u rrezikohet jeta e tyre, ose nëse gruaja shtatzënë ka frikë për fetusin ose gruaja gjdhënëse për foshnjën, në bazë të disa shenjave ose përvojave, madje edhe nëse kjo përvojë është nga dikush tjetër, kur në pyetje është sëmundja e njëjtë, ose në bazë të mendimit të mjekut të kualifikuar, i cili është mysliman që nuk i dihet gjendja e tij, pra nuk



Nëse gjdhënësja dhe shtatzëna nuk ndikohen nga agjërimi dhe nuk i shkakton ndonjë rrezik atyre apo fëmijës së tyre, atëherë në këtë rast, të dyjave u obligohet agjërimi dhe nuk lejohet prishja e tij.



njihet për mëkate, Islami ua lejon të mos agjërojnë. Këtë e dëshmon hadithi: *“Allahu e ka liruar udhëtarin nga agjërimi dhe gjysma e namazit, si dhe shtatzënë dhe gjdhënësen.”*²

Në këtë hadith, Pejgamberi a.s., dispozitën e shtatzënës dhe gjdhënësës e ka bërë të njëjtë me të udhëtarit dhe të sëmurit. Udhëtarit dhe i sëmuri e prishin agjërimin dhe e kompensojnë atë, po ashtu edhe gruaja shtatzënë dhe gjdhënëse.

Gjdhënësës, gjithashtu i lejohet të prishë agjërimin për shkak të pirjes së ilaçit që parandalon diarrenë e foshnjës, nëse këtë ia rekomandon mjeku.

Nga kjo nënkuptojmë se agjërimi për gruan shtatzënë apo gjdhënësen në thelb është i detyrueshëm, si për çdo mysliman tjetër që është i detyruar ta bëjë këtë. Atyre nuk u lejohet ta prishin agjërimin gjatë muajit Ramazan nëse trupi i tyre është i fortë dhe mund të agjërojnë, si dhe nëse agjërimi i tyre nuk e dëmton fetusin ose foshnjën. Mirëpo, ashtu siç nuk i lejohet një gruaja shtatzënë apo gjdhënëse të prishë agjërimin gjatë muajit Ramazan nëse trupi i saj është i fortë dhe mund të agjërojë dhe nëse agjërimi gjithashtu nuk i shkakton dëm fetusit ose foshnjës, nga ana tjetër, prishja e agjërimit është obligim për gruan shtatzënë dhe gjdhënëse nëse e shohin se agjërimi mund t'i shkaktojë dëme serioze. Atyre u lejohet ta prishin agjërimin gjatë muajit Ramazan, me dy kushte, të cilat janë si vijon:

Gruaja shtatzënë ose gjdhënëse duhet të ketë frikë për veten apo fetusin dhe foshnjën, apo dëmtimin e rëndë ose sëmundjen.

Frika e gruas duhet të bazohet në udhëzimet e mjekut të kualifikuar, një përvojë të mëparshme ose një rekomandim nga një grua tjetër që e ka pasur këtë përvojë më parë.

Nëse shtatzëna dhe gjdhënësja e prishin agjërimin, ato obligohen vetëm me kompensimin e ditëve e pa agjëruara dhe nuk obligohen të paguajnë fidjen.

KOMPENSIMI I AGJËRIMIT TË RAMAZANIT

Nëse shtatzëna dhe gjdhënësja e prishin agjërimin, ato obligohen vetëm me kompensimin e ditëve e pa agjëruara dhe nuk obligohen të paguajnë fidjen. Kjo duke bërë analogji me udhëtarin dhe të sëmurin, të cilët i përmend Allahu në Kuran: *“E kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëron), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë.”* (El Bekare, 184).

Allahu xh.sh. e obligon të sëmurin dhe udhëtarin me kompensimin e ditëve të pa agjëruara dhe nuk e përmend fidjen. Ndërsa dispozita e shtatzënës dhe gjdhënësës është e njëjtë me të udhëtarit dhe të sëmurit, shërimi i të cilit shpresohet, kështu që ajo duhet ta kompensojë atë nëse është në gjendje ta bëjë këtë. Kjo mbështetet gjithashtu nga hadithi: *“Allahu e ka liruar udhëtarin nga agjërimi dhe gjysma e namazit, si dhe shtatzënë dhe gjdhënësen.”*³

Sipas këtij hadithit, bëhet e qartë se dispozita e shtatzënës dhe gjdhënësës është e njëjtë me të udhëtarit dhe të sëmurit. Udhëtarit dhe i sëmuri e prishin agjërimin dhe e kompensojnë atë, po ashtu edhe gruaja shtatzënë dhe gjdhënëse. Nëse themi se duhet dhënë fidjen, atëherë detyrohemi të shtojmë në Kuran, prandaj mund konkludohet se pagimi i fidjes nuk është obligim, por është një veprim i rekomanduar (mustehab).

Është e rëndësishme të përmenden edhe mendimet e tre shkollave juridike të tjera lidhur me këtë çështje për shkak të fetvave të ndryshme që dëgjoen në kundërshtim me të gjitha këto shkolla. Sipas këtyre tre shkollave juridike, nëse një grua shtatzënë ose gjdhënëse frikësohet për veten dhe për fëmijën e saj, ose vetëm për veten, ajo është e detyruar të kompensojë vetëm ditët e pa agjëruara. Por, nëse ajo frikësohet vetëm për fëmijën e saj, ajo është e detyruar të kompensojë ditët e pa agjëruara dhe të paguajë fidjen.

Nga kjo, kuptohet që gruaja shtatzënë dhe gjdhënësja unanimisht obligohen të kompensojnë ditët e pa agjëruara sipas katër shkollave juridike. Ndërsa mospajtimi i tyre lidhet me faktin se a janë gjithashtu të detyruara të paguajnë fidjen apo jo. Sipas shkollës hanefite, nuk janë të detyruara të paguajnë fidjen, ndërsa tre shkollat e tjera e konsiderojnë atë të detyrueshme.

KUSHTET E OBLIGIMIT TË KOMPENSIMIT

Të gjitha kushtet, të cilat duhet plotësuar për agjërimin e Ramazanit janë kushte për kompensimin e tyre, me përjashtim të kohës dhe caktimit të nijetit natën. Kjo do thotë se mund të kompensohen në çfarëdo kohe, me përjashtim të ditëve kur është i ndaluar agjërimi, si dhe nuk lejohet të kompensohen vetëm se me bërjen nijet natën, e kundërta e agjëtimeve në kohën e tyre.

Personat, që nuk e kanë agjëruar Ramazanin, që në mesin e tyre në këtë rast është shtatzëna dhe gjdhënësja, obligohen me kompensim të aq ditëve që nuk i kanë agjëruar në Ramazan. Ato obligohen të kompensojnë ditët e pa agjëruara, pas kalimit të muajit Ramazan, sepse atëherë më nuk ka arsye për mos agjërim. Mirëpo, nëse vdesin gjatë kohës së ekzistimit të justifikimit të tyre, për to nuk është obligim kompensimi, sepse kanë vdekur para se t'u bëhet obligim kompensimi. E nëse e lënë testament që të ushqejnë të varfër për to, testamenti i tyre është i drejtë edhe pse nuk kanë qenë të obliguara, kurse të varfrit ushqehen nga një e treta e pasurisë së tyre.

Në rast se shtatzëna dhe gjdhënësja nuk i kompensojnë ditët e pa agjëruara derisa të vdesin, duke pasur mundësinë e kompensimit të agjërimin, ato duhet ta lënë testament që trashëgimtarët e tyre të japin fidjeh, për çdo ditë ta ushqejnë nga një të varfër. Kjo për shkak se kompensimi u është bërë obligim dhe mandej u është paraqitur paafësia, shkak i lënies së tyre pas dore, kështu që obligimi transferohet në atë që e zëvendëson atë, e që në këtë rast është fidja. Këtë e dëshmon hadithi, të cilin e transmeton Amrah bint Abdurrahmani r.a., e cila thotë: *“E pyeta Aishen r.a. e i thashë asaj: “Nëna ime ka vdekur e i ka mbetur Ramazani (pa agjëruar), a bën ta kompensoj për të?” Ajo tha: “Jo, mirëpo jep sadaka për të për çdo ditë një të varfëri, kjo është më e mirë se agjërimi yt për të.”*⁴

Këtë e dëshmon gjithashtu etheri i transmetuar nga Nafiu r.a., i cili thotë: *“Ibën Umeri r.a. kur pyetej për ndonjë njeri që kishte vdekur dhe kishte ditë të pa agjëruara nga Ramazani ose zotimi, thoshte: “Askush nuk agjëron për askënd, mirëpo jepni lëmoshë për të nga pasuria e tij për agjërim, për çdo ditë një të varfëri.”*⁵ Në një transmetim tjetër nga ai, thuhet: *“Askush nuk falet për askënd, dhe askush nuk agjëron për askënd, por në qoftë se e bëni atëherë jepni sadaka për të.”*⁶

Shtatzëna dhe gjdhënësja, e ka lirinë të zgjedhë kur të kompensojë ditët e pa agjëruara dhe në cilën kohë do të fillojë agjërimin.

KOHA E OBLIGIMIT TË KOMPENSIMIT

Kohë e kompensimit janë të gjitha ditët jashtë Ramazanit me përjashtim të gjashtë ditëve, e që ato janë: dy bajramet dhe ditët e teshrikut. Këtë e dëshmon ajeti: *“E kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëron), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë.”* (El Bekare, 184).

Urdhri për kompensimin e ditëve të pa agjëruara në ajet është i pakufizuar në kohë, andaj nuk lejohet të kufizohet në një periudhë të caktuar, përveç nëse ka ndonjë argument të vlefshëm për të bërë këtë.

Prandaj, sipas mendimit të drejtë, kompensimi i ditëve të pa agjëruara nuk kufizohet të bëhen në ditë të caktuara, mirëpo i obliguari me kompensim, që në këtë rast është shtatzëna dhe gjdhënësja, e ka lirinë të zgjedhë kur të kompensojë ditët e pa agjëruara dhe në cilën kohë do të fillojë agjërimin. Koha në të cilën zgjedhë të agjërojë do të konsiderohet si plotësim i obligimit. Nëse i

obliguari me kompensim, që në këtë rast është shtatzëna dhe gjdhënësja, nuk fillon të agjërojë, atëherë kufiri kohor i obligimit i ngushtohet në vitet e fundit të jetës së tij dhe gjatë kësaj kohe agjëron kurdo që i jepet mundësia para vdekjes.

Nuk kushtëzohet që ditët e pa agjëruara të agjërohen para ardhjes së Ramazanit tjetër. Prandaj, është thënë nuk është mekruh për personin që ka për t'i kompensuar ditët e pa agjëruara të Ramazanit të agjërojë vullnetarisht dhe nëse e vonon derisa të hyjë Ramazani tjetër, nuk ka nevojë të paguaj fidjeh. Megjithatë, duhet ditur se është më mirë shpejtimi i kompensimit të ditëve të pa agjëruara.

Gjithashtu, agjërimi i ditëve të pa agjëruara nuk kushtëzohet të jetë i njëpasnjëshëm, por personi është i lirë t'i agjëroj ato ditë të ndara ose të njëpasnjëshme. Ky fleksibilitet është për shkak të mungesës së kufizimit të përmendur në ajetin e lartpërmendur. Megjithatë, praktika e preferuar është të agjërohen ditët e pa agjëruara njëra pas tjetrës për heqjen e obligimit sa më shpejt që është e mundur.

1 El Buhari, nr: 1904, 3/26, Muslimi, nr: 1151, 2/807.

2 Ahmedi, nr: 20326, 33/436, Shejh Shuajbi thotë: *“Hadithi është i mirë”*.

3 Ahmedi, nr: 20326, 33/436, Shejh Shuajbi thotë: *“Hadithi është i mirë”*.

4 Sherhu Mushkel el Athar, 5/178. Et Turkmani, në El Xhevher nekij, 4/257, thotë: *“Senedi i tij është sahih”*.

5 Sunen el Kubra i Bejhekiut, nr: 8215, 4/4242.

6 Abdurrezak, nr: 16346, 9/61. Et Tehanevi, në l'au es Sunen, 9/159, thotë: *“Transmetuesit e tij janë transmetues të sahihut, përveç Abdullahut që është prej transmetuesve të Muslimit”*.

Ç'është e urryer për agjëruesin?

Vehbi Sylejman Gavoqi¹

Për agjëruesin janë të urryera disa veprime:

1. Të përtypurit e çamçakëzit, era dhe shija e së cilit është harxhuar, dhe që prej tij nuk rrjedh gjë që arrin në brendi-stomak.²

Megjithëqë nuk arrin gjë në brendi të trupit nga jashtë, për shkak se është e urryer, është rrezik për ta prishur agjërimin duke gëlltitur ndonjë pjesë të tij (të çamçakëzit) dhe se tek ata që e shohin duke mbajtur në gojë dhe përtypur diçka gjatë kohës së agjërimit, lind dyshimi se ai nuk është duke agjëruar. Aliu r.a. ka thënë: “Ndalohuni prej asaj që urren mendja, edhe nëse te ti ka ndonjë arsye.”

Ibni Omeri ka thënë: “Kush e paraqet veten të dyshimtë, të mos e qortojë atë që mendon keq për të (akuzuesin).”

2. Të shijuarit e ushqimit dhe pijeve, pa arritur gjë në brendi, siç është rasti me gruan që shijon gjellën ose ushqimin për fëmijën e saj, pa nevojë, pasi në shtëpi ka dikush që nuk është agjërueshëm me arsye dhe ka mundësi ta shijojë ushqimin e ta përgatitën si duhet.

E nëse në shtëpi nuk ka njeri që nuk agjëron dhe gruaja frikësohet prej sjelljeve të këqija të burrit, apo se do ta prishë ushqimin, atëherë asaj i lejohet shijimi i ushqimit, pa kurrfarë vërejtjeje për të.

Gjithashtu urrehet shijimi i qumështit ose i prodhimeve të tij gjatë blerjes në treg, nëse ka dikush që nuk është agjërueshëm për ta shijuar ose i besohet shitësit, në të kundërtën nuk është gjë e urryer.

Gjithashtu është e urryer rregullimi i dhëmbëve te stomatologu duke qenë agjërueshëm, për shkak të shijes së ilaçit të përdorur, me kusht që të mos i shkojë diçka

nga ilaçi brenda, e nëse i shkon, atëherë agjërimi priset dhe duhet të bëhet *kaza* pa kefare.

3. Puthja e bashkëshortes nga i riu, pastaj përqaftimi dhe prekja e vendeve të turpshme, nëse nuk është i sigurt në veprime të mëtejshme (nëse nuk e ka veten nën kontroll).

Transmetohet nga Ebi Hurejre se një njeri e kishte pyetur Pejgamberin a.s. për ledhatimin e gruas duke qenë agjërueshëm, e Pejgamberi a.s. e lejoi atë. Më pastaj erdhi një tjetër dhe i bëri të njëjtën pyetje, e Pejgamberi a.s. e ndaloi. Ai që e lejoi ishte i vjetër në moshë, e ai që e ndaloi, ishte i ri.³

Imam Maliku, Shafiu dhe Ahmedi e quajnë të urryer puthjen dhe përqaftimin e gruas në qoftë se është i sigurt se nuk do të ketë marrëdhënie intime, ndërsa e konsiderojnë haram (të ndaluar) nëse nuk është i sigurt ose është i bindur se një gjë e tillë mund të ndodhë.

Autori thotë: “Mendimi më i këshilluar fetarisht është mendimi i tre imamëve, kurse mendimi (i lartpërmendur) i hanefive është më i lehtë. E nëse ndodh orgazma (hedhja e spermës), gjatë puthjes apo ledhatimit, agjërimi priset. Ai e vazhdon atë ditë me agjërim për ta kompensuar atë ditë me një ditë tjetër, pa kefare.”

4. Veprimi i asaj që dyshohet se e dobëson njeriun për agjërim, siç është dhënia e gjakut apo hixhamja (nxjerrja e gjakut në kokë, një metodë shërimit). I është thënë Enes bin Malikut: “A e kini urryer hixhamen për agjëruesin gjatë kohës së Pejgamberit a.s.?” Ai tha: “Jo, me përjashtim si shkak dobësimi (lodhjeje).”⁴

E nëse në shtëpi nuk ka njeri që nuk agjëron dhe gruaja frikësohet prej sjelljeve të këqija të burrit, apo se do ta prishë ushqimin, atëherë asaj i lejohet shijimi i ushqimit, pa kurrfarë vërejtjeje për të.



5. Angazhimi i tepërt i agjëruesit në punë, lojë, ecje etj., veprime të cilat e vështirësojnë agjërimin duke mos qenë të domosdoshme. Ebul Huda ka thënë: “Nuk është mirë që dikush të punojë shumë deri në atë masë sa vështirëson agjërimin. Le të punojë gjysmë dite dhe pjesën tjetër le të pushojë, e nëse thotë se kjo nuk i mjafton, gënjen, qoftë edhe në ditët më të shkurtra të dimrit, siç përmendet në librin “*Ed Durru-muhtar*”.

Ibën Abidini ka thënë: “Nevojat ndryshojnë, në verë e në dimër, shtrenjtimit ose çmime të lira, familje e vogël ose e madhe.” Pastaj vazhdon e thotë se vlen të ceket kjo: “Nëse besimtari posedon mjete materiale që mjaftojnë për të dhe për familjen e tij, nuk i lejohet mos agjërimi, e në të kundërtën i lejohet, duke e ditur se të lypurit (lypësia) prej njerëzve është e ndaluar për të, prandaj mos agjërimi ka përparësi ndaj lypësisë. Përndryshe, ai duhet të punojë aq sa i mjafton një jetë të dinjitetshme, kurse, nëse (puna e rëndë) e shtyn për të prishur agjërimin, atëherë i lejohet derisa të mos gjejë një punë tjetër që nuk e shtyn për të prishur agjërimin.”

Kjo vlen edhe në rastet kur njeriu frikësohet për shkatërrimin e drithërave ose vjedhjen e tyre, duke mos gjetur ndonjërin që punon për të me pagesë reale, që ai ka mundësi ta bëjë. Në këtë rast, i lejohet mos agjërimi, ngase atij i lejohet ndërprerja e namazit për shkaqe edhe më të vogla.

Punëtori që angazhohet në punë të rëndë, pa pasur rrugëdalje tjetër për plotësimin e nevojave të tij, për çdo ditë të Ramazanit duhet të zgjohet në mëngjes agjërueshëm dhe të vazhdojë agjërimin deri në çastin kur nuk ka më mundësi (fuqi) për ta vazhduar, dhe patjetër i duhet të punojë. Atëherë ai e prish agjërimin dhe duhet të bëjë *kaza* ditë për ditë, pa

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Ai që nuk largohet nga fjalët gënjeshtre dhe veprimi me to, Allahu xh.sh. nuk ka nevojë që ai të braktisë ushqimin dhe pijen.”

kefare. Po nuk i lejohet të zgjohet në mëngjes jo agjërueshëm, me arsyetimin se i duhet të punojë. Të ketë drojë dhe t'i frikësohet Allahut ai që u jep fetva njerëzve që punojnë punë të rënda, si në miniera, furra buke dhe të ngjashme me to, duke u thënë se nuk kanë nevojë për t'u zgjuar me nijetin e agjërimin, dhe as obligim të agjërojnë deri në momentin e fundit të urisë, etjes së madhe ose lodhjes, në pikën kur ka frikë për shkatërrim të tyre ose të ndonjë gjymtyre. Kush mund ta dijë, ndoshta punëtori në Ramazan e ndërpret punën e tij në fillim të ditës ose ndoshta do të ketë mundësi për të agjëruar deri në fund të ditës, e pra si t'i lejohet atij mosvendosja për agjërim, kur ai është obligim, duke u mbështetur në paragjykime ose duke dyshuar se do të arrijë në gjendje të rraskapitjes dhe shkatërrimit. Allahu e di më së miri!

6. Tubimi i jargës ose këlbazës në gojë dhe gëlltitja e tyre.

7. Të folurit keq pas kurrizi për të tjerët dhe gënjeshtre gjatë agjërimin. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Ai që nuk largohet nga fjalët gënjeshtre dhe veprimi me to, Allahu xh.sh. nuk ka nevojë që ai të braktisë ushqimin dhe pijen.”⁵

Përktheu: Ekrem Simnica

1 Marrë nga libri “Erkanul Islam – Shtyllat e Islamit”.

2 Dihet se lloje të njohura të çamçakëzëve prishin agjërimin kur i përtyq agjëruesi, sepse ato kanë shije dhe erë, sikurse bonbonet kur treten, e në brendi arrin ëmbëlsira, dhe kjo pa dyshim shkakton prishjen e agjërimin.

3 Transmetojnë Ebu Davudi dhe Bejhakui.

4 Transmeton Buhariu.

5 Transmeton Buhariu.

Historiku i agjërimit te popujt e tjerë dhe specifikat e agjërimit islam

Mr. Sead Paqarizi

Përgjatë historisë së njerëzimit, feja ka qenë një faktor relevant dhe me prezencë të theksuar te çdo shoqëri, sepse, si veçori kryesore e saj është lidhja e individit me Krijuesin apo shtytja për strehim tek Ai. Rrjedhimisht edhe ibadetet janë pjesë e pandashme e besimeve dhe praktikave të ndryshme fetare. Një prej këtyre praktikave padyshim se zë vend edhe agjërimi apo format e ndryshme të tij si dieta, abstenimi i përkohshëm nga disa lloje të ushqimeve, pijeve dhe jo vetëm.

Andaj agjërimi si fenomen te fetë dhe popujt e ndryshëm është një çështje dhe nocion i gjërë që ka pasur shtrirje, praktikim, koncept dhe metoda të ndryshme.

ÇKA ËSHTË AGJËRIMI?

Në aspektin etimologjik, agjërimi rrjedh nga fjala “saum”, që do të thotë abstenim nga ushqimi, qëndrimi larg diçkaje dhe përmbajtja e vetes nga diçka, ndërsa në aspektin terminologjik, agjërimi është abstenimi nga ushqimi, pija dhe marrëdhëniet intime nga agimi i hershëm (imsaku) deri në perëndimin e diellit duke iu përmbajtur dispozitave të sheriatit dhe duke pas për qëllim kryerjen e adhurimit të agjërimit.

Praktikat e zbatimit dhe qasja ndaj agjërimit tregojnë se ka koncepte dhe lloje të ndryshme të tij në mesin e popujve dhe kulturave të ndryshme përgjatë historisë.

LASHTËSIA, KONCEPTET DHE LLOJET E AGJËRIMIT

Agjërimi është një praktikë e lashtë fetare që ka qenë dhe vazhdon të jetë prezentë te secili popull, fe qiellore, fe të sajura apo fraksione të feve, etnive dhe kulturave të

Në aspektin etimologjik, agjërimi rrjedh nga fjala “saum”, që do të thotë abstenim nga ushqimi, qëndrimi larg diçkaje dhe përmbajtja e vetes nga diçka.

ndryshme në botë. Në çdo etapë të historisë së njerëzimit agjërimi është vlerësuar si një metodë e mundshme nga të gjitha shtresat e shoqërisë për t’ju përkushtuar “zotit” si superfuqi apo besimi më i lartë i një shoqërie të caktuar. Prandaj edhe Allahu xh.sh. në ajetin ku obligon muslimanët me agjërime saktëson qartë se agjërimi ishte obligim edhe për popujt e mëhershëm.¹ Por agjërimi si fenomen fetar i këtyre popujve kishte përmbajtje dhe koncepte të ndryshme.

AGJËRIMI I PARË

Të gjithë pejgamberët, nga Ademi a.s. deri te Muhamedi a.s. kanë qenë të obliguar me praktika të ndryshme fetare duke synuar afrimin te Zoti. Duke u mbështetur në ajetin e agjërimit kuptohet që agjërimi ishte obligim edhe për popujt e mëparshëm, gjegjësisht



agjërimi i parë ka filluar me Ademin a.s.. Sipas transmetimeve të ndryshme është përmendur se edhe pejgamberët si, Sulejmani a.s., Ibrahim i a.s., Musai a.s., Isa a.s. etj., kanë agjëruar ditë të ndryshme të muajit, ndërsa agjërimi i Davudit a.s.² përmendet si agjërimi më i mirë, duke agjëruar një ditë po, një ditë jo përgjatë tërë jetës.

AGJËRIMI TE POPUJT E AZISË SË LARGËT

Agjërimi te fetë e Azisë së Largët, gjegjësisht te fetë e sajuara në Indi, Kinë dhe Japoni, është praktikuar në lidhje me ngjarjet që ndërlihen me lëvizjet e Diellit dhe Hënës.

HINDUIZMI

Agjërimi te hindusët mbahet në ditë të caktuara gjatë vitit dhe ditët e festave me qëllim të edukimit dhe fuqizimit të shpirtit. Obligimi i agjërimin sot praktikohet dhe ka të bëjë më shumë me udhëheqësit fetar. Elita hinduse e njohur si brahmanë, janë të obliguar të agjërojnë gjatë vitit ditë të shumta dhe kohë të gjatë. Më të njohur janë dy lloje të agjërimin: Agjërimi i adakut (zotimit), i cili mbahet me qëllim që të realizohet një dëshirë dhe ky agjërim zgjatë 15 ditë pa ndërprerje; agjërimi periodik vjetor, i cili praktikohet nga brahmanët ku agjërohet dita e parë dhe e pesëmbëdhjeta e çdo muaji. Disa prej tyre vullnetarisht agjërojnë edhe ditën e dhjetë, njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë dhe kështu rregullisht agjërojnë çdo muaj nga pesë ditë.³ Lutjet gjatë kohës së agjërimin i drejtohen Brahmës⁴ duke shprehur adhurim dhe madhërim ndaj tij.

BUDIZMI

Budizmi duke qenë një fe e cila ka përvetësuar sistemin e jetës të mbështetur në asketizëm, edhe agjërimin e ka përshtatur si mjet të ndëshkimit të njeriut. Agjërimi në budizëm është i obliguar katër ditë në çdo muaj hënor nga lindja deri në perëndim të diellit. Këto ditë janë dita e parë, e nëntë, e pesëmbëdhjetë dhe dita e njëzet e dytë, të cilat përkohet me katër shenjat e fillimit të hënës dhe të njëjtën kohë konsiderohen si ditë të pushimit dhe gjatë këtyre ditëve nuk lejohet asnjë lloj pune, duke e ndaluar edhe përgatitjen dhe shtrimin e sofrës.⁵ Për shkak të kësaj, gjatë këtyre katër ditëve ushqimin e përgatisin para se të fillojnë agjërimin, pra para lindjes së diellit. Disa budist, 24 orë nuk hanë asgjë, duke mos gëlltitur as pështymen. Gjatë ditëve të agjërimin kryesisht luten dhe rrëfejnë mëkatet e tyre. Në kohën moderne, agjërimi te budistët vërehet që është ndikuar nga praktikatat e agjërimin te hinduizmi dhe xhainizmi.⁶

Budizmi duke qenë një fe e cila ka përvetësuar sistemin e jetës të mbështetur në asketizëm, edhe agjërimin e ka përshtatur si mjet të ndëshkimit të njeriut.

XHAINIZMI

Themeluesi i xhainizmit i quajtur me epitetet Mahavira (Hero i Madh) dhe Xhina (Fitimtari) për shkak të reformave dhe sukseseve të mëdha, ka pasur një jetë të thellë askete dhe dietale. Andaj edhe ndjekësve të tij iu ka preferuar dhe i ka nxitur të praktikojnë një agjërim ekstrem, duke stimuluar dhe lavdëruar edhe humbjen e jetës nga uria. Edhe vetë ai ka agjëruar deri sa ka vdekur. Pra kjo është një praktikë ekstreme e agjërimin që sot nuk përfillet nga ndjekësit e kësaj doktrine. Xhainistët agjërojnë 40 ditë pa ndërprerje, duke ngrënë vetëm disa kokrra oriz, disa nuk konsumojnë ushqimet e pjekura në zjarr, disa të tjerë largohen nga lloje të ndryshme të ushqimeve etj..⁷

TAOIZMI

Taoizmi, një prej feve kineze, agjërimin e ka vlerësuar si një metodë të ruajtjes së shëndetit, përmes të cilit ka synuar shtyrjen apo vonimin e vdekjes. Andaj në taoizëm agjërimi është një prej ibadeteve kryesore i cili praktikohet gjatë festave dhe gjatë ditëve të vështira kur ballafaqohen me sprova apo fatkeqësi të ndryshme.⁸

AGJËRIMI TE HEBREJTË

Agjërimi te hebrejtë ka zanafillën që nga Musai a.s., i cili në kodrën Sina, gjatë pranimit të shpalljes ka agjëruar 40 ditë dhe 40 net. Andaj agjërimi në literaturën dhe burimet çifute zë një vend të rëndësishëm dhe si i tillë është konsideruar një prej adhurimeve që synohet pendimi dhe shpagimi për mëkatet e bëra. Po ashtu edhe në raste dhe kohë të vështira hebrejtë kanë agjëruar me qëllim që të fitojnë kënaqësinë dhe faljen e Zotit. Në hebraizëm agjërimi quhet 'Taanit', dhe përmendet tërthorazi në Tevrat, ndërsa në Talmud,⁹ përmendet drejtpërdrejt. Hebrejtë kanë agjërimin në bashkësi që e quajnë 'Taanit Tsibur' dhe përveç të sëmurëve dhe fëmijëve, të tjerët janë të obliguar ta respektojnë atë, si dhe agjërimin individual që quhet 'Taanit Yahid', i cili obligohet kur personi sheh ndonjë ëndërr të keqe, me qëllim që të mbrohet nga ajo e keqe dhe kur personi ka bërë ndonjë zotim, atëherë obligohet që të agjërojë.¹⁰

Gjatë historisë, agjërimi te hebrejtë ka pësuar ndryshime të ndryshme me ndikimin e rabinëve, të cilët duke qenë autoritet i bekimit të agjëruësve, e të cilët kanë vendosur rregulla të veçanta dhe përveç ditëve të agjërimin të cekura në shkrimet e shenjta, ata kanë obliguar edhe agjërimin e 25 ditëve të tjera.

Llojet e agjërimit: hebrenjtë kanë agjërimet e detyrueshme si:

Agjërimi i Yom Kippur - agjërimi i faljes së mëkateve, i vetmi i mbështetur në Tevrat dhe që është dita më e shenjtë dhe e rëndësishme e tyre. Agjërimi i kësaj dite fillon me perëndimin e diellit në ditën paraprake dhe vazhdon 25 orë deri në perëndimin e diellit dhe shfaqjes së yjeve të ditës vijuese.¹¹ Gjatë kësaj kohe abstenojnë nga ushqimi, pija dhe marrëdhëniet intime.

Tisha Be Av - agjërimi i 9 prillit, që konsiderohet dita më e zezë e hebrenjve, duke përkujtuar shkatërrimin e tempullit të parë në 586 p.e.s. nga babilonasit dhe shkatërrimin e tempullit të dytë nga romakët në vitin 70, ndërsa në të njëjtën datë në vitin 1492, çifutët përkujtojnë edhe dëbimin nga Spanja.

Shiva Asar Be Av - agjërimi i 17 korrikut në përkujtim të okupimit të Jerusalemit nga babilonasit, të cilën e konsiderojnë si ditë zie dhe gjatë këtij agjërimi javor nuk vishen bukur, nuk zbaviten dhe nuk argëtohen.¹²

Asara Betevet - agjërimi i ditës së dhjetë të muajit të dhjetë në shenjë të përkujtimit të pushtimit dhe shkatërrimit të Kudsit (Jerusalemit) nga mbreti Nebukadnessar në vitin 586 p.e.s., ky agjërim është një ditor dhe gjatë kësaj dite vetëm abstenohet nga ngrënia dhe pirja.

Në judaizëm ka edhe agjërim individual, siç është agjërimi për lindjen e parë, që aludohet në lindjen e Musait a.s., agjërimi i dhëndrit dhe nuses me rastin e kurorëzimit, agjërimi me rastin e vdekjes së të afërmeve etj..

Agjërimi te çifutët mbahet nga agimi deri në perëndimin e diellit, përveç agjërimit të Yom Kippur, që fillon një ditë para me perëndimin e diellit. Fëmijët deri rreth moshës 15-13 vjeç dhe të sëmurët janë të liruar nga agjërimi.

Në krishterizëm agjërimi ka zanafillë të hershme, stimulohet të praktikohet dhe konsiderohet si një çështje mes njeriut dhe Zotit, si dhe paraqitet si mundësi e faljes dhe arritjes së kënaqësisë së Zotit.

AGJËRIMI NË KRISHTERIZËM

Në Bibël flitet për agjërimin e Isait a.s. dhe apostujve si dhe këshillat e tij për vlerën e agjërimit.¹³ Andaj edhe në krishterizëm agjërimi ka zanafillë të hershme, stimulohet të praktikohet dhe konsiderohet si një çështje mes njeriut dhe Zotit, si dhe paraqitet si mundësi e faljes dhe arritjes së kënaqësisë së Zotit. Murgjit dhe fetarët e tjerë e praktikojnë agjërimin duke e vlerësuar si metodë të rëndësishme të edukimit shpirtëror të njeriut dhe asketizmit.

Në fillimet e para, ashtu si edhe në hebraizëm, koncepti i agjërimit të krishterët ka ngjashmëri me konceptin e agjërimit në Islam. Me kalimin e kohës dhe ndikimet e ndryshme, koncepti i agjërimit ka pësuar ndryshime thuajse rrënjësore dhe është devijuar.

Në Bibël nuk përmendet ndonjë ditë e caktuar për të agjëruar, ndërsa ceket se Isai a.s. pasi agjëroi 40 ditë dhe 40 net ndjeu uri.¹⁴ Prandaj Isai a.s. e ka praktikuar agjërimin e

ngjashëm me Musain a.s..

Në shekullin e parë të erës sonë kanë filluar të vendosen rregulla në lidhje me agjërimin dhe në këtë periudhë ata që pagëzoheshin dhe ai që i pagëzonte agjëronin një ditë, dy ditë apo dikush edhe 40 ditë. Në shekujt e parë, të krishterët agjëronin ditën e mërkurë dhe ditën e premte, me qëllim të përkujtimit të vuajtjeve të Isait a.s.. Gjatë vitit, të krishterët, disa ditë nuk konsumojnë ushqimet me përbërje mishi dhe qumështi.

Ndërsa në shekullin e katërt ishte bërë obligim agjërimi i dy ditëve para festës më të madhe të krishterë që janë Pashkët. Me këtë besojnë që Isai a.s. është ringjallur dhe është ngritur në qiell. Agjërimi i Pashkëve ndryshon te fraksionet e



krishtera. Katolikët para kësaj feste agjërojnë 46 ditë duke mos konsumuar vetëm disa ushqime të caktuara.¹⁵

Sot te të krishterët janë dy lloje kryesore të agjërimit:

Okaristik - Agjërimi i falënderimit, i cili vepohet çdo të diel para ceremonisë së kungimit, duke mos përdorur pije alkoolike. Disa fraksione këtë agjërime e fillojnë pas darkës së ditës së shtunë, disa të tjerë vetëm disa orë para kungimit dhe ky agjërime i falënderimit përfundon me fillimin e ceremonisë së kungimit.¹⁶

Ekleziastik - Agjërimi i anëtarësimit në kishë, i cili zgjat 40 ditë në shenjë të përkujtimit të vuajtjeve të Isait a.s., i cili mbahet 40 ditë para festës së Pashkëve. Ditëve të sotme ky agjërime është lehtësuar dhe ka marrë formë dietale, duke mos konsumuar ushqime të caktuara apo duke ngrënë vetëm njëherë në ditë, ndërsa në kohët e tjera nuk konsumohet yndyrë e të ngjashme.

Përveç këtyre, fraksionet e ndryshme të krishtera kanë përvetësuar edhe metoda të tjera të agjërimit, të cilat kanë marrë formë sipas ndikimit të prijësve fetarë, të cilët kanë autoritet të vendosin për format e agjërimit, kohën dhe prishjen e tij.

SPECIFIKAT E AGJËRIMIT ISLAM

Duke qenë agjërime një prej ibadeteve të para që ka shoqëruar çdo të dërguar dhe shpallje, edhe te myslimanët ka një zanafillë të hershme. Arabët para fillimit të shpalljes agjëronin ditën e ashures.¹⁷ Ndërsa nga viti i dytë hixhri, me zbritjen e ajeteve rreth agjërimit dhe muajit Ramazan,¹⁸ agjërime është bërë obligim për çdo mysliman të moshës së rritur (bulug) mashkull apo femër dhe që janë të shëndoshë psikikisht dhe fizikisht apo nuk kanë ndonjë arsye të lirimit nga agjërime. Agjërime në Islam synon devocionin dhe dëlirësinë shpirtërore, afrimin tek Allahu xh.sh. dhe edukimin shpirtëror për t'iu përkushtuar dhe nënshtruar vetëm Krijuesit, fitimin e kënaqësinë së Tij, si dhe pastrimin nga mëkatet me pendim të sinqertë.

Agjërime në Islam është obligativ gjatë tërë muajit Ramazan dhe fillon nga imsaku deri në iftar duke abstenuar nga ushqimi, pija dhe marrëdhëniet intime gjatë kohës së agjërimit. Po ashtu në Islam gjatë agjërimit kërkohet kujdes i shtuar ndaj gjuhës, fjalorit, dorës dhe gjymtyrëve tjera që mos të mëkatojnë. Ata të cilët kanë arsye të lirohen nga agjërime gjatë Ramazanit, janë të obliguar të agjërojnë po aq ditë pas Ramazanit.¹⁹

LLOJET E AGJËRIMIT

Islami ka agjërimitin farz, i cili është agjërime i obliguar gjatë muajit të Ramazanit, agjërime vaxhib, i cili është agjërime i zotimit apo agjërime vullnetar, i cili është prishur dhe pastaj duhet kompensuar, pra është agjërime obligativ. Agjërime nafile, apo vullnetar, është agjërime i ditëve jashtë muajit

Ramazan apo agjërimit vaxhib. Agjërime vullnetar janë agjërime i ditës së ashures, ditëve të hënë dhe të enjte, tre ditët e mesme të çdo muaji hënor etj.. Agjërime i ndalur dhe i qortuar është agjërime i ditës së Bajramit të Ramazanit dhe tre ditëve të Bajramit të Kurbanit.

Në Islam agjërime është një ibadet i rëndësishëm, i cili ka rregullat e përcaktuara në Kuran dhe hadithe të Pejgamberit a.s., si dhe në burimet e tjera të Sheriatit. Agjërime është një ibadet i përhapur në mesin e myslimanëve, të cilët me rastin e ardhjes së muajit Ramazan bëjnë përgatitje të veçanta dhe krijohet një atmosferë e ndjeshme shpirtërore dhe festive.

PËRFUNDIM

Agjërime është një prej ibadeteve që kanë shoqëruar njerëzimin që nga njeriu i parë Ademi a.s. dhe ka qenë prezent në forma të ndryshme të gjitha fetë dhe shoqëritë. Po ashtu agjërime është një ibadet i rëndësishëm si në Islam ashtu edhe te popujt e mëhershëm. Te fetë qiellore, agjërime ka ngjashmëri të madhe, si dhe për nga synimi dhe përmbajtja kanë elemente të përbashkëta, ndërsa te praktikimi dhe te kohëzgjatja kanë disa dallime thelbësore. Agjërime te të gjithë popujt ka shërbyer si një ibadet për ngritje dhe pastrim shpirtëror nga gabimet dhe mëkatet e mundshme. Forma dhe specifikat e agjërimit në Islam janë vazhdimësi dhe artikulum i formës së agjërimit të kërkuar nga Allahu xh.sh., i përshtatshëm maksimalisht gjendjes dhe mundësisë së njeriut për të praktikuar këtë ibadet, për të përfituar nga ai si dhe për t'iu afruar Allahut xh.sh..²⁰

- 1 "O ju që besuat, agjërime (saum) u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm." (El Bekare 183).
- 2 "Agjërime më i dashur te Zoti është agjërime i Davudit. Ai agjëronte një ditë dhe ushqehet të nesërmen..." (Ebu Davud, 2248).
- 3 Ali Ihsan Yitik, TDV Islam Ansiklopedisi, TDV yay., vëll. 33, İstanbul 2007, fq. 414
- 4 Zija Abdullahu, "Studim krahasimtar i feve", Koha, Prishtinë, 2010, fq.70.
- 5 Recep Demir, (Fasting in Islam and Other Religions), The Jurnal of International Social Research, Vol. 9, February 2016, fq.1786.
- 6 Yitik, fq.414.
- 7 Recep..., fq.1787.
- 8 Recep..., fq.1786.
- 9 Dhjata e vjetër, Levitiku XVI 29-31; Eksodi-Dalja XXXIV 18.
- 10 Mehmet Aydın, Ansiklopedik Dinler Sözlüğü, Din Bilimler Yay., Konya 2005, fq.576.
- 11 Rahim Ay, İlahi dinlerde oruç: kaynağı, amacı ve uygulanışı bakımından karşılaştırmalı bir inceleme, Journal of Analytic Divinity International Refereed Journal 5/2, 2021, fq.214.
- 12 Zija..., fq.290.
- 13 Dhjata e re, Mateu, Veprat e apostujve, 13/2 dhe 14/23.
- 14 Rahim Ay..., fq.222.
- 15 Recep..., fq.1790.
- 16 Yitik..., fq.415.
- 17 Tahir Olgun, Muslimanlıkta İbadet Tarihi, Akçağ yay., Ankara 1998, fq.122.
- 18 Kuran, Bekara 183-185.
- 19 Ibën Kethiri, Kandili Ndrîçues, vol.I, Fondacioni i Rinisë Islame, Zürich 2007, fq.439-441.

Një ditë e Muhamedit a.s. në Ramazan

Mr. Rashit Zylfiu

Edhe pse Muhamedi, a.s., ishte i ngarkuar me aktivitetet dhe detyrat që na obligon ky muaj, ai u jepte shpirt këtyre ditëve dhe emocione që do ta lidhnin çdo anëtarë të ymetit të tij me këto ditë pa marrë parasysh distancën kohore nga ai.

Falënderimi i takon Allahut, që e ka bërë rrugën e dashurisë ndaj Tij të lidhur me pasimin e të dashurit tonë, Muhamedit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të.

Sa herë që dita dhe nata pasojnë njëra-tjetrën, po aq paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi atë që është udhërrëfyes, kandil ndriçues, thirrës përgëzues, mëshirë e begati hyjnore.

Lidhja e Profetit Muhamed a.s. me ymetin është e veçantë, lidhje që karakterizohet edhe nga aspekti emocional dhe shpirtëror i saj.

Ne gjithmonë duhet të përpiqemi që hapësira kur përshkruajmë diçka nga jeta e tij të mos jetë thjesht përshkrim biografik, por t'i japim brendësisë shpirt dhe emocion, që të lidhemi edhe më shumë me të.

Ramazani më shumë se një projekt jete i mbushur me aktivitete, na jep edhe mundësinë për të eksploruar një ditë të jetës së Muhamedit, alejhi selam.

Edhe pse ai ishte i ngarkuar me aktivitetet dhe detyrat që na obligon ky muaj, ai u jepte

shpirt këtyre ditëve dhe emocione që do ta lidhnin çdo anëtarë të ymetit të tij me këto ditë pa marrë parasysh distancën kohore nga ai.

Eksplorimi i kësaj dite, se si ai e kalonte, na jep shumë detaje, sepse vetëm kështu do të përkthehej ky adhurim në praktikë për ymetin e tij.

Ky eksplorim nis nga koha kur del hëna e ramazanit, që ngjall te ne përkujtimet e jetës së të Dërguarit Muhamed, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, për të kujtuar se si ishte gjendja e tij në raport me veprat e mira, shtimi i tyre dhe të garuarit për to. Për këtë arsye ky muaj duhet shfrytëzuar në vepra të mira, që të shtojmë në llogarinë tonë sa më shumë shpërblime. Ne kemi shëmbëlltyrën tonë, Muhamedin, alejhi selam, se si ai vepronte, garonte dhe i inkurajonte të tjerët në vepra të mira gjatë ditëve të ramazanit.

Pejgamberi Muhamed, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, është shëmbëlltyrë e çdo besimtari që mundohet ta kënaqë Zotin e



tij, prandaj kushdo që dëshiron të bëjë vepra të mira, kur ta dëgjojë këtë përshkrim të jetës së tij, duhet të shpejtojë në vepra të mira dhe të largohet nga veprat e këqija dhe ta shfrytëzojë kohën e tij në çdo gjë që i bën dobi për këtë botë dhe botën tjetër.

Kjo reflektoi edhe në jetën e myslimanëve të parë, të cilët garonin për vepra të mira si individë apo edhe si shoqëri. Nuk ka dyshim se çdo garues ëndërron vendin e parë. Në të njëjtën kohë frytet e garës për vepra të mira kanë rezultate të frytshme e të kënaqshme në dynja dhe ahiret. Fryti më madhor i garimit në vepra të mira është afrimi te Zoti i gjithësisë.

Allahu xh.sh. thotë: “...dhe ata që kanë prirë (në besim) e që do të prijnë (edhe në xhenet). Ata janë të afërtit (tek Allahu).” (El Vakkia, 10-11).

Kur nisemi nga fakti se ramazani është një ndër shtyllat e Islamit me të cilën obligohet agjërimi për çdo besimtar që është mirë mentalisht dhe fizikisht dhe jo udhëtar, nuk ka se si të mos hulumtojmë rreth një dite të të dashurit tonë, alejhi selam. Përkthimin në praktikë të gjithë asaj që zhvillohet për një muaj do ta gjejmë brenda ditëve që ai kaloi në këtë muaj, ngase Pejgamberi, a.s.,¹ e dallonte këtë muaj me adhurime të shumta, me të cilat nuk i dallonte muajt e tjerë.

Një ditë me Muhamedin alejhi selam në ramazan do të ndahej në tri pjesë.²

PJESA ME ZOTIN E VET

Kjo pjesë ishte shumë e rëndësishme për të, alejhi selam, sepse i jepte prioritet jo vetëm në ramazan. Në ramazan me Zotin e vet ai përpiquej të ishte më afër.

Ai një ditë në ramazan e fillonte me syfyr, edhe pse nganjëherë preferonte që syfyrin ta hante me shokët e tij. Imam Buhariu transmeton nga Zejd bin Thabiti, r.a., i cili ka thënë: “Kemi ngrënë syfyr me Pejgamberin, alejhi selam, më pas u ngrit për ta falur namazin.”³ Abdullah bin Harithe transmeton nga një sahabi i Pejgamberit, alejhi selam, i cili ka thënë: “Kam hyrë te Pejgamberi, alejhi selam, dhe ai ka qenë duke ngrënë syfyr dhe tha: “Ky është një bereqet të cilin ua ka dhuruar Zoti, prandaj mos e lini!”⁴

Ka ndodhur që ta zë koha e namazit të sabahut, dhe ai kishte nevojë të lahej, kështu ai pastrohej pas agimit, para lindjes së diellit, e falte namazin dhe agjëronte.

Pejgamberi, alejhi selam, bënte iftar para se të falej. Iftarin e bënte me disa hurma të lëngshme nëse gjente, nëse jo,

Një ditë e jetës së Muhamedit, alejhi selam, në ramazan kishte edhe gëzime. Në ramazanin e vitit të tretë të hixhretit lindi Hasani, nipi i tij, djali i Aliut dhe Fatimes. Gjithashtu kishte edhe pikëllim, se pikërisht në një rënë ndër ditët e ramazanit vdiq vajza e tij, Rukija, që ishte gruaja e Uthmanit r.a..

atëherë me hurma të thata. E nëse nuk gjente, atëherë me ujë.⁵

Përmendet se kur bënte iftar, thoshte: “U largua etja, venat u lagën dhe u realizua shpërblimi, nëse do Allahu!”⁶

Enes bin Maliku ka thënë: “Nuk e kam parë asnjëherë Pejgamberin, alejhi selam, të jetë falur para iftarit, edhe në qoftë se ka pirë vetëm një gotë me ujë.”⁷ Ai, alejhi selam, preferonte që të falej i vetëm në namazin e natës, që sot njihet si namazi i teravive, edhe pse nganjëherë me të faleshin disa nga shokët e tij.

PJESA ME FAMILJEN

Për ata që eksplorojnë në jetën e Profetit, alejhi selam, nuk ka si të mos jetë e hapur çdo herë dera e shtëpisë së tij, për të kuptuar se si u zhvillua jeta familjare, bashkëshortore brenda atyre kasolleve të vogla ku ai jetonte, e sidomos në ramazan, sepse kjo i jepte shpirt dhe emocion jetës familjare, që duhet të jetë frymëzuese për ne. Aishja, Allahu qoftë e kënaqur me të, i tha të Dërguarit, a.s.: “Çfarë duhet të them nëse e arrij Natën e Kadrit?” Ai tha: “O Allahu! Ti je Falës dhe e do faljen, prandaj më fal!”⁸

Një ditë e jetës së Muhamedit, alejhi selam, në ramazan kishte edhe gëzime. Në ramazanin e vitit të tretë të hixhretit lindi Hasani, nipi i tij, djali i Aliut dhe Fatimes. Gjithashtu kishte edhe pikëllim, se pikërisht në një rënë ndër ditët e ramazanit vdiq vajza e tij, Rukija, që ishte gruaja e Uthmanit r.a.. Ajo njihet si “migruesja e dyfishtë”, sepse kishte migruar një herë në tokën e Abisinisë dhe herën e dytë për në Medinë.

Pejgamberi, alejhi selam, ditëve të fundit të ramazanit përpiquej dhe bënte më shumë vepra të mira sesa në ditët e tjera. Aishja na ka njoftuar se Pejgamberi, alejhi selam, angazhohej në dhjetë ditët e fundit (me ibadet dhe vepra të mira) jo si në ditët e tjera, por shtonte dhe përpiquej më shumë.⁹

Gjithashtu ajo na ka treguar se Pejgamberi, alejhi selam, kur vinte dhjetëshja e fundit e ramazanit, i ngjallte netët (me ibadete), zgjonte familjen e tij prej gjumi, përpiquej (për ibadet të shumtë) dhe shtrëngohej (për ibadet) si dhe largohej nga marrëdhëniet seksuale me gratë (e veta).¹⁰

PJESA ME YMETIN E TIJ

Ishte praktikë e Pejgamberit, alejhi selam, që t'i përgatiste shokët e tij për ramazan. Kur afrohej ramazani, i përgëzonte ata dhe u thoshte: “Juve ju erdhi ramazani, i cili është muaj i

bereqetshëm! Allahu ua bëri obligim (farz) agjërimitin e tij. Në këtë muaj hapen dyert e xhenetit dhe mbyllen dyert e xhehenemit dhe shejtanët prangosen. Në të është një natë e cila është më e vlefshme sesa 1000 muaj. Ai i cili privohet nga mirësia e saj, vërtet është privuar nga çdo mirësi.”¹¹

Le të ndalemi edhe pak dhe të shpalesim pjesë nga jeta e Muhamedit, alejhi selam, se si ishte një ditë e tij në ramazan. Këtë na e ka treguar shoqëruesi i tij, i biri i xhaxhait të tij, Ibën Abasi, i cili thotë: “Pejgamberi, alejhi selam në ramazan, kur takonte Xhibrilin, tregonte një bujari që nuk e kishte në muajt e tjerë. Ai, Xhibrili, e takonte atë për çdo natë të ramazanit dhe e përsërisnin së bashku Kurandin. Kështu Pejgamberi, alejhi selam, në këtë muaj ka qenë për njerëzit më i dobishëm se era pas së cilës vjen shiu.”¹²

Ai agjëronte nganjëherë edhe pa ndërprerë, por i ndalonte nga kjo shokët e tij. Ata i thoshin “por ti po e vepron një gjë të tillë”, kurse ai, alejhi selam, ua kthente përgjigjen duke u thënë: “Unë dalloj prej jush sepse Zoti im më furnizon me ushqim”.

Ebu Hurejra kumton se Pejgamberi, alejhi selam, ka thënë: “Agjërimi është mburojë. Nëse dikush nga ju është agjërueshëm, mos të flasë fjalë të ndyra e as të mos bëjë zhurmë. E, nëse dikush e fryn apo e sulmon, le t’i thotë unë jam agjërueshëm.”

Pejgamberi, alejhi selam, e përgëzonte ymetin e tij duke u thënë: “Çdo natë Allahu liron njerëz nga zjarri i xhehenemit.”

Ai gjithashtu i shoqëronte njerëzit dhe bashkëjetonte me ta edhe në udhëtimet që kishte.

Nuk shënohet ndonjë ngjarje përveç asaj që shënon Buhariu nga Ebu Derdaja, i cili ka thënë: “Dolëm me Pejgamberin, alejhi selam, në një udhëtim, në një ditë shumë

Ai agjëronte nganjëherë edhe pa ndërprerë, por i ndalonte nga kjo shokët e tij. Ata i thoshin “por ti po e vepron një gjë të tillë”, kurse ai, alejhi selam, ua kthente përgjigjen duke u thënë: “Unë dalloj prej jush sepse Zoti im më furnizon me ushqim”.

të nxehtë, derisa e vendosnim dorën mbi kokë për shkak të të nxehtit të madh. Asnjëri prej nesh nuk ishte agjërueshëm përveç Pejgamberit, alejhi selam.” Në transmetimin e Muslimit: “Kemi dalë me Pejgamberin, alejhi selam, në muajin ramazan në një vapë ekstreme.”

Ishte praktikë e tij që njerëzit të jenë solidarë mes vete dhe këtë praktikë të vlerave humane ai e bënte përmes inkurajimit që i bënte ymetit të tij. Nga Zejd ibën Halid el Xhuheni transmetohet se i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: “Kush i jep iftar një agjëruesi, do të ketë një shpërblim të ngjashëm me të tijin, pa iu zvogëluar aspak shpërblimin agjëruesit (që i dha iftarin).”¹³

Le të mbeten ditët e Profetit Muhamed, alejhi selam, në ramazan frymëzim dhe inkurajim për vepra të mira ashtu siç na ilustron edhe imam Shafiu, i cili thotë: “Dua që njeriu të jetë bujar në ramazan duke pasuar Pejgamberin, alejhi selam, për shkak të nevojës së njerëzve dhe preokupimit të tyre me agjërimin dhe namazin në raport me furnizimin e tyre.”

1 Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të.

2 Fejsal bin Alij el Badanij, *Hakedha Kane Nebij fi Ramadan*, Rijad, Mexheletu-l-Bejan, 2007, fq. 27.

3 Shënon Buhariu, 4/138.

4 Shënon Nesaiu, 4/145.

5 Abdulhakim el Enis, *Pejgamberi a.s. në Ramazan*, Prishtinë, Kryesia e BIK-ut, 2019, përktheu, Vedat Shabani, fq. 70.

6 Shënon Ebu Davudi.

7 Shënon Ibën Hibani, 8/274.

8 Shënon Termidhiu, 3513.

9 Shënon Muslimi.

10 Shënon Muslimi.

11 Shënon Ahmedi.

12 Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

13 Shënon Termidhiu, nr 807.



Kurani – libri madhështor që zbriti në një natë madhështore

Prof. dr. ass. Lulzim Esati

Qoftë i Lartësuar Ai, i Cili zgjodhi kontekstin kohor më madhështorin për zbritjen e Librit madhështor, Kuranit fisnik. Ky zarf i kohës është muaji Ramazan. Allahu xh.sh., për zbritjen e fjalës së Tij të madhërishme, zgjodhi muajin e madhërishëm, e në këtë muaj zgjodhi natën madhështore të këtij muaji, ajo është Nata e Kadrit.

Padyshim që madhështia e këtij muaji buron nga dy anë, e para, ky muaj, respektivisht agjërimi i tij është një shtyllë kryesore nga pesë shtyllat e fesë islame, dhe e dyta, në këtë muaj zbriti Kurani fisnik, siç na tregon vetë Kurani: “*Muaji Ramazan që në të (filloi të) shpallet Kurani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqaruesi i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria).*” (El Bekare, 185).

Besoj që madhështia e këtij muaji buron nga e dyta, zbritja e Kuranit fisnik. Pra, mund të themi që Kurani është burimi i dy madhështive. Për këtë arsye së pari do të flasim për arsyet që e bënë Kuranin librin më të madhërishëm nga

të gjitha librat e tjerë, pastaj do të flasim për Natën e Kadrit. Kurani i madhërishëm, është fjalë e Allahut xh.sh., siç dëshmon Ai Vetë për këtë: “*(Kurani është) Zbritje e plotfuqishmit, e Mëshiruesit.*” (Jasin, 5).

Kurani është një rikujtim i bekuar që u shpall përmes një melaqeje të bekuar në një natë të bekuar te një profet i bekuar për një ymet të bekuar.

Ky libër i madhërishëm i garanton njeriut udhëzimin në rrugën e drejtë, kur njeriu para vetës ka shumë rrugë në këtë jetë, dhe e ka të vështirë, nëse nuk themi të pamundur që ta zgjedh rrugën e duhur për këtë dhe jetën tjetër. Lidhje me këtë i Lartëmadhërishmi thotë: “*Është e vërtetë se ky Kuran udhëzon për atë rrugë që është më se e vërteta,...*” (El Isra, 9), d.m.th. nëse themi se për të arritur tek e vërteta ka shumë rrugë, atëherë mund të themi se ato nuk janë të njëjta, qoftë për nga distanca, por edhe për nga kostoja. Nga ky ajet kuptojmë se rruga, e cila na shpie me një

Kurani është një rikujtim i bekuar që u shpall përmes një melaqeje të bekuar në një natë të bekuar te një profet i bekuar për një ymet të bekuar.



distancë sa më të shkurtër e me një kosto sa më të ulët tek e vërteta absolute, është rruga në të cilën udhëzon ky Libër.

Madhështia e tij buron edhe nga fakti se Allahu në Kuran ka ofruar për njeriun çdo shembull që i duhet. Ai në të thotë: “Në këtë Kuran Ne shtruam çdo lloji shembulli për hir të njerëzve.” (El Kehf, 54). Ai e bëri Kuranin të lehtë për nxënie: “Në të vërtetë, Ne Kuranin e kemi bërë të lehtë për këshillim, – e a ka kush që këshillohet (me të)?” (El Kamer, 17).¹ Ai xh.sh. ka bërë ftesë që të shkoqiten ajetet e tij: “A nuk e studiojnë me vëmendje Kuranin?” (Muhamed, 24). Allahu i Madhërishëm i ka kritikuar ashpër ata që nuk e studiojnë me vëmendje Kuranin! Ai për këtë Libër madhështor, thotë se është mëshirë dhe shërim për besimtarët: “Ne të shpallim Kuranin që është shërim dhe mëshirë për besimtarët.” (El Isra, 82), por edhe për ata që nuk i besojnë, duke iu garantuar këtyre të fundit drejtësi dhe siguri: “Dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t’i shmangeni drejtësisë, bëhuni të drejtë!” (El Maide, 8). Me zbritjen e këtij Libri të madhërishëm, është pezulluar imponimi i besimit dhe i fe: “Në fe nuk ka imponim.” (El Bekare, 256).

Këto pra ishin disa nga faktet e shumta që shfaqin dhe ndriçojnë madhësinë e Kuranit. Për të provuar dhe vërtetuar saktësinë e tij, dhe të vërtetën që e thotë, Kurani bën apel për sfidë për ata që nuk e besojnë: “E në qoftë se jeni në dyshim në atë që Ne ia shpallëm gradualisht robit tonë, atëherë sillni ju një kaptinë të ngjashme si ai (Kurani).” (El Bekare, 23). Kjo ftesë qëndron hapur që 15 shekuj, dhe është valide deri në ditën e Kiametit: “E mos e paçi bërë (deri më tash), e as që do ta bëni kurrë (edhe në të ardhmen).” (El Bekare, 24). Dhe as që kanë për ta bërë ndonjëherë. Po ashtu, Allahu xh.sh. u bën ftesë të gjithë atyre që dyshojnë në të, që ta shkoqisin me vëmendje, duke thënë: “A nuk e përfillin ata (me vëmendje) Kuranin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie.” (En Nisa, 82).

E pas një studimi të thukët dhe pas një hulumtimi të mirëfilltë, ata do të binden se ky Libër është i zbritur nga Allahu, sepse sikur të ishte prej dikujt tjetër, pos prej Allahut, atëherë ata do të gjenin në të shumë kundërthënie. Doktor Myller² filloi ta lexonte Kuranin me vëmendje, me shpresë se do të gjente në të ndonjë gabim. Mirëpo, ai u trondit kur e dëgjoi ajetin e lartpërmendur: “A nuk e përfillin ata (me vëmendje) Kuranin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie.” Prandaj, për këtë ajet ai tha: “Prej parimeve shkencore të njohura në kohën tonë është parimi i gjetjes së gabimeve në teori, derisa të vërtetohet se teoria në fjalë është e saktë, siç quhet *falsification test* (testi i falsifikimit). Është për t’u habitur se vetë Kurani i thërret myslimanët dhe jomyslimanët që të hulumtojnë për të gjetur gabime në të dhe nuk do të gjejnë kurrë.” Pastaj thotë: “Nuk ka asnjë autor në botë që merr guximin ta shkruajë ndonjë libër e pastaj të thotë se ky libër është pa

Doktor Myller filloi ta lexonte Kuranin me vëmendje, me shpresë se do të gjente në të ndonjë gabim. Mirëpo, ai u trondit kur e dëgjoi ajetin e lartpërmendur: “A nuk e përfillin ata (me vëmendje) Kuranin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie.”

gabime. Mirëpo, Kurani është e kundërta e kësaj plotësisht, të thotë se nuk ka gabime! Bile edhe ta ofron mundësinë që të hulumtohet e të gjejnë gabime dhe nuk ke për të gjetur kurrë.”³

Ymeti mysliman është ymet madhështor për arsye se beson në këtë Libër madhështor, në Kurani kerimin. Madhështia e myslimanëve është barazim me afërsinë që kanë me këtë Libër të shenjtë. Kur afërsia e tyre me Kuranin është e madhe, atëherë edhe madhështia e tyre është e madhe. E kur distanca mes Kurani kerimit e myslimanëve rritet dhe afërsia me të zvogëlohet, atëherë edhe madhështia e myslimanëve është e vogël dhe në zvogëlim e sipër, në proporcion me distancën që kanë me këtë Libër të shenjtë. Ibën Atije ka thënë: “Ai (Allahu) që e dalloi dhe e nderoi Ademin ndaj melaqeve, duke ia mësuar atij të gjitha emrat (dituritë), po ai e nderoi dhe e lartësoi këtë ymet përballë ymeteve të tjera me mësimin e Kuranit.”⁴



NATA MADHËSHTORE

E sa i përket kohës së zbritjes së këtij Libri madhështor, ajo është nata e Kadrit, në muajin e shenjtë Ramazan. Në fillim treguam se Allahu xh.sh. zgjodhi muajin Ramazan për ta zbritur Kuranin, tani ju tregojmë se në cilën natë të këtij muaji ka zbritur Kurani i madhërishtëm.

Allahu në Kuran thotë: “*Ne e zbritëm atë (Kuranin) në natën e Kadrit. E ç’të bëri ty të dish se çështë nata e Kadrit? Nata e Kadrit është më e rëndësishme se një mijë muaj! Me lejen e Zotit të tyre në (atë natë) të zbresin engjëj dhe shpirti (Xhibrili) për secilën çështje. Ajo (që përcakton Zoti) është paqe deri në agim të mëngjesit.*” (El Kadër, 1-5).

Kjo sure tregon më së miri për madhësitë e Natës së Kadrit dhe proceset që ndodhin në këtë natë, si dhe arsyet e madhësisë së kësaj nate.

Allahu xh.sh. thotë se kjo natë është e bekuar: “*Ne e zbritëm atë në një natë të bekuar.*” (Ed Duhan, 3). Për nder të kësaj nate që u bë zarf i zbritjes së Kuranit madhështor, këtë natë e bëri natë që do të caktohen procese të rëndësishme për njerëzit. Në këtë natë do të merren vendime madhështore për njerëzit, do të caktohen exhelet e tyre, se kush do të vdesë brenda këtij viti. Po ashtu, do të caktohet rrësku për secilin gjatë këtij viti që vijon pas kësaj nate. Ai xh.sh. thotë: “*Në atë (natë) zgjidhet çdo çështje në mënyrë të prerë.*” (Ed Duhan, 4).

Për vlerën e kësaj nate, Imam Kurtubiu, ka thënë: “Virtyti i kohës qëndron në bollëkun e virtyteve që ndodhin brenda saj. Atë natë shpërndahen aq shumë mirësi, sa që nuk gjenden në një mijë muaj, Zoti e di! Shumë komentues thanë se është më mirë të punosh në të sesa të punosh në një mijë muaj që nuk kanë Natën e Kadrit.”⁵

Ebu Bekër el Verraki⁶ ka thënë: “Zoti i Madhëruar i ndau netët e këtij muaji⁷ sipas fjalëve të kësaj sureje, kështu që kur arriti në natën e njëzet e shtatë, ai tregoi dhe tha: “*Është (هَيَّ).*” Gjithashtu, nata e Kadrit është përmendur tri herë, dhe është nëntë shkronja, (لَيْلَةُ الْقَدْرِ), pra i bie njëzet e shtatë herë.”⁸

“Vërtet, Ne e zbritëm atë në Natën e Kadrit”, që do të thotë, Ne e zbritëm këtë Kuran të mrekullueshëm në Natën e Kadrit dhe komentuesit thanë: “Ajo u quajt Nata e Kadrit për shkak të madhësisë së saj dhe nderit që ka.” Ajo që nënkuptohet me shpalljen e Kuranit në këtë natë është se ai zbriti nga pllaka e ruajtur në qiellin më të ulët, siç ka thënë Ibën Abbasi: “Zoti e zbriti Kuranin të tërin nga Tabela të Ruajtura në Shtëpinë e Lavdisë deri te qielli më i ulët, pastaj e zbriti në detaje sipas ngjarjeve për njëzet e tri vjet tek i Dërguarit i Zotit a.s.”⁹

Transmetohet nga El Zuhriu se ai ka thënë: “Nata e Kadrit është një natë e madhësisë dhe nderit, nga thënia e tyre: “*Filani ka peshë te filani-فلان قدر عند فلان*”, që do të thotë pozitë dhe nder.”¹⁰

Zemehsheriu për komentimin e ajetit të dytë të sures El Kader, ka thënë: “Dhe çfarë të bën të dish se çfarë është Nata e Kadrit?” Do të thotë, dija jote nuk ka arritur nivelin e lartë të

begatisë së saj dhe lartësinë e pozitës së saj.” Pastaj tregoi se ajo është më e mirë se një mijë muaj, dhe arsyeja e ngritjes së saj në këtë pozitë madhështore është për dobietë fetare që gjenden në të që ai përmendi, si zbritja e melaqeve dhe shpirtit dhe përcaktimi i çdo çështjeje të urtë.¹¹

Imam Err Rrazi ka thënë: “Dhe dijeni se caktimi i Zotit nuk ndodh në atë natë, sepse Zoti i Madhëruar i ka caktuar vendimet para se të krijonte qiejt dhe tokën në amshim (ezel), përkundrazi, ajo që nënkuptohet është se vendimet/caktimet iu shpallën melaqeve atë natë duke i shkruar ato në Tabelën e ruajtur, dhe ky mendim është mendimi i përzgjedhur nga shumica e dijetarëve.”¹²

Myslimanët përveç që janë të privilegjuar nga popujt e tjerë, ata janë dhe të bekuar me këtë natë madhështore, për arsye se kjo natë, ua mundëson që të bëjnë të mira për një natë sa të tjerët nuk mund të arrijnë të bëjnë këto vepra të mira për një mijë (1000) muaj. Kështu që myslimanët duhet të përfitojnë gjatë kësaj nate, duke bërë ibadet/adhurime të ndryshme si; *namaz, sadaka, lexim të Kuranit, dhikër, dhe dua-lutje!* E dua ja më e preferuar është të thuhet: “*Allahume ineke afuvun kerimun tuhib el-afve, fe afu ani!*”¹³ Por, mund të bëhen edhe lutjet të tjera që janë në Kuran apo në Sunet, sikur edhe që mund të bëhen lutje e kërkesa personale për vete, familjen dhe shoqërinë.

Ibën el Xhevi ka thënë: “Paraardhësit përgatiteshin për të, kështu që Temim ed Dari, kishte një kostum me vlerë prej njëmijë dërhëmësh që do ta vishte në natën që shpresohej të ishte Nata e Kadrit.”¹⁴

Në fund nuk na mbetet tjetër pos ta lavdërojmë dhe ta falënderojmë Allahun xh.sh. që na ka bërë fat dhe na ka bërë besimtarë të kësaj nate madhështore dhe të këtij Libër madhështor!

- 1 Ky ajet është përsëritur në këtë sure katër herë më numër: 17, 22, 32 dhe 40.
- 2 Gari Myller është shkencëtar kanadez, i cili e pranoi Islamit në vitin 1977, pasi e lexoi ajetin e 30-të të sures El Enbija.
- 3 27/11/02, 08 :06 08:06:26 PM/www.Nusrah.tv/“Big Bang”.
- 4 El Harurij, “*Hadaiku rrevhi ve rrejhan*”, vëll. 28, Daru Turukunexhat, Kajro, 2001, f. 266.
- 5 El Kurtubi, Muhamed bin Ahmed, (671, h), “*El Xhamiu li Ahkamil Kuran*”, Bejrut: sh.b. Darul kutub el Ilmije, Bejrut, 1991, vëll. 20, f.115.
- 6 Muhamed ibën Omer et Termidhij, v. 240h.
- 7 Ramazani.
- 8 El Xhamu li Ahkamil Kuran, vëll. 20, f. 119.
- 9 Es Sabuni, Muhamed Ali, “*Safvetu Tefasir*”, sh.b. Mektebetul Asreije, 1997 Kajro, vëll. 3. f. 231.
- 10 “*Mfatihul Gajb*”, vëll. 32, f. 345.
- 11 Ez Zemahshari, Mahmud ibën Omer, (v. 538 h), “*El Keshaf*”, sh.b: Dar Ihja et Turath el arabij, botimi i I-rë, 1997, Bejrut, vëll. 3, f. 223.
- 12 “*Mefatihul Gajb*”, vëll. 32, f. 355.
- 13 Kështu e ka porositur Pejgamberi a.s. Aishen që të thotë në këtë natë. Et Termidhi, Muhammed ibën Isa ibën Sureh, (v.275h), Sunen et Termidhi, kitab Ed Davat, bab: hedethena Jusuf bin Isa, nr. 3513. Imam en Nisai, “*Sunen el Kubra*”, nr. 7712. Ibën Maxhe, nr. 3580.
- 14 Ibën el Xhevi, “*Et Tefsira*”, sh.b: Darul Hadith, 2004, vëll. 1, f. 482.

Dita, që nuk qe si ditët e tjera (BETEJA E BEDRIT)

Blerim Musliu

Dielli do të lindte edhe në ditën e shtatëmbëdhjetë të muajit të bekuar Ramazan, të vitit të dytë pas hixhretit të të Dërguarit të Zotit a.s., nga Meka për në Medine. Por kjo ditë, që dielli do të lindte zakonshëm, nuk do të ishte e zakonshme, ngase në këtë ditë, Zoti i Gjithësisë, kishte përgatitur një nga befasitë më të këndshme për të Dërguarin e Tij dhe për besimtarët mbarë. Por krahas kësaj, Ai, edhe për mushrikët dhe armiqtë e fesë kishte përgatitur ditën, të cilën, ata, nuk do ta harronin asnjëherë.

Kësaj dite të bekuar i kishin parapri disa ditë të tensionuara, lojërash me nerva, ku në një rën anë ishte i Dërguari i Zotit a.s., i cili nuk kishte dalë për të luftuar, por vetëm për ta vëzhguar karvanin që kthehej nga Shami dhe për të shpresuar se ndoshta Allahu Fuqiptotë do t'ua kompensonte sado pak humbjet e jashtëzakonshme që ua kishin shkaktuar kurejshitë në tërë pasurinë e konfiskuar pas dëbimit nga Meka.

Nuk qe si ditët e tjera, sepse këtu u thyen rregullat e fitores dhe të humbjes. Kush do të mendonte se një grup i vogël njerëzish, i papërgatitur për luftë, do ta mposhte një ushtri trefish më të madhe e me të gjitha përgatitjet për luftë?!

Përballë kësaj gjendeshin kurejshitë, që me mburrjen e tyre, me kryelartësinë e tyre, nuk mund ta pranonin faktin se ata të cilët i kishin maltretuar deri në dëbim nga vendi, tanimë janë forcuar dhe po ua rrezikonin imazhin e tyre të pathyeshëm në imagjinatën e tyre.

Kurejshëve, edhe pse u kishte shpëtuar karvani, dhe ku Ebu Sufjani, si udhëheqës i karvanit, kërkonte nga mekasit që të ktheheshin, sepse nuk kishin asnjë arsye për luftë, prapëseprapë, një grup i udhëheqësve kurejshë, të rrëmbyer nga mburrja, siç ishte ndër ta Ebu Xhehli, nuk pranuan në asnjë mënyrë të ktheheshin me një ushtri që ishte trefish më e madhe se e myslimanëve, diku një mijë ushtarë, që të gjithë të përgatitur për luftë, në krahasim me myslimanët, të cilët ishin treqind e disa, dhe atë të papërgatitur për luftë.¹ Ebu Xhehli tha se do të bëjnë tri ditë festë para ballafaqimit. Të hënën do të theren shumë deve, e do të kemi një festë për të cilën do të dëgjojnë tërë arabët. Ne, tha ai, përveçse do ta mposhtim këtë grup të rebeluar





njerëzish, ne do t'ua fusim edhe frikën në palcë kujtdo që vetëm guxon të mendojë t'i sfidojë kurejshitë, fqinjët e Qabesë.

Por, dita e Bedrit kishte përgatitur krejt diçka tjetër...

Këtë ditë, Allahu Fuqiptotë, e kishte caktuar që të mos ishte si ditët e tjera.

Nuk qe si ditët e tjera, sepse këtu u thyen rregullat e fitores dhe të humbjes. Kush do të mendonte se një grup i vogël njerëzish, i papërgatitur për luftë, do ta mposhte një ushtri trefish më të madhe e me të gjitha përgatitjet për luftë?!

Nuk ishte ditë e zakonshme, sepse ndodhi ajo që nuk e prisnin asnjë, zbritja e pesëmijë melaqeve për ndihmë ndaj të Dërguarit a.s. dhe sahabëve nga ana e Allahut xh.sh., ashtu siç e dëshmon Ai xh.sh. në suren Ali Imran: *“Po nëse jeni të qëndrueshëm e të matur, e ata (armiqtë) t’ju vinë tash në këtë moment, Zoti juaj ua vazhdon juve ndihmën me pesëmijë prej engjëjve të ushtruar (për luftë) ose të shënuar.”* (Ali Imran, 125).

Nuk ishte si ditët e tjera ku kryeneçët dhe arrogantët vazhdojnë arrogancën e tyre, ngase në luftën e Bedrit, ata i priti përdhosja e kësaj krenarie të rreme dhe nga aty dolën kokulur si asnjëherë më parë, disa prej tyre të vdekur e disa të tjerë të nënçmuar.

Nuk ishte si ditët e tjera, sepse në këtë ditë, burrat e vërtetë e dëshmuuan burrërinë e besnikërinë ndaj të Dërguarit a.s.. Një prej tyre ishte Sad ibën Muadhi r.a., i cili tha: *“Unë betohem në Zotin që të ka dërguar ty me të drejtë si peygamber, se sikur të na urdhërosh të hymë në det, ne do të futemi të gjithë menjëherë, pa munguar nga ne asnjë. Ne nuk do të themi siç i thanë Musait shokët e tij, shko ti e lufto bashkë me Zotin tënd se ne po të presim këtu, e madhështia*

e kësaj dite ishte se ensarët – medinasit, ia kishin dhënë besën se do ta përkrahnin të Dërguarin a.s. në Medine, e tani ata ishin jashtë saj, Medinës.”²

Kjo ditë nuk ishte si të tjerat, ku njerëzit e duan dhe japin gjithçka pas dynjasë e nuk e duan vdekjen. Në këtë ditë, kishte nga ata që kur përmendej Xheneti, nuk pranuan as t'i hanin hurmat që i kishin në duar nga frika se po vonoheshin, siç ishte rasti me Umer ibën el Humami el Ensariju.³

Dita që nuk i përngjanë asnjë dite, sepse Vetë Zoti i Madhëruar e quajti *“Dita e dallimit të madh”*, pra dita ku u bë diferenca dhe dallimi përfundimtar ndërmjet të vërtetës dhe të kotës: *“... dhe të (Kuranin) që ia zbritëm robit Tonë (Muhamedit) ditën e furkanit (ditën e Bedrit, kur u dallua e vërteta nga e shtrembra)...”* (El Enfal, 41).

Këto janë vetëm disa nga gjërat që e bëjnë këtë ditë të jetë më ndryshe dhe më e veçantë, e për ata që e bënë këtë ditë të veçantë, Pejgamberi i Zotit a.s., tha se Allahu tha për ata që ishin në Bedër, veproni çfarë të doni, se Ai, Allahu ju ka falur.⁴ Ju ka falur, sepse ju e ndihmuat të Dërguarin a.s. në momentet më të vështira, ju e përkrahët atë dhe nuk kursyet asgjë, madje as jetën, që kjo ditë të jetë dita e shpresës. Bindja se rrugëtimi i kësaj feje po merr vrullin e pandalshëm, në vazhdimësinë e së cilës jemi edhe ne, që tash, pas shumë viteve e kujtojmë këtë me krenari, duke lutur Zotin që të na bëjë edhe ne hallkë përcjellëse të dritës së fesë tek ata që vinë pas nesh, deri në atë ditë kur do të përfundojë i tërë tregimi e do të mbetet e përjetshme kënaqësia nën hijet e xheneteve, të gjithë së bashku, nën mëshirën e Krijuesit të Gjithësisë.

1 Ibni Hishami, “Sijer en Nebeviye”.

2 Transmeton Taberaniu me sened të mirë.

3 Transmeton Muslimi.

4 Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

Koncepti i zekatis në Kuran

Akademik Enes Kariq

Zekati (dhënia e detyrueshme e pasurisë me qëllime të mira) është një nga fjalët shtytëse të Kuranit. Sipas Kuranit, zekati është i mbarsur me Islamin në kuptimin bazë të dhënies së pasurisë “moralisht të detyrueshme” për qëllime të së mirës dhe moralit. Por me kalimin e kohës, zekati, si nga ana kuptimore ashtu edhe praktike, është ngushtuar në *lëmoshë*. Kështu, zekati prej kohësh ka rënë viktimë e interpretimeve reduktuese të Kuranit dhe interpretimeve që nuk marrin parasysh tërësinë e Librit themelor të Islamit. Ndër pasojat e rëndësishme të një interpretimi kaq *prekës* dhe *patetik* të fjalës zekat është përkthimi i saj semantikisht shumë i shpërndarë.

Për shembull, shumë përkthime të Kuranit në anglisht nga epoka të ndryshme të zekatis reduktohen kryesisht në *lëmoshë* ose fjalë sinonime të *lëmoshës*. Muhamed Marmaduke Pickthall,¹ zekatin më së shpeshti e përkthen me fjalën *the poor-due* (“pjesa e varfër” nga pasuria në pronë, nga pasuria që “u shkon të varfërve”, “pjesa e varfër”). Në përkthimin popullor në anglisht të Kuranit nga Abdullah Yusuf Ali,² zekati përkthehet kryesisht me sintagmën *regular charity* (“lëmoshë e rregullt”, “dhënie e rregullt/në kontinuitet të lëmoshës”). Për më tepër, edhe në përkthimi më të fundit në anglisht të Kuranit nga Seyyed Hossein Nasri (dhe grupi përkthyesish),³ zekatin e përkthejnë si *alms*, “lëmoshë”.

Nga ana tjetër, përkthimet gjermane zekatin e përkthejnë ndryshe. Hartmut Bobzin,⁴ përdor fjalën *die Armensteuer* (fjalë për fjalë: “taksë për të varfrit”, “taksë e varfër”), ndërsa Max Henning,⁵ fjalën zekat e përkthen

vazhdimisht si *die Steuer* (“taksë” në kuptimin më të përgjithshëm).

Sigurisht, fjala kuranore zekat, është e vështirë të përkthehet me sukses në përvoja, sisteme dhe botë të tjera gjuhësore duke përzgjedhur një fjalë. Kjo mund të shihet edhe në luhatjet në përkthimet e Kuranit të cituara këtu. Ata që e përkthejnë zekatin me fjalën *lëmoshë* dhe sinonimet e saj, e humbin vëmendjen se fjala zekat në Kuran është një çift i barabartë me fjalën *salat*, e cila nënkupton *përballje dhe takim i shumëfishtë i njeriut me Zotin*, si dhe *përballje dhe takim i Zotit me njeriun*. Njëjtë sikurse që bëhet padrejtësia e fjalës *salat* kur përkthehet vetëm me fjalën *lutje*, ashtu bëhet padrejtësi edhe kur zekati përkthehet vetëm si *lëmoshë*.

Kështu, është e gabuar ta shikosh *salatin* dhe *zekatin* vetëm në kontekstin e *lutjes* dhe *lëmoshës*, megjithëse të dyja fjalët pjesërisht, natyrisht, përfshijnë *lutjen* dhe *lëmoshën*. Këtë e ndjenin shumë përkthyes të Kuranit,

Njëjtë sikurse që bëhet padrejtësia e fjalës *salat* kur përkthehet vetëm me fjalën *lutje*, ashtu bëhet padrejtësi edhe kur zekati përkthehet vetëm si *lëmoshë*.



kështu që në përkthimet e tyre ata e përkthyen fjalën *salat* në fjalën persiane *namaz*. Dhe fjala zekat u la si zekat, duke iu përmbajtur paprekshmërisë së kuptimit të saj origjinal dhe duke llogaritur se fjala zekat, ashtu si fjala salat, u afirmua në mënyrë konjitive nga devotshmëria islame dhe u bë e njohur përmes thesareve simbolike të kulturës islame.

ZEKATI - FORMË E BASHKËPUNIMIT PASUROR MIDIS NJERIUT DHE ZOTIT

Ragib el Isfahani (vdiq më 1108 pas ‘Isa el Masihut, a.s.) në “Fjalorin e tij të Kuranit”,⁶ etimologjikisht kur e shqyrton fjalën zekat, pohon se ajo përmban idenë e “shtimit” ose “rritjes” (*en-numuww*), kjo rritje ka një aureolë morale, sepse vjen nga bekimi i Zotit (*barakah*) në pronë, për më tepër, ky bekim kuptohet si në gjërat e kësaj bote dhe të asaj bote. Në të njëjtin vend, El Isfahani e përkufizon “zekatin si atë që njeriu e lë mënjanë sipas ligjit të Zotit për të varfrit (*min haqqi llāhi ta ‘ālā ilā l-fuqarā’i*)”. El Isfahani përmend shprehjen “tezkiyyatu n-nefs” (pastrimi i shpirtit) si pasojë e drejtpërdrejtë e dhënies së zekatit.

Por, me zekatin pastrohet edhe pasuria. Sipas Azim Nanji, autor i tekstit enciklopedik mbi zekatin në “Encyclopaedia of the Qur’ān”,⁷ në kontekstin e zekatit nuk është vetëm “pastrimi i vetvetes” (*the cleansing of oneself*), por ka të bëjë edhe për “pastrimin e pasurisë” (*the cleansing of one’s property*).

Nëse i kthehemi vendit të zekatit në tërësinë kuranore, kuptimi i asaj fjale do të jetë më i qartë për ne si një dhënie moralisht obliguese, e detyrueshme e pasurisë me qëllim të së mirës. Arsyet për rëndësinë e zekatit bëhen të dukshme vetëm kur dëgjohen shpalljet e Kuranit se “çdo gjë në qiej dhe në tokë i përket Zotit”,⁸ si dhe se njerëzit nuk ndajnë të tyren, por vetëm “atë që Zoti u ka dhuruar, furnizuar.”⁹ Kjo e bën njeriun të vetëdijshëm se duhet të rishqyrtojë nëse ai (në pasuri, mendje, shpirt...) është një qenie plotësisht autonome?! Dhe sa është njeriu një krijesë e përgjegjshme, e cila e mori këtë Tokë si një “trashëgim” të përkohshme, si dhe pasuritë, frutat dhe dhuratat e saj të shumta?! Nga

Sipas Azim Nanji, autor i tekstit enciklopedik mbi zekatin në “Encyclopaedia of the Qur’ān”,⁷ në kontekstin e zekatit nuk është vetëm “pastrimi i vetvetes” (*the cleansing of oneself*), por ka të bëjë edhe për “pastrimin e pasurisë” (*the cleansing of one’s property*).

thirrja e fuqishme e tërësisë kuranore vjen shpallja: “Zoti është i pasur dhe ju jeni të varfër”¹⁰ d.m.th.: Zoti ju ka huazuar aftësitë, arritjet, fitimet, pasuritë tuaja dhe ju, në këtë mënyrë, keni hyrë në statusin e borxhlinjve të përparuar ndaj Zotit! Kështu i gjithë Kurani thotë: të japësh zekat dhe të japësh *sadakat* do të thotë t’i kthesh borxh Zotit.

Këto shpalosje të përgjithshme të Kuranit shpjegojnë arsyet ose *reason d’etre*: se pasuria (që Kurani e quan *māl* ose *amwāl*)¹¹ është e detyrueshme të shpenzohet për hir të së mirës duke i ndihmuar njerëzit dhe plotësuar nevojat e tyre, të gjitha në përputhje me parimin e *bil-ma’rūfi* (promovimi i së mirës).¹² Është karakteristikë se në reshtin e Kuranit 2: 177, proklamohet se një person “duhet të japë pasuri, pavarësisht se është ajo pasuri e dashur për të” dhe se sa është afër zemrës ajo (*wa āta l-māla ‘alā hubbihi*).¹³

Të gjitha këto shpallje të Kuranit shërbejnë si pikënisje për pranimin e zekatit si një detyrë morale e pacenueshme, si një trajtim moral i detyrueshëm si me pasurinë e dikujt ashtu edhe me kategoritë e veçanta të njerëzve që kanë “të drejtën e asaj pasurie (*haqq*)”, siç thotë Kurani.¹⁴

Por, kuptohet edhe nga vetë Kurani se, ndarja e pasurisë në rrugën e së mirës përfundon jo vetëm në mënyrën e “kthimit të Zotit atë që veç është e Zotit”, por në këtë ndarje njerëzit “i japin një hua të bukur Zoti” (*yuqridullāha qardan hasanan*),¹⁵ duke rritur kështu burimet dhe pasurinë e përfshirë në proceset e zekatit. Kjo hap perspektiva për bashkëpunimin e shumanshëm të Zotit dhe njeriut në rrugët e së mirës dhe zekati është vetëm një nga mjetet e shumta të këtij bashkëpunimi që përmirëson mundësitë reale të jetës së njerëzimit.

ZEKATI SI “SADAKAT”

Në Kuran, zekati përmendet edhe sinonimisht me fjalën *sadakat*, me kuptimin e rreptë të dhënies së pasurisë për të mirë. Megjithatë, ndonjëherë kuptohet nga Kurani se *sadakat* nuk e arrin shkallën e detyrimit moral në të cilin ndodhet zekati. Kjo është pikërisht ajo që Ragib el Isfahani në Fjalorin e tij të Kuranit¹⁶ ka thënë: “Sadaka është që një njeri ndanë nga pasuria e tij për afërsisht me



Në kushtet tona, kur linja shtetërore, civile dhe laike, nga njëra anë, dhe fetare nga ana tjetër, është e demarkuar qartë, zekati më së miri i jepet Bashkësisë Islame, e cila i ka kapacitete të veta për ta mbledhur atë dhe nevoja të veta për ta shpenzuar.

zekatin, por sadakaja është në thelb ajo që jepet në baza vullnetare, ndërsa zekati është i bazuar në detyrë...”

Fjala kuranore *sadakat* është e gabuar të barazohet me fjalën *sadaka*, në kuptimin e thjeshtë lëmoshës që shprehet në dhënien e parave të imta lypsarëve në rrugë, rrugicë, shesh apo pragun e derës. Në kuadrin e tërësisë kuranore, *sadakat* konsiderohet dhe komunikohet në lidhje me fjalët që tregojnë “të vërtetën” ose “sinqeritetin”, “besimin e sinqertë në Zot” dhe më pas angazhimin e pasurisë së dikujt për të mirën e besimit. Janë të gjitha këto kuptime që i përmban rrënja kuranore *s-d-q*. Në këtë kuptim, *sadakat* janë zekati që jepen tërësisht, në të vërtetë, sinqerisht, nga bindje, pa mbajtur për vete asnjë pjesë të pasurisë që duhet t’u shpërndahet kategorive të përcaktuara të njerëzve.

Siç mund të shihet, fjala *sadakat* është sinonim i zekatit, si i tillë shpesh ndodh përmes Kuranit. Edhe pse fjala *sadakat* përmban gjithashtu idenë e lëmoshës (ose dhuratë “të rastësishme” dhe rastësore, të vogël për të varfrit dhe nevojtarët), *sadakat* nuk duhet të reduktohet në asnjë mënyrë vetëm në lëmoshë, në *sadakanë* tonë në kuptimin bisedor të fjalës.

Si përfundim, në kushtet tona, kur linja shtetërore, civile dhe laike, nga njëra anë, dhe fetare nga ana tjetër, është e demarkuar qartë,

zekati më së miri i jepet Bashkësisë Islame, e cila i ka kapacitete të veta për ta mbledhur atë dhe nevoja të veta për ta shpenzuar. Kjo ndihmon në ruajtjen e trashëgimisë fetare, kulturore, qytetëruese, të Islamit dhe myslimanëve.

*Përktheu dhe përshtati nga gjuha boshnjake:
Dr. Azmir Jusufi*

- 1 Mohammed Marmoduke Pickthall, *The Meaning of the Glorious Koran*, (published by the Penguin Group / A Mentor Book, New York, 1994).
- 2 Abdullah Yusuf Ali, *The Holy Qur'an*, (Wordsworth Classics of World Literature, London – Birmingham, 2000).
- 3 Seyyed Hossein Nasr (editor-in-chief), *The Study Quran*, (Harper Collins Publishers, New York, 2015).
- 4 Hartmut Bobzin, *Der Koran, Neu übertragen*, (C. H. Beck, München, 2010).
- 5 Max Henning, *Der Koran*, (Çağrı Yayınları, İstanbul, 1998).
- 6 Krhs. ar-Rāgib al-İsfahānī, *Mufradātu l-Qur'an*, (botimi i Dāru l-fikr, Bejrut, 1972), 286.
- 7 Krhs. Azim Nanji, *Almsgiving*, (botuar nga Jane Dammen McAullife - redaktore, *Encyclopaedia of the Qur'an*, vol. I, Leiden, 2001), 66.
- 8 Surja *Lopa/el-Bakare*, 2:284.
- 9 Surja *Lopa/el-Bakare*, 2:3.
- 10 *Muhamed/Muhammed*, 8.
- 11 Krhs. *Lopa/el-Bakare*, 2:177; *Lopa/el-Bakare*, 2:188.
- 12 Krhs. *Familja e 'Imrāniti/Alī 'Imrān*, 3:114.
- 13 Krhs. *Lopa/el-Bakare*, 2:177.
- 14 Krhs. *Ata që fryjnë/edh-Dharijat*, 51:19.
- 15 *Lopa/el-Bakare*, 2: 245.
- 16 Krhs. ar-Rāgib al-İsfahānī, *Mufradātu l-Qur'an* (botimi i Dāru l-fikr, Bejrut, 1972), 286.



Sadakatul fitri

Mr. Fitim Gashi

Sadakatul fitri është një obligim fetar sjetor, një ibadet-adhurim material, i cili praktikohet vetëm në muajin Ramazan dhe është i lidhur ekskluzivisht me të. Atë, sipas shumicës së dijetarëve islamë, e kanë detyrim-vaxhib ta zbatojnë myslimanët që posedojnë pasuri përtej nevojave ditore familjare.

NORMA-DISPOZITA E SADAKATUL FITRIT

Sipas së drejtës së shariatit, sadakatul fitri bën pjesë apo hynë në kategorinë e atyre normave dhe dispozitave të cilat llogariten vaxhib-obligative për t'u zbatuar. Sadakatul fitri si i tillë është bërë obligim në vitin e dytë të hixhretit, në të njëjtën kohë kur është bërë obligim edhe agjërimit i muajit Ramazan.¹

Abdullah ibën Umeri transmeton dhe thotë se: *“Pejgamberi a.s. e ka caktuar detyrë obliguese sadakatul fitrin për Ramazan një saâ hurma ose një saâ elb për çdo person të lirë ose skllav, mashkull ose femër nga myslimanët.”*²

Po ashtu, Ibën Abasi transmeton dhe thotë: *“Pejgamberi a.s. e ka bërë obligim zekatul fitrin (sadakatul fitrin) pastrim për agjëruesin për fjalët e kota e të ndyta, dhe ushqim për të varfrit, andaj kush e jep atë para namazit të Bajramit, ajo është sadaka e pranuar, e kush e jep pas namazit të Bajramit, konsiderohet vetëm një sadaka e rëndomtë.”*³

Mbi bazën e këtyre haditheve kuptohet qartazi se ligjësimi i sadakatul fitrit është bërë për ta pastruar agjëruesin nga ajo që mund të ketë bërë nga mëkatet gjatë agjërimit të tij, qoftë me fjalë apo me vepra, e po ashtu edhe ushqim dhe ndihmë për të varfrit dhe nevojtarët në mënyrë që të mos kenë nevojë për shtrirjen e dorës në ditën e Bajramit.

Kur e shikojmë urtësinë e synuar prej ligjësimit të sadakatul fitrit, vërejmë se ajo përmban dy gjëra të rëndësishme: njëra ndërlidhet me individin e tjetra me shoqërinë. E para ka të bëjë me individin që agjëron muajin Ramazanit, prandaj ky agjërues duhet ta bëjë agjërimitin e tij të plotë dhe kjo arrihet duke e ruajtur gjuhën dhe gjymtyrët e tij nga ajo që Allahu dhe i Dërguari i Tij e ndaluan të thotë apo të veprojë. Ai nuk duhet të flas në mënyrë të turpshme ose të kotë, por duhet të thotë dhe të flas vetëm atë që është e mirë dhe e dobishme, ashtu siç ka ardhur në hadith: *“... le të flas mirë ose le të heshtë”*⁴, sepse agjërimiti nuk nënkupton vetëm abstenim nga dëshirat e stomakut dhe të epshit, përkundrazi ai duhet të bëhet i plotë me të gjitha gjymtyrët në mënyrë që të arrihen synimet e tij dhe agjëruesi të jetë fitimtar në këtë botë dhe në botën tjetër. Mirëpo, meqenëse mundësia për lëshime është gjithëherë e evidente, plotësimin dhe pastrimin e agjërimit dhe të agjëruesit më së miri e bën dhënia e sadakatul fitrit.



Ligjësimi i sadakatul fitrit është bërë për ta pastruar agjëruesin nga ajo që mund të ketë bërë nga mëkatet gjatë agjërimit të tij, qoftë me fjalë apo me vepra, e po ashtu edhe ushqim dhe ndihmë për të varfrit dhe nevojtarët në mënyrë që të mos kenë nevojë për shtrirjen e dorës në ditën e Bajramit.

Gjithashtu synimet e sadakatul fitrit shtrihen përtej rrafshit individual, ato nuk mbesin vetëm në këtë dimension, por kanë një rëndësi të madhe dhe luajnë një rol të rëndësishëm edhe në aspektin shoqëror. Përmes sadakatul fitrit krijohet afërsi ndërmjet njerëzve, forcohen lidhjet shoqërore e po ashtu është një lloj solidariteti social, i cili manifestohet në festa të veçanta.

SASIA E SADAKATUL FITRIT

Sasinë e sadakatul fitrit, sikurse e përmendëm, e caktoi vetë Pejgamberi a.s. kur e obligoi atë, një sa'a ushqim nga hurmat, rrushi i thatë, gruri apo elbi. Një sa'a është e barabartë për afërsisht me 3.800 gr.⁵ Nga llojet e përmendura të ushqimeve, sasia e sadakatul-fitrit është për afërsisht sa ushqimi njëditor i një të varfëri, prandaj me sadakatul fitr është synuar të plotësohet ushqimi njëditor i një të varfri, sipas rrethanave dhe standardeve të shoqërisë ku ai ka jetuar.

DHËNIA E SADAKATUL FITRIT ME VLERËN E TË HOLLAVE

Dhënia e sadakatul fitrit me artikujt e lartpërmendur, në ditët dhe rrethanat tona pothuajse është e pa aplikuar dhe jo shumë efektive, prandaj ajo lejohet dhe mund të jepet edhe me kundërvlerën e tyre. Madje, disa dijetarë bashkëkohorë, dhënie e kundërvlerës së tyre në të holla, në kohën dhe rrethanat e sotme, e konsiderojnë më të dobishme dhe shumë më efektive. Imami Ebu Hanife (Allahu e mëshiroftë!), ka lejuar që myslimani ta japë sadakatul fitrin e sasisë së vlerës së ushqimit me vlerën e të hollave.⁶ Transmetohet se Omer ibën Abdulazizi, kalifi i drejtë, (Allahu e mëshiroftë!) i shkroi guvernatorit të tij në Basra, Adijj ibën Urtah, të cilin e urdhëronte për ta marrë sadakatul fitrin nga banorët, për çdonjërin nga gjysmë dërhem. Në atë kohë, gjysmë dërhem kishte vlerën e një sa'i të ushqimit. Të këtij mendimi janë edhe Thevriu, Hasan el Basriu e të tjerë.

Sigurisht se kjo mund të jetë më e dobishme, dhe sidomos kur i varfëri ka nevojë për të. Sepse, nëse të varfrit i grumbullohen ushqimet, ai nuk do të ketë shumë dobi prej tyre, dhe ndoshta do të detyrohet edhe t'i shesë me çmim më të ulët. Ndërkaq, prej të hollave mund të ketë dobi, sepse me to mund

Imami Ebu Hanife (Allahu e mëshiroftë!), ka lejuar që myslimani ta japë sadakatul fitrin e sasisë së vlerës së ushqimit me vlerën e të hollave. Transmetohet se Omer ibën Abdulazizi, kalifi i drejtë, (Allahu e mëshiroftë!) i shkroi guvernatorit të tij në Basra, Adijj ibën Urtah, të cilin e urdhëronte për ta marrë sadakatul fitrin nga banorët, për çdonjërin nga gjysmë dërhem.

të blejë atë për të cilën ka nevojë si, rroba, ushqim, ëmbëlsira për fëmijët e vet, ose edhe diçka tjetër të dobishme për familjen e tij.

Caktimin e vlerës së sadakatul fitrit e bëjnë institucionet kompetente, të cilat sipas standardit jetësor në vendet ku jetojnë e përcaktojnë vlerën e sasisë. Në rastin tonë është Bashkësia Islame i vetmi institucion kompetent për të caktuar vlerën e sadakatul fitrit, gjë të cilën e bënë me autoritet dhe në kohë të duhur.

KUSH OBLIGOHET TA JAPË SADAKATUL FITRIN?

Sadakatul fitrin, sipas shumicës së dijetarëve islamë, është i obliguar ta japë secili person që posedon vlerën e tij, që i mbetet tepriç nga nevojat familjare të tij. Ai e ka obligim për vete dhe për ata që janë të varur dhe janë nën kujdestarinë e tij, pavarësisht nëse janë të rritur ose të vegjël, meshkuj ose femra, të shëndoshë ose jo.

KOHA E DHËNIES SË SADAKATUL FITRIT

Në kuptimin e lejueshmërisë, sadakatul fitri mund të jepet në secilën kohë gjatë muajit Ramazanit, edhe po të nxirrej në fillim në ditën e parë apo të mesit të Ramazanit është i ligjshëm dhe është krejtësisht në rregull, mirëpo preferenca e dhënies së tij ndërlihet me pjesën e fundit të Ramazanit, gjegjësisht prej natës së Kadrit deri në natën e Bajramit. Koha e fundit për ta dhënë sadakatul fitrin është para faljes së namazit të Bajramit, e nëse vonohet pas kësaj kohe, obligimi nuk bie, mirëpo vlera e tij mbetet e një sadakaje të rëndomtë.⁷

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Ai që e jep sadakatul fitrin para namazit (të Bajramit), i konsiderohet sadaka e pranuar, kurse ai që e jep pas namazit (të Bajramit), i konsiderohet sadaka (lëshoshë) e rëndomtë.”⁸

KUJT I TAKON SADAKATUL FITRI

Personave ose institucioneve që u takon dhe kanë të drejtë ta pranojnë zekatin, mund ta marrin edhe sadakatul fitrin. Allahu i Lartësuar thotë: “Allahu e caktoi obligim, që lëshosha (zekati etj.) t’ju takojë vetëm të varfërve (nevojtarëve), të ngratëve (që s’kanë

fare), punonjësve (që e tubojnë), atyre që duhet përfituar zemrat (të dobëtëve në besim), e duhet dhënë edhe për lirimin nga robëria, të mbyturve në borxhe, (luftëtarëve) në rrugën e Allahut dhe atij që ka mbetur në rrugë...” (Et Tevbeh, 60). Në këtë ajet kuranor flitet për tetë kategori të cilat sigurisht se nuk janë të gjitha përherë aktuale. Ndonjëherë është aktuale njëra e ndonjëherë një tjetër kategori, e gjithëherë i jepet përparësi asaj që është më e rëndësishmja. Kështu veproi Muhamedi a.s. në kohën e tij. Ai përcaktonte përparësitë në varësi nga nevojat dhe rrethanat që ishin prezentë. Kjo praktikë është ndjekur edhe nga pasardhësit e tij, kalifët dhe dijetarët myslimanë deri në ditët e sotme. Hanefitë, e po ashtu edhe shumë dijetarë të kohës sonë, kategorisë “fi sebililah – të angazhuarit në rrugën të Allahut”, i kanë dhënë një kuptim të gjerë duke i përfshirë: kërkuesit e diturisë, shkollimin dhe aftësimin e brezave që ta kuptojnë dhe ta shpjegojnë islamin, rrugët e mirësisë apo nevojat e përgjithshme. Andaj, pa dyshim, institucioni më i denjë në vendosjen e prioriteteve se kush është më primar në pranimin e sadakatul fitrit është institucioni fetar i vendit.

Në vendin tonë, në përputhje me fetvanë e nxjerrë nga njerëzit kompetent për çështje të fikhut, por edhe në vendet përreth, organizimin e tubimit dhe shpërndarjes së sadakatul fitrit e bëjnë institucionet e Bashkësisë Islame. Mjetet e tubuara nga sadakatul fitri, zekati dhe ndihmat e tjera, kryesisht janë të destinuara për mirëmbajtjen e institucioneve fetaro-arsimore, siç janë medresetë dhe Fakulteti i Studimeve Islame me qëllim të nxjerrjes së kuadrove fetarë, të cilët do të shërbejnë dhe punojnë në ngritjen e vlerave edukativo-arsimore, por edhe për qëllime

Sadakatul fitrin, sipas shumicës së dijetarëve islamë, është i obliguar ta japë secili person që posedon vlerën e tij, që i mbetet tepricë nga nevojat familjare të tij. Ai e ka obligim për vete dhe për ata që janë të varur dhe janë nën kujdestarinë e tij, pavarësisht nëse janë të rritur ose të vegjël, meshkuj ose femra, të shëndoshë ose jo.

humanitare, nëpërmes organeve e institucioneve të veta nëpër terren.

Andaj, shpresojmë se besimtarët tanë në Kosovë, por edhe ata në diasporë, traditën e tubimit të sadakatul fitrit, sipas kësaj fetvaje, do ta vazhdojnë ta bëjnë në fondet e Bashkësisë Islame. Duke kryer këto detyrime fetare në këtë mënyrë, kontribuojmë në ruajtjen e Islamit në vendin tonë.

E lusim Allahun e Madhërishëm që sadakatul fitrin, zekatin dhe të gjitha ndihmat e tjera të na i pranojë dhe të na shpërblejë me mirësitë e Tij!

1 Prof. dr.Vehbet ez Zuhejli, “*El Fikh el-I slami ve ediletuhu*”,(Damask, Darul Fikr, 2002), fq. 2035-2037.

2 Buhariu, 1504; Muslimi, 984.

3 Ebu Davudi, 1609; Ibën Maxheh, 1827.

4 Buhariu, 6138; Muslimi 47.

5 Prof. dr.Vehbet ez Zuhejli, “*El Fikh el Islami ve ediletuhu*”, fq. 2035.

6 Shih Abdurrahman bin Muhamed el Xheziri, “*Kitabul Fikh alel medhahib el-erbeatu*”, Bejrut, Dar ibën Hazem, bot 1, 2001, fq. 353, dhe prof. dr. Vehbet ez Zuhejli, “*El Fikh el Islami ve ediletuhu*”, fq. 2044.

7 Shih prof. dr. Vehbet ez Zuhejli, “*El Fikh el Islami ve ediletuhu*”, fq. 2041-2043.

8 Hadithi është shënuar më herët.



Kuptimi i hadithit në dritën e Sunetit

Dr. Muhamed Stublla

Hadithi, sikurse Kurani, burimin e kanë prej Allahut të Madhërishëm. Kështu që, shpallja hyjnore është përcjellë te njerëzimi mbarë, përmes Kuranit dhe hadithit. Shpjegimi i hadithit përmes haditheve të tjera, nënkupton shpjegimin e hadithit prej Zotit xh.sh., dhe sigurisht që ky do të jetë shpjegimi i duhur.

Funksioni i haditheve nuk është vetëm interpretimi dhe shpjegimi i ajeteve, sepse hadithet sjellin edhe kuptime, norma dhe informacione të reja, të cilat nuk i përmend Kurani. Hapi apo kusht i veçantë për kuptimin e drejtë të haditheve të Pejgamberit a.s., pas kushtit të kuptimit të haditheve në dritën e Kuranit, është kuptimi i haditheve përmes haditheve apo transmetimeve të tjera, tematika e të cilave ndërlidhet me atë hadith, kuptimin të cilit duam ta shpjegojmë, ashtu sikurse e ka synuar Pejgamberi a.s.. Ajetet e Kuranit janë transmetuar tekstualisht, çdo fjalë, fjali dhe ajeti është mësuar ashtu sikurse i ka zbritur Muhamedit a.s..

Kuptimi i haditheve të Muhamedit a.s. është shpallje nga Zoti, tek ai a.s., i cili si zakonisht i formulonte tekstet e atyre kuptimeve. Këtë metodologji apo rrugë të formulimit të fjalëve, fjalive të haditheve, e kanë bërë transmetuesit prej Muhamedit a.s. dhe kështu me radhë. Pak nga totali i haditheve janë transmetuar tekstualisht, ashtu si i ka thënë Muhamedi a.s.. Por duhet të kemi në konsideratë, që shumë herë përsëritet hadithi, apo ngjarja e natyrës së ngjashme, të cilat sillen në të njëjtën orbitë, dhe bashkimi i tyre e plotëson atë.

Njashtu, është me rëndësi të theksojmë, që përveç fjalëve të Muhamedit a.s., të cilat në përgjithësi janë transmetuar kuptimisht,

veprat, cilësitë dhe pëlqimet e tij, të cilat gjithashtu janë hadithe, janë përshkrime të sahabëve, të cilat burojnë nga kuptimet e tyre ndaj veprave, pëlqimeve apo cilësive të Muhamed Mustafasë a.s.. Kjo metodologji e transmetimit të hadithit, është trashëguar edhe nga tabiinët - nxënësit e shoqëruesve të Muhamedit a.s., sahabëve, por edhe nga dijetarët, autorët e koleksioneve të haditheve, etj.. Dëshmi që transmetimet janë transmetuar në formë të kuptimit, janë shprehjet e ndryshme në të njëjtin hadith, dhe të cilat janë thënë vetëm njëherë.¹ Sikurse të ishte përsëritur hadithi apo ngjarja, do të ishte e natyrshme që formulimi i tekstit, respektivisht i hadithit tjetër, të ndryshonte nga ai paraparak. Mirëpo, përderisa hadithi është thënë vetëm njëherë nga Muhamedi a.s., por është përcjellë me shprehje të ndryshme, kjo tregon që hadithi nuk është bartur tekstualisht, veçanërisht kur versionet e transmetimit kanë kuptim të përafërt apo plotësojnë njëra-tjetrën.

Transmetimi i haditheve kuptimisht, është shfaqur shumë qartë edhe te koleksionet e sakta të haditheve, specifikisht te hadithet që i transmeton imam Buhariu, i cili e dëgjonte hadithin në një vend, por e shkruante në një vend apo qytet tjetër. Ndërsa imam Muslimi ishte më preciz në shprehjet e transmetimit, meqë ai nuk e praktikoi metodën e imam Buhariut për shkrimin e koleksionit të tij. Andaj, gjejmë hadithe të njëjta te të dy koleksionet e sakta të hadithit, por ndryshojnë shprehjet apo fjalët për shkak të transmetimit të mbështetur vetëm nga memorizimi, i cili nuk e ka fuqinë e saktësisë sikurse të ishte e shkruar, por ka mundësi që ndryshimet në hadith të jenë edhe për shkak të transmetimit kuptimisht.²

Përderisa hadithi është thënë vetëm njëherë nga Muhamedi a.s., por është përcjellë me shprehje të ndryshme, kjo tregon që hadithi nuk është bartur tekstualisht, veçanërisht kur versionet e transmetimit kanë kuptim të përafërt apo plotësojnë njëra-tjetrën.

Askush, në asnjë kohë dhe në asnjë vend nuk krahasohet me diturinë, besnikërinë dhe fetarizmin e sahabëve, megjithatë, përshkrimi dhe kuptimi i tyre nuk është sikurse shprehja tekstuale e Pejgamberit, Muhamed Mustafasë a.s.. Ndërsa të gjithë transmetuesit e tjerë, përveç sahabëve, për pranimin e haditheve të tyre, i janë nënshtruar kontrollit, ku u siguria për besnikërinë dhe diturinë e tyre, si në aspektin e memorizimit, njëashtu edhe në atë të shkrimit. Pas gjithë këtij kontrolli, kalimit në filtrat e kritikës së hadithit, vendosej për pranimin apo jo të haditheve që transmetonin ata transmetues.

Prandaj, që hadithi të kuptohet drejt, saktë, të mos keqkuptohet dhe të mos keqinterpretohet, duhet që të mblidhen të gjitha transmetimet e hadithit. Në rastin e tubimit të të gjitha versioneve të transmetimit të hadithit, do të përshkruhet ngjarja apo objektiva e kuptimeve të haditheve prej të gjitha këndeve, gjë e cila do të ndihmojë apo vetvetiu do të shpjegojë qëllimin e një shprehje apo fjalie të pa qartë në hadithin përkatës.

Nevojën e bashkimit të transmetimeve, për kuptimin e tyre të drejtë, mbetet e pa zëvendësueshme, për faktin që dobësia gjuhësore dhe shkencore fetare, kuptimi jo i drejtë, paragjykimi apo paracaktimi i koncepteve, por edhe injoranca, janë shumë të shfaqura në kohën tonë. Andaj, nëse nuk i bashkojmë të gjitha transmetimet për të njëjtën temë, nuk mund dhe nuk duhet të tentojmë që të shpjegojmë hadithin ashtu sikurse kërkohet, përndryshe përshkrimi i temës sigurisht se do të jetë i mangët dhe jo i plotë.

Që kuptimi i hadithit të jetë i saktë dhe gjithëpërfshirës, duhet që transmetimi i tij të jetë i plotë dhe gjithëpërfshirës.

Me rëndësi është që të potencojmë se ndër shkaqet e tjera të transmetimit të haditheve kuptimisht është edhe përmendja e pjesës argumentuese apo të përshtatshme me temën e caktuar. Transmetuesi, por edhe autori i koleksioneve duke shpjeguar ndonjë çështje, përmend vetëm pjesën apo shprehjen që i shërben argumentimit të asaj që shpjegon apo temës boshtore. Andaj, kur të vijë hadithi prej disa rrugëve etj., plotësohen pjesët e pa potencuara në hadithin përkatës.


Njëra prej kushteve qendrore të vërtetimit të saktësisë apo dobësisë së hadithit, padyshim që është edhe bashkimi i rrugëve të transmetimit të hadithit. Në këtë kontekst, bashkimi i transmetimeve të haditheve kuptimisht, është

Nëse nuk i bashkojmë të gjitha transmetimet për të njëjtën temë, nuk mund dhe nuk duhet të tentojmë që të shpjegojmë hadithin ashtu sikurse kërkohet, përndryshe përshkrimi i temës sigurisht se do të jetë i mangët dhe jo i plotë.

kriter për saktësinë apo shfaqjen e dobësisë së hadithit, i cili kriter është i pa kompromis të dijetarët që japin vlerësime për normën e haditheve.³

Mos bashkimi i rrugëve dhe versioneve të teksteve të hadithit, lehtësisht do të mundësojë në gabim të normës apo kategorisë së saktësisë së hadithit, por edhe mundësinë e mos kuptimit të drejtë dhe të plotë të haditheve. Në mënyrë që të konkretizojmë praktikisht atë që u përmend më lartë, do të sjellim dy shembuj të kuptimit të haditheve përmes bashkimit apo përmbledhjes së haditheve.

Ezani për namazin e sabahut. Se sa herë duhet të thirret ezani i sabahut, Muhamedi a.s., ka thënë: “Bilalli e thirr ezanin natën, hani dhe pini derisa të thirr ezanin Ibën Umi Mektumi.”⁴ Nga ky hadith kuptohet që në namazin e sabahut janë thirrur dy ezanë, pa u kufizuar me ndonjë kohë të caktuar. Këtë koncept e sqaron hadithi tjetër. Ibën Mesudi r.a., tregon se Muhamedi a.s., ka thënë: “Ezani i Bilallit nuk ju ndalon nga ushqimet dhe pijet e syfyrit, sigurisht që ai e thirr ezanin që të përfundojnë namazin ata që falen natën dhe të zgjohet ai që është në gjumë.”⁵ Ky hadith tregon që ishte përcaktuar njëri nga ezanët që t’ju tregojë besimtarëve se është ofruar koha e imsakut, ndërprerjes apo largimin nga gjërat që e prishin agjërimin, dhe ishin të informuar që ezani i dytë ishte caktuar për stopim,



respektivisht ndalonte gjërat që e prishin agjërimin.

Ndërsa hadithi vijues tregon që ky format i ezanëve ishte vetëm në Ramazan. Ebu el Mahdhureh thotë: “Në kohën e Resulullahut a.s., nuk është thirrur ezani përveç se në sabah, dhe nuk është thirrur ezani derisa ka hyrë koha e namazit të sabahut.”⁶ Kështu përmes bashkimit të të gjitha transmetimeve, kuptohet që nuk lejohet të veprohen gjërat që e prishin agjërimin pas ezanit që ishte përcaktuar për imsak apo stopim të gjërave që e prishin agjërimin. Ezani i parë ka qenë vetëm si rikujtim, apo formë që të tregohet se duhet të përgatitemi për të filluar agjërimin. Dhe se dy ezanë janë thirrur vetëm në Ramazan. Këto janë elemente të rëndësishme, të cilat ne nuk do t'i dinim apo nuk do t'i kuptonim po që se nuk do t'i bashkonim hadithet që ndërlidhen me këtë tematikë.

Rrobat që janë nën nyjën apo zogun e këmbës. Prej shembujve më të qasshëm për shpjegim të kësaj teme kemi hadithet që flasin për këtë temë, për shkak të qartësisë së saj.

Fillimisht, kemi disa tekste apo versione të haditheve që jo vetëm që thërrasin në shkurtimin e rrobave mbi nyjën e këmbës, por ato edhe kërcënojnë ashpër atë që nuk i shkurtojnë atë. Në bazë të këtyre versioneve, gjejmë qëndrime që shkurtimi i rrobave për meshkuj është obligim, dhe ai që nuk e bënë është gjynahqar i madh. Ndër këto hadithe, Muhamedi a.s. thotë: “Çdo veshje që është e lëshuar nën nyje të këmbëve do të jetë në zjarr.” Hadith tjetër të ngjashëm është edhe ky: “Tre njerëz Allahu nuk do t'i shikojë në Ditën e Gjykimit; ai që dhuron lëmoshë me krenarinë e cila e injoron marrësin, ai që betohet rrejshëm për ta shitur ndonjë mall dhe ai që i lëshon pantallonat nën nyje të këmbës.” Në një version tjetër, në pjesën e qortimit shtohet: “...dhe as nuk do t'i pastrojë (nga mëkatet), ata i pret dënim i dhembshëm.”⁷

Cilësia ekzistuese apo përmbledhëse që merr pjesë te të tri kategoritë është mendjemadhësia. Ai që injoron dikë, e konsideron vetën më të lartë, është mendjemadh. Njëra prej cilësive të atyre që betohen shpesh për gjëra të pavlefshme është mendjemadhësia. Njashtu ishte shenjë e mendjemadhësisë që shfaqte pasurinë e dikujt

Zgjatja e rrobave apo lëshimi nën nyje të këmbës mund të konsiderohej për atë kohë edhe masraf, shpërfillje e pa nevojshme e pasurisë, kjo pasi që materiali i rrobave ishte në mungesë.

nëse lëshonte rrobat nën nyje. Andaj, sigurisht që mendjemadhi e meriton dënimin e mos shikimit dhe mos të folurit e Zotit me fjalë mëshire e rahmeti, duke rezultuar edhe me dënim në zjarr.

Dëshmi që arsye e përfshirjes në kërcënim ndaj atij që lëshon apo zgjat rrobat nën nyjën e këmbës është mendjemadhësia, kemi hadithin e Abdullah ibën Omeri r.a., i cili ka thënë: “E kam dëgjuar Pejgamberin a.s., me këta dy veshë duke thënë: “Kush e tërheq veshjen e tij nëpër tokë, duke mos pasur qëllim tjetër gjë, përveç se mburrjes, atë Allahu nuk do ta shikojë në ditën e Gjykimit.”⁸

Nga ky hadith, duhet të potencojmë dy elemente:

Fjala e transmetuesit: “E kam dëgjuar Pejgamberin a.s., me këta dy veshë duke thënë...”, tregon sigurinë e transmetuesit në atë që transmeton. Në rast të kundërthënive, kjo shprehje ka prioritet apo përparësi para shprehjeve që nuk janë të kësaj natyre.

Tregon që shkak i këtij kërcënimi për këtë vepër qenka mendjemadhësia, e cila për atë kohë shumë herë shfaqej përmes gjatësisë së rrobave.

Vështirësitë e varfërisë ishin të shfaqura edhe në veshmbathje, andaj, ai që zgjaste rrobat nën nyje, ishte sinjal i dëshirës së tij që të shfaqet para të tjerëve. Sot çmimi i rrobave, nuk dallon nga gjatësia, por nga cilësia, andaj, mund që dikush të ketë rrobat mbi nyje dhe të meritojë dënimin nëse për qëllim ka mendjemadhësinë. Zgjatja e rrobave apo lëshimi nën nyje të këmbës mund të konsiderohej për atë kohë edhe masraf, shpërfillje e pa nevojshme e pasurisë, kjo pasi që materiali i rrobave ishte në mungesë.

Ebu Bekri r.a., kur e kishte dëgjuar këtë kërcënim, ju kishte drejtuar Muhamedit a.s.: “O i Dërguar i Zotit, njëra pjesë e rrobës time po më bie poshtë nën nyje apo po tërhiqet për tokë, edhe pse po të premtojë se do të përkujdesem për këtë.” Pejgamberi a.s., i tha: “Nuk je prej atyre që e vepron nga mendjemadhësia.”⁹ Kuptim i këtij hadithi është i qartë dhe është shprehur edhe në hadithe të tjera, por edhe nëse do të ishte vetëm hadithi i Ebu Bekrit do të mjaftonte, sepse në rregullën e njohur mes juristëve: “Mësimet merren nga



kuptimi i shprehjes apo fjalës, jo nga shkak i thënies.”¹⁰ Shkak është i veçantë, ndërsa norma juridike është e përgjithshme, dhe jo e kufizuar.

Imam Buhari në librin e tij të saktë ‘Sahih’, në njërin ndër titujt e librit të tij, kishte shkruar: “Kush lejon që veshja t’i zvarritet nëpër tokë nga mendjemadhësia.”¹¹ Përmes këtyre titujve, imam Buhari, tregonte qëndrimet e veta për çështje juridike. Pastaj, hadithin e parë që kishte transmetuar nën këtë titull është hadithi nga Ebu Hurejre, në të cilin thuhet: “Allahu nuk e shikon njeriun, i cili tërheq zvarrë veshjen e tij nga mendjemadhësia.”¹²

Në këtë transmetim, fjala është e përgjithshme dhe e pa kufizuar, edhe norma juridike është e tillë, e cila ndërlidhet me mendjemadhësinë. Në lidhje me mendjemadhësinë, Pejgamberi a.s., ka thënë: “Nuk do të hyjë në Xhenet, personi në zemrën e të cilit ka qoftë edhe një grimcë mendjemadhësie.” Dikush e pyeti: “Me të vërtetë njeriu dëshiron të ketë rroba dhe këpucë të bukura.” Për këtë Pejgamberi tha: “Me të vërtetë Allahu është i bukur dhe e do bukurinë, ndërsa mendjemadhësia është refuzim i së vërtetës dhe poshtërim i njerëzve.”¹³

Çështjet sikurse kjo, përderisa nuk kanë të bëjnë me ibadete e adhurime, kërcënimet e tilla zakonisht vijnë për shkaqe të tjera, të ndërlidhura me këtë, e që këtu është mendjemadhësia.

Urdhrat për organizimin e jetës, zakonisht më së shumti bëhen sunet, të preferuara. Në këtë rast kjo është e ndërlidhur me mendjemadhësinë. Veshja mbetet çështje zakoni në shoqërinë në të cilën jeton, me kusht që të mos ketë zbulim të avretit dhe përkufizim të gjymtyrëve.

Pra, nga kjo kuptojmë se është e lejuar që besimtari t’i ketë rrobat e tij qoftë edhe nën zogun e këmbës, dhe kjo nuk paraqet aspak problem, meqë nuk bëhet nga mendjemadhësia.

Duhet që për shpjegimin e haditheve të kalojmë përmes kësaj rruge. Kjo është metodë e selefëve për kuptimin e hadithit, prandaj është edhe shkencore. Mos respektimi i rregullave shkencore islame rezulton në devijime, deformime e keqkuptime të fesë.

- 1 Es Sujuti, Abdurrahman bin Ebi Beker, Xhelaluddin, Tedrib Err Rravi fi Sherh Takrib en Nevevij, recensoi: Ebu Kutejbeh, Nadhar Muhamed el Farjabii, (bot. Dar Tajibeh), 1/533.
- 2 Ibën Haxher, Ahmed ibën Ali ibën Muhamed, “Feth El Bari”, (Bejrut: Dar el Marifeh, 1379 h.), 11/210.
- 3 Ibën Ebi Hatim, Abdurrahman er Rrazi, “El Illel li Iben Ebi Hatim”, (Bejrut: Metabia el Hamidii, 2006), 1/60.
- 4 Imam Malik, Malik ibën Enes, “El Muvata bi Rivajet Muhmed ibën El Hasan Esh Shejbani”, (Liban, Bejrut, El Mektebeh el Ilmije), nr. 347, 1/122. Hidithi i saktë në Buhari, nr. 621/127, 1.
- 5 El Buahriu, Muhmed bin Ismail, Ebu Abdullah, “Sahih el Buhari el Xhamia el Musned es Sahih el Muhtesar min Umuri Resululahi a.s. ve Ejamihi ve Sunenih”, recensoi: Muhamed Zehir bin Nasir en Nasir, (Liban, Bejrut, Dar Tuk en Nexhah, 1422) nr.621, 1/127.
- 6 Esh Shejbani, Muhamed ibën el Hasan, “El Huxheh Ala Ehl el Medineh”, (Bejrut, Alim el Kutub 1987) 1/76. Hadith Hasen.
- 7 Muslimi, Ibën Haxhaxh en Nejsaburi, “Sahih Muslim el Musned es Sahih el Muhtesar Binakl el Adël Ani el Adël Ila Resulullahi a.s.”, recensent: Muhamed Fuad Abdul Baki, (Liban, Bejrut, Dar Ihja et Turath el Arabij), nr.: 201/1, 601.
- 8 Sahih Muslim, nr. 2085, 3/1652.
- 9 El Buahriu, Muhmed bin Ismail, “Sahih el Buhari el Xhamia el Musned es Sahih el Muhtesar min Umuri Resululahi a.s. ve Ejamihi ve Sunenih”, (Liban, Bejrut, Dar Tuk en Nexhah, 1422) nr.: 5784, 141/7.
- 10 Errazi, Ebu Abdullah, Muhamed bin Umer bin el Hasesn; “El Mausul”, (Liban, Messesstu Errisaleh, 7991) 521/3.
- 11 Sahih el Buahri, 7/141.
- 12 Burimi paraprak, nr. 5788, 7/141.
- 13 Sahih Muslim, nr. 91, 1/93.

Ramazani në “Diturinë Islame” – përmbledhje bibliografike

Dr. Sedat Islami

HYRJE

Revista “Dituria Islame” është një revistë profesionale, e cila për dekada ka shërbyer dhe vazhdon të shërbejë besimtarët me sinqeritet dhe devocion. Në çdo numër të saj mund të gesh materiale me vlerë në të cilat trajtohen çështje nga më të ndryshmet, duke filluar nga ato me të cilat ballafaqohemi, për të vazhduar më pas me të tjera që kanë rëndësi besimi për ne, e për të përfunduar me të tjera kulturore, të cilat mëtojnë ta formojnë lexuesin sa më shumë që të jetë e mundur në aspektin kulturor dhe intelektual. Në fakt, këto janë edhe trajektorët që revista ndjek në misionin e saj.

Për shkak të rëndësisë që mund të kenë ngjarje dhe data të caktuara, revista ndonjëherë ua kushton tërë numrin ose pjesën më të madhe të tij atyre ngjarjeve dhe datave të caktuara. Kështu ndodhë zakonisht me muajin Ramazan, ditët e haxhillëkut, etj.. Me këtë mëtohet që çështjet që kanë të bëjnë me këto adhurime apo data të mbulohen sa më shumë që të jetë e mundur. Në këtë punim do të ofrojmë një përmbledhje bibliografike të shkrimeve përkitazi me muajin Ramazan, për ta dëshmuar këtë detyrë që me nder e ka luajtur revista, por edhe për të qenë një lloj ndihmese dhe përkrahje për hatibët dhe vaizët tanë, të cilët në këtë muaj janë më të angazhuar se kurdoherë më parë. Shkrimet e ofruara në revistë tematikisht mbulojnë pothuajse çdo gjë që ka të bëjë me Ramazanin dhe agjërimin, duke filluar nga historiku, normat, vlerat, etika, ngjarjet historike e materiale tjera me rëndësi si p.sh., hytbet e xhumave dhe Fitër Bajramit.

Metodologjia që kemi ndjekur në përshkrimin e përmbajtjes ramazaneske të revistës është si në vazhdim: fillimisht kemi shënuar numrin e revistës dhe në bazë të tij kemi bërë radhitjen e materialit, pastaj titullin, emrin e autorit dhe në fund numrin e faqeve të shkrimit përkatës.¹ Nga përshkrimet del se, ndërmjet numrave 1-377, janë publikuar gjithsej 296 shkrime me tematikë ramazani.

NR. 8-9, JANAR-QERSHOR 1988

Këshilla e Muhammedit a.s., në prag të Ramazanit, përktheu: R. L., f. 10.

Agjërimi i Ramazanit në hadithet e Muhammedit a.s., Miftar Ajdini, f. 11-14.

Agjërimi gjatë historisë, Nexhat Ibrahim, f. 14-17.

Ramazani, muaj i agjërimit, Avni Aliu, f. 18-20.

Vlerat themelore të agjërimit: Edukimi dhe vetëmposhtja, Muhammed Abdullah Draz, përktheu: Nexhat Ibrahim, f. 20-25.

Agjërimi, faktor me rëndësi në ruajtjen e shëndetit, Ebu Nehar, f. 25-26.

Lamtumira nga Ramazani, Muhammed Abdullah Draz, përktheu: Nexhat Ibrahim, f. 27-28.

NR. 12, JANAR-MARS 1989

Ramazani, muaj i bekuar, Sherif Ahmeti, f. 3-5.

Nata e madhe e Kadrit – hytbe, Avni Aliu, f. 6-8.

NR. 35, MARS 1992

Muaji i Ramazanit është muaj i fitoreve, Rexhep Boja, f. 3.

Si duhet të jetë ramazani ndër ne, f. 4.

Çështje agjërimi dhe përse na u bë farz, H.Ali, f. 5-7.

Ramazani muaji i Kur'anit, Izuddin Belik, f.8-10.

Agjërimi dhe zekati i fitrit, Muhamed bin Salih Uthejmin, përktheu Ylvi Durguti, f. 10.

Agjërimi ilaç i organizmit, Rrahman Ratkoceri, f. 12-13.

Agjërimi te fetë tjera, Nedvi, përktheu Qemajl Morina, f. 13-15.

Për shkak të rëndësisë që mund të kenë ngjarje dhe data të caktuara, revista ndonjëherë ua kushton tërë numrin ose pjesën më të madhe të tij atyre ngjarjeve dhe datave të caktuara. Kështu ndodhë zakonisht me muajin Ramazan, ditët e haxhillëkut, etj..

Mirë se na vjen Ramazan – poezi, Mexhid Yvejsi, f. 29.

Agjërimi – poezi, Mehmet Zhinipotoku, f. 41.

NR. 36, PRILL 1992

Porosia e ramazanit – editorial, f. 3.

Bajrami i madh – hytbe, Vehbi Ismaili, f. 5-6.

Zekatu-l-fitri, përktheu: M. Polisi, f. 6-9.

Çka pas Ramazanit, f. 9-10.

Lufta e Bedrit, fitorja e parë muslimane, Sabri Bajgora, f. 16-17.

Ramazani ka traditë gjithandej, Elez Osmani, f. 29-30.

NR. 55, SHKURT 1994

Agjërimi, provë e devocionit dhe e realitetit shpirtëror, Avni Aliu, f. 24-25.

Muaji i Ramazanit – poezi, Hysen Shabani, f. 25.

Disa nga rregullat e agjërimit, përktheu Qemajl Morina, f. 26-27.

Namaz i teravive, Sadik Mehmeti, f. 28.

Ramazani, muaj i adhurimit, Sylejman Osmani, f. 29-30.

Miku i vjetër – poezi, Ali Vezaj, f. 30.

Ramazani '92, Zaim Qafleshi, f. 31-32.

NR. 56, MARS 1994

Lamtumirë, muaji i mëshirës, Zaim Qafleshi, f. 30.

Çka piqet nuk hiqet – reagim rreth shkrimit “Agjërimi ngarkesë për nxënësit”, Redaksia, f. 31.

A duhet të agjërojnë fëmijët?, Qemajl Morina, f. 32.

NR. 64, JANAR 1995

Agjërimi nga aspekti medicinal, Ali Iljazi, f.6.

Agjërimi jashtë kohës së Ramazanit, Ahmed Adiloviq, f. 9.

Ramazani muaj i Kur'anit, Avni Aliu, f. 10.

NR. 65, SHKURT 1995

Agjërimi dhe Kur'ani, Ridvan el-Bili, f. 7.

NR. 66, MARS 1995

Për një konceptim të drejtë të agjërimit islam, Fatmir Jëlliçi, f. 33.

NR. 76, JANAR 1996

Ramazani gërshetim ndërmjet shpirtërores e materiale, Rexhep Boja, f. 3.


Ramazani muaj i agjërimit, Sylejman Osmani, f. 5.

Medreseja fton besimtarët: Zekati dhe sadakaja e fitrit e drejtë e saj, Avni Aliu, f. 8-10.

Ardhja e Ramazanit – poezi, Nijazi Sulça, f. 10.

Beteja e Bedrit -1, Ismet Shehibrahimoviq, përktheu Nexhmedin Hoxhaj, f. 11-13.

Vendimi në prag të Ramazanit: jam shqiptar dhe besimtar, Mexhid Yvejsi, f. 46.



NR. 77, SHKURT 1996

Madhërojeni Allahun për atë që iu ka udhëzuar – Këshilla e Fitër Bajramit, Qemajl Morina, f. 6-8.

Beteja e Bedrit -2, Ismet Shehibrahimoviq, përktheu Nexhmedin Hoxhaj, f. 22-25.

NR. 78, MARS 1996

Letër nga burgu: Ramazani im i parë, Gazmend Morina, f. 2.

NR. 87, JANAR 1997

Ramazani kalit njeriun: mesazh me rastin e muajit Ramazan, Rexhep Boja, f. 3.

Agjërimi devotshmëri ndaj Allahut, Sylejman Osmani, f. 4-6.

Si të jetojmë në Ramazan – poezi, Mexhid Yvejsi, f. 6.

Vështrim mbi agjërimitin, Qazim Qazimi, f. 7-10.

Zeqati dhe zeqatul fitri, Qemal Mehmeti, f.

11-14.

Gruaja që agjëroi pa ndërprerë 45 vjet, f. 15.

NR. 88, SHKURT 1997

T'i përgjigjemi detyrave fetare dhe atdhetare – Mesazhi me rastin e Fitër Bajramit, Rexhep Boja, f. 3.

NR. 98, DHJETOR 1997

Mesazhi i Kryetarit të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës me rastin e fillimit të muajit të Ramazanit, Rexhep Boja, f. 3.

Agjërimi dhe sadakatul fitri, Avni Aliu, f. 12-16.

NR. 99, JANAR 1998

Agjërimi i Ramazanit, Sejid Sabik, përktheu Xhabir Hamiti, f. 4-8.

Kur'ani dhe hadithi mbi rregullat e agjërimit islam, Jusuf Ramiq, përktheu Shaban Basha, f. 9-11.

Muaji i Ramazanit, Vehbi Sylejman Gavoçi, përktheu Ekrem Simnica, f. 12-13.

Ramazani, muaj i mëshirës, Xhavit Qerimi, f. 14-15.

Zekatul fitri, Idriz Xhigoli, f. 16-17.

Aty ku ka Ramazan – poezi, Mexhid Yvejsi, f. 17.

Meditim për Kur'anin gjatë muajit të ramazanit, Ali Iljazi, f. 20-22.

Lufta e madhe e Bedrit, Fahrush Rexhepi, f. 23-26.

NR. 107, DHJETOR 1998

Si të manifestohet agjërimi në sjelljet dhe veprimet e myslimanit, Qemajl Morina, f. 4-8.

Porosi të arta të muajit të bekuar të Ramazanit, Ali Iljazi, f. 9-11.

Muaji i Ramazanit rast ideal për transformim nga mosbesimi në besim, Agron Muçaku, f. 12-13.

NR. 113-114, NËNTOR-DHJETOR 1999

Ramazani, muaj i mëshirës hyjnore, Sabri Bajgora, f. 5-9.

Agjërimi, ibadet i veçantë islam, Jusuf Kardavi, përktheu Bashkim Mehani, f. 10-12.

Agjërimi i Ramazanit, Hajrullah Hoxha, f. 13-15.

Dispozita e fikhut rreth Ramazanit sipas Kuduriut, Muhammed Ilahi Ashik Bereni, f. 16-21.

Ramazani, forcë që realizon, Musa Vila, f. 22-23.

Rëndësia e Ramazanit dhe roli i imamëve në ngritjen e vlerave shpirtërore të myslimanëve, Rexhep Boja, f. 29-30.

Kush i dha besë Zotit –poezi, Ali Vezej, f. 19.

NR. 125, NËNTOR 2002

Mesazhi i Myftiut me rastin e Ramazanit, Rexhep Boja, f. 3.

Veçoritë dhe vlerat e Ramazanit, Rexhep Lushta, f. 7-9.

Zekati, obligim islam, Sulejman Osmani, f. 10-14.

Vlera e muajit Ramazan, Bahri Simnica, f. 15-17.

Hytbeja e Fitër Bajramit, f. 18.

NR. 127-128, JANAR-SHKURT 2001

Një ditë xhumaje në Ramazan, Nexhat Nahi, f. 67.

NR. 137, NËNTOR 2001

Ramazani, Sherif Ahmeti, f. 4-6.

Muaji i Ramazanit shkollë edukimi shpirtëror, Idriz Bilalli, f. 7-9.

Agjërimi nën prizmen e fikhut islam, Flamur Sofiu, f. 10-12.

Ramazani dhe vlerat e tij, Rexhep Lushta, f. 13-14.

Lufta e Bedrit – kthesë historike në Islam, Sulejman Osmani, f. 15-18.

Leximi i Kur'anit dhe dobitë e tij gjatë Ramazanit, Musa Vila, f. 19-22.

Sadakatul fitri, Resul Rexhepi, f. 23-24.

Mirë se na vjen o muaj i bekuar, Mexhid Yvejsi, f. 24

Institucioni i zekatit të fitrit, Ekrem Simnica, 25-27.

Namazi i teravive, Bahri Simnica, f. 28-29.

Nata e Kadrit, Taxhudin Ibrahim, f. 30-31.

NR. 148, TETOR 2002

Qëndrimi i muslimanit gjatë Ramazanit, Musa Vila, f. 8-9.

Agjërimi i Ramazanit dhe rregullat e itikafit, Flamur Sofiu, f. 10-13.

Vlera e agjërimin të ramazanit, Hajrullah Hoxha, f. 14-17.

Agjërimi, Husein Gjoza, f. 18-21.

Roli i agjërimin në formimin e personalitetit të njeriut, Muhidin Ahmeti, f. 22-25.

Agjërimi ekuilibër në mes materiale dhe shpirtërores, Xhevrije Dërguti – Vila, f. 26-27.

Agjërimi fisnikërimi i shpirtit, Rexhep Lushta, f. 30-31.

Ramazani, rast i mirë për thirrjen dhe këshillat islame, Bahri Simnica, f. 28-29.

Sadakatul fitri, Vahidin Behluli, f. 33-36.

Frymëzimi i hënës së re – poezi, Ali Vezej, f. 32.

Këshilla për ruajtjen e shëndetit gjatë agjërimin, Ferid Agani, f. 37-38.

NR. 159, TETOR 2003

Energjia qytetëruese në agjërim, Zija Abdullahu, f. 17-19.

Agjërimi, parim dallues në mes të vërtetës së qenies njerëzore dhe pozicionit hyjnor, Musa Vila, f. 20-22.

Agjërimi shërim i shpirtit dhe i trupit, Orhan Bislimaj, f. 23-27.

Agjërimi i Ramazanit dhe disa rregulla të tij, Xhafer Fejziu, f. 28-30.

Ramazani kthim nga Zoti, Nexhmedin Dernjani, f. 31-32.

Urtësia e agjërimin, Agim Hyseni, f. 33-34.

Nxitja për agjërim, Vehbi Sulejman Gavoçi, f. 35-38.

Me Kur'an në muajin e Kur'anit, Nail Halimi, f. 39-41.

Komentimi i kaptinës Kadër, Sadik Mehmeti, f. 42-44.

Kaptina Kadër, Jusuf Ramiq, f. 45-46.

Nata e Kadrit, Ilmi Krasniqi, f. 47.

Bajrami: simbol i unitetit dhe humanitetit, Xhevrije Dërguti – Vila, f. 48-50.

NR. 170-171, SHTATOR-TETOR 2004

Dispozita e agjërimin dhe rregullat e tij, Vehbi Sulejman Gavoçi, f. 7-9.

Ndikimi i agjërimin në përforcimin e besimit, Zija Abdullahu, f. 10-11.

Ramazani, muaj i mëshirës, Jakup Çunaku, f. 15-17.

Agjërimi dhe itikafi, Flamur Sofiu, f. 18-21.

Sot është Ramazan, Lavdi Allahut – poezi,

Mexhid Yvejsi, f. 22.

Për shumë vjet muajin e njeriut, Muhamed Sytari, f. 23.

Beteja e Bedrit dhe porosinë e saj, Xhafer Fejziu, f. 24-25.

Çlirimi i Mekkes, Fahrush Rexhepi, f. 26-28.

Zekati dhe sadakatul fitri, El-Bureni, f. 29-32.

Vlera e Sadakatul fitrit, Rexhep Lushta, f. 33-34.

Me fat Ramazani, Husejn Kabbani, f. 35-36.

NR. 182, SHTATOR 2005

Në pritje të Ramazanit, Fahrush Rexhepi, f. 10-12.

Dobitë nga agjërimi, Jakup Çunaku, f. 13-15.

Rregullat e agjërimin, Bahri Curri, f. 16-17.

Agjërimi, edukator psikologjik, Rexhep Suma, f. 18.

Nata e bekuar e Kadrit, Hajrullah Hoxha, f. 19-20.

NR. 194, SHTATOR 2006

Mesazhi i Myftiut me rastin e Ramazanit, Naim ef. Tërnavë, f. 4.

Muaji i Ramazanit, Vehbi Sulejman Gavoçi, f. 7-9.

Çfarë ke përgatitur për Ramazan, Amër Halid, f. 10-11.

Agjërimi në edukimin e vetëkontrollit dhe disiplinës, Avni Aliu, f. 12-15.

Merita e muajit të Ramazanit, Jusuf Kardavi, f. 16-19.

Agjërimi në Kur'anin Fisnik, Sadik Mehmeti, f. 20-22.

Ramazani dhe reforma shpirtërore, Rexhep Suma, f. 23-24.

Vlera e Ramazanit sipas haditheve të Pejgamebrit a.s., Fitim Flugaj, f. 25-26.

Ngjarje që kanë ndodhur në Ramazan, Bahri Curri, f. 27-29.

Jeta, Ramazani dhe Kur'ani, Mexhid Yvejsi, f. 30.

Agjërimi dhe diabetikët, Ali Iljazi, f. 31-34.

NR. 204-205, KORRIK-GUSHT 2007

Obligueshmëria e agjërimin nga urtësitë e

Krijuesit, Adnan Simnica, f. 9-10.

Muaji i bekuar i Ramazanit dhe ne, Muharrem Tërnavë, f. 11-12.

Duaja në Ramazan, Rrustem Spahi, f. 13-14.

Komentimi i ajeteve mbi agjërimin sipas Fikhut, Muhammed Ali Sabuni, përktheu Mehas Alija, f. 15-19.

NR. 206, SHTATOR 2007

Qëndrime pas Ramazanit, Jusuf Kardavi, përktheu Faruk Ukallo, f.9-12.

Komentimi i ajeteve mbi agjërimin sipas Fikhut - (2), Muhammed Ali Sabuni, përktheu Mehas Alija, f. 13-17.

NR. 216-217, SHTATOR 2008

Ramazani muaj i bekuar, Bahri Curri, f. 20-21.

Ramazani, muaji i garave më të mëdha që përjeton bota islame, Fahrush Rexhepi, f. 22-24.

Përgatitja për Ramazan – Hytbe, Sedat Islami, f. 25-26.

Beteja e madhe e Bedrit, Miftar Ajdini, f. 27-29.

Në atmosferën e agjërimin, Avni Aliu, f. 30-34.

Ramazani kryemysafiri i vitit, Rexhep Suma, f. 35-39.

Dhjetë netët e fundit të Ramazanit, Rexhep Lushta, f. 40-41.

NR. 218, TETOR 2008

Fitër-Bajrami vjen si një fllad i cili qetëson dhe gëzon zemrat e besimtarëve - Hytbeja e Myftiut, Naim ef. Tërnavë, f. 4-5.

Ndikimi i agjërimin në proceset biokimike dhe bioritëm, Ali F. Iljazi, f. 9-11.

NR. 228-229, KORRIK – GUSHT 2009

Si duhet ta presim muajin e Ramazanit, Fahrush Rexhepi, f. 5-8.

Ramazani, muaj i devotshmërisë dhe pastrimit shpirtëror, Besim Mehmeti, f. 9-10.

Ramazani muaji i ripërtëritjes së besimit, ymetit dhe xhematit, Muharem Omerdiç, f. 11-13.

Ramazani - muaji i mësimin fetar, Ismail Bardhi, f. 14-17.

Sekretet e agjërimin, Jusuf Kardavi, f. 18-21.

Agjërimi Islam, Arsim Dauti, f. 22-24.

Vendosmëria në agjërim dhe heqja e dyshimeve, Orhan Bislimaj, f. 25-27.

Agjërimi – një dhuratë e madhe hyjnore, Ajni Sinani, f. 28-29.

Vlera dhe dispozitat e agjërimin, Sabri Jonuzi, f. 30-32.

Nata e Kadrit, shancë e paqes së përhershme dhe stabile, Jusuf Zimeri, f. 33-35.

Mbi agjërimin me fe dhe mbi agjërimin shpirtëror, AbdulKadir Gjejlani, f. 36.

Efektet mahnitëse të agjërimin në organizëm, Ali F. Iljazi, 41-43.

Muaji i bekuar i Ramazanit dhe mirëqenia biologjike, psikosociale dhe shpirtërore e njeriut, Ferid Agani, f. 44-45.

Filozofia e agjërimin, Hamdi Thaçi, f. 46-48.

Në prag të muajit të bekuar të Ramazanit!,

Vedat Shabani, f. 49-51.

Ramazani lartësim shpirtëror për besimtarët, Rexhep Suma, f. 52-54.

Rezonim në fund të Ramazanit, Rrustem Spahiu, f. 55-56.

Agjërimi im i parë dhe Deriku, Zekerija Ibrahim, f. 57.

NR. 230, SHTATOR 2009

Çka pas Ramazanit?, Besim Mehmeti, f. 12-13.

NR. 241, GUSHT 2010

Ramazani, muaj i gëzimit, Orhan Bislimaj, f. 5-7.

Ramazani dhe pranimi i lutjeve, Adnan Simnica, f. 8-9.

Aspekti shpirtëror i muajit Ramazan, Fitim Flugaj, f. 10-12.

Ramazani shpëtim për njerëzimin, Rrustem Spahiu, f. 13-15.

Shkolla e Ramazanit, Almedin Ejupi, f. 16-17.



Nata e Kadrit, Jusuf Kardavi, f. 18-19.

Agjëro ditë të caktuara të shpaguhen sa një mujë muaj!, Afrim Jusufi, f. 20-21.

Agjërimi është për Mua, Refik Gërbeshi, f. 22-24.

Aspekti edukativ dhe shëndetësor i agjërimin, Ali F. Iljazi, f. 31-32.

Mjekësia dhe agjërimi, Bernard Tahirbegolli, f. 33-35.

Rëndësia e Bajramit dhe manifestimi i drejtë i tij, Besart Shala, f. 39-41.

Jeta, Ramazani dhe Kur'ani, Mexhid Yvejsi, f. 42-43.

Nr. 243, tetor 2010

Hytbeja e Fitër Bajramit, Naim ef. Tërnavë, f. 48-49.

Nr. 253, gusht 2011

Mysafiri i ri po vjen, kush i shpreh mirëseardhje!?, Vedat Shabani, f. 11-12.

Llogaria astronomike apo dukja e Hënës?, Driton Arifi, f. 13-15.

Ramazani dhe bereqeti i tij, Behxhet Jashari, f. 16-17.

Muaji ramazan dhe dobitë e tij, Ermal Bega, f. 18-20.

Koha më e bekuar e vitit – dhjetë ditët e fundit të Ramazanit, Zymer Ramadani, f. 20-22.

Nr. 254, shtator 2011

Hytbeja e Fitër Bajramit, Naim ef. Tërnavë, f. 6-7.

Nr. 264, korrik 2012

Agjërimi ndërmjet shpirtërores dhe fizikes, Nexhat Ibrahim, f. 14.

Ramazani – muaji i devotshmërisë, Ajni Sinani, f. 17.

Virtytet e agjëruësve, Vedat Shabani, f. 19.

Ramazani, virtytet, vlera dhe rëndësia e tij, Fitim Gashi, f. 22.

Ramazani, simbol i ndryshimit të individit dhe shoqërisë, Fejsal Spahiu, f. 25.

Të sëmurët dhe dispozitat që kanë të bëjnë me ta gjatë agjërimin, Driton Arifi, f. 28.

Sadakatul-Fitri, Jusuf Kardavi, f. 33.

Inserte Ramazani tek shqiptarët, Refik Gerbeshi, f. 47.

Nr. 265-266, gusht-shtator 2012

Hytbeja e Fitër Bajramit, Naim ef. Tërnavë, f. 5-7.

Nr. 276, korrik 2013

Ramazani muaj i adhurimit dhe i shpërblimit, Fahrush Rexhepi, f. 8.

Ramazani dhe ndihma e Allahut, Orhan Bislimaj, f. 12.

Fshehtësitë e agjërimit, Vedat Shabani, f. 15.

Ramazani - muaji i shpëtimit, Fatmir Hadri, f. 17.

Mysafiri më i mirë që na viziton, Mustafë Ahmeti, f. 19.

Vlera dhe rëndësia e dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit, Fitim Gashi, f. 22.

Rregulla të veçanta për agjërimitin e femrave, Fehime Gashi-Jusufi, f. 25.

Ramazani një shans i mirë për ne të rinjtë, Fejsal Spahiu, f. 27.

Agjërimiti, mburojë e besimtarit, Sedat Islami, f. 30-31.

Leximi i Kur'anit, Tarik Ramadan, f. 32.

E mbara nisi në Ramazan, Ali Vezaj, f. 38.

Përfshirja e njerit a të gjitha grupeve në dhënien e zekatit, Ejup Haziri, f. 39.

NR. 277-278, GUSHT-SHTATOR 2013

Hytbeja e Fitër Bajramit, Naim Tërnavë, 5-6.

NR. 287, QERSHOR 2014

Në pritje të muajit të bekuar të Ramazanit, Fahrush Rexhepi, f. 10-12.

Ramazani dhe roli i tij në jetën e muslimanit, Musa Vila, f. 13-16.

Ramazani muaj i Allahut, Qemajl Morina, f.

17-18.

Agjërimiti ibadet dhe edukim shpirtëror, Xhafer Fejziu, f. 18-19.

Ramazani muaj i duasë, Isa Tërshani, 20-23.

Namazi i teravisë dhe namazi i natës, Ragmi Destani, f. 23-26.

I'tikafi dhe normat e tij, Ekrem Maqedonci, f. 27.

Nata e Kadrit, Fitim Gashi, f. 28-30.

Hëna letrare e Ramazanit, Hysen Matoshi, f. 31-33.

Ligjërata e Fitër Bajramit, Jusuf Kardavi, f. 34-35.

NR. 297, MAJ 2015

Veçoritë e muajit Ramazan, Fitim Gashi, f. 16-17.

Agjërimiti, shkollë e urtësive, Ekrem Maqedonci, f. 18-20.

Kultura e agjëruesit, Isa Tërshani, f. 21-23.

Etika e agjërimit – hytbe, Sedat Islami, f. 24-25.

Ramazani dhe synimet tona gjatë këtij muaji të bekuar, Burim Bibaj, f. 26-27.

Namazi i teravisë, Driton Arifi, f. 28-30.

Në përkujtim të Ramazanit, Qemajl Morina, f. 31-32.

Agjërimiti në aspektin shëndetësor, Teuta Borovci-Jaha, f. 33-35.

NR. 308, MAJ 2016

Vlera e muajit Ramazan dhe të mirat që sjell ky muaj, Fahrush Rexhepi, f. 21-22.

Ramazani, muaj i humanizmit dhe unifikimit të radhëve të besimtarëve, Rexhep Suma, f. 23-26.

Agjërimiti dhe disa nga dobitë e tij, Isa Tërshani, f. 27-29.

Dispozitat e prishjes dhe mosprishjes së agjërimit, Ekrem Maqedonci, f. 30-33.

Porositë e luftës së Bedrit, Xhafer Fejziu, f. 34-36.

Nata e Kadrit, Bajrush Ahmeti, f. 37-40.

Dobitë e agjërimit nga perspektiva psikologjike, Ardiana Hajraj, f. 41-43.

NR. 309, QERSHOR 2016

Hytbeja e Fitër Bajramit!, Naim ef. Tërnavë, f. 6-8.

NR. 319, MAJ 2017

Agjërimiti (savmi) në Kuran, Azmir Jusufi, f. 23-25.

Vërtetimi i muajit Ramazan, Vehbi Sulejman Gavoçi, f. 26-27.

Filozofia shpirtërore e muajit Ramazan, Rexhep Suma, f. 28-31.

Ramazani, faktor në edukimin e besimtarit, Musa Vila, f. 32-34.

Lamtumira e Ramazanit dhe pritja e Bajramit

– hytbe, përshtati Miftar Ajdini, f. 35-37.

NR. 320, QERSHOR 2017

Hytbeja e Fitër Bajramit, Naim ef. Tërnavë, f. 5-6.

NR. 330, PRILL 2018

Si ta presim mikun e dashur, Ramazanin, Amër Halid, f. 13-16.

Parapërgatitjet për muajin Ramazan, Vedat Shabani, f. 17-19.

Në vigjilje të Ramazanit!, Artan Musliu, f. 20-22.

Kurani dhe hadithi për rregullat e agjërimit islam, Jusuf Ramiqi, f. 23-25.

Ramazani – muaji i Kuranit famëlartë, Azmir Jusufi, f. 26-27.

Ramazani, muaj i edukimit dhe ndryshimit, Isa Tërshani, f. 28-29.

Bajrami i Ramazanit mes së kaluarës dhe trendeve të reja ndër shqiptarë, Nexhat Ibrahim, f. 30-32.

Beteja në Bedër, përktheu Ajni Sinani, f. 33-38.

Ramazani dhe Jusufi a.s. – poezi, Ilmi Rexhepi, f. 78.

NR. 341, PRILL 2019

Muaji i Ramazanit, Vehbi Sulejman Gavoçi, f. 18.

Agjërimiti – një dhuratë e madhe nga Allahu, Ajni Sinani, f. 21.

Agjërimiti në rrafshin e mjekësisë bashkëkohore, Ali F. Iljazi, f. 25.

Leximi i Kuranit në Ramazan, Bali M. Sadiku, f. 23.

NR. 342, MAJ 2019

Hytbeja e Fitër Bajramit, Naim ef. Tërnavë, f. 5.

Përkushtimi pas Ramazanit, Vedat Shabani, f. 21.

NR. 352-353, MARS-PRILL 2020

Agjërimiti i muajit Ramazan, Resul Rexhepi, f. 9.

Ramazani - Muaji i mëshirës dhe i bujarisë, Ajni Sinani, f. 14.

Agjërimiti është mburojë...!, Muhamed B. Sytari, f. 17.

Mirëpritja e Ramazanit, Valon Myrta, f. 19.

Ramazani është muaj i ndërtimit të umetit, Ilmije Kuqi, f. 22.

Kandilat e Ramazanit në kohën e pandemisë...!, Mehas Alija, f. 26.

Dituri të nevojshme për agjërimitin, Muhamed Stublla, f. 27.

NR. 364, MARS 2021

Rëndësia e agjërimit, Resul Rexhepi, f. 8.

Agjërimiti – një nga pesë shtyllat e Islamit, Ajni Sinani, f. 11.

Agjërimiti dhe klasifikimi i tij juridik në Islam, Ekrem Maqedonci, f. 15.

Çka e prish dhe çka nuk e prish agjërimitin, Abdulhamid Mahmud Tuhmaz, f. 18.

Agjërimiti kaza dhe kefareti, Nexhmi Hoxha, f. 22.

Nata e Kadrit dhe fshehtësitë e madhështisë së saj, Driton Arifi, f. 25.

Namazi i teravisë, kuptimi dhe ligjshmëria, Abdulkerim Zejdan, f. 28.

Sadekatul fitri, Ilmije Kuqi, f. 30.

Malli për Ramazanin, Mehas Alija, f. 33.

Ramazani, muaji i së vërtetës, Nashit Ferati, f. 35.

Mësimet pedagogjike nga lufta e Bedrit, Naser Ramadani, f. 37.

Prangosja e shejtanëve në Ramazan, Ragmi Destani, f. 39.

Gruaja në Ramazan, Mihana Goga – Bekteshi, f. 41.

Përse Ramazani shndërrohet në një muaj zbavitjeje, në vend të një muaji shpirtëror?, Mustafa Mahmud, 43.

I kthyer te Zoti në Ramazan, Mesud Sabri, f. 44.

Agjëruesit – njerëz me kulturë të lartë civilizuese, Ali F. Iljazi, f. 46.

NR. 365, PRILL 2021

Disa njohuri themelore lidhur me sadakatul-fitrin, Resul Rexhepi, f. 10.

Bajrami i Ramazanit, Muhidin Ahmeti, f. 13.

Ibadetet t'i vazhdojmë edhe pas Ramazanit, Mihana Goga, f. 16.

NR. 376, MARS 2022

Mirë se vjen muaji i madhërishtëm Ramazan, Muhidin Ahmeti, f. 10-12.

Ta presim Ramazanin sikur të jetë i fundit, Ali F. Iljazi, f. 13.

Takimi me Ramazanin, Husein Gjozo, f. 14-15.

Agjërimi, Abdulhamid Mahmud Tuhmaz, f. 16-19.

Agjërimi i të Dërguarit a.s., Nexhmi Hoxha, f. 20-23.

Agjërimi, shpresë për Rejjanin, Bajram Zeqiri, f. 24-26.

Po të presim me mall, Blerim Musliu, f. 27.

Ramazani dhe agjërimi, Isa Tërshani, f. 28-30.

Ramazani, ilaçi i trupit dhe shpirtit, Mihana Goga-Bekteshi, f. 31-33.

Ramazani në shkrimet e hafëz Ali Korçës, Abdullah Klinaku, f. 34-36.

NR. 377, PRILL 2022

Le t'i vazhdojmë adhurimet edhe pas Ramazanit – editorial, Ajni Sinani, f. 4.

Paqe e dashuri për të gjithë, e jo konflikte, urrejtje e mosdurim - hytbeja e Fitër Bajramit, Naim Tërnavë, f. 5-6.

Reflektime të Ramazanit në besim dhe sjellje – ligjërata e Fitër Bajramit në manifestimin, qendror, Bahri Hoxha, f. 7-9.

Në përcjellje të Ramazanit, Isa Tërshani, f. 21-22.


NR. 388, MARS 2023

Aroma e këndshme e muajit që ngjallë shpresën për ndryshim, editorial, mr. Driton Arifi, f. 4

Përsiatje shkencore rreth ajeteve të agjërimit (1), Mr. Samir Zullufi, f. 5-7

Si e prisnin të parët Ramazanin?, Rashit Zylfiu, f. 8-9

Përcaktimi i fillimit të Ramazanit, syfyrin dhe iftarit, dr. Muhamed Stublla, f. 10-13



Dispozita për agjëruesen e Ramazanit, dr. Violeta Smajlaj, f. 14-16

Agjërimi në vendet që kanë gjatësi të disbalancuar të ditës e të natës, Bashkim Aliu, f. 17-20

Përfitimet shëndetësore të agjërimit, Dren Qerimi, f. 21-23

NR. 389, PRILL 2023

Kurani, libri që vuan miqësinë e ngrohtë të myslimanëve, editorial, mr. Driton Arifi, f. 4

Shoqërimi me Kuranin në Ramazan, hfz. Mehas Alija, f. 5-7

Agjërimi në këndvështrimin kuranor, dr. Valmire Batatina – Krasniqi, 8-10

Përsiatje shkencore rreth ajeteve të agjërimit (2), mr. Samir Zullufi, f. 11-13

Vlerat edukative të Ramazanit, dr. Ejup Haziri, f. 14-17

Agjërimi si vlerë sociokulturore, dr. Xhevdet Rusinovci, f. 18-19

Ndërtimi i karakterit ndërmjet këshillave të psikologut dhe praktikimit të agjërimit të Ramazanit, mr. sci. mjek. Adem Zalihiq, f. 20-22

Ramazani, thesar që nuk shteron, Mihana Goga – Bekteshi, f. 23-24

Ramazani, muaj i fitoreve, Blerim Musliu, f. 25-26

Itikafi dhe dhjetë netët e fundit të Ramazanit, Nehat Shehu, f. 27-29

Nata e Kadrit, vlera dhe shfrytëzimi i saj, dr. Selatin Mehani, f. 30-33

Dhënia e sadakatul fitrit në para – kundërvlerë monetare, Jusuf Zimeri, f. 34-37

Roli i zekatit dhe sadakatul fitrit në mbarëvajtjen e jetës fetare të myslimanëve në trojet shqiptare, Vahidin Beluli, f. 38-40

Bajrami, festë për myslimanët, Nexhmi Hoxha, f. 41-43

NR. 390, MAJ 2023

Vendi ynë merr peshë e kuptim, vetëm me bijtë e bijat e saj - hytbeja e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me rastin e festës së Fitër Bajramit, Naim ef. Tërnavë, f. 5-6

Ndikimi dhe porosinë e Ramazanit, dr. Muhamed ef. Stublla, f. 7-10

Ruajtja dhe kultivimi i asaj që e përvetësua në Ramazan, mr. Muharrem Bryma, f. 15-16

PËRFUNDIM

Nga kjo përmbledhje mund të shihet se materialet kushtuar Ramazanit janë të shpërndara në 67 numra ose 15% e numrave të revistës në total (duke llogaritur me këtë rast numrin 390 si të fundit kur janë publikuar materialet për Ramazanin). Ndërsa sa u përket artikujve, janë 328 artikuj që nga aspekte dhe perspektiva të ndryshme kanë trajtuar Ramazanin, agjërimit dhe gjëra që lidhen në një ose formë tjetër me to.

Kjo flet për përkushtimin e përhershëm të revistës për muajin Ramazan, përkushtim ky që, me lejen e Zotit, do të vazhdojë edhe në të ardhmen!

1 Versioni fillestar i këtij punimi është prezantuar si ide në tryezën Sfidat bashkëkohore të periodikut të Bashkësisë Islame të Kosovës, e organizuar nga Kryesia e BIK-ut, përkatësisht Drejtoria për Shtyp dhe Botime, përkritazi me publicistikën e BIK-ut dhe të ardhmen e saj, më 10 mars 2022.

Pritja e muajit të bekuar Ramazan në Toronto të Kanadasë

Mr. Adnan Berbatovci

Muaji Ramazan është muaji i mëshirës, i faljes dhe muaji i Kuranit fisnik. Është edhe muaji i kënaqësisë shpirtërore, bashkimit të njerëzve, jo vetëm në vendet islame, por edhe në botën perëndimore.

Thënë të drejtën, sa isha në Kosovë, kisha një rezervë dhe e imagjinoja që në perëndim, në përgjithësi e posaçërisht në Kanadanë e largët, ky muaj i bekuar ka një kënaqësi thujtë sikur në vendlindje e ndoshta ndonjëherë si atmosferë, të jetë edhe më mbresëlënëse.

Xhamia Shqiptare në Toronto ka një histori të pasur sa i përket organizimit të jetës fetare dhe kombëtare. Ajo daton që nga viti 1957 si institucion fetar, dhe është xhamia e parë në Provincën e Ontarios dhe e dyta në të gjithë Kanadanë. Imami i parë dhe themeluesi i kësaj xhamie ishte imami Rexhep Asimi nga Korça së bashku me Sejfid Aliun, po ashtu nga Korça, Zoti i mëshiroftë! Me një numër jo të madh të xhematlinjëve kanë hapur këtë xhami, e cila falë Allahut Fuqplotë, pastaj sinqeritetit të tyre dhe të xhematit, ka vazhduar punën që nga formimi e deri më tani. Tani xhamia jonë numëron mbi 2000 anëtarë të rregullt, shtu këtu edhe anëtarë dhe donatorë të tjerë.

Duhet ta dimë se në Toronto me rrethinë, janë përafërsisht rreth 100 xhami të nacionaliteteve të ndryshme. Kemi edhe shkolla të licencuara islame, si fillore dhe të mesme, të përshtatura me kurrikulat e arsimit të Kanadasë, që statusi i tyre i ngjason medreseve në vendet tona. Traditën e mësim-besimit e praktikojmë edhe ne, dhe numri i nxënësve mund të shkojë deri në 20, por

Duhet ta dimë se në Toronto me rrethinë, janë përafërsisht rreth 100 xhami të nacionaliteteve të ndryshme. Kemi edhe shkolla të licencuara islame, si fillore dhe të mesme, të përshtatura me kurrikulat e arsimit të Kanadasë, që statusi i tyre i ngjason medreseve në vendet tona.

varësisht prej periudhave, ky numër edhe varion.

Këto xhami funksionojnë plotësisht me leje paraprake të shtetit, ku secila ka numër personal të licencuar dhe ka një mbrojtje të plotë nga ana e shtetit. Të gjitha aktivitetet kulturore dhe fetare bëhen me liri të plotë, pa kurrfarë ndërhyrje nga askush. E tërë ajo që mësohet në to ka të bëjë me shpjegimin e Islamit autokton, duke shmangur çdo lloj interference politike apo sektare që do të shpinte në përçarjen e xhematit, gjegjësisht banorëve të Torontos – Kanadasë.

Kalendar për fillimin e muajit të bekuar Ramazan, zakonisht përdorim takvimin – kalendarin e bazuar në kalendarin islam të bashkësive fetare shqiptare të vendlindjes. Kjo meqë diferenca kohore mes vendit tonë dhe Amerikës Veriore është 6 orë.

Thënë të drejtën, ne si xhami shqiptare e shtypim kalendarin tonë islam tash e 30 vjet, përfshirë këtu kohët e namazit, vaktinë e Ramazanit dhe festat fetare. Meritë të veçantë për këtë punë të madhe ka haxhi Nexhmi Aliu nga Prespa e Maqedonisë së Veriut, i cili e ka marrë këtë përgjegjësi që nga ajo kohë dhe kujdeset që kalendari të jetë gati, në kohë të duhur, normal duke u konsultuar me imamin e xhamisë, në këtë rast me ne tash e 8 vjet sa jemi imam në këtë xhami.

Ramazani na gjen gjithmonë të përgatitur në të gjitha aspektet, atë e presim me gëzim dhe kënaqësi, si nga aspekti i përgatitjes së xhamisë dhe organizimi i xhematit, ashtu edhe nga aspekti shpirtëror.

Namazi i teravive kuptohet që është esencial, duke pasur parasysh kënaqësinë dhe rehatinë



që sjell ai gjatë këtij muaji të shenjtë. Kemi një numër të konsiderueshëm të xhematit që marrin pjesë në namaz të teravive, si burra ashtu edhe gra, posaçërisht vikendeve ku shumica e xhematit janë në pushim, prandaj pjesëmarrja e tyre është shumë e lartë dhe atmosfera bëhet shumë brilante dhe të duket vetja sikur je duke u falur në vendlindje.

Gjuha shqipe tingëllon gjithandej xhamisë si dhe jashtë saj, zërat e fëmijëve duke lozur në ambientin e xhamisë, si dhe në oborr, të bëjnë të ndjehesh krenar se munda dhe përpjekja jonë për këtë xhema dhe këta shqiptarë myslimanë nuk do shkon kot.

Organizmi i iftareve që bëhet në Xhaminë Shqiptare në Toronto është fantastik. Xhema linjtë tonë regjistrohen në listën e iftareve, e cila përgatitet nga imami dhe Kryesia e Xhamisë që para Ramazanit.

Në çdo Ramazan, më shumë se gjysmën e muajit apo saktësisht 17 iftare, organizohen në xhami. Aty marrin pjesë xhema linjtë, familjarë e shumë mysafirë të tjerë dhe bëjnë iftar së bashku në një atmosferë të ngrohtë e vëllazërore.

Normal së pari bëjmë iftar siç e do zakoni islam me hurma dhe me ujë, pastaj e falim namazin e akshamit, e më pas ulemi në sofër apo tryeza të shtruara dhe hamë iftarin së bashku. Këtu në Kanada, por edhe në tërë Amerikën e Veriut është e njohur metoda "self service" apo vetëshërbim, që është e ngjashme me tavolinën suedeze. Ushqimet e përgatitura renditen në një qoshe të sallës së xhamisë, e cila gjendet në katin e dytë, dhe ne si xhema të shërbehemi secili vetë, duke e lehtësuar procesin dhe mbarëvajtjen e ngrënies së iftarit. Këtu nuk duhet harruar fakti se pas iftarit shtrohet edhe çaji tradicional, ka edhe kafe, por sa për satirë gjithmonë çaji ia kalon kafes.

Gjatë namazeve ditore lexojmë edhe Kuran në xhami, apo mukabele, ndërkaq namazin e

teravive, tash e 5 vjet e falim me hatme, në çdo namaz të teravive lexojmë nga një xhuz të Kuranit.

Namazi i xhumasë sikur edhe muajve të tjerë, por gjatë muajit Ramazan ka një shije tjetër të këndshme, ku e përjetojmë më një vullnet të madh, e ajo që na gëzon më shumë është pjesëmarrja e madhe e xhematit dhe përjetimi i kënaqësisë gjatë ditës së xhuma është i madh.

Xhamia jonë nuk ka kapacitet të pranojë numrin shumë të madh të xhematit, prandaj me t'u afruar fundi i Ramazanit, ne duhet që të marrim me qira një sallë të madhe afro 600 m², ta adaptojmë atë në ambient xhamie dhe ta falim Bajramin, meqë në çdo Bajram, xhema është shumë e madh. Në Bajramin e Ramazanit të vitit të kaluar, numri i tyre ka shkuar në mbi 1300 xhema linjtë. Vërtet unë si imam kur shoh numrin e madh të tyre më kaplon një ndjenjë e ngrohur në zemër e shpirt dhe mendoj që sado që jemi larg vendlindjes dhe trojeve tona, prapë se prapë nuk e harrojmë fenë islame, as gjuhën e kombin tonë shqiptar.

Pas faljes së Bajramit, fillojnë uratat në mes xhematit me njëri-tjetrin, duke e lutur Allahun Fuqiplotë të na pranoj ibadetet dhe adhurimet e Ramazanit që shkoi.

Këto janë disa nga momentet më të veçuara të përjetimit të muajit të bekuar Ramazan në Toronto të Kanadasë, edhe pse të gjitha ato përjetime që i ndiejmë në shpirt nuk mund t'i përshkruajmë dot më fjalë.

Me këtë rast dhe nëpërmjet këtij shkrimi, i përshëndesim të gjithë lexuesit e revistës, duke iu uruar muajin e bekuar Ramazan në emrin tim, të Kryesisë dhe xhematit të Xhamisë Shqiptare të Torontos. Agjërim të lehtë e vepra e adhurime të pranuar nga Zoti i Madhërisëm!

Adnan Berbatovci është imam i Xhamisë Shqiptare në Toronto të Kanadasë

Pas faljes së Bajramit, fillojnë uratat në mes xhematit me njëri-tjetrin, duke e lutur Allahun Fuqiplotë të na pranoj ibadetet dhe adhurimet e Ramazanit që shkoi.

Hëna - simbol i fesë islame apo jo!?

(PËRBËRJA KIMIKE E SAJ)

Njomza Sadriu

A ËSHTË GJYSMËHËNA, SIMBOL I ISLAMIT!?

Islami si fe u shfaq në shtetet arabe në kohën kur udhëtimi përgjatë rrugëve tregtare të shkretëtirës bëhej kryesisht gjatë natës dhe lundrimi varej nga pozicioni i Hënës dhe yjeve. Kështu, Hëna përfaqëson udhëheqjen e Zotit në rrugën e jetës.

Hëna e re përfaqëson gjithashtu kalendarin mysliman, i cili ka 12 muaj secili nga 29 ose 30 ditë. Pra, në fenë islame, muaji hënor dhe ai kalendarik përkojnë me hënën e re, dhe ajo pritet me padurim, veçanërisht në fund të muajit Ramazan, kur pamja e saj do të thotë se mund të fillojnë festimet e muajit Ramazan.

Informacioni mbi origjinën e simbolit është i vështirë për t'u përcaktuar, por shumica e burimeve pajtohen se këto simbole të lashta qiellore ishin në përdorim nga popujt e Azisë Qendrore dhe Siberisë në adhurimin e perëndive të Diellit, Hënës dhe qiellit. Ka gjithashtu raportime se hëna dhe ylli i gjysmëhënës janë përdorur për të përfaqësuar perëndeshën Kartagjenase Tanit ose perëndeshën greke Diana. Qyteti i Bizantit (i njohur më vonë si Kostandinopoja dhe Stambolli), miratoi simbolin e gjysmëhënës. Sipas disa raporteve, ata e zgjodhën atë për nder të perëndeshës Diana. Të tjerë tregojnë se ajo daton në një betejë në të cilën romakët mundën gotët në ditën e parë të një muaji hënor. Në çdo rast, gjysmëhëna u shfaq në flamurin e qytetit edhe para lindjes së Krishtit. Komuniteti i hershëm mysliman nuk kishte vërtet një simbol. Gjatë kohës së Profetit Muhamed paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, ushtritë dhe karvanët islamikë mbanin flamuj të thjeshtë me ngjyra të forta (përgjithësisht të zeza, jeshile ose të bardha) për qëllime identifikimi. Në gjeneratat e mëvonshme, udhëheqësit myslimanë vazhduan të përdornin një flamur të thjeshtë të zi, të bardhë ose jeshil pa shenja, shkrime ose simbolikë mbi të.


Gjatë kohës së Profetit Muhamed paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, ushtritë dhe karvanët islamikë mbanin flamuj të thjeshtë me ngjyra të forta (përgjithësisht të zeza, jeshile ose të bardha) për qëllime identifikimi.

Vetëm në Perandorinë Osmane, gjysmëhëna u bë e lidhur me botën myslimane. Kur turqit pushtuan Kostandinopojën (Stambollin) më 1453, ata miratuan flamurin dhe simbolin ekzistues të qytetit. Legjenda thotë se themeluesi i Perandorisë Osmane, Othmani, pa një ëndërr në të cilën gjysmëhëna shtrihej nga një skaj i tokës në tjetrin. Duke e marrë këtë si një ogur të mirë, ai zgjodhi të mbante gjysmëhënën dhe ta bënte atë simbol të dinastisë së tij. Ka spekulime se pesë pikat në yll përfaqësojnë pesë namazet ditore, por kjo është hamendje e pastër. Pesë pikat nuk ishin standarde në flamujt osmanë dhe gjithashtu nuk janë standarde për flamujt që përdoren sot në botën myslimane. Për qindra vjet, Perandoria Osmane sundoi mbi botën myslimane. Pas shekujsh beteje me Evropën e krishterë, është e kuptueshme se si simbolet e kësaj perandorie u lidhën në mendjet e njerëzve me besimin e Islamit në tërësi.

Bazuar në këtë histori, shumë myslimanë refuzojnë përdorimin e gjysmëhënës si një simbol të Islamit. Besimi i Islamit historikisht nuk ka adoptuar asnjë simbol dhe shumë refuzojnë të pranojnë atë që në thelb është

një ikonë e lashtë pagane.

Studiuesi mysliman amerikan, Yusuf Estes, drejtor i islamtomorrow.com dhe Kapelani Kombëtar WAMY, thotë se: "Simboli i Islamit nuk është gjysmëhëna dhe ylli, por ai u përdor nga dinastia e fundit islame, ajo osmane. Perandoria Osmane e pa të përshtatshme të përdorte yllin dhe gjysmëhënën si simbolet e tyre, por jo simbolet e Islamit. E përsëris, ylli dhe gjysmëhëna nuk janë pjesë e fesë islame." Përveç kësaj, Islami i ndalon imazhet (statujat) e çdo lloji njeriu, kafshësh apo ndonjë prej krijesave të Allahut xh.sh..



HËNA SIPAS PËRBËRJES KIMIKE TË SAJ

Hëna e Tokës është e ngjashme me Tokën, e cila gjithashtu ka një kore, mbulesë dhe bërthamë. Përbërja e dy trupave është e ngjashme, gjë që është pjesë e arsyes pse shkencëtarët mendojnë se Hëna mund të jetë formuar nga një përplasje e madhe meteori duke shkëputur një pjesë të Tokës, ndërsa ishte ende në formim. Shkencëtarët kanë mostra nga sipërfaqja ose korja e Hënës, por përbërja e shtresave të brendshme është një mister. Bazuar në atë që dimë se si formohen planetët dhe Hëna, besohet se bërthama e Hënës është të paktën pjesërisht e shkrire dhe ka të ngjarë të përbëhet kryesisht nga hekuri, me pak sqfur dhe nikel. Bërthama ka të ngjarë të jetë e vogël, duke përbërë vetëm 1-2% të masës së Hënës.

Pjesa më e madhe e Hënës së Tokës është manteli. Kjo është shtresa midis kores (pjesës që shohim) dhe bërthamës së brendshme. Manteli hënor besohet të përbëhet nga olivina, ortopirokseni dhe klinopirokseni. Përbërja e mantelit është e ngjashme me atë të Tokës, por Hëna mund të përmbajë një përqindje më të lartë hekuri.

Shkencëtarët kanë mostra të kores hënore dhe marrin matje të vetive të sipërfaqes së Hënës. Korja përbëhet nga 43% oksigjen, 20% silikon, 19% magnez, 10% hekur, 3% kalcium, 3% alumin dhe sasi gjurmë të elementëve të tjerë, duke përfshirë kromin (0,42%), titanin (0,18%), manganin (0,12%), dhe sasi më të vogla të uraniumit, toriumit, kaliumit, hidrogjenit dhe elementëve të tjerë. Këta elementë formojnë një shtresë betoni të quajtur regolit. Nga regoliti janë mbledhur dy lloje shkëmbinjsh të hënës: plutonik mafik dhe bazalt maria. Të dy janë lloje të shkëmbinjve magmatikë, të cilët janë formuar nga ftohja e llavës.

ATMOSFERA E HËNËS

Hëna ka një atmosferë edhe pse është shumë e hollë. Përbërja nuk dihet mirë, por vlerësohet se përbëhet nga heliumi, neoni, hidrogjen (H_2), argoni, neoni, metani, amoniaku dhe dioksid i karbonit, me sasi të vogla të oksigjenit, aluminit, silikonit, fosforit, natriumit dhe jonet e magnezit. Për shkak se kushtet ndryshojnë ndjeshëm në varësi të orës, përbërja gjatë ditës mund të jetë disi e ndryshme nga atmosfera gjatë natës. Pasi që Hëna ka një atmosferë shumë të hollë ajo paraqet vështirësi për të marrë frymë dhe përfshin përbërës që nuk janë të përshtatshëm për mushkëritë.

SHKENCËTARËT E NASA-S TREGOJNË SE SI PËRBËRËSIT PËR UJIN MUND TË KRIJOHEN NË SIPËRFAQEN E HËNËS

Kur një rrymë grimcash të ngarkuara të njohura si era diellore bien në sipërfaqen e Hënës me shpejtësi 450 kilometra në sekondë (ose gati 1 milion milje në orë), ato pasurojnë sipërfaqen e Hënës me përbërës që mund të formojnë ujë, kanë gjetur shkencëtarët e NASA-s.

Duke përdorur një program kompjuterik, shkencëtarët simuluan kiminë që shpaloet kur era diellore godet sipërfaqen e Hënës. Ndërsa Dielli dërgon protone në Hënë, ata zbuluan se ato grimca ndërveprojnë me elektronet në sipërfaqen hënore, duke krijuar atome hidrogjeni (H). Këto atome më pas migrojnë nëpër sipërfaqe dhe lidhen me atomet e bollshme të oksigjenit (O) të lidhura në silicë (SiO_2) dhe molekula të tjera që përmbajnë oksigjen që përbëjnë tokën hënore, ose regolitin. Së bashku, hidrogjeni dhe oksigjeni e formojnë molekulën hidroksil (OH), një përbërës i ujit ose H_2O .

William M. Farrell, një fizikant i plazmës në Qendrën e Fluturimeve Hapësinore të NASA-s Goddard në Greenbelt, Maryland, i cili ndihmoi në zhvillimin e simulimit, ka thënë: “Ja çfarë është e mahnitshme në Hënë, çdo shkëmb ka potencialin për të formuar ujë, veçanërisht pasi rrezatohet nga era diellore.”

Referencat:

1. Helmenstine, Anne Marie, Ph.D. “What Is the Moon Made Of?” ThoughtCo, Sep. 7, 2021, [thoughtco.com/what-is-the-moon-made-of-604005](https://www.thoughtco.com/what-is-the-moon-made-of-604005).
2. Shekhtman, Lonnie “NASA Scientists Show How Ingredients for Water Could Be Made on Surface of Moon, a ‘Chemical Factory’ ” NASA, Shkurt 20, 2019. <https://www.nasa.gov/goddard>.
3. Linda and Phil Holmes, Cottingham, N Humberside “WHAT is the origin of the crescent moon symbol seen throughout Islamic cultures?” , The Guardian, 2011. <https://www.theguardian.com/notesandqueries/query/0,5753,-1411,00.html#:~:text=YESTERYEAR-,WHAT%20is%20the%20origin%20of%20the%20crescent%20moon%20symbol%20seen,on%20the%20path%20through%20life>.
4. Huda. “A History of the Crescent Moon in Islam.” Learn Religions, Sep. 3, 2021, <https://www.learnreligions.com/the-crescent-moon-a-symbol-of-islam-2004351>.
5. <https://fiqh.islamonline.net/en/is-crescent-moon-symbol-of-islam/>

Si arritën dijetarët myslimanë ta ruanin pavarësinë e tyre prej pushtetarëve?

Muhamed el Sijad

Dijetarët qëndronin afër popullit. Kishin si mision të fuqizonin ymetin. Këtë pavarësi ata e shfaqnin njëkohësisht në artikujt e shumtë që shkruanin rreth çështjeve të ndryshme fikhere. Kjo bëri që në ndërgjegjen e ymetit, kjo kastë dijetarësh të kishte vend të lartë e të nderuar.

Kur imamit dhe muhadithit të njohur, Jezid ibën Zureja ibën el Hafidhi (183 hixhri) i vdiq i ati, i cili kishte qenë i ngarkuar me detyrën e valiut në El Abula të Irakut, atij i la pasuri marramendëse. Por imami nuk e preku pasurinë e trashëguar prej tij për arsye se ai kishte punuar nëpunës në administratën shtetërore dhe kishte marrë dhurata të shumta prej sundimtarëve. Në mënyrë të njëjtë veproi edhe Ebu el Kasem el Andalusi (493 hixhri), i cili nuk e trashëgoi të plotë pasurinë e të atit, meqë ishte e përzier me shpërblimet e majme të dhuruara prej sulltanit. Ai i hoqi të gjitha shpërblimet e dhëna babait të tij prej sundimtarëve, dhe mori çfarë mbeti prej pasurisë. Këto janë histori të paimagjinueshme për kohërat tona, por të cilat kanë ardhur të regjistruara prej historianit dhe imamit të njohur, El Dhehebiut (748 hixhri), i cili i ka regjistruar në veprën e tij “Sajir Ealam el Nubla`a”.


Këto kanë qenë pjesë e rregullave dhe kushteve të ashpra të përcaktuara nga dijetarët

myslimanë për të vendosur rregulla mbi bashkësinë e dijetarëve për të ruajtur pavarësinë e tyre prej pushtetit. Kjo i ndihmoi të arrinin të vepronin të pavarur në fushën e gjyqësorit, arsimit fetar e deri dhe në lëshimin e fetvave.

Dijetarët u kujdesën të ruanin distancën e vendosur mes institucioneve të pushtetit dhe bashkësisë së dijetarëve. Dijetarët qëndronin afër popullit. Kishin si mision të fuqizonin ymetin. Këtë pavarësi ata e shfaqnin njëkohësisht në artikujt e shumtë që shkruanin rreth çështjeve të ndryshme fikhere. Kjo bëri që në ndërgjegjen e ymetit, kjo kastë dijetarësh të kishte vend të lartë e të nderuar. Përpjekjet e vazhdueshme të dijetarëve për të ruajtur pavarësinë prej pushtetit, solli rezultatet e saj, solli përparimin e dijes fetare.

VENDOSJA E DISTANCËS

Dijetarët u kujdesën që të mos përziheshin me sundimtarët e të gjitha rangjeve. Nuk pranonin të merrnin as rroga dhe as





shpërblime prej emirëve dhe sulltanëve. Librat e historisë kanë shënuar rastin e dijetarit Sufjan eth Theuriut (161 hixhri), që ai nuk e preku pjesën e plaçkës të ndarë prej sulltanit që i takonte prej luftës duke thënë: “E di që është e lejuar për mua, por urrej të më hyjë në zemër tendenca lakmuese ndaj tyre (emirëve).”

Në shekujt e parë të Islamit, ishin të rralla rastet e dijetarëve, të cilët pranonin dhuratat e sundimtarëve. Por në shekullin V hixhri, do të shikojmë të fillojë të gjejë përhapje të madhe mbështetja e dijetarëve në formën e dhurimeve prej sundimtarëve. Mesa duket kjo ishte forma e cila filloi të përfshinte të gjithë sistemin qeverisës dhe shoqëror.

Kjo bëri që të kishte grup dijetarësh t'i frikësoheshin dobësimin të pavarësisë së gjykimin në fushën e vendimeve fetare duke bërë thirrje për vetëpërmbytje, për të mos qenë të varur prej dhuratave të sundimtarëve.

Por në shekujt e mëvonshëm, do të shikojmë që do gjejë përhapje në masë të madhe, qoftë edhe pa shkak, pranimi i dhuratave të sundimtarëve prej dijetarëve, gjë e cila çoi në korrupsion të gjyqësorit në shumë raste. Këtë do e shikojmë në shënimet që kanë lënë dijetarë të ndryshëm, si El Shenterini, Ebu Shuxha el Dilmu. El Karafi do të tërhiqte vërejtje për lëshimin e fetvave me dy standarde prej dijetarëve të cilët mbështeteshin në dhuratat e sundimtarëve. I lëshonin fetvatë të shtrënguara për popullin dhe të lehtësuara për sundimtarët duke arritur të mbulonin deri edhe gjynahet e padrejtësitë që kryenin.

El Karafi do të vinte theksin te frika karshi Allahut të Lartësuar që duhej të ketë dijetari krahas pajisjes me dituri.

Populli e ka lidhur fenë me figurën e dijetarit përgjatë gjithë historisë islame. Për këtë arsye dijetari duhet t'i mishërojë dijet fetare dhe t'i zbatojë ato në praktikë.

Një dituri e shoqëruar me frikën ndaj Allahut të Lartësuar, do të sjellë ruajtjen e kufijve të tij. Përndryshe dituria e zhveshur prej frikës ndaj Allahut, sjell daljen e dijetarit jashtë kufijve të lejuar për të.

Do të jenë të shumtë dijetarët të cilët do këmbëngulin për ruajtjen e pastërtisë të figurës së dijetarit dhe ruajtjes së kufijve, duke i pasqyruar në librat të cilat i kanë lënë dhe kanë ardhur deri në ditët tona.

Pikë tjetër për të cilën u kujdesen dijetarët ishte të mos merrej dituria prej dijetarëve të korrumpuar, dhe myftiu duhej të ishte i devotshëm. Devotshmëria është ajo dera madhështore për të hyrë pa asnjë dyshim në marrëdhënie me institucionet qeverisëse. Pajisja e dijetarëve me këto cilësi do të sillte respektin e dyanshëm, të dijetarëve dhe të masës së njerëzve. Në rast se dijetarët nuk i ruajnë këto cilësi, atëherë këto do të pasqyrohen te gjykimet dhe vendimet e tyre në kundërshtim me dispozitat e zbritura në Kuran dhe Sunet, në dëm të popullit dhe në favor të sundimtarëve. Kjo sjellë pasoja në lëkundjen e besimit (imanit) të popullit të thjeshtë, duke çuar deri dhe në daljen e tij prej besimit. Populli e ka lidhur fenë me figurën e dijetarit përgjatë gjithë historisë islame. Për këtë arsye dijetari duhet t'i mishërojë dijet fetare dhe t'i zbatojë ato në praktikë.

Në rast se dijetarët qysh në shekujt e parë vendosën distancë me institucionet administrative, ata, këtë nuk e bënë me popullin. Ishin zëri i popullit, përfaqësonin të varfrin dhe të shtypurin. Të gjithë nevojtarët shkonin te dijetarët e fesë për problemet e tyre. Institucioni i fesë ishte institucioni social

në sytë e popullit, i cili studioje gjendjen sociale të shoqërisë.

Në librin “*Tarih el Islam*” të El Dhehebiut, do të lexojmë rastin kur sulltani Jusuf ibën el Tashfin, për të armatosur ushtrinë, vuri dorë në pensionet e jetimëve dhe vejushave. Atëherë gjykatësi Ebu Abdullah el Andaluzi, i dërgoi mesazh, duke i thënë: “Atë pasuri të cilën e quan “ndihmë”, u mor nga pasuria e jetimëve dhe të ngratëve me forcë. Ti je përgjegjës për këtë, ti dhe ata që të mbështesin. Kjo ka ardhur si pasojë e disa dijetarëve të prishur pranë teje që të kanë këshilluar.” Pas këtij mesazhi sulltani ktheu 1/3 e donacioneve për armatosjen e ushtrisë.

Rast tjetër i ngjashëm që kanë shënuar librat e historisë është përplasja e dijetarit Izzedin ibën Abduselam me

sulltanin, i cili kundërshtoi vendimin e sulltanit duke i thënë se vetëm nëse arka e shtetit nuk do ketë të ardhura, të gjithë ushtarakët pa përjashtim të shesin të gjitha sendet me vlerë që disponojnë, e të jenë njësoj si populli deri dhe në rroba, përndryshe është padrejtësi të marrësh me forcë atë që nuk ju takon prej popullit. Duhet emirët të paguajnë taksat para popullit, dhe jo të taksohen të varfrit dhe të pasurit jo. Dijetari Izzedin ibën Abduselami ishte zëri i popullit, i mbronte të drejtat e tij si dhe u kishte shpallur “luftë” qeveritarëve të padrejtë. Për këtë do të njihet si “Sulltani i dijetarëve”.

Rast tjetër që ka shënuar historia është kur në vitin 1258, sulltani memluk, El Zahir Bebarsi, dëshironte të përgatiste ushtrinë në përballje me ushtrinë tatarë. Ai kërkoi që dijetarët të lëshonin fetva që lejonin rritjen e taksave mbi popullsinë e Shamit për të pajisur ushtrinë me armatimin e duhur. Por ndërkohë, imam Neveviu e kundërshtoi fetvanë e lëshuar prej dijetarëve pranë sulltanit. Kur sulltani e pyeti për arsyen e refuzimit të fetvasë, imami i tha pikërisht atë që sulltani kishte frikë të dëgjonte: “E di që ke qenë nën zotërimin e emirit Alaa el Din el Bundukdarit. Nuk zotëroje pasuri. Pastaj më vonë, Allahu i Lartësuar ta lehtësoi duke të bërë prijës mbi myslimanët. Nën zotërimin tënd janë 1000 djem, të cilët zotërojnë kuaj të pajisur me kapistër të shtrenjtë në vlerën e 1000 dinarëve. Nën zotërimin tënd janë 200 robëresha, ku secila disponon sënduk personal me vlerën e 10 000 dinarëve. Në rast se do të përdorsh të gjitha këto sende me vlerë pa përjashtim, atëherë kërkohet prej masës së popullit të paguaj.”

Po kështu do të gjejmë qëndrim të ashpër dhe refuzues prej dijetarëve të tjetërsimit të vakëfeve; rritjes së taksave për të rritur rrogat e ushtarëve kur ndërkohë në letren që i dërgon myftiu Ibën Dekik el Iid sulltanit, i jep si argument refuzues faktin se ka plotë ushtarakë në radhët e ushtrisë të cilët lundrojnë në para, takat e këpuçëve të grave të tyre janë të mbuluara në xhevahire, gotat në të cilat pinë janë prej argjendi, vajzat e tyre janë të mbuluara prej perlave dhe xhevahireve. Ndërkohë një ndër kundërshtimet më të forta ndaj sulltanit, ka ardhur prej Ibën Tejjmijes, ku sulltani kërkoi fetva të vriste disa prej dijetarëve, meqë ata kishin kërkuar vrasjen e tij (vrasjen e Ibën Tejjmijes). Por Ibën Tejjmije e refuzoi duke i thënë se ai, sulltani, në të vërtetë, e donte këtë fetva meqë ata dijetarë i dhanë besën konkurrentit të tij për fronin, Bebars el Xhashankiri. Sulltani dëshironte të shfrytëzonte armiqësinë që kishin dijetarët karshi Ibën Tejjmijes, për të realizuar synimin e tij. Por nga fundi i sundimit të tyre, do të shikojmë se si sulltanët kërkojnë me

Imami Ebu Hanife, i cili refuzoi postin e gjykatësit të ofruar prej sundimtarit abasit. Ebu Hanife merrej me tregtinë e mëndafshit për të siguruar jetesën.

çdo mënyrë të përligjin vjedhjet, rrëmbimin e pronës së tjetrit me pa të drejtë. Shikojmë se si ata shkarkojnë dijetarë dhe emërojnë të tjerë, derisa të gjejnë atë që mund t’ua ligjësojë padrejtësinë. Kështu në regjistrat e fetvave është regjistruar rasti kur sulltani donte të vinte dorë mbi pasurinë e një tregtari të vdekur. Por gjykatësi i tha se me prova, tregtari ka trashëgimtar dhe shteti nuk mund ta konfiskojë pasurinë e tregtarit. U zemërua sulltani, e shkarkoi dhe emëroi gjykatës tjetër.

DHURATAT E SUNDIMTARËVE DHE DIJETARËT

Për pranimin e dhuratave prej sundimtarëve, qysh në fillimet e organizmit të mendimit islam, dijetarët do të ndahen në dy grupe: grupi i parë janë ata që i pranojnë dhuratat e sundimtarëve; ndërsa në grupin e dytë janë

ata që kundërshtojnë marrjen e dhuratave. Grupi i cili nuk i pranon dhuratat prej sundimtarëve të çfarëdo natyre qofshin ato, janë ai grupi më i madh. Dijetarët e shikonin këtë si të vetmen formë për të ruajtur pavarësi të plotë mendimi dhe veprimi. Në krye të këtij grupi qysh në fillimet e tij qëndronte imami Ebu Hanife, i cili refuzoi postin e gjykatësit të ofruar prej sundimtarit abasit. Ebu Hanife merrej me tregtinë e mëndafshit për të siguruar jetesën. Sufjan eth Theuriu merrej me tregtinë e shitjes së vajit. Fudejl ibën Ijadi, pavarësisht se ishte i varfër, nuk pranonte të merrte dhuratat prej sundimtarëve. Ahmed ibën Hanbeli, jo vetëm që nuk pranonte dhurata, por ia kishte ndaluar vetes të hynte në shtëpitë e të afërmeve të tij dhe të të tjerëve ku mund të kishte hyrë para e sundimtarit. Të tjerë dijetarë kanë punuar si hekurpunues, zdrukthëtar, bukëpjekës, rrobaqepës etj..

Nga ata që i kanë pranuar dhuratat për shkak të kushteve socio-ekonomike, por dhe që e kanë urreyer në të njëjtën kohë, ka qenë Malik ibën Enesi.

Formë tjetër që siguronte pavarësinë e dijetarëve ishin vakëfet e dhuruara për të gjitha institucionet fetare: xhami, bezistane, bimaristane, mesxhide, medrese, kutabe, etj.. Por në dy shekujt e fundit, qysh kur pushtuesit në vendet islame vunë dorë mbi vakëfet, si dhe më mbura, pas pavarësisë së këtyre vendeve, vakëfet e humbën pavarësinë e vet. Ato u drejtuan prej klasës politike qeverisëse. Kjo solli dobësim të ndjeshëm të pozicionit të dijetarëve në mbarë botën islame.

Përktheu: Klodiana Xhafferraj

Kandilat e Ramazanit në xhamitë e Kosovës sipas vakëfnameve

Dr. Besir Neziri

Shoqëritë myslimane, muajin e bekuar Ramazan, e presin me padurim, si në aspektin shpirtëror, edhe në atë material. Ramazani është muaji i adhurimit, ngase në të, ne agjërojmë, falim namazin e teravive, japim zekatin dhe fitrat, qëndrojmë në itikaf, lexojmë Kuran, pendohemi, dëgjojmë më shumë ligjëratat dhe këshillime, dhe mundohemi ta përjetojmë natën e Kadrit, e cila është më e mirë se një mijë muaj.

Besimtarët myslimanë me fillimin e këtij muaji të bekuar ndjejnë thellë në shpirt një lumturi të pa përshkruar dhe fillojnë të ndryshojnë në disa aspekte, duke u munduar të bëjnë vepra të mira, që nuk kanë mundur t'i bëjnë jashtë muajit Ramazan, si dhe të largohen nga disa shprehje të këqija.

Te shoqëritë myslimane, për dallim nga muajt e tjerë, në muajin e bekuar Ramazan shihen disa ndryshime edhe në aspektin e mënyrës së jetesës. Prania e Ramazanit ndjehet në çdo vend, në shtëpi, në çarshi, në institucione, etj..

Por, ndryshimi më i madh gjatë këtij muaji të bekuar vërehet në shtëpitë e Zotit, në xhami. Lirisht mund të thuhet se muaji Ramazan është muaji i xhamive. Numri i atyre që shkojnë për t'u falur në xhami rritet shumë në krahasim me muajt e tjerë. Besimtarët çdo natë të këtij muaji shkojnë në xhami për të falur namazin e teravive, për dëgjuar ligjëratat nga imamët, për të lexuar mukabele (Kuran). Një ndër traditat e mira në muajin e bekuar Ramazan është ndriçimi i xhamive me kandila.

INSTITUCIONI I VAKËFIT DHE VAKËFNAMET

Institucioni i vakëfit është një ndër institucionet më të rëndësishme që është zhvilluar në qytetërimin islam. Feja islame, e cila i kushton rëndësi të madhe ndihmës dhe solidaritetit social, e ka ngritur këtë në nivelin më të lartë përmes institucionit të vakëfit. Në qytetërimin islam, vakëfet janë institucione të themeluara nga njerëz të pasur me qëllim të fitimit të kënaqësisë së Allahut, të ardhurat e të cilave përdoren vetëm për nevojat shoqërore. Personi që lë vakëf, heq dorë plotësisht nga pasuria e tij që e lë vakëf, e shndërron

atë në pronë të Zotit dhe asnjëherë nuk ka të drejtë që ta kthejë këtë pasuri apo pronë (Neziri, 2020:76). Vakëfet kryesisht janë themeluar për të mbështetur institucionet si xhamitë, shkollat, medresetë, teqetë, zavijat, shatërvanët dhe kuzhinat publike. Të gjitha shpenzimet e këtyre institucioneve mbuloheshin nga vakëfi. Ndërsa vakëfname apo vakfije, quhet dokumenti zyrtar në lidhje me administrimin e vakëfit të themeluar nga vakëflënësi. Pra vakëfimet janë dokumente në të cilat vakëflënësi përcakton në detaje se si do të administrohet vakëfi i themeluar, ku dhe çfarë shpenzimesh do të bëhen, sa njerëz do të punojnë, sa do të paguhen punëtorët, me çfarë të ardhurash do të mbulohen shpenzimet, kush do të mund të përfitojë nga ky vakëf dhe në çfarë mënyre, etj.. (Özgündenli, 2012: 465-466). Në vakëfname, përveç të tjerave, janë përcaktuar edhe shpenzimet për aktivitetet në xhami gjatë muajit të bekuar Ramazan, si ndriçimi i xhamive me kandila, leximi i mukabeleve, ligjëratat fetare etj., të cilat duhet të mbuloheshin nga të ardhurat e vakëfit.



NDRIÇIMI I XHAMIVE ME KANDILA

Tradita e ndriçimit të xhamive me kandila, të cilat qëndrojnë të hapura gjatë gjithë natës për adhurim në ditët dhe netët e shenjta daton që në shekujt e parë të Islamit. Xhamia e Pejgamberit a.s., e cila pas ndërtimit ndriçohet me djegien e degëve të thata të hurmës, është xhamia e parë në botën islame që është ndriçuar me kandila, të cilët i kishte sjellë sahabiu Temim ed Dari. Pejgamberi a.s., kishte mbetur shumë i kënaqur me këtë dhe robin e liruar të Temimit r.a., i cili ndezi kandilat, e quajti “Siraxh”. Omeri r.a., derisa ishte udhëheqës i myslimanëve, e ka zgjeruar hapësirën e Haremit të Qabesë dhe ka vendosur kandila në murin rrethues të saj, dhe xhamitë e tjera i ka ndriçuar me kandila. Aliu r.a., kur i vizitoi këto vende gjatë një muaji Ramazan, është lutur për Omerin r.a., “Allahu ia ndriçoftë varrin, ashtu siç i ka ndriçuar xhamitë tona!” (Bozkurt, 2001: 299-300). Fakihi tregon se Haremi i Qabesë ka pasur gjithsej 455 kandila, disa prej të cilave ndriçonin më shumë ndizeshin vetëm gjatë muajit Ramazan dhe sezonit të haxhit dhe se këta kandila ishin të varura në litarë të shtrirë ndërmjet shtyllave me grepa bakri (Bozkurt, 2003: 397).

Kjo traditë e ndriçimit të xhamive me kandila ka vazhduar edhe në Perandorinë Osmane, sa që është bërë ndër simbolet më të rëndësishme të muajit Ramazan dhe të netëve të mëdha. Në Perandorinë Osmane, netët e mëdha, si nata e Regaibit, Miraxhit, Beratit, Kadrit dhe nata e Mevludit, për shkak se xhamitë ndriçoheshin me kandila në këto net, quheshin “netët e kandilit” (Aslan, 2009: 200) ose “qirat”, siç quhen edhe te shqiptarët.

Nuk dihet saktësisht se kur ka filluar tradita e ndezjes së kandilave nëpër xhami gjatë muajit Ramazanit dhe në netët e mëdha. Ndriçimi i xhamive dhe ndezja e kandilave në minare për net të mëdha nga shumica pranohet se ka filluar gjatë sundimit të Sulltan Selimit të Dytë (1566-1574). Ndërsa për ndezjen e kandilave në xhamia nga nata e parë e Ramazanit deri në natën e Bajramit thuhet se ka filluar në vitin 1019/1610 gjatë sundimit të Sulltan Ahmedit të Parë (Aslan, 2009: 205).

Në arkivin osman, ka shumë dokumente për ndezjen e kandilave në xhami në muajin Ramazan dhe në netët e mëdha. Në disa prej tyre kërkohet të bëhen përgatitjet e nevojshme për ndezjen e kandilave në xhami dhe mesxhide, ndërsa në disa të tjera thuhet se ndezja e kandilave në xhami të caktuara për lajmërimin e ardhjes së muajit Ramazanit dhe


Xhamia e Pejgamberit a.s., e cila pas ndërtimit ndriçohet me djegien e degëve të thata të hurmës, është xhamia e parë në botën islame që është ndriçuar me kandila, të cilët i kishte sjellë sahabiu Temim ed Dari.

të netëve të mëdha është një adet i mirë dhe se duhet ndezën kandilat, sidomos në xhamitë sulltanore (Aslan, 2009: 206-207).

Tradita e ndriçimit të xhamive me kandila ka qenë prezente edhe në xhamitë e Kosovës. Më poshtë do të trajtohet ndriçimi me kandila të disa xhamive në Kosovës, për të cilat kanë dhënë informacione të hollësishme vakëfnamet e tyre.

XHAMIA E JASHAR PASHËS – PRISHTINË

Xhamia e Jashar Pashës apo Xhamia së Mesme, siç njihet në popull, në Prishtinë është ndër xhamitë e Kosovës që është ndriçuar me kandila në muajin e bekuar Ramazan dhe në net të mëdha. Në vakëfnamen e saj ceket se është bërë kusht që nga ardhurat e hanit në Lipjan, çifligut dhe të mullirit në fshatin Muzeqinë, të cilat i ka lënë vakëf Jashar Pashë Gjinolli, të mbulohen shpenzimet për ndezjen e më shumë se 160 kandilave të xhamisë, të kandilave në minare, shatërvan, oborr dhe në muri. Gjithashtu që të ndizen kandilat edhe në netët e mëdha, si nata e Regaibit, Miraxhit dhe Beratit, në Ramazan, në dy festat e bajramit dhe në natën e Mevludit të Pejgamberit a.s.. Përveç kësaj potencohet se nga këto të ardhura duhet të mbulohen edhe shpenzimet e vajit të ullirit të nevojshëm për ndezjen e kandilave, si dhe shpenzimet e tjera për drita, kuti të kandilave, etj.. (Neziri, 2020: 88).



XHAMIA E KOXHA SINAN PASHËS – KAÇANIK

Kjo xhami është ndërtuar në Kaçanik në vitin 1594 nga Koxha Sinan Pashë Topojani, sadrazem (kryeministër) në Perandorinë Osmane. Afër xhamisë ka ndërtuar edhe një imaret dhe një shkollë, ndërsa për funksionimin e tyre, për pagat e shërbyesve, për ushqimin në imaret dhe për nevoja të tjera të vakëfeve, ai ka lënë vakëfe të mëdha, të cilat i përshkruan në vakëfnamenë e tij. Në vakëfnamenë e tij, përshkruan edhe pozicionin e një kandilndezezi, i cili ka obligim për ndezjen e kandilave dhe llambave duke mos veçuar muajin Ramazan dhe netët e mëdha, por që nënkuptohet se janë ndezur në muajin Ramazan dhe në net të mëdha, dhe se paga e tij ka qenë dy derhem në ditë (Kaleshi, 2007: 120-135).

XHAMIA E EMIN PASHËS – PRIZREN

Kjo xhami është ndërtuar nga mytesirifi i Prizrenit, Emin Pasha, emrin e të cilit e bartë edhe sot. Emin Pasha nga shuma prej 10.000 grosh që e ka lënë vakëf për mirëmbajtjen e xhamisë dhe shatërvanit të saj, pos të tjerash ka e caktuar edhe një shumë për ndriçim me kandila të xhamisë në netët e muajit Ramazan, në festat e dy bajrameve, në netët e Ragaibit, Miraxhit dhe Beratit si dhe në natën e Mevludit. Sipas vakëfnames së Emin Pashës, është bërë kusht që në muajin Ramazan dhe në net të mëdha, brenda xhamisë, të ndizen 30 kandila, jashtë xhamisë 3 kandila, në minare 15 kandila dhe në shatërvan 3 kandila (Avdija, 2021: 63-64).

XHAMIA E MAHMUT PASHËS – PRIZREN

Kjo xhami është ndërtuar nga Mahmud Pashë Rrotlla, i cili ka shërbyer si mytesarif i Prizrenit në gjysmën e parë të shekullit XIX dhe ka lënë shumë vakëfe. Ai brenda kompleksit të xhamisë ka ndërtuar edhe një medrese, një mejtep dhe një ders'hane në lagjen Terzi të qytetit të Prizrenit. Sot kjo xhami njihet me emrin “*Xhamia e Hoqa Mahallës*”. Në vakëfnamenë e tij ceket se është ndarë një shumë e caktuar nga të ardhurat e vakëfit për blerjen e kandilave, të cilët do të ndizen në netët e muajit Ramazan, në festat e bajrameve, në netët e Ragaibit, Miraxhit dhe Beratit. Sipas vakëfnamesë, në muajin Ramazan dhe në net të mëdha, 12 kandila duhet të ndezen brenda xhamisë dhe 12 kandila në minare të saj. (Avdija, 2020: 95).

Në vakëfnamenë e Mahmud Pashë Rrotllës jepen shumë detaje edhe rreth mirëmbajtjes së xhamisë së Kalasë. Ndër të tjerash përshkruhet edhe për ndriçimin me kandila të xhamisë në netët e muajit Ramazan, në festat e bajrameve, në netët e Ragaibit, Miraxhit dhe Beratit...

XHAMIA E KALASË SË PRIZRENIT

Në vakëfnamenë e Mahmud Pashë Rrotllës jepen shumë detaje edhe rreth mirëmbajtjes së xhamisë së Kalasë. Ndër të tjerash përshkruhet edhe për ndriçimin me kandila të xhamisë në netët e muajit Ramazan, në festat e bajrameve, në netët e Ragaibit, Miraxhit dhe Beratit, duke caktuar numrin e kandilave, 7 kandila brenda xhamisë, një kandil në sofa të xhamisë dhe 12 kandila në minare e saj (Avdija, 2020: 95).

XHAMIA E ÇARSHISË – GJILAN

Kjo xhami është ndërtuar nga Shehzade Hanmi, e bija e Tahir Pashë Rrotullës nga Prizreni në vitin 1834, dhe për mirëmbajtjen e saj ka lënë vakëf një shumë prej 4000 groshëve. Në vakëfnamenë e saj, përveç të tjerash, ka bërë kusht që në muajin Ramazan, në festat e bajrameve, në netët e Ragaibit, Miraxhit dhe Beratit, të ndizen 6 kandila në muret e brendshme të xhamisë, një kandil jashtë xhamisë dhe 12 kandila në minaren e saj. (Avdija, 2021: 68-69).

Përveç këtyre xhamive, në qytete të ndryshme të Kosovës që janë ndriçuar me kandila në muajin e bekuar Ramazan dhe në netët e mëdha, hasim se edhe disa xhami të fshatrave që kanë vakëfname, të cilat janë ndriçuar me kandila në net të mëdha. Sipas vakëfnameve janë ndarë shuma të

caktuara që në net të mëdha të ndriçohen me kandila xhamia e fshatit Gadime – Lipjan, xhamia e Komoranit – Drenas, xhamia e Lluzhanit – Podujevë dhe xhamia e Struzhës – Prizren. (Avdija, 2020: 95).

1. Aslan, Halide, 2009. “Osmanlı İmparatorluğu’nda Mübarek Gün ve Gecelerden Kandiller”. İstem 7, no. 13: 199 – 231.
2. Avdija, Fahri, 2020. “Vakëfet e Mutasarrëfit të Prizrenit Mahmud Pashës.”. Rumeli Araştırmaları İslâm Dergisi 3, no. 5 (Spring): 90-100.
3. Avdija, Fahri, 2021. “Kosova Vilayetindeki Vakıflar.” Doktora Tezi, T.C. İstanbul Üniversitesi.
4. Bozkurt, Nebi, 2001. “Kandil.” DİA, vol. 24, 299-300.
5. Bozkurt, Nebi, 2003. “Mahya.” DİA, vol. 27, 396-398.
6. Kaleshi, Hasan, për Ismail Rexhepi dhe Sadik Mehmeti. 2007. “Veziri i Madh Koxha Sinan Pasha – Përshpirtënimet dhe vakëfnameja e Tij.” Edukata Islame XXXVI, no. 82: 95-144.
7. Neziri, Besir, 2020. “Vakëfnamja e Jashar Pashë Gjinnollit” Edukata Islame L, no. 122: 75-100.
8. Özgüdenli, Osman Gazi. 2012. “Vakfiye.” DİA, vol. 42, 465-467.

Mulla Sejdiu dhe Ur`e Vezirit në Shkodër¹

Akademik Feti Mehdiu

“Një çerek shekulli” nga ndarja e mulla Sejdi Simnicës nga kjo botë, më 1 mars 1999. Po them “Një çerek shekulli” se po të thosha 25 vjet, mu dukën shumë. U bënë 25 vjet nga masakra e Reçakut, edhe 25 vjet nga vdekja e mulla Sejdi A. Simnicësm 1932-1999, por duken si 25 ditë.

U takuam diku në pranverë të viti 1962 apo 1963, në zyrën e kryeimamit lokal të Kryesisë së Bashkësisë Islame, në Prishtinë. Unë si nxënës i medresesë së ulët, e mulla Sejdiu, akoma pa marrë thirrjen mulla Sejdi, ani pse e kishte kryer këtë medrese dhe këtu ishte ndal. Në Prishtinë nuk kishte Medrese të Mesme, në Sarajevë nuk kishte arritur të shkoi dhe kaq.

Në vitin shkollor 1962/63, kur filloi medreseja e mesme “Alauddin” në Prishtinë, të cilën unë e vazhdova si nxënës i rregullt, mulla Sejdiu, për shkak të moshës nuk mund të vijonte mësimet me status të nxënësit të rregullt dhe ai kishte vendos të jap provimet me korrespondencë.

Kishin kaluar disa vjet nga takimi i parë, kur ne sërish takohemi dhe përkundra dallimit në moshë (ai i vitit 1932, kurse unë i vitit 1944) deri në ditët e fundit të jetës nuk u ndamë. Ai, këtë lidhje tonën e dëshmoi me një akt të rrallë që praktikohet te shqiptarët, kur për ta farkuar këtë lidhje, kur i lindi djali i katërt i vuri emrin, Feti.

Ai mësoi nga unë të jap provimet e Medresesë së Mesme “Alauddin”, me shënimet e fletoreve të mia, që sapo kryente provimin m`i kthente, prandaj edhe unë ia jepja pa ngurrim, kurse unë mësoja nga ai rrugëtimin jetësor me valët e kulturës popullore shqiptare. Mësoja nga përvoja e tij

Në vitin shkollor 1962/63, kur filloi medreseja e mesme “Alauddin” në Prishtinë, të cilën unë e vazhdova si nxënës i rregullt, mulla Sejdiu, për shkak të moshës nuk mund të vijonte mësimet me status të nxënësit të rregullt dhe ai kishte vendos të jap provimet me korrespondencë.


nëpër oda të Kosovës si imam dhe njeri me autoritet profesional – MULLA SEJDI.

Edhe gjatë kohës sa isha në studime në Beograd, sa herë që vizitoja familjen time në Zajaz, ndalesha edhe në Prishtinë e në Bellaqevc, ku jetonte familja e mulla Sejdiut.

Në vitin 1971, kur bëhej regjistrimi i popullsisë në Jugosllavi, kishte nxjerr krye ideja që në Kosovë të stimulohet propaganda për regjistrim të popullatës së përkatësisë islame në rubrikën myslimanë, në vend shqiptarë. Kjo e brengoste tejmasë mulla Sejdiun, ngase në këtë grackë kishin ra edhe dashamirë të rrethit të tij profesional dhe joprofesional – por miq e dashamirë gjithsesi. Ai ishte vazhdimisht në front me këtë rrymë, kurse mua më rastisi dy herë që të kalojmë natën deri në orën 01:30, kur më shkonte treni nga F. Kosova për Beograd, për të sqaruar prapavijën e kësaj gracke të quajtur “liri” nga ithtarë të identitetit islam të painformuar lidhur me këto rrjedha. Nuk kam qenë në tëra frontet, por porosia ka shkuar edhe atje ku nuk kisha qenë unë fizikisht, sepse e kishte bart mulla Sejdiu, i cili e dinte shumë mire prapavijë ne kësaj “lirie”.

E kisha ndihmuar me një ilustrim, që ma kërkoi konaku dhe unë vendosmërisht e qartë e përcolla përvojën e kontakteve të mia me kolegë nga Bosnja që i kisha në studime. Kur më dhanë fjalën lidhur me këtë për disponimin në Bosnjë, e shqiptova thekshëm uratën që ma pati shprehur kolegu nga Bosnja, i cili e kuptonte thellë kurthin politik, kur më tha: “Të lumët ju që keni identitet kombëtar shqiptar dhe identitet fetar islam!”

Mulla Sejdiu e kishte përdorë këtë edhe në vende të tjera dhe më thoshte se kjo kishte pas ndikim dhe shumë efekt pozitiv në vetë-



dijesimin e popullatës për të sqaruar përkatësinë kombëtare dhe përkatësinë fetare.

Boshnjakët nuk e kishin këtë. Regjistrimi në rubrikën mysliman ishte kamuflim për manipulim demografik statistikor me pasoja të rënda për gjendjen e kombit shqiptar.

Më vonë, edhe si nëpunës i devotshëm në Këshillin e Bashkësisë Islame në Prishtinë, edhe si anëtar i Këshillit për ndihmë popullatës Kosovës në vitin 1990, i cili Këshill funksiononte në kuadër të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, me qëllim që të vazhdojë si trup i Bashkësisë Islame të Kosovës, të ringjallte traditën e imaretit, ai ishte gjithmonë i përkushtuar në realizimin me korrektësi të detyrave që na ngarkonte situatë dramatike e krizës financiare, kur minatorët e Trepçës dhe ndërmarrjeve të tjera, pushteti i dhunshëm i Beogradit i la me gishta në gojë, duke ua rrëmbyer kafshatën e gojës dhe duke i larguar nga puna.

Përvoja jetësore e mulla Sejdiut, me detyrë të imamit, myezinit, edukatorit të Medresesë “Alauddin”, ekonomist i internatit, arkëtar i Këshillit të vakëfit në Prishtinë, etj., peripecitë jetësore edhe familjare ishin mësim i vlefshëm për mua. Të gjitha i bisedonim bashkërisht dhe ndonjëherë kundërshtoheshim në koncepte dhe kjo na pasuronte të dyve. Pas kundërshtimeve, kur mbyllnim rrokopujat, si dy miq të singjertë, më thoshte, ti ke të drejtë, por nuk doja ta pranoja në fillim, se po ta pranoja mbyllej biseda dhe asnjëri nuk fitonte asgjë të re. Kështu kemi fituar të dy, edhe ti edhe unë.

“Nuk i di të gjitha ti” – ishin këto biseda që u merrte lakmi edhe ndonjë dashamirë, i cili, rastësisht ose me qëllim ndodhej bashkë me ne.

MËSIMET NGA PËRVOJA E MULLA SEJDIUT

Do të përmendi me këtë rast diçka që më ka lënë përshtypje për mençurinë e deponuar në popull dhe është kultivuar nëpër odat shqiptare, për këtë rast, në odat e Drenicës. Mulla Sejdiu kishte miqësi me Drenicën dhe kishte pas rast më shpesh të gjendet në oda “University” dhe të thith urtinë e popullit shqiptar.

Unë te disa vjet pas tij, kam pas rastin të njihem me persona të njëjtë, por “mitanin e ri dhe sofrën e dreqnive”, e mësova nga mulla Sejdiu.

Prej tij e mësova përgjigjen në këngë, nga pleqnari i Drenicës, të cilin kur e pyetën për hallin e Kosovës, vendosi të përgjigjej me këngë për shumë arsye.

“Oh, moj Kosovë, mori bi,

Ta kanë pre një mintat t`ri,

është i shkurt dhe pak i xhane,

Vishe `i herë a t`bjen taman,

Thonë i ri, po është vjetër,

Vishe `i herë se nuk ke tjetër!”

Urtia tjetër, për ta mbështjellë mençurinë delikate, që të mos rrezikohej kush, por të kuptohej situata se si duhet bërë përpjekje për të nxjerr sado pak ndonjë përfitim nga situata e stërmbushur me shumë të panjohura, ishte ajo që e kishte dëgjuar, po ashtu në Drenicë.

Për punën tonë, biro, doemos të ulesh në sofrën e dreqëve, por si?

Aty s`ka vend për insanin.

Është marifet i hollë të shtihesh si dreq, por mos dalish dreq nga ajo sofrë.

Atij i kishte bërë përshtypje edhe stërhollimi i malësoreve shkodrane për urën e Siratit, që e krahasoi me urën e Vezirit në Shkodër.

Mulla Sejdi Simnica ishte hoxhë - për imam dhe për hatib e vaiz, por ishte edhe për odën shqiptare. Ishte edhe kritik ndaj “nasihateve” të stërzgjatura pa mbulesë nga Kurani dhe nga Hadithi, prandaj i kishte pëlqyer reagimi i malësoreve shkodrane.

Ajo, një ditë xhumaje, i vuri veshin hatibit se si e trajtonte urën e Siratit... *“shumë e ngushtë..., e hollë..., e mprehtë, e gjatë...” etj.*, dhe kjo si ishte duke gatuar, iu mbush mendja, dhe brofi në oborr:

“Efendi, lëri këto muhalife, mos u tall me punë t`Zotit! Po neve veziri na e ka bërë urën të gjanë sa të duash, e Zoti po e bëka aq të ngushtë!”

Mulla Sejdiu ishte i vendosur dhe mbronte me ngulm dy identitete të popullit shqiptar, e kishte të qartë se xhemati i tij është shqiptarë dhe është i fesë islame.



Këtë e dëshmonte dhe e kultivonte gjithandej ku shërbente.

U dallua, sidomos në vitin 1991, me “tallkinin” që ia kushtoi dëshmorit Naim Syla dhe që u botua në të përmuajshmen “Dituria Islame”, nr. 22-23, 1991, fq. 50. Ishte kjo periudhë kur u shpeshatuan rastet kur ushtarët shqiptarë ktheheshin në arkivol nga ushtria me urdhëresën rreptësishtë “Mos e hap!”

I prekur thellë nga vdekja mizore e të riut shqiptar, Naim Sylës, mulla Sejdiu iu shmang traditës për t`iu afruar elitës, kur pas lëshimit në varr, i drejtohet: “O Naim, bir i popullit shqiptar! NË EMËR TË ALLAHUT, dhe besnik mësimëve të Pejgamberit, të vumë në tokë. Të kthyem të pastër, në barkun e nënës Tokë, prej së cilës kemi lindur dhe në të cilën do të pushojmë për kohësisht, derisa të vijë momenti i ringjalljes dhe pastaj më nuk ka vdekje!”

O NAIM, BIRI I POPULLIT SHQIPTAR!
Ata që japin jetën për lirinë e atdheut nuk vdesin kurrë...!

Në vend tradicionales “O filan, i biri nënës tënde...!” mulla Sejdiu iu shmang kësaj tradite sepse Naim Syla nuk ishte ekzekutuar pse është i biri i nënës së vet, por pse ishte bir i popullit shqiptar, prandaj ky “tallkin” jehoi fuqishëm në opinionin shqiptarë – veçanërisht të Kosovës, se ai që i beson Kuranit i del zot vatanit, ashtu që zuri vend në ditarin e Pajtim Shalës (Muhamet Pirrakut), i cili e përjetësoi në faqet e revistës “Dituria Islame” për muajin shkurt-mars, 1991.

Kjo qasje e mulla Sejdi Simnicës jehoi si akt me vlerë shumëdimensionale që preku ndërgjegjen e elitës shqiptare që morën pjesë në varrimin e Valon Sylës.

Medreseja na bashkoi, islamja dhe shqiptarësia e çimentoi këtë shoqërim tonin dhe ne i ramë trup e tërthorë Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi, për raste urimesh, siç ishte vënia e gurthemelit të Medresesë “Isa Beg” në Shkup, vënia e themelit të xhamisë në Fushë Kosovë, ose ngushëllimesh kudo që arrinim, por masakra e Reçakut, e janarit të vitit 1999, na ndau për këtë jetë.

Medreseja na bashkoi, islamja dhe shqiptarësia e çimentoi këtë shoqërim tonin dhe ne i ramë trup e tërthorë Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi, për raste urimesh, siç ishte vënia e gurthemelit të Medresesë “Isa Beg” në Shkup, vënia e themelit të xhamisë në Fushë Kosovë, ose ngushëllimesh kudo që arrinim, por masakra e Reçakut, e janarit të vitit 1999, na ndau për këtë jetë.

Të vdesësh mjafton vetëm një shkak – ky është universal, të jesh lindur - por mulla Sejdi Simnica pati edhe një shkak tjetër. Ishte masakra e Reçakut, e janarit të vitit 1999. Ai e ndiente detyrën e vet morale se është përgjegjës të jetë në shërbim të popullit të vet, si imam, jo domosdoshmërisht imam zyrtar, prandaj u angazhua maksimalisht në përgatitjen e xhenazeve të shehidëve të Reçakut që t`i përcjell denjësisht për Ahiret, dhe këtë e bëri me korrektësinë e merituar, por e përjetoi shumë rëndë këtë ngjarje.

Nuk vonoi shumë dhe iu bashku edhe ky shehidëve të Reçakut.

Zoti mos e ndaftë prej shehidëve, sidomos atyre të Reçakut të Kosovës, të cilëve ua dha hakun me shërbimin e fundit kur i pastroi dhe i përgatit për rrugën njëkahëshe.

Ne nuk u takuam më!

Unë sapo mora lajmin se mulla Sejdiu ishte i sëmurë, dhe kur gjeta rastin të thërras Nysretin dhe ta pyesja si e ka gjendjen – ishte bërë vonë!

Disa orë më parë kishte ndërruar jetë!
Allahu e gradoftë me Xhenetin Firdevs!

1 Më përpara kanë marrë rrugë, pak më ndryshe, kolosët e dijës: Fehima Bajraktareviq, Hasan Kaleshi, Ukshin Hoti, Tahir Kolgjini...Për VITIN 2024 janë në radhë: Haxhi Bahri Ganiu, dr. Ibrahim Rugova, Ai doktori i Medresesë...

Në kujtim të orientalistit të parë shqiptar, Tahir Dizdarit

Muhamed Arnaut

Në vitin 1919, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, u botua një libër me titull “Shqipëria, çelësi kryesor i Lindjes së Afërt”, i shkrimtarit shqiptar Kristo Dako, i cili pati një marrëdhënie me presidentin e ShBA-ve, Woodrow Wilson, pasi që ai doli në Konferencën e Paqes në Paris me teza mbi një Evropë të re, të bazuar në shtetet kombëtare që do të zëvendësonin perandoritë e shembura. Megjithatë, ajo që bie në sy këtu është se Shqipëria mbeti e konsideruar si një “çelës kryesor” për Lindjen e Afërt, e cila përfshinte Ballkanin, ani pse sundimi osman ishte larguar nga ky rajon (me përjashtim të një enklave të vogël rreth Stambollit) si rezultat i Luftës Ballkanike (1912-1913).

Me këtë tranzicion, nga perandoritë e shembura në shtetet kombëtare (Jugosllavia, Shqipëria, Bullgaria e të tjera), filloi kalimi nga lokalizimi brenda Lindjes në orientalizëm, veçanërisht me hapjen e departamenteve akademike për Studime Orientale në këto vende që mbetën për disa shekuj nën sundimin osman. Në këtë kontekst, Beogradi, i cili deri në shekullin e nëntëmbëdhjetë njihej si “Porta e Lindjes”, ishte dëshmitar i themelimit të departamentit të parë të orientalistikës në universitetin e tij. Nga ai dhe nga seksione të tjera pasuese, doli brezi veteran që lindi në kohën e Perandorisë Osmane dhe mësoi nga kultura e saj dhe më vonë u bë brezi i parë i “orientalistëve”, që vendosën bazën për studimet orientale, që përfshinin këtu trashëgiminë orientale në Ballkan dhe ndikimet orientale në gjuhët dhe kulturat ballkanike.

Nga ky brez, në Shqipëri është Tahir Dizdari (1900-1972), i cili jetoi nëpër disa vende dhe regjime që sunduan Shqipërinë

Dizdari nuk mori nderimin që i takoi, vetëm se deri pas përfundimit të qeverisjes së Partisë Komuniste, kur Presidenti i Republikës, Salih Berisha, e nderoi në vitin 1995 me medaljen më të lartë “Medaljen Naim Frashëri” për vlerën e tij dhe kontributin në zhvillimin e studimeve shqiptare në fushën e orientalizmit.


dhe vuajti shumë gjatë qeverisjes së Partisë Komuniste (1945-1990), por meritoi titullin “Orientalisti i parë shqiptar”, për shkak të kontributeve të tij pioniere në fushën e orientalistikës në gjuhën shqipe. Dizdari nuk mori nderimin që i takoi, vetëm se deri pas përfundimit të qeverisjes së Partisë Komuniste, kur Presidenti i Republikës, Salih Berisha, e nderoi në vitin 1995 me medaljen më të lartë “Medaljen Naim Frashëri” për vlerën e tij dhe kontributin në zhvillimin e studimeve shqiptare në fushën e orientalizmit. Gjithashtu, në vitin 1997 (me rastin e 25 vjetorit të vdekjes së tij), u mbajt një simpozium shkencor në të cilin u prezantuan kumtesa që mbulonin kontributet e tij të ndryshme pioniere.

**AUTOR I VEPRAVE REFERUESE PËR
NDIKIMIN E GJUHËS SHQIPE NË
ARABISHT, TURQISHT DHE
PERSISHT**

Interesi dhe nderimi për të nuk u kufizua vetëm me kaq, por vazhdoi edhe në vitet e mëvonshme, me botimin e artikujve dhe studimeve për të, duke çuar në botimin e përpjekjes më të madhe këtë vit, të përfaqësuar në një vëllim prej 557 faqesh nga studiuesi kosovar, Irfan Morina dhe studiuesja nga Shqipëria, Lindita Khanari, me titull “Tahir Dizdari - Jeta dhe veprat e tij”, i cili u publikua pak javë më parë në kryeqytetin shqiptar në pesëdhjetë vjetorin e vdekjes së tij.

Tahir Dizdari lindi në vitin 1900 në qytetin e lashtë të Shkodrës në veri të Shqipërisë, në një familje, ekzistenca dhe vazhdimësia e së cilës ishin të lidhura me sundimin osman. Edhe pse situata ishte ngushtuar pas transformimit të gjyshit dhe babait të tij në punonjës të

thjeshtë, ai filloi shkollimin në gjuhën turke në shkollën osmane “Rushdije” në qytet, ku mësoi turqisht, arabisht dhe persisht. Megjithatë, kushtet e Luftës Ballkanike të viteve 1913-1912, dhe më pas Luftës së Parë Botërore, çuan në kalimin e qytetit nga festimi i pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912, në sundimin malazez dhe më pas austriak deri në vitin 1918.




Kopertina e librit “Tahir Dizdari - Jeta dhe vepra e tij”,
botuar së fundmi në shqip

Kështu, nën sundimin austriak, Dizdari kreu arsimin e mesëm në shkollën jezuite, ku mësoi frëngjisht dhe italisht. Me stabilitetin e shtetit shqiptar në kufijtë e tij aktual në vitin 1920, ai punoi si punonjës për të mbajtur shtatë vëllezërit e tij dhe jeta e tij ndryshoi kur takoi dhe u martua në vitin 1923 me një gjinekologe turke, Fatime Makbule, e cila erdhi në Shqipëri në vitin 1921 me kërkesën e qeverisë për të ndihmuar gratë në një vend me shumicë myslimane, gjë që ringjalli lidhjen e tij me gjuhën turke.

Gjatë sundimit të Ahmed Zogut si kryeministër i Republikës dhe Mbret i Shqipërisë (1922-1939), Tahir Dizdari ishte përkrahës i reformave të ndërmarra nga Zogu, ngjashëm me Mustafa Kemal në Turqinë republikane, ku u zhvendos në poste të ndryshme brenda komunave të Ministrisë së Brendshme. Prandaj, ai mori pjesë në rezistencën ndaj pushtimit italian të Shqipërisë në prill 1939, e cila çoi në arrestimin dhe internimin e tij deri

në vitin 1943. Me dorëzimin e Italisë, Gjermania, në shtator 1943, shpalli rivendosjen e pavarësisë së Shqipërisë nën ndikimin gjerman, gjë që lejoi Tahir Dizdarin të kthehet në vendin e tij dhe të marrë pjesë në jetën kulturore duke botuar artikuj dhe studime në fushën e gjuhës shqipe, folklorit dhe ndikimeve orientale. Ndër këto ishte studimi i tij i parë mbi “Fjalorin persisht në gjuhën shqipe”, të cilin e botoi në vitin 1944.

Në atë kohë, Lëvizja Nacionalçlirimtare e udhëhequr nga Partia Komuniste luftonte në dy fronte: kundër të djathtës



Tahir Dizdari në rininë e tij, 1920 (Arabia e Re)

Dizdari mori pjesë në rezistencën ndaj pushtimit italian të Shqipërisë në prill 1939, e cila çoi në arrestimin dhe internimin e tij deri në vitin 1943.

kombëtare dhe kundër pranisë ushtarake gjermane në vend, të cilën Tahir Dizdari dhe gruaja e tij e simpatizonin, pasi i jepnin mbështetje kësaj lëvizje. Me ardhjen e Partisë Komuniste në pushtet dhe shpalljen e Republikës në vitin 1946, emri i Dizdarit filloi të shfaqet në organet e reja të pushtetit, duke përfshirë Unionin e Shkrimtarëve dhe Artistëve, i cili u themelua në vitin 1946 dhe Dizdari ishte një nga anëtarët e saj.

Megjithatë, hedhja e një bombe në ambasadën sovjetike në Tiranë në shkurt të vitit 1951 u konsiderua si një komplot kundër regjimit, dhe kjo solli arrestimin e dhjetëra intelektualëve - përfshirë Tahir Dizdarin - si rezultat i një raporti të rremë, dhe ekzekutimin e 22 prej tyre me akuzën e pjesëmarrjes në këtë komplot. Ndonëse Dizdari u lirua pas disa muajsh, ai u internua me gruan e tij dhe

u bë një nga të dyshuarit që nuk mund të pritej nga institucionet shkencore e kulturore të vendit. Ai u internua dhe u persekutua në jetën e tij, dhe karriera e tij dhe veprat e tij u njohën vetëm kohët e fundit.

Në këtë situatë të vështirë, studiuesit shqiptar nuk i mbeti gjë tjetër veçse të punonte në shtëpinë e tij në përmirësimin e projektit të tij madhështor, “Fjalori i termave oriental në gjuhën shqipe”, që i zgjati rreth dhjetë vjet dhe filloi botimin e disa pjesëve të tij në fillim të viteve gjashtëdhjetë, të cilat paralajmëruan komunitetin shkencor për rëndësinë e kontributeve të tij dhe nxitën Institutin e Gjuhësisë në vitin 1965 që ta pranonte të punonte atje si studiues, pavarësisht dosjes së tij politike të fabrikuar, dhe ai vazhdoi të punonte atje deri në vdekjen e tij në 1972.

Ndonëse Tahir Dizdari u rehabilitua si orientalisti i parë shqiptar në kuptimin shkencor, pas tranzicionit demokratik në Shqipëri (1990-1992) dhe pas artikujve dhe studimeve të botuara rreth tij që shpalosën kontributet e tij pioniere në fushën e orientalistikës, më në fund drejtësia erdhi për të, duke botuar një libër të ri që flet për të. Një libër, pjesa e parë e të cilit përfshin biografinë e tij të mbledhur nga burime të shumta, pjesa e dytë përmban artikujt dhe studimet e tij që ai botoi me emrin e tij ose me pseudonime, ndërsa pjesa e tretë dhe e katërt i kushtohen veprës së tij enciklopedike “Fjalori i termave orientale në gjuhën shqipe”. Seksioni i pestë përmban korrespondencën e tij, dhe pjesa e gjashtë i kushtohet martesës së tij me të parën gjinekologe myslimane në Shqipëri, ndërsa në pjesën e shtatë një album fotografik, i cili përfshinë shumë foto të publikuara për herë të parë.

Ndoshta këtu është e rëndësishme të ndalemi te vepra e tij enciklopedike “Fjalori i termave oriental në gjuhën shqipe”, e cila mbeti në dorëshkrim deri sa u botua në Tiranë në vitin 2005 nga Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam. Në këtë fjalor të madh (rreth 1200 faqe), Dizdari shpalos rreth 4500 mijë fjalë arabe, persiane dhe turke që hynë në gjuhën shqipe gjatë sundimit të gjatë osman, i cili zgjati rreth pesë shekuj.

Një libër, pjesa e parë e të cilit përfshin biografinë e tij të mbledhur nga burime të shumta, pjesa e dytë përmban artikujt dhe studimet e tij që ai botoi me emrin e tij ose me pseudonime, ndërsa pjesa e tretë dhe e katërt i kushtohen veprës së tij enciklopedike “Fjalori i termave orientale në gjuhën shqipe”.

Këtu duhet pasur parasysh se me sundimin osman u fut një kulturë e re e lidhur me përhapjen e Islamit, e cila u bë fe e shumicës, e manifestuar përmes përhapjes së gjuhëve të reja (arabe, turke dhe perse) në letërsi dhe jetën e përditshme dhe u lidh me ngritjen e shkollave, profesioneve të reja dhe strukturave urbane me karakter dhe përmbajtje orientale etj. Prandaj, nuk është për t'u habitur që gjuha e varfër shqipe u hap në fund të mesjetës ndaj këtyre gjuhëve që përfaqësonin një kulturë të përparuar dhe në të cilat filluan të shkruanin edhe poetët dhe shkrimtarët shqiptarë dhe shkronjat e saj u përdorën për të shkruar gjuhën shqipe.

Kështu, Dizdari zbulon në këtë leksik të paparë se janë 1732 fjalë turke, 1460 fjalë arabe, 505 fjalë arabe, dhe 72 fjalë arabe-persiane, 43 fjalë arabo-turke dhe 24 fjalë turqisht-persisht. Këtu theksohet se ky fjalor mbulonte ndryshimet e mëdha administrative, fetare, letrare e profesionale, arkitekturën e re orientale dhe jetën e përditshme që u kristalizua gjatë sundimit të gjatë osman të Shqipërisë. Megjithëse Shqipëria u pavarësua nga Perandoria Osmane në vitet 1912-1913, me kufij që përfshinin vetëm gjysmën e shqiptarëve, ndërsa gjysma e mbetur u shpërnda në vendet fqinje (Serbi, Mali i Zi dhe Greqi), por ky fjalor mbeti në përdorim për disa dekada deri sa u zhvilluan fjalorë të shqipes moderne (që u bënë të zakonshme midis Veriut dhe Jugut). Fjalorët mbetën peng, nën ndikimin e regjimit totalitar të Enver Hoxhës, i cili e shpalli Shqipërinë në vitin 1967, shtetin e parë ateist në histori, dhe u kërkua të reduktonin këta fjalorë, të cilët u konsideruan të padëshirueshëm.

Edhe pse ky trend mundi të zhdukte rreth gjysmën e këtyre fjalorëve në Shqipëri të paktën, gjysma tjetër mbeti solide, sepse u bë pjesë e gjuhës dhe kulturës shqipe, veçanërisht pas transformimit demokratik në vend dhe rikthimit të jetës në kulturën fetare të shumicës myslimane. Megjithatë, “Fjalori i termave oriental në gjuhën shqipe” mbetet një vepër e gjallë dhe e pazëvendësueshme, veçanërisht për studiuesit e orientalistikës, sepse burimet historike e letrare dhe folklori i pasur shqiptar (përralla popullore, këngë historike etj.) nuk mund të kuptohen nga brezi i ri pa këtë fjalor.

Marrë nga gazeta: “The New Arab”
Përktheu nga arabishtja: Shpend Hulaj

Kontributi i Taki el Dinit (Takijjeddin) në zhvillimin e shkencave (1526 - 1585)

M.sc Artan S. Mehmeti

Derisa ishte i ngarkuar si gjyqtar në Tinnin të Egjiptit, ai bëri disa vëzhgime astronomike me ndihmën e një instrumenti astronomik, të cilin e kishte montuar në një pus të thellë rreth 25 m.

Taki el Dini Muhamed ibën Ma'ruf esh Shami el Asadi (në gjuhën turke, Takijjeddin), lindi në Damask. Për një kohë të shkurtër, ai erdhi në Stamboll së bashku me të atin Ma'ruf Efendi, dhe më pas emigroi për në Egjipt, ku qëndroi 20 vjet, për t'u rikthyer prapë në Stamboll. Sa i përket përkatësisë etnike, ai është përshkruar si: arab, turk dhe sirian, kurse Enciklopedia Islame, nuk e tregon fare përkatësinë e tij etnike, por e quan vetëm si "astronomin më të rëndësishëm të Perandorisë Osmane". Taki el Dini, njihet për kontributin e dhënë në astronomi, hartografi, gjeografi, matematikë, mekanikë, optikë dhe filozofi natyrore.

Rreth vitit 1550, Taki el Dini, vizitoi Stambollin. Në këtë vizitë, ai u njoh dhe krijoi raporte shoqërore me vezirin e madh të Perandorisë Osmane, të quajtur Semiz'Ali Pasha, i cili e lejoj Taki el Dinin të shfrytëzonte bibliotekën e tij private, si dhe koleksionin e tij të orëve mekanike të sjellë nga Evropa. Më shumë përfitoi nga njohja me Semiz'Ali Pasha, kur ky i fundit u emërua guvernator i Egjiptit dhe Taki el Dinin, e emëroi si mësues dhe gjyqtar (kadi) në Egjipt. Që të merret me studime në matematik dhe astronomi, ai u inkurajua nga një nip i Ali Kushçit, i cili mblodhi dhe i dha Taki el Dinit punën shkencore të gjyshit të tij, të Mesud el Kashit, të Kadizade el Rumi, si dhe punime rreth instrumenteve të ndryshme vëzhgimi. Derisa ishte i ngarkuar si gjyqtar në Tinnin të Egjiptit, ai bëri disa vëzhgime astronomike me



ndihmën e një instrumenti astronomik, të cilin e kishte montuar në një pus të thellë rreth 25 m.

Në Stamboll, Taki el Dini kthehet në vitin 1570, kurse në vitin 1571, ai emërohet astronomi kryesor (Müneccimbasi) nga Sulltan Selimi II-të, pas vdekjes së astronomit të quajtur Mustafa ibën Ali el Muekkit. Vëzhgimet e tij, Taki el Dini i vazhdoi nga Kulla e Gallatës. Me mbështetjen e zyrtarëve të lartë, saktësisht të Sokullu Mehmed Pashes dhe Hodja Sadettin Efendi, ai mori lejen nga Sulltan Murati i III-të, për të krijuar një observator për vëzhgime astronomike. Qëllimi i Taki el Dinit në dertimin e këtij observatori ishte të përfitonte rezultate, të korrigjuara në mënyrë rrënjësore, me ndihmën e "një lloji të ri vëzhgimi" (rasad xhedid) dhe me ndihmën e mjeteve të reja të ndërtruara në dimensione shumë të mëdha. Libri që ka

mundësi të jetë shkruar fillimisht në gjuhën arabe dhe që ne na ka ardhur në gjuhën turke i Taki el Dini, i cili emigroi në Stamboll pas qëndrimit të tij në Siri dhe Kajro, jep të dhëna në lidhje me këtë observator dhe mjetet e tij, si dhe përmban paraqitjen dhe përshkrimet e ilustruara të tetë mjeteve vëzhguese në dimensione që ishin të pajohura deri në atë kohë.

Observatori i Stambollit u vendos në pjesën e sipërme të Tophanit. Për këtë observator janë mbledhur libra dhe instrumente të rëndësishme astronomike. Punimet në miniaturë që ndodhën në librin e Alaaddin Mansur i titulluar “Alat-i Rasadije li Zixh-i Shehinshahije”, theksojnë se Taki el Dini bëri shumë mjete vëzhgimi për observatorin. Pothuajse 20 vepra të tij, janë kryesisht për astronominë. Në dy nga veprat e tij, ai shkroi mbi orën diellore, matësit e ujit dhe mjete mekanike, në të cilat Sulltan Murati i III-të ishte i interesuar. Për fat të keq, observatori nuk zgjati më shumë se pesë vjet (1575-1580). Për shkak se Sulltan Murati III ishte gënjer nga këshilltarët e tij fanatikë dhe rivalët e Taki el Dinit me pretextin se observatori ishte një mjet i astrologjisë dhe se do të shfaqte rezultate kërcënuese për të ardhmen e vendit, ai, mbas disa vitesh nga ndërtimi i tij, e shembi këtë observator.

Më vonë, në vendin e observatorit u ndërtua pallati francez. Është për të ardhur keq që shkatërrimi i observatorit nënkuptonte që ai nuk ishte në gjendje të përfundonte programin e tij të vëzhgimit.

Për t'i pasur sa më të sakta vëzhgimet e tij në këtë observator, Taki el Dini, përdori një sërë instrumentesh astronomike. Disa ishin instrumente që tashmë ishin në përdorim nga astronomët evropianë, ndërsa të tjera që ai i shpiku vetë. Ndërsa punonte në këtë observator, Taki el Dini, nuk përdorte vetëm instrumente dhe teknika të krijuara më parë, por gjithashtu shpiku edhe shumë instrumente të reja. Nga këto shpikje të reja, ora automatike-mekanike konsiderohet si një nga shpikjet më të rëndësishmit në këtë observator.

Taki el Dini na përshkruan tetë mjete astronomike, një orë astronomike dhe një kompas të veçantë që shërben për të vizatuar rrrathë me rreze të mëdha. Në fakt, gjashtë

Si rezultat i metodave të reja që ai zhvilloi, si dhe pajisjeve që shpiku, Taki el Dini, ishte në gjendje t'i afrohej vëzhgimeve të tij në një mënyrë inovative dhe të prodhonte zgjidhje të reja për problemet astronomike. Ai përcaktoi shkallën ekliptike në $23^{\circ} 28' e 40''$, e cila është shumë afër vlerës aktuale të $23^{\circ} 27'$.

mjetet e para njiheshin nga paraardhësit grekë apo arabë dhe më pas, veçanërisht në Observatorin e Meragas, përjetuan një fazë zhvillimi të qartë. Në përshkrimin e Taki el Dinit vihet re se këto mjete janë ndërtuar përgjithësisht në dimensione të mëdha dhe pa pasur asnjë veçanti shtesë. Ai e konsideron mjetin e shtatë dhe të tetë, “Mjeti me Kodra” (Alet Zat el Evtar) dhe “Mjeti që shërben për të matur distanca midis yjeve” (Ale Mushebbehe bie el Manatik) si zbulime të tij. Tycho Brahe mund të këtë pasur njohuri mbi mjetin e tetë dhe mjetin e pestë që është një kuadrant prej druri.

Si rezultat i metodave të reja që ai zhvilloi, si dhe pajisjeve që shpiku, Taki el Dini, ishte në gjendje t'i afrohej vëzhgimeve të tij në një mënyrë inovative dhe të prodhonte zgjidhje të reja për problemet astronomike. Ai përcaktoi shkallën ekliptike në $23^{\circ} 28' e 40''$, e cila është shumë afër vlerës aktuale të $23^{\circ} 27'$. Taki el Dini përdori një metodë të re në llogaritjen e parametrave diellorë, si dhe në përcaktimin e madhësisë së lëvizjes vjetore të apogjës së diellit në $63''$. Duke pasur parasysh se vlera e sotme e njohur është 61 sekonda, rezultati që Taki el Dini fitoi duket se ka qenë më i saktë se ai i Kopernikut ($24''$) dhe Tycho Brahe ($45''$). Po ashtu edhe metoda që përdori për gjetjen e koordinatave të yjeve, thuhet se ishte aq e saktë, sa që ai fitoi rezultate më të mira se të Kopernikut dhe Tycho Brahe.

“Sidrat el muntaha el afkar fi malakut el falak el davvar (el Zixh el Shahinshahi)” thuhet se është një nga veprat më të rëndësishme të Taki el Dinit në astronomi. Ai e përfundoi këtë libër në bazë të vëzhgimeve të tij si në Egjipt ashtu edhe në Stamboll. Qëllimi i kësaj pune ishte përmirësimi, korrigjimi dhe përfundimi i plotë i librit të Ulug Begut (“Zidj-i Xhedid Sultani”), i cili ishte një projekt i hartuar në qytetin Samarkand, përkatësisht në Observatorin e Samarkandit dhe më tutje në Observatorin e Stambollit.

Shkatërrimi i Observatorit të Stambollit ndaloi vëzhgimet astronomike të Taki el Dinit, e gjithashtu ngjall dyshime se libri “Sidrat muntaha el afkar fi malakut el falak el davvar (el Zixh el Shahinshahi)” nuk është

përfunduar kurrë. Këtë dyshim më shumë e forcon edhe mungesa e një përfundimi në këtë libër.

“Jaridat el durar ve haridat el fikar” është një libër që thuhet se është puna e dytë më e rëndësishme e Taki el Dinit në astronomi. Ky libër përmban përdorimin e parë të regjistruar të fraksioneve dhjetore dhe funksioneve trigonometrike në tabelat astronomike. Ai gjithashtu jep pjesët e shkallës së kthesave dhe këndeve në fraksione dhjetore me llogaritje të sakta.

“Dustur el terxhah li kava'id el tastih” është një tjetër punë e rëndësishme e Taki el Dinit, e cila përqendrohet në projektimin e një sferë në një rrafsh, midis temave të tjera gjeometrike.

Taki el Dini është gjithashtu i njohur si autor i “Rajhanat el ruh fi rasm el sa'at 'ala mustavi el sutuh”, ku flitet rreth orëve diellore dhe karakteristikat e tyre janë të vizatuara në një sipërfaqe mermeri.

Nuk ka pasur shumë hulumtime në lidhje me interesin e Taki el Dinit në hartografi, edhe pse dihet se ai ishte themeluesi i observatorit të parë në Perandorin Osmane. Dy librat e tij të njohura më “Rajhanat el ruh fi rasm el sa'at 'ala mustavi el sutuh” dhe “Dustur el terxhah li kava'id el tastih”, përmbajnë informacione rreth punimit dhe përdorimit të hartës. Përpos librit “Kitab-i Bahrije” të Piri Reisit, këto dy libra të Taki el Dinit, janë ndër librat më të rëndësishëm hartografik në Perandorinë Osmane.

Miniaturat që ndodhën në “Alat-i Rasadije li Zixh-i Shehinshahije”, tregojnë dhomën e observatorit së bashku më

vëzhguesit që ndodhën në të duke bërë vëzhgime me disa nga mjetet astronomike që i posedonin. Në këto miniatura, një nga mjetet astronomike që bie në sy është edhe globi tokësor, që thuhet se këtë glob e ka punuar Taki el Dini. Në këtë glob, ajo që vërehet është se Deti Mesdhe paraqitet më i gjatë se sa është me të vërtetë, Brazili i afrohet Afrikës drejt lindjes dhe Poli i Jugut afrohet me Kepin e Shpresës së Mirë. Megjithatë, shihet se vendet, të cilat sapo janë zbuluar, janë vizatuar më saktë se ato në hartat e Piri Reis.

Fakti që astronomia dhe matematika janë degët më të rëndësishme shkencore që mbështesin hartografinë, lehtësisht mund të thuhet se Taki el Dini nuk pati shumë vështirësi për të bërë globin për shkak të njohurive të tij të gjera mbi këto tema.

Burimet

1. Prof. dr. Fuat Sezgin, Epoka e madhe e panjohur. Nga historia e shkencës dhe e teknologjisë islame, përktheu nga turqishtja: Altin Qefaliu, LOGOS-A, Shkup, 2015.
2. The Illustrated History Of Turkish Cartography, THE OLDEST MAP IN HISTORY. (https://www.hgk.msb.gov.tr/english/images/kurumsal/history_of_turkish_cartography.pdf,
3. https://islamsci.mcgill.ca/RASI/BEA/Taqi_al-Din_BE.html,
4. <http://muslimheritage.com/article/taqi-al-din-ibn-ma%E2%80%99ruf-0>,
5. <http://www.muslimheritage.com/article/taqi-al-din-ibn-ma%E2%80%99ruf-survey-his-works-and-scientific-method>,
6. https://en.wikipedia.org/wiki/Taqi_ad-Din_Muhammad_ibn_Ma%27ruf



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM ANËTAREN E PARLAMENTIT TË BRITANISË SË MADHE, ZNJ. FIONA BRUCE



Më 16 shkurt 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim anëtarin e Parlamentit të Britanisë së Madhe, znj. Fiona Bruce, e cila njëherësh është përfaqësuese speciale e kryeministrit të Britanisë për liritë fetare dhe besimin.

Myftiu Tërnavë fillimisht i uroi mirëseardhje znj. Bruce në institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës, e më pas e njohu atë me punët dhe

angazhimet e këtij institucioni. Ai tha se Bashkësia Islame e Kosovës është institucioni më i madh fetar në Kosovë, andaj si i tillë ka luajtur një rol kyç në kultivimin e tolerancës dhe bashkëjetesës fetare në vend. “Kosova është një shembull për të gjithë për bashkëjetesë dhe tolerancë ndërfaqetare. Ne si popull, edhe pse i përkasim tri besimeve fetare, nuk kemi pasur asnjëherë asnjë konflikt ndërfaqetar ndërmjet vetë” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Nga ana e saj, znj. Fiona Bruce, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe për angazhimin e tij dhe të institucionit që ai drejton për mbarëvajtjen e jetës fetare në Kosovë.

Gjatë këtij takimi po ashtu u diskutua edhe për Projektligjin për Liritë Fetare, si dhe për kontributin e bashkësive fetare për rehabilitimin e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM ZËVENDËSKRYETARIN E DIJANET-IT TË TURQISË, Z. KADIR DINÇ



Më 22 shkurt 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim zëvendëskryetarin e DIJANET-it të Turqisë, z. Kadir Dinç, i cili shoqërohej nga drejtori i Përgjithshëm i Administratës, z. Bunjamin Kahraman, shefi i Departamentit të Vendeve të Euro-Azisë, z. Salih Gör dhe nga atasheu për Çështje Fetare pranë Ambasadës së Turqisë, z. Bunjamin Albayrak.

Myftiu Tërnavë fillimisht i uroi mirëseardhje mysafirëve, e më pas i

njohu ata me punët dhe aktivitetet që zhvillon BIK-u. Ai shprehu falënderimet e tij për përkrahjen e vazhdueshme që ka pasur shteti turk dhe DIJANET-i për popullin e Kosovës në përgjithësi dhe për Bashkësinë Islame në veçanti. Myftiu potencoi faktin se kanë një bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë me DIJANET-in e Turqisë, e si kurorezim i këtij bashkëpunimi është edhe ndërtimi i Xhamisë Qendrore në Prishtinë, i cili po financohet nga DIJANET-i. Ai tha se bashkëpunimi i mirë që ka mbretëruar deri më tani

duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen, për çka shprehu gatishmërinë e tij dhe të institucionit që ai drejton.

Nga ana e tij, zëvendëskryetari z. Dinç, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen, duke përcjellë kështu edhe përsëndetjet e kryetarit të DIJANET-it, Ali ef. Erbash. Ai tha se ndihma dhe përkrahja për Bashkësinë Islame të Kosovës dhe për popullin e Kosovës do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM AMBASADORIN JOREZIDENT TË KATARIT, Z. JABOR ALI HUSSEIN AL HAWASHELA AL DOSARI



Më 23 shkurt 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim ambasadorin jorezident të shtetit të Katarit, z. Jabor Ali Hussein al Hawashela al Dosari.

Myftiu Tërnavë fillimisht i uroi mirëseardhje në institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës, duke i uruar kështu punë të mbarë dhe të suksesshme në misionin e tij. Ai më pas e njohu Al Dosarin me punët dhe

aktivitetet që zhvillon Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, duke potencuar kështu edhe bashkëpunimin e mirë që kanë me shtetin e Katarit në realizimin e shumë projekteve të përbashkëta. Myftiu Tërnavë përmes ambasadorit Al Dosari, shprehu falënderimet e sinqerta për ndihmën dhe përkrahjen e vazhdueshme që ka dhënë shteti i Katarit për popullin e Kosovës. Ai edhe njëherë shprehu gatishmërinë e tij dhe të institucionit të

BIK-ut për vazhdimin e bashkëpunimit të mirë që kanë me shtetin e Katarit, si dhe për intensifikimin e këtij bashkëpunimi edhe në projekte të tjera.

Nga ana e tij, ambasadori Al Dosari, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe njëkohësisht çmoi dhe vlerësoi lart kontributin e tij dhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës për mbarëvajtjen e jetës fetare në Kosovë.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM DREJTORIN E “QATAR CHARITY”, Z. ESAM DABAB



Më 1 shkurt 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim drejtorin e organizatës “Qatar Charity”, z. Esam Dabab.

Gjatë këtij takimi, Myftiu Tërnavë dhe drejtori Dabab, nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi, e cila ka për qëllim furnizimin me libra nga

“Qatar Charity” për bibliotekat e Bashkësisë Islame. Kjo bëhet me qëllim të mbështetjes së përpjekjeve të Bashkësisë Islame në përhapjen e njohurive dhe gjetjen e mënyrave që ndihmojnë mësime të mësimdhënës, imamët dhe predikuesit që të kenë qasje me lehtësi në informacionin që u nevojitet dhe të njëjtin ta bartin te të gjithë myslimanët në Kosovë.

Myftiu Tërnavë edhe njëherë shfrytëzoi rastin që të falënderoi organizatën “Qatar Charity” për bashkëpunimin e deritanishëm që kanë pasur me institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës, duke potencuar se edhe marrëveshja e sotme është në kuadër të këtij bashkëpunimi.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E KOMUNËS SË DRAGASHIT, Z. BEHXHET XHELADININ



Më 6 shkurt 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim kryetarin e Komunës së Dragashit, z. Behxhet Xheladinin.

Gjatë këtij takimi u diskutua për bashkëpunimin e mirë që ka Bashkësia Islame e Kosovës me Komunën

e Dragashit, për çka Myftiu Tërnavë, falënderoi kryetarin Xheladinin, si dhe shprehu gatishmërinë e tij dhe të BIK-ut që një bashkëpunim i tillë të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ndërkaq, kryetari Xheladini, fillimisht shfrytëzoi rastin që të uroi Myftiun Tërnavë për rizgjedhjen e tij

në krye të BIK-ut, si dhe më pas falënderoi atë dhe institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës për rolin e tyre të dhënë në procese të ndryshme që ka kaluar vendi.

U MBAJT TAKIMI PËRGATITËS PËR KRIJIMIN E “BIBLIOTEKËS FAMILJARE” TË BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS



Më 7 shkurt 2024, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, konkretisht Drejtorja për Veprimtari Botuese, mbajti një takim përgatitës për krijimin e “Bibliotekës familjare” të Bashkësisë Islame të Kosovës. Ky projekt do të përfshijë disa libroracakë tematikë për besimin dhe detyrimet kryesore të fesë islame. Këta libra do të përmbajnë elementet bazë të Islamit, të cilat duhet t'i njoh dhe t'i praktikojë një familje myslimane.

Drejtori për Veprimtari Botuese në Kryesinë e BIK-ut, Ramadan Shkodra,

tha se nëpër xhami janë vërejtur literaturë që nuk përkojnë me BIK-un.

“Prej punës në teren, prej vizitave nëpër xhami e nëpër objekte fetare, janë vërejtur literatura të ndryshme, të cilat kanë telashe të ndryshme, duke filluar nga gjuha e përdorur dhe deri tek ato botime që nuk përkojnë me atë çfarë prezanton Bashkësia Islame e Kosovës”, tha ai.

Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, tha se biblioteka e tillë do t'i përmbajë elementet bazë të fesë islame.

“Me botimin e librave të tillë, përveç se po kryejmë një obligim tonin, ne edhe po ruajmë besimtarët tonë, po ruajmë në këtë formë edhe pjesën më të rëndësishme të shoqërisë, po ruajmë rininë tonë nga interpretimet e ndryshme të fesë islame”, tha Myftiu Tërnavë.

Me realizimin e këtij projekti, pritet të shtohen edhe rreth 20 libra-doracakë tematikë, të cilat përmbajnë bazën e fesë islame.

KRYESIA E BIK-UT EMËROI KRYETARËT E KËSHILLAVE TË BI-SË

Më 14 shkurt 2024, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, ka mbajtur mbledhjen e rregullt të saj, të cilën e hapi dhe e kryesoi Myftiu Naim ef. Tërnavë.

Në këtë mbledhje, Kryesia në rend dite pati certifikimin e anëtarëve të Këshillave të BI-së, si dhe emërimin e kryetarëve të këtyre Këshillave. Pas certifikimit të anëtarëve, Kryesia vendosi që të emërojë këta kryetarë:

KBI – Prishtinë, Hetem Sopjani; KBI – Podujevë, Mensur Hoti; KBI – Fushë Kosovë, Valon Ibrahim; KBI – Obiliq, Rexhep Qerkezi; KBI – Lipjan, Zaim Baftiu; KBI – Drenas, Valon Bequku; KBI – Mitrovicë, Ekrem Avdiu; KBI – Vushtrri, Ejup Haziri; KBI – Skenderaj, Ibrahim Hoti; KBI – Pejë, Musli Arifaj; KBI – Deçan, Naser Tolaj; KBI – Klinë, Kadri Berisha; KBI – Istog, Abedin Haxhiaj; KBI – Gjakovë, Valon Myrta; KBI – Rahovec, Shani Sylka; KBI – Malishevë, Sead Paçarizi; KBI – Prizren,

Valon Ibrahim; KBI – Dragash, Driton Çengaj; KBI – Rajoni i Gorës, Munafis Hoxha; KBI – Suharekë, Haki Hoxha; KBI – Ferizaj, Nexhmedin Bajrami; KBI – Shtime, Skender Baftiu; KBI – Kaçanik, Fidaim Fazliu; KBI – Hani i Elezit, Musa Vila; KBI – Gjilan, Naim Aliu; KBI – Viti, Husamedin Hoxha; KBI – Kamenicë, Ferid Dermaku; KBI – Preshevë, Nexhmedin Ademi; KBI – Bujanoc, Sylejman Fejzullahu.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E KOMUNËS SË OBILIQIT, Z. XHAFER GASHIN



Më 15 shkurt 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim kryetarin e Komunës së Obiliqit, z. Xhafer Gashi.

Gjatë këtij takimi Myftiu Tërnavë dhe kryetari Gashi diskutuan për bashkëpunimin e mirë që kanë ndërmjet vete dy institucionet, Bashkësia

Islame e Kosovës dhe Komuna e Obiliqit, dhe për fushat në të cilat duhet që edhe më të intensifikohet bashkëpunimi, gjithnjë për të mirën e besimtarëve dhe qytetarëve tanë.

Kryetari Gashi çmoi dhe vlerësoi lart gatishmërinë për bashkëpunim të Myftiut Tërnavë dhe të Bashkësisë Islame të Kosovës. Gjithashtu,

kryetari gjatë këtij takimi i dhuroi Myftiut Tërnavë “Kokën Antropomorfe të Ritualit të Besimit Ilir, Periudha Antike (Enolitik)”, e zbuluar në fshatin Dardhishtë të Obiliqit, në vitin 2012, që simbolizon ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe historike të vendit tonë.

URIMI I MYFTIUT TËRNAVA PËR PËRVJETORIN E 16-TË TË PAVARËSISË SË KOSOVËS

Të dashur qytetarë,

Vëllezër e motra!

Më lejoni që me rastin e përvjetorit të 16-të të pavarësisë e shtetësisë së vendit tonë, t'ju uroj e t'ju përgëzoj, duke i dëshiruar kështu vendit e popullit tonë mirësi, zhvillim e konsolidim në radhët e shoqërive të lira, të drejta e demokratike.

17 Shkurti për popullin tonë është moment i veçantë, ngase pikërisht në këtë datë, më 2008, pas sakrificave të popullit tonë nëpër dekada, finalizuam e përjetuam pavarësinë e vendit tonë. Tani Kosova është rrëfim i suksesshëm, faktor stabilizues në rajon dhe vend i sigurt për të gjithë qytetarët e saj.

Në këtë përvjetor të veçantë, kujtojmë me respekt e pietet, të gjithë dëshmorët, martirët dhe aktivistët, të cilët u angazhuan e kontribuuan që të



jetësohet pavarësia e vendit tonë. Po ashtu, edhe njëherë çmojmë e kujtojmë kontributin e miqve dhe aleatëve tanë, të cilët mbështetën të drejtën tonë për liri, pavarësi e shtetësi.

Në këtë datë të shënuar për ne, edhe njëherë ju drejtohem me përgëzimet

më të mira, duke lutur Zotin e Madhëruar që të na japë mbarësi në shtetin tonë të lirë e sovran.

Myftiu i Kosovës,

Naim ef. Tërnavë

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E RRJETIT TË BIZNESEVE SHQIPTARE NË ZVICRËN QENDRORE, Z. FLORIM USEININ



Më 23 shkurt 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim kryetarin e Rrjetit të Bizneseve Shqiptare në Zvicrën Qendrore, z. Florim Useini.

Gjatë këtij takimi, Myftiu Tërnavë së bashku me z. Useini diskutuan për urat lidhëse për një bashkëpunim ndërmjet

dy institucioneve, Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Rrjetit të Bizneseve Shqiptare.

Myftiu Tërnavë e njohu me punët dhe aktivitetet që zhvillon Kryesia e BIK-ut, duke shprehur kështu një gatishmëri për një bashkëpunim të mirë me Rrjetin e Bizneseve Shqiptare.

Nga ana e tij, edhe z. Useini, e njohu Myftiun Tërnavë me aktivitetet dhe ecurinë e punëve të Rrjetit, si dhe për projektet madhore që priten të organizohen nga ky Rrjet në të ardhmen.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM DEPUTETEN, ZNJ. DUDA BALJE



Më 26 shkurt 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim deputeten e Parlamentit të Kosovës, znj. Duda Balje.

Gjatë këtij takimi u diskutua për shqetësimin e Myftiut Tërnavë dhe të institucionit të Bashkësisë Islame të

Kosovës, rreth ecurisë së miratimit të disa projektligjeve, e në veçanti miratimi i projektligjit për fertilizimin e asistuar, i cili kontribuon direkt në prishjen e institucionit të familjes.

Myftiu nuk la pa përmendur edhe takimin e përbashkët që kanë pasur edhe me prijësit e institucioneve të tjera

fetare në vend, me të cilët edhe ka nënshkruar deklaratën e përbashkët për kundërshtimin e projektligjit që lejon martesat e së njëjtës gjini.

Nga ana e saj, znj. Balje, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe për angazhimin e tij për një mirëqenie të të gjithëve.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM ANËTARIN E KËSHILLIT DREJTUES TË IHH-SË, Z. OSMAN ATALAY



Më 26 shkurt 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim anëtarin e Këshillit Drejtues të Fondacionit Humanitar për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut – IHH, z. Osman Atalay.

Në këtë takim, Myftiu Tërnavë, shfrytëzoi rastin që ta njoh mysafirin

me punët dhe aktivitetet që zhvillon Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, me theks të veçantë aktivitetet humanitare, të cilat zhvillohen në kuadër të Shoqatës Humanitare Bamirëse “Bereqeti”, që funksionon në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës. Ndër të tjera gjatë këtij takimi u diskutua edhe për format dhe

mundësitë e bashkëpunimit në fushën humanitare ndërmjet dy institucioneve.

Nga ana e tij, z. Atalay, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen, e më pas theksoi rëndësinë e bashkëpunimit me Bashkësinë Islame të Kosovës, aty ku është e nevojshme për një gjë të tillë.

KRYETARI I BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS, MYFTIU NAIM EF. TËRNAVA, KA TAKUAR SOT KRYETARËT E KËSHILLAVE TË BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS

Takimi filloi me leximin e një pjese nga Kurani fisnik, e më pas Myftiu Tërnavë, shfrytëzoi rastin që fillimisht t'i uronte kryetarët e këshillave, duke ju dëshiruar mbarësi dhe punë të suksesshme. Ai ua rikujtoi përgjegjësinë e organizimit të jetës fetare që kanë në këshillat ku ata udhëheqin, duke thënë

se amanetin të cilin e kemi marrë mbi supet tona, atë të kumtimit dhe të

shpjegimit të fjalës së të Madhit Zot, duhet ta çojmë në vend me nder e me përgjegjësi, ngase kështu na mësojnë fjalët e Kuranit fisnik dhe hadithet e Pejgamberit a.s..

Temë kryesore e këtij takimi ishte përgatitja për ardhjen e muajit të bekuar

Ramazan, ku nga kryetarët u kërkua që të kenë koordinim sa më të mirë ndërmjet Kryesisë, këshillave dhe imamëve rreth përgatitjeve dhe realizimit të aktiviteteve gjatë këtij muaji të bekuar. Myftiu Tërnavë në fund, porositi kryetarët, e nëpërmes tyre edhe imamët që gjithnjë të jenë sa më pranë xhematit.



KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS MBAJTI MBLEDHJEN E RREGULLT TË SAJ



Më 27 shkurt 2024, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, ka mbajtur mbledhjen e rregullt të saj, të cilën e hapi dhe e kryesoi kryetari i saj, Myftiu Naim ef. Tërnavë.

Kjo mbledhje u mbajt në prag të fillimit të muajit Ramazan, dhe si pikë kryesore të rendit të ditës së saj kishte parapërgatitjet për muajin e bekuar Ramazan.

Gjatë kësaj mbledhje po ashtu u shqyrtuan lëndë dhe u morën vendime në bazë të kompetencave të kësaj Kryesie.

BIK NËNSHKROI MARRËVESHJE ME QENDRËN “MBRETI SELMAN”

Më 6 shkurt 2024, Bashkësia Islame e Kosovës nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën për Humanizëm “Mbreti Selman” të Arabisë Saudite. Kjo marrëveshje ka për qëllim realizimin e shpërndarjes së mbi 8000 pakove ushqimore në të gjitha qendrat e Kosovës. Ky projekt do të realizohet nëpërmjet Shoqatës Humanitare Bamirëse “Bereqeti”, dhe pritet që të realizohet në prag të muajit të bekuar Ramazan.

Në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, këtë marrëveshje e nënshkroi shefi i kabinetit të Myftiut Tërnavë, Besim ef. Mehmeti, ndërsa në emër të



Qendrës “Mbreti Selman”, marrëveshjen e nënshkroi z. Fahad Albavardi.

Kjo marrëveshje është vazhdimësi e marrëveshjeve nga vitet e kaluara dhe

nga bashkëpunimi i Bashkësisë Islame të Kosovës me Qendrën “Mbreti Selman”.

DREJTORI SIMNICA PRITI NË TAKIM SHPËTIM SOLLOVËN

Më 5 shkurt 2024, drejtori për Diasporë i Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, ka pritur në takim anëtarin dhe aktivistin e xhamisë shqiptare në Toronto të Kanadasë, z. Shpëtim Sollovën.

Gjatë këtij takimi, drejtori Simnica, fillimisht i uroi mirëseardhje mysafirit, dhe shfrytëzoi rastin që ta njoh atë me ecurinë e punëve dhe zhvillimeve në Bashkësinë Islame të Kosovës, si dhe për bashkëpunimin që kanë me qendrat islame në diasporë. Ai edhe njëherë rikonfirmoi gatishmërinë e tij që të kenë edhe më tutje bashkëpunim në të gjitha fushat me rëndësi për besimtarët myslimanë.



Nga ana e tij, aktivisti Sollova, fillimisht falënderoi për pritjen dhe pas falënderoi drejtorin Simnica për bashkëpunimin e deritanishëm që ka pasur ai dhe institucioni i BIK-ut me qendrat islame në diasporë.

Që të dyja palët u pajtuan që edhe më tej të shtohet dhe të intensifikohet bashkëpunimi me xhaminë shqiptare në Kanada.

DEPARTAMENTI I GRUAS I BIK-UT SHËNOI 1 SHKURTIN, DITËN NDËRKOMBËTARE TË MBULESËS

Më 1 shkurt 2024, Departamenti i Gruas pranë Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës shënoi 1 Shkurtin, Ditën Ndërkombëtare të Mbulesës. Me këtë rast, në bashkëpunim me World Hijab Day Kosovo, u organizua një konferencë, që për qëllim kishte sensibilizimin, vetëdijesimin dhe ndërgjegjësimin e masës së gjerë se mbulesa është obligim nga Zoti.

Pjesë e këtij paneli ishin: Vaxhide Podvorica – Bunjaku, udhëheqëse e Departamentit të Gruas, Valbone Bytyqi – ambasadore e World Hijab Day Kosovo, Violeta Smajlaj – teologe, Valbone Sadiku – ekonomiste, Albulena Rrustemi – Kurti, psikologe dhe Rovena Tujani – Klinaku, avokate.



Algjeria hap zyrtarisht “Xhaminë më të Madhe”

Ditën e diel, më 25.02.2024, presidenti algjerian, Abdulmexhid Tebbun, përoroi “Xhaminë më të Madhe”, e cila është njëra prej xhamive më të mëdha në botë dhe më e madhja në Afrikë, me një sipërfaqe prej 200,000 m² dhe ka një kapacitet prej 120,000 besimtarësh. Minarja e saj arrin lartësinë rreth 265 metra.

Xhamia u ndërtua në gjirin e kryeqytetit, konkretisht në territorin e komunës Muhammedie, e cila gjatë kohës së kolonializmit francez quhej “La Verge”, sipas emrit të kardinalit Charles Marcial Allman La Verger, i cili ishte themelues i Shoqatës së Misionarëve në Algjeri.

Xhamia përfshin një sallë të madhe për faljen e namazeve, e cila është e mbuluar me qilima ngjyrë të kaltër bruz me dizajnë lulësh, sipas një karakteristike tradicionale vendas. Salla mbulon një sipërfaqe prej 20,000 m².

Përveç sallës së lutjeve, “Xhamia më e Madhe”, e njohur gjithashtu si “Xhamia e Algjerit”, përfshinë 12 objekte, në kuadër të të cilave janë një bibliotekë e cila përmban një milion ekzemplarë librash, një sallë konferencash, një muze të artit dhe historisë islame dhe një shkollë të lartë të shkencave islame për studentët e doktoratës.

Kostoja e ndërtimit të xhamisë, me të gjitha objektet e saj përcjellëse, ka arritur shumën e 898 milionë euro, sipas asaj që ka bërë të ditur ish-ministri i Financave, Ejmen ibën Abdurrahman.

XHAMIA MË E MADHE

Ndërtimi i “Xhamisë së Algjerit” filloi në vitin 2013 në kohën e ish-presidentit Abdulaziz Bouteflika. Në tetor të vitit 2020, presidenti Tebbun nuk pati mundësi ta bëjë përrurimin e sallës së faljes në xhami, për shkak të infektimit të tij me virusin Corona, kështu që, në emër të tij, përrurimin e kishte bërë kryeministri i atëhershëm Abdulaziz Xherrat.

Shtypi algjerian thonë se kjo xhami është xhamia e tretë më e madhe në botë pas dy Xhamive të Shenjta në Arabinë Saudite (Mekë dhe Medinë), ndërsa lartësia e minares së saj 265 metra, është më e larta në botë. Autoritetet vendore konfirmojnë se kjo xhami është një qendër shkencore dhe turistike.

Ndërtesa përfshin tre kate nëntokë me një sipërfaqe prej 180,000 m² të destinuar për parkimin e më shumë se 6,000 makinave. Dy salla konferencash me sipërfaqe prej 16,100 m², njëra me 1500 ulëse dhe tjetra me 300 ulëse, gjithashtu, përfshin një bibliotekë me 2000 ulëse dhe një sipërfaqe prej 21,800 m².

Që nga vendosja e gurthemelit të xhamisë në vitin 2011 nga ish-presidenti Abdulaziz Buteflika, media franceze dhe ato lokale nisën një fushatë të egër kundër këtij projektit, të cilit presidenti aktual Abdulmexhid Tebbun, i cili atëherë ishte ministër i Strehimit gjatë epokës së Buteflikas, iu kundërpërgjigj duke thënë se Ministria e tij ishte ngarkuar me mbikëqyrjen e këtij projektit.

Tebun, gjatë një konference për shtyp të mbajtur në vitin 2016, konsideroi se “një kompani franceze po nxit disa media franceze kundër Algjerisë pasi ajo dështoi të merrte përsipër projektin”, të cilin projekt e kishte fituar një kompani ndërtimi kineze.

Në prill të vitit 2023, Algjeria përjetoi polemika lidhur me mos hapjen e xhamisë për namazin e xhumasë dhe namazin e taravisë gjatë muajit Ramazan, pavarësisht asaj se pesë kohët e namazeve faleshin që nga viti 2020, kohën kur pandemia “Covid-19” u zhduk në një formë pothuajse plotësisht.

Në atë kohë, administrata e xhamisë, ia atribuoi shkaqet e saj për mos hapjen e xhamisë për namazet e xhumasë dhe teravisë për arsye teknike, dhe tha në një deklaratë se vonesa ishte për shkak të “pritjes për përfundimin e heqjes së rezervave teknike të regjistruara në objekte të ndryshme, me qëllim që të zgjerohen mundësitë në sallën e namazit.”

Përktheu: Vedat Shabani (Burimi: <https://www.aljazeera.net>)





Shoqata Humanitare Bëmirëse

“BEREQETI”

NË PRAG TË MUAJIT TË MADHËRUAR RAMAZAN,
ORGANIZON AKSIONIN TRADICIONAL

SOFRA E RAMAZANIT

04 - 18 MARS 2024

“Allahu e ndihmon robin e Vet
për sa kohë që robi është
në ndihmë të vëllait të vet”.

(Hadith)



Vlera për pako 40€

Kontribuo edhe ti në xhirollogarinë: OJQ SHOQATA BEREQETI,
Banka Ekonomike Sh.a. - IBAN: XK05140100000813233 - SWIFT Code (BIC): EKOMXXPRXXX,
me përshkrimin e donacionit: “SOFRA E RAMAZANIT 2024” .  paypal.me/bislame

Donacionet tuaja mund t'i dorëzoni edhe në këshillat e Bashkësisë Islame nëpër qytetet e Kosovës.

 Shoqata Humanitare Bëmirëse Bereqeti

 +383 38 224 024

 +383 44 261 121



DITURIA ISLAME • Nr. 400 MARS 2024